After approximately one week of work, it became clear that there is a relatively great variation between the manner in which the Israeli engineers assessed dwellings that were largely categorized as *capable of rehabilitation* (yellow or green signs), and buildings that were assessed by other foreign missions and categorized as unfit for use (red sign). In many buildings it was possible, by performing some simple renovation and removal of rubble, to return the population to the upper stories. The reason for the variation among the different engineers was investigated. It became clear that some of the local engineers, as well as some of the foreign engineers, hesitated to define buildings as safe for use before dangers are removed or a plan for renovation or rehabilitation is proposed. The variation may also be attributed to the fact that triage teams have no interest in a confrontation with civilians who, for various reasons, disagree with their approval, for instance their fear or lack of trust in the engineers' professional qualifications. Consequently, many buildings that are safe for use were declared unfit. We were also asked by civilians, "Would you return your children to a building that you just categorized as safe for use?" Our findings were presented to the Minister in charge, with our recommendation to rehabilitate these buildings and not to build new buildings in their place.

2. Integration of needs, "themap of pain"

In addition to assembling building triage data, we held field interviews, and the social media were monitored, in order to map civilian needs. The Israeli team combined with international aid centers and municipal offices to receive their activity data up to that point. After that, the team began to integrate the needs. Three days later a preliminary "map of pain" was prepared and presented to the Prime Minister when he visited the city. The "map of pain" pointed to the central focal points where the main engineering activity in building triage, and distribution of aid, food, and equipment, should be focused.

When the mission departed the integrated needs were mapped and presented to the decision-makers, with the addition of specific recommendations for focusing resources in the "painful" locations.

3. Monitoring moods

Analysis by technological tools (civilian / open) in monitoring social media (such as Facebook and Instagram) in cities damaged in the earthquake provided a sharper understanding of the main population needs. By these means, and with the assistance of in-depth interviews performed at the same time, a "blind spot" was discovered. No reports were received from distant rural areas (around Krujë), which are less exposed to technology, although that is an area where 15 people were killed when a building collapsed; and so no aid and triage forces were sent there. In addition, we discovered that in these rural areas there are ancient houses, in which no triage was performed, because of gaps in the proficiency of the triage engineers. As a consequence of these findings, contact was established with the National Academy, and triage activities were then also performed in these areas.

4. Aid in the emergency system

When the earthquake occurred, the emergency system of the local authority, and

even of the Albanian national government, did not function according to a predetermined plan. The government immediately appointed other people with authority to organize the assessment and rehabilitation activities. These new officials, headed by Mr. Bledar ("Bledi") Çuçi, fulfilled their official duties intelligently and displayed leadership. Within approximately five days a designated "Albanian" application was developed for building triage by a team set up by the Minister. This application makes possible transmitting data digitally from a cellular telephone directly to the central computer. The Israeli mission accompanied the new officials and assisted the Minister's team in organizing the activity plan. I believe that today Albania has an orderly plan for officials with defined areas of responsibility. That plan meets the requirements of the principle, "Whatever works in routine times – will work in an emergency."

5. National damage assessment

As mentioned above, the tool for assessment of economic damages is a product of Israeli development, and has been used thus far in several countries. In Albania, following reconnaissance of dozens of sites of destruction throughout the country and receiving a comprehensive picture of the types of damage, the team managing the disaster together with engineers from the Israeli mission developed an economic assessment of the damages caused by the disaster on a national level. This assessment was tested and examined in the physical rehabilitation of one apartment which the mission renovated in the city of Durrës.

The Israeli mission's assessment of economic damages pointed to a gap, compared with prior national assessments up to that point. The complete calculation was appended to the mission's summary report, and was adopted by the Prime Minister.

Activity results:

- The Israeli mission triaged 128 buildings, of which 67 are historical buildings for preservation and approximately 30 are public buildings. The mission also returned some 1,600 families to their homes. In addition, the mission provided 80 tents for the homeless.

- The Israeli mission assisted in determining rehabilitation principles, organizing knowledge, focusing on decisions that needed to be made, and issued an appraisal report for evaluating the extent of damages and the required expenses.

The main recommendations that the Israeli mission left for the government were: advancing and developing a digital format for the building triage system; in-depth training of local engineers for the task of building triage; defining permanent official positions for managing emergency situations; preparedness already in the initial stages after an earthquake for building rehabilitation on different levels.

6. Summary

The greater a country's level of knowledge and preparedness for dealing with a widespread disaster, the more it will have the independence to manage the disaster effectively and professionally when it occurs.

In this article I surveyed the main points of the Israeli concept for managing the Supplementary Stage of a national disaster, a stage critical for preservation of functional continuity and the national resilience. I pointed out the daily aspects and challenges of various areas in which preparedness in advance of a disaster is required, and I dealt with the challenges and insights with which the Israeli mission in Albania dealt.

AKADEMIA
E SIGURISË

Konferencë
shkencore
ndërkombëtare:

« Fenomenet
ekstreme
të natyrës
dhe çështjet
e sigurisë »

Let me add that the Israeli mission is grateful for the honor of helping the Albanian nation in this difficult hour, and of supporting the decision-makers and teams working in the city.

Even more than the professional aid the Israeli mission provided, its activity represented an expression of the solidarity of State of Israel, the Israel Defense Forces, and the Home Front Command, with Albania, its citizens and leaders. I hope that the cooperation of our countries will continue in building the countries' national resilience, the welfare of their citizens in routine times, and saving life in emergencies.



AKADEMIA E SIGURISË

*Konferencë
shkencore
ndërkombëtare:*

**« Fenomenet
ekstreme
të natyrës
dhe çështjet
e sigurisë »**

Përmbytjet në Shqipëri, faktor ekstrem kërcënues i sigurisë



■ **Prof. Asc. Dr. Zaho GOLEMI**
Shef i sektorit të kërkimit shkencor,
QKSH, Akademia e Sigurisë
zaho.golemi@asp.gov.al

Abstrakt

Përmbytjet janë fenomene bashkëshoqëruese të njerëzimit, që shkaktojnë dëme e probleme të konsiderueshme njerëzimit deri në katastrofike, me pasoja të rënda ekonomike, sociale dhe ekologjike, e për rrjedhojë kërcënon sigurinë kombëtare të shteteve. Gjiganti motorik "Google" i përmend përmbytjet/"flood"¹, 96 milionë herë, mjaft i përdorshëm dhe i pakrahasueshëm me të tjerë terma në botë. Nuk është vetëm termi që mbart brenda kërcënime reale për sigurinë e komuniteteve njerëzore në mbarë planetin. Reflektimi ndaj përmbytjeve kap një spektër të gjerë kur perceptohet drejtë, ku lidhen e përfshihen gjerësisht shtete, grupshtete, struktura gjeopolitike e gjeostrategjike, politikanë, shtetarë, specialistë të fushave të shumta që i mbledh rreth vetes detyrimi reflektues për të "bërë zap" në formatin e disiplinës shkencore, profesionalisht dhe financiarisht. Përmbytjet kanë qenë ndër të para sfida që është përballur njerëzimi. Mjaft vende që përmbytjet/"flood", i kanë "dhuratë" natyre, kanë ditur të gjejnë rrugëzgjidhjet afatshkurtra, afatmesme dhe afatgjata. Në fakt ka dhe vende që kanë krijuar aty ku nuk ka pasur, lumenj e liqene artificiale, duke konkurruar me natyrën sikurse ka edhe vende që i ka mposhtur natyra me shpërthimet e "luftës ujore". Shqipëria sikurse vendet rajonale dhe europiane, por dhe më gjerë po ecën në rrugë të shkelura, duke braktisur "rrugët e pashkelura", edhe në përballje me përmbytjet. Bazuar në "...Raportin e rrezikut botëror të Universitetit të Kombeve të Bashkuara, Shqipëria zuri vendin e parë në Europë për ekspozimin ndaj fatkeqësive natyrore². Shqipëria renditet e para në Evropë, për 2019-ën, dhe e 61-të në botë për ekspozim veçanërisht për përmbytjet dhe tërmetet (UNDRR)³. Përmbytjet janë fenomeni i lashtë natyror që ka sjellë në vëmendje të çdo niveli të pushtetit qendror apo lokal, të komunitetit, të segmenteve shtetërore dhe posaçërisht të komunitetit shkencor për të gjetur rrugë, mjete e mënyra që fjala përmbytje/"flood", të minimizohet dhe përdoret gjithnjë e më pak, falë nismave legislative, politikave, strategjive, mbështetjes së fuqishme buxhetore që lumenjtë të "shtrohen" e disiplinohen, duke eliminuar vërshimet e padisiplinuar të ujërave. Parandalimi i përmbytjeve është një problematikë më pak për vetë komunitetin e "mbjellë" buzë lumenjve e liqeneve si dhe një lehtësim për strukturat e emergjencave civile, të Policisë së Shtetit, të Forcave të Armatosura, që gjenden jo rrallë në vorbullën e "luftës me ujërat", si detyrim misionar shtetëror dhe si detyrim moral e njerëzor. Hedhja dritë në këtë punim për fenomenin ekstrem natyror të përmbytjeve do jetë fokusi i "Përmbytjeve në Shqipëri faktor ekstrem kërcënues i sigurisë".

Fjalëkyçe:

përmbytje, diga, lumenj, reshje, bllokim, siguri, pasiguri, legjislacion, fenomen natyror, politika, strategji, sasi vjetore e shirave, evakuim, mbështetje policore.

1. Metodologjia

Kjo temë është paraqitur duke e konceptuar si një prej fenomeneve më të njohur të natyrës, që ka vepruar në nivele të ndryshme dhe me një shtrirje masive. Lidhja e fenomenit “përmytje” si një fenomen katastrofe natyrore është parë si në planin historik ashtu edhe atë praktik, por që lidhet ngushtë me sigurinë komunitare dhe me sigurinë kombëtare. Modeli i përdorur ka sjellë të detajuar aktorë e faktorë që kanë çuar, vijnë të çojnë dhe që edhe në të ardhmen parashikohen të vijnë e të kenë ndikim në jetën komunitare. Nga ana tjetër masat juridike, politikat, strategjitë dhe buxhetet për ndërtimin e projekteve dhe veprave hidrike, të destinuara për të minimizuar fenomenet dhe katastrofat natyrore të natyrës së përmytjeve, por dhe ndryshimeve mjedisore lidhen drejtpërsëdrejti me çështjet e sigurisë.

Kontributi i strukturave dhe segmenteve shtetërore në frenimin e fenomenit “përmytje” është kontribut në sigurinë njerëzore dhe që detyrimsht mund e duhet të çojë në lehtësimin e konfliktit, kërcënimit dhe luftës që individët apo grupim individësh kanë me natyrën, nga ku formatohet dhe krijon vartësi marrëdhënia midis komuniteteve të përmytura, faktorëve socio-ekonomikë, qasjeve institucionale vendore dhe qendrore.

Metodologjia e ndërtimit të punimit pas analizës e fakteve e të dhënave gjen kulmet e saj me përfundimet dhe rekomandimet, duke i parë problemet e përmytjeve jo si një “ligjësi” e natyrës, por si një zgjidhje e papërfunduar, duke prekur të djeshmen, të sotmen dhe zgjidhjeve të mundshme të së nesërme, të pranueshme dhe të besueshme,

¹ <https://www.thefreedictionary.com/flood>.

² WorldRiskReport 2019. https://reliefweb.int/sites/reliefweb.int/files/resources/WorldRiskReport-2019_Online_english.pdf

³ The United Nations Office for Disaster Risk Reduction (UNDRR).

që koha do t'i vërtetojë. Është kjo arsyeja që fenomeni “përmbytje” përballë së nesërme, kërkon një trupë menaxheriale edhe për çështjet e sigurisë komunitare dhe kombëtare, që njeriu të hyjë në “marrëveshje” me natyrën me qëllim që lumenjtë, vërshimet dhe përmbytjet të mundësohen që të disiplinohen.

1. Përmbytjet, një fenomen i përbotshëm dhe i përsëritshëm i natyrës

Analiza e fenomenit “përmbytje”, këtij ekstremi të natyrës, kërkon “thirrjen” për ndihmë të studimeve të shkencëtarëve shqiptarë dhe jo vetëm, të atyre që ngritën diga e hidrovorë, që vunë nën kontroll ujërat, i disiplinuan ujërat e shekujve të harbuar nga prurjet, ata që jetën e shkrinë që komuniteti dhe siguria publike të ishte në stadin e përparësive, ata që ja lehtësuan detyrën policisë, ushtrisë dhe strukturave të pushtetit vendor e qendror. Analiza do të ishte e paplotë pa aktorët e faktorët që studiuuan, projektuan, zbatuan dhe hoqën në “kurriz” telashin e përmbytjeve shqiptare, atyre që njohën thellë historikun e detajuar të përmbytjeve shqiptare e rajonale deri në kufijtë ekstremë nga rrjedhin lumenj, përrenj e rrëqe përtej hapësirës që dikur fliste shqip në 105 km², (ndërsa sot nën Shqipërinë “londineze”⁴), për ata që e kanë parë përmbytjen si “fenomen ekstrem, që mund e duhet të disiplinohet”. Kjo për faktin se mbi këtë planet “ligjin” nuk e bën natyra, nuk dikton natyra dhe nuk e ka pushtetin natyra, por njerëzimi, njerëzit me dijet dhe përvojat njerëzore të mbledhura dora-dorës, shekujve e qytetërimeve. Njerëzit diktuan vendndërtimet, vendpritat, kanalizimet, disiplinimet e ujërave, nga lartësitë e maleve në lindje e që përfundojnë me grykëderdhjet e lumenjve në detin Adriatik dhe Jon. Tradita shqiptare e krijuar si rezultat i investimeve dhe përvojave të fituara ndër vite, pas viteve ‘90-të me “ridimensionimin e instituteve dhe mendimit të “vjetër” bëri që të rinjtë “nuk mundën as ta marrin, as ta blejnë dhe as ta trashëgojnë” përvojën e dekadave.

Prandaj specialistët e instituteve janë pasuri kombëtare intelektuale e tekniko-shkencore sepse studim projektimet në spontanitet krijojnë natyrshëm mosfunksionim të përballjes ndaj fenomeneve kërcënuese të natyrës, veçanërisht kur bëhet fjalë për përmbytjet. Vende të përparuara i kanë klasifikuar studimet për përballimin e fenomeneve ekstreme të natyrës si nevojë e përhershme dhe shumë prestigjioze për bonifikimet, që amerikanët e kanë të atashuar në Departamentin Amerikan të Mbrojtjes, edhe pse aktiviteti i saj është shërbim ndaj komunitetit. Por fuqitë ekonomike, ushtarake, dhe gjithë zhvillimi i një vendi mbështetet fuqishëm në shkencë. Nuk është nevoja për të shkëlur në rrugë të pashkelura, ndërkohë që eksperiencat janë të shumta në lindje dhe në perëndim. Imitimi nuk është dhe nuk mund të jetë i gabuar, por gjithmonë në varësi me kushtet konkrete të vendit. Përvojat nuk vijnë vetëm nga të mëdhenjtë e ekonomive botërore, por edhe nga europianë dhe fqinjë rajonalë si Bullgaria, Kroacia, Maqedonia e Veriut, Kosova, të cilat shërbimet e mbrojtjes nga fenomenet ekstreme të natyrës i kanë të mirëorganizuara.

Edhe pse është e ridimensionuar dhe ristrukturuar me një departament për “Klimën dhe Mjedisin”⁵ përmbytjet në Shqipëri nuk janë ndalur. Janë një sërë aktorësh e faktorësh ja e bën të vështirë disiplinimin e ujërave në Shqipëri. Ende nuk ka mundur të japë

⁴ Shqipëria londineze është 28748 km² me 2,9 milion banorë, përllogaritet e 1.1.2015, sipas INSTAT, më 13 nëntor 2015

⁵ Departamenti i Klimës dhe Mjedisit në IGJEUM (sipas <https://www.geo.edu.al/neëëeb>).

zgjidhjet IGJEUM,⁶ dhe kjo në radhë të parë për fonde financiare të pamjaftueshme, për politika e strategji, për projekte që presin ose nuk kanë dalë akoma nga “inkubatori projektues”. Detyrat institucionale është që të japë zgjidhje teorike sipas përcaktimit të detyrave se: “Studimi dhe vlerësimi i burimeve natyrore të vendit për sa i përket burimeve nëntokësore minerale, energjetike dhe atyre ujore” dhe “Realizimi i kërkimit shkencor në fushën e rreziqeve natyrore si dhe të atyre të krijuara nga aktiviteti i njeriut (rreshqitje, erozion, përmbytje, ndotje e mjedisit etj.)”, duke ofruar të dhëna në kohë reale për vendimmarrësit dhe opinionin e gjerë mbi përmbytjet në Shqipëri, edhe pse kjo është një “pëmë”, që nuk pritet me një të rënë të sëpatës”, çka është vërtetuar nga koha. Duke lënë mënjanë spektrin e diskutimeve legislative, përfshi dhe “teatrin” e debatit politik e parlamentar, pikëpamjet që mohojnë çdo gjë të së djeshmes në pikëpamjet e gjykimit të ftohtë e arsyeshme do të ishte analiza përmes fakteve, në lidhje me përmbytjet në Shqipëri. Ndërkohë që rreziqet dhe katastrofat e natyrës mund të jenë të shumta si përmbytje, zjarre, orteke, rreshqitje dherash e gurësh, stuhi rëre, temperatura ekstreme e valë të nxehtit, tornado, stuhi breshëri e dëbore, pandemi sikurse është aktualisht, që ka përfshirë mbarë botën etj.

Fenomeni “përmbytje” në planin praktik në Shqipëri shkon përtej teorizimit. Le të analizojmë fenomenin “përmbytje” shqiptare. Në bazë të të dhënave Shqipëria disponon 280 mijë ha toka bujqësore fushore dhe në total të gjitha hapësirës administrative shqiptare rreth 11% të tokave. Fakt është se rreth 250 mijë ha janë trajtuar me vepra bonifikimi. Rreth 50 mijë ha është përfituar tokë e re dhe rreth 200 mijë ha janë përmirësuar. Por vendi ynë në Ultësirën Perëndimore në disa raste ka toka nën nivelin e detit, ku kullimi kryhet me ngritje mekanike nëpërmjet hidrovoreve⁷.

“Zonat problematike” ose “hartat e përmbytjeve” në Shqipëri tashmë janë të njohura në veri dhe në jug të vendit. Në dekada lumenjtë në Shqipëri kanë “zgjedhur” zonat problematike të përmbytjeve dhe ndër to një vend të posaçëm në vëmendjen e inxhinierëve dhe rrjetit institucional përgjegjës për eliminimin e pasojave nga përmbytjet. Politika, strategji, projekte kanë marrë e marrin në shqyrtim prurjet dhe ujëmbledhësit që vijnë nga lumenjtë Drin, Buna, Vjosa, Devoll, Shkumbin, etj. Ka zona që fillojnë shtrihen në territorin shqiptar, sikurse ka edhe të tilla që shkaktarë janë reshjet me intensitet të lartë si dhe kur ato reshje shoqërohen me shtresë të madhe dëbore, krijojnë një volum të madh uji, e për rrjedhojë prurjet e madhe të lumenjve sjellin përmbytje të tokave bujqësore, të zonave të banuara dhe të bizneseve e gjësë së gjallë.

Në këto raste hyjnë në veprim shtabet e emergjencave, ushtria, policia, struktura e pushtetit, specialistët që studiojnë, projektojnë e ndërtojnë vepra, që sipas kushteve, mund të përmirësojnë gjendjen dhe sipërfaqen e përmbytur, që uji të mos qëndrojë 7 ditë mbi të por 3 ose 4 ditë, ose që thellësia e ujit të jetë sa më e vogël. Prurjet e shirave, pellgjet shimbledhës, niveli i tyre, statistikën, çdo e dhënë historike për prurjet e reshjeve, kohëzgjatja janë objekt i vijueshëm për tejkalimin e situatës. Kështu, të dhënat flasin se lumi Buna sjell rreth 1300-400 m³/sek ujë, ndërsa lumi Drini kanë arritur 6000-7000 m³/sek⁸. Bonifikimi i Talës në Lezhë, Thumanës në Krujë, Hoxharës në Fier, Maliqit në Korçë etj, kanë qenë pjesë e të shkuarës së ndërmarrjeve të bonifikimit në çdo rreth të

**AKADEMIA
E SIGURISË**

*Konferencë
shkencore
ndërkombëtare:*

« Fenomenet
ekstreme
të natyrës
dhe çështjet
e sigurisë »

⁶ Instituti i Gjeoshkencave, Energjisë, Ujit dhe Mjedisit - njësi kombëtare kërkimore shkencore që vepron nën ombrellën e Universitetit Politeknik të Tiranës. Nga pikëpamja organizative është hartuar në 5 departamente kryesore, secila prej tyre përmban deri në tre njësi kërkimore. Këto departamente janë: Departamenti i Klimës dhe Mjedisit, Departamenti i Gjeologjisë, Departamenti i Sizmologjisë dhe Departamenti i Ekonomisë së Ujrave.

⁷ Shqipëria disponon 31 hidrovore me kapacitet nga 2 m³/sek më i vogël, në 70 m³/sek më i madh.

⁸ Prof. Dr. Perikli Qiriaz, “Përse janë shtuar përmbytjet në Shqipëri”, Gazeta Panorama, 22.1.2021. faqe 3.

vendit. Por vëmendja ndaj tyre është që ato mos të rikthehen sërish në vatra kënetore. Nga ana tjetër veprat ujitëse fillimisht që merrnin ujë nga lumenjtë e përrënjtë, krijuan 650 rezervuarë me një rrjet ujitës 25 mijë km, të cilët së bashku me kanalet me rrjedhje të lirë siguronin për ujitje të tokave bujqësore rreth 2 miliard m³ ujë, me të cilën ujiteshin çdo vit rreth 350 mijë ha, që përfaqësojnë 65-70% të tokës në kulturë që ka Shqipëria. Fakt është se ndërtimi dhe projektimi i veprave të kullimit dhe ujitjes u realizua nga specialistët shqiptarë të inkuadruar në Institutin e Studimit e të Projektimit të Veprave të Kullimit dhe Ujitjes dhe më gjerë, edhe sipas përvojave ruse e kineze, por bazë ka qenë personeli inxhiniero-teknik⁹ në studimin, projektimin e ndërtimin e këtyre veprave, që i rezistuan kohës.

Nëse vëzhgojmë mendimin e specialistëve, përmbytet më të mëdha në vendin tonë kanë një historik të detajuar, siç janë ato “në dimrin e viteve 1962-1963 në Ultësirën Perëndimore; përmbytet e fundvitit 1970 dhe të fillimvitit 1971; të viteve 2009–2010, 2011, dhjetor 2017, mars 2018 në rajonin e Shkodrës; e shkurtit 2015 nga Vjosa dhe Drino, nga Semani, Zeza etj., e janarit 2016 nga Shkumbini, dhjetor 2017 dhe shkurtit 2018 nga Vjosa e Semani, që u shoqëruan me dëme ekonomike jashtëzakonisht të mëdha që shkojnë në miliona euro, probleme të mëdha sociale, mjedisore, ekologjike afatgjata; rrezikuan jetë njerëzish etj”¹⁰. Nuk ka përmbytje në Shqipëri që nuk vë në lëvizje shtetin FA-në, Policinë e Shtetit, strukturat vendore e qendrore. Por nga ana tjetër investimet që janë realizuar në Shqipëri për fenomenin e përmbytjes nuk i kalon milionat që bëhen dëme çdo vit dhe pikërisht këtu është paradoksi në investime, që meriton vëmendje. Studimet e projektimet mbi disiplinimin e ujërave në vendin tonë ose u injoruan, ose u neglizhuan, ose nuk u zbatuan plotësisht standardi i projekteve duke lënë problemet të pazgjidhura. Shqipëria nuk ka mundur të shmangë përmbytjet e reshjeve të shiut e vërshimet e lumenjve, ndërkohë që të dhënat hidrike dhe meteorologjike për lumenjtë kryesorë janë të njohura dhe të dokumentuara. Lumenj që përshkojnë vendin tonë nga lindja në perëndim përlllogaritur sipas mesatares së prurjeve shumëvjeçare të ujit janë rreth 238.5 m³ ujë në sekondë¹¹. Nga ana tjetër Shqipëria në krahasim me shtetet e tjera të botës zë një vend me rreth 11% të sipërfaqes së tokës të punueshme,¹² që njëherazi është edhe toka e përmbytshme e Ultësirës Perëndimore shqiptare.

Bota vijon të jetë e kërcënuar nga katastrofat e veçanërisht nga përmbytjet edhe në vitin 2021. Faqja zyrtare e UNDRR-së shkruan: “Bota po humbet terren në betejën për të zvogëluar humbjet nga katastrofat.”¹³. Në këta aspekt edhe Shqipëria nuk bën përjashtim sepse është pjesë e pashmangshme e përballjes me rreziqet që vijnë nga faktorët ekstremë të natyrës. Në gjithë këndshikimet me qëllim që përmbytjet mos të ngelen një fenomen i përsëritshëm, dhe shteti mos të harxhojë energji, forca, mjete, buxhete të shumta është domosdoshmëri plan kombëtar serioz në investime me afate

⁹ Projektuesit e ndërtuesit e veprave hidrike shqiptare janë: Inxhinierët Farudin Nuri, Miçe Veshi, Iljaz Cerga, Ilia Plasa, Murat Klosi, Zef Rakacolli, Kujtim Kadriu, Nezir Nota, Agim Basha, Ismet Teli, Stavri Naço, Dod Doçi etj.

¹⁰ Prof. Dr. Perikli Qiriaz, Përse janë shtuar përmbytjet në Shqipëri, Gazeta Panorama, 22.1.2021, faqe 4.

¹¹ Përlllogaritja është bërë për lumenjtë Buna-44 km i gjatë, me 652 m³/sekondë; Drini - 285 km i gjatë, me 340 m³/sekondë; Vjosa - 272 km i gjatë, me 210 m³/sekondë; Semani - 281 km i gjatë, me 95 m³ ujë në sekondë; Mati - 115 km i gjatë, me 74 m³/sekondë; Shkumbini - 181 km i gjatë, me 60 m³/sekondë. Por prurjet rekord për lumin Drinin mund të shkojnë edhe përtej parashikimeve në m³/sekondë.

¹² Ramiz Fiçori, Fatkeqësitë e natyrës dhe mbrojtja prej tyre, Tiranë, 2016, faqe 73.

¹³ Sipas deklaratës që evidenton gjashtë vjetorin e Kornizës Sendai për Reduktimin e Rrezikut nga Katastrofa (2015-2030), nga Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm të KB për Reduktimin e Rrezikut nga Katastrofa, Mami Mizutori. <https://www.undrr.org/news/sendai-framework>.

me studime të mirëfillta inxhinierike hidroteknike strategjike me qëllim që të “harrohen” dëmet e përvitshme të përmbytjeve në Shqipëri si dhe menaxhimi i situatës të jetë plotësisht i standardizuar.

2. Përmbytjet që “përzunë” civilizimet (“Spinarica”, qytet-porti në grykëderdhjen Vjosës, fqinj i Apolonisë, që e përmbytën prurjet ujore)

Kulturat dhe civilizimet lindën luginave të lumenjve të mëdhenj dhe patën specifika të civilizimeve dhe besimeve të popujve. Edhe në Shqipëri sikurse qytetërimet e egiptianëve, sumerëve, babilonasit etj., zhvillime të vrullshme morën anëdetëve, liqeneve dhe luginave të lumenjve. Bashkë me zhvillimet pati edhe faktorë natyrorë si përmbytjet që “sulmonin” njerëzimin, për rrjedhojë edhe vendin tonë. Duke e parë problemin në fokus historik, janë të përmendura, përmbytjet në qendra të zhvilluara të ekonomisë si Durrësi, Lezha, Shkodra, Apolonia, Vlora etj. Por krahas këtyre qyteteve pati edhe zhvillime të vrullshme të tregtisë dhe u ngrit buzë detit, por edhe buzë lumit Aaos (Vjosa). Edhe pse ka kaluar një periudhë e gjatë që qyteti i zhdukur në grykëderdhje të Vjosës, dëshmitë dhe të dhënat vijojnë të tregojnë. Bashkë me zhvillimin një frikë e përhershme qëndronte që në lashtësi përballë fenomeneve të dhunshme të ekstremit natyror, që jo gjithmonë mundnin që t’i shpjegonin si fenomenet e përmbytjeve, tërmete, zjarre, orteke, rrëshqitjeve etj., dhe kur nuk gjenin shpjegim ja atribuonin “fuqisë së mbinatyrshme”, “hyjnive”, “zotave”, etj.

Me kalimin e viteve, dekadave e shekujve shkenca munda të kristalizojë dhe shpjegojë çdo fenomen natyror. Një studim i Universitetit të Teknologjisë së Vjenës (TU Wien), bashkë me Universitetin e Barcelonës, tregon që modeli i përmbytjeve gjatë dekadave të fundit në Evropë ka ndryshuar në krahasim me shekujt e kaluar. Studimi, flet për “një nga periudhat më të pasura me përmbytje në Evropë nga pesëqind vitet e fundit”. Madhësinë e përmbytjeve në Evropë ka ardhur në rritje. Nga viti 1500 deri në vitin 1900, përmbytjet zhvilloheshin më shumë në dimër, ndërsa pas vitit 1990, përmbytjet u rritën në kontekstin e ngrohjes globale. Kanë qenë disa periudha të prekshme¹⁴. Aktualisht përmbytjet shkaktojnë dëme vjetore që përbëjnë më shumë se 100 000 milionë euro, me tendencë të përmbytjeve në rritje.

Edhe Shqipëria sikurse europianët dhe ballkanasit ka qenë pjesë e rrjetëzimit europian të përmbytjeve të “hartës ballkanike dhe europiane” të përmbytjeve¹⁵. Rrjedhojat e përmbytjeve nëpër shekuj në Shqipëri kanë sjellë mjaft pasiguri e kërcënim nga reshjet me prurje të paparashikuara. Përmbytjet kanë vijuar shekujve edhe kur ndryshuan pushtuesit, drejtuesit, format e shtetit, aleancat, teknologjitë, politikat, strategjitë. Në kushtet kur vendi tonë është ndër vendet me më pak tokë bujqësore për frymë të popullsisë në Europë¹⁶, kujdesi për përmbytjet është më se legjitim. Në dekada dhe shekuj vendi ka pasur humbje kolosale në njerëz, në prona, në tokë bujqësore e deri në humbjen dhe braktisjen e një qyteti të tërë sikurse ishte qyteti “Spinarica” qytet mesjetar

¹⁴ Nga 1560-1580 (Evropa perëndimore dhe qendrore), 1760-1800 (pjesa më e madhe e Evropës), 1840-1870 (Evropa perëndimore dhe jugore) dhe 1990-2016 (Evropa perëndimore dhe qendrore). <https://www.heritagedaily.com/2020/07/study-analyses-500-years-of-floods-in-europe>

¹⁵ Po aty.

¹⁶ Zvicra ka 600 m²/banor, Shqipëria 1300 m²/banor, Franca 3300 m²/banor, Greqia 3800 m²/banor, Bullgaria 4000 m²/banor, SHBA 6300 m²/banor, etj. (sipas të dhënave inxhinierike të studimeve të tokave)

me rëndësi në bregdetin e Adriatikut, ku edhe sot ka një kishë e stilit bizantin. Spinarica kaloi nga sundimi i Bizantit nën Venedikun, hohenshtaufët, Anzhiuniët dhe ishte pjesë e Despotatit të Vlorës. Qyteti “Spinarica”¹⁷ pati një veprimtari të gjallë tregtare (drithëra, kripë, hekur, sende ushqimore, drurë, mëndafsh, prodhime luksi), veçanërisht ky qytet “jetoi” midis viteve 1205-1370. Qyteti lindi si nevojë e zhvillimit ekonomik e sidomos e tregtisë me tregjet detare dhe u shua si pasojë e përmytjeve masive të përvitshme.

Rreth vitit 1370 qyteza u braktis nga tregtarët, peshkatarët, artizanët që u zhvendosën drejt Vlorës. Gurët e kështjellës, bankinave, magazinave dhe banesave u morën prej banorëve të vendbanimeve fqinje për t’u përdorur si material ndërtimi. Për herë të parë emri “Spinarica” ndeshet nga vendasit në mesin e shekullit të XIX, peshkopi i Mitropolisë së Beratit, Anthim Aleksudhi (1855-1887).

Në librin e tij “Përshkrim i shkurtër historik i mitropolisë së shenjtë të Beratit”, botuar në Korfuz në vitin 1868, tek kapitulli “Shënime për Apoloninë të Epirit të Ri”, ku shkruhet: “...jo shumë larg ku derdhet sot (Vjosa) nga ana e vendit të quajtur Laçani (udhëshenja demonësh-djajsh) ku ndodhet një kështjellë e vjetër që ndofta u nevojitej banorëve të Apolonisë”¹⁸. Aristotel Mici shkruan: “sipas rrëfimeve gojëdhane të peshkatarëve e të barinjve, njerëzit në ato kohëra i lanë shtëpitë, i braktisën nga shkaku i shejtanëve të tmerrshëm, që dilnin nga deti, që quheshin Laço. Nga ky emër i “Laçove” vendi u quajt Laçanë, kurora e lumi atje u quajt kurora e Laçanit dhe kisha Shën e Premtja në Laçanë”¹⁹. Në burime të huaja gjejmë se, “...u formua Spinarica e kohëve të mesme mbi lumin e Vjosës...”²⁰.

Ndërkohë që historiani P. Xhufi referuar ngjarjeve mesjetare gjykon se: “në Spinaricë duhet të kishte një kantier ndërtimi anijesh”,²¹ referencë që bazohet në zhvillimet e qytetit bregdetar dhe në anë lumit. Dhe më tej: “Spinarica ishte porti kryesor ku evadoheshin produktet e Despotatit të Beratit në drejtim të Venedikut dhe Raguzës, ku shfaqej si një treg shtetëror i këtij Despotati”²². Pavarësisht shumë hipotezave mund të nxjerrim përfundimin se “Shën e Premtja” ka ngelur në “këmbë”, për të dëshmuar historinë e vendndodhjes së Spinaricës mesjetare, qytet-portit, tashmë të zhdukur nga përmytjet në Adriatikon jugor. Por në fakt nga shumë të dhëna të tjera të autorëve të shumtë autorëve të shumtë²³ vërtetohet se shkaku i parë dhe themelor i braktisjes së një qyteti të tërë ka qenë “përmytja” nga lumi Vjosa e “ndihmuar” nga dallgëzim i fuqishëm deti. Por, si ky rast ka edhe të tjerë që shekujt ose e kanë fshirë, ose e kanë mbuluar me mister.

Për një periudhë të gjatë kohore veçanërisht atë të pushtimit osman, shqiptarët e vetëmbrojtën nga përmytjet për arsye se qendra e sultanatit “ishte larg” dhe mbështetja buxhetore zor se arrinte deri tek veprat e digat mbrojtëse nga përmytjet. Për këtë u gjet “zgjidhja” e përzgjedhjes së vendbanimeve si dhe aktivitetit tjetër jashtë zonës së rrezikshme të përmytjeve, një zgjidhje që jua kishte treguar eksperiencia jetësore e

¹⁷ Gjika-Canaj, Debati mbi lumin e Vjosës. Ku ndodhej Spinarica mesjetare, Standard, 11 qershor 2014.

¹⁸ Anthimos D. Alexoudes, Syntonos Historike Perigrafe Tes Hieras Metropoles Belegradon, Ionia, Kerkyra 1868, f. 42. Referuar sipas “Java nëës”, Ilirjan Gjika “Spinarica! Të dhëna të reja rreth vendndodhjes së qytetit-port”, 22.12.2019.

¹⁹ Aristotel Mici, “Rreth Portit të Mundshëm Detar të Apolonisë”, Dielli, 16 gusht 2014.

²⁰ Milan Shufilaj, Serbët dhe Shqiptarët”, Shtëpia botuese “Bargjini”, Tiranë, 2001, faqe 82.

²¹ Pëllumb Xhufi, Dilemat e Arbërit, SHB Pegi, Tiranë, 2006, Faqe 186.

²² Pëllumb Xhufi, “Nga Paleologët tek Muzakajt”, Tiranë 2009, faqe 35-36.

²³ Autorë që kanë shkruar për “qytetin e zhdukur” “Spinarica” kanë qenë Hasan Ceka, Neritan Ceka, Aristotel Mici, Muzaffer Kurkuti, Ilirjan Gjika, Injac Zamputi, Halil Inalcik, Mark Tirta, Kozma Ndoni, Ilir Gjipali, Aleksandër Meksi, Pëllumb Xhufi, Milan Shufilaj etj.

tyre si dhe tradita e të parëve. Krijimi i shtetit shqiptar dhe fillimi i aktivitetit nuk mundi të merrej me detyrime “dytësore”, ndërkohë që nuk ishte siguruar hapësira administrative e shtetit, rendi dhe qetësia, të huajt që ishin turrur në të gjithë anët e vendit, për të “kapur momentin”, kur shteti nuk ishte ende shtet.

Edhe përpjekjet e mëvonshme rezultuan fragmentare dhe se pushteti e qeveritë e viteve 1912-1939 bënë vetëm disa zgjidhje teorike, por në fakt përmbytjet e fushave, fshatrave e qyteteve vazhdoi pa u ndalur. Nga ana tjetër gjysmëshekulli i parë XX ishte mbërthyer nga dy luftëra botërore dhe sakrificat për ngritjen e shtetit. Le të sjellim një fragment të një segmenti shtetëror të viteve ‘20-të, që lidhet edhe me detyrimet të një segmenti të policisë për kohën, edhe pse policia në këtë periudhë ka qenë e nënvleftësuar për shkak se përparësinë e vlerësimeve regjimi i kohës ja jepte xhandarmërisë. Policia e Shtetit ka pasur detyrimin e kontributit për rregullin, qetësinë dhe sidomos sigurinë e komunitetit edhe përgjatë përmbytjeve. Kështu “Rregullorja mbi detyrat e Policisë”²⁴ që në vitin 1921, që përcaktonte edhe rregullat “kur bie zjarr, kur vjen lumi me rrëmbye, kur bie tërmet, kur ndigjon za shpëtimi që brenda nga ajo shtëpi”.²⁵ Krahas detyrimeve të shtetit, të organeve të pushtetit vendor dhe qendror në kulturën popullore të popullit shqiptar, banesat. Lloji i saj, vendi i vendosjes, projekti e kërkesa të tjera, ka qenë kërkesë e hershme e vendosjes së ndërtesave për banim, e kullave në vende të përshtatshme, jo rrëzë lumenjve, në vende të pjerrëta, në vende që rrezikohen nga shembja e gurëve, rrëshqitja e dherave, pra sikurse thotë populli në një fjalë të urtë: “Mbi të luajtshmen nuk ndërtohet e paluajtshmja”²⁶.

3. Realitetet e përmbytjeve në Shqipëri (fokus praktik të ekstremitetit të përmbytjeve)

Burimet dokumentare mbi fenomenin e përmbytjeve flasin për periudhat: 1854, 1860, 1865, 1867, 1868, 1869, 1870, 1871, 1937, 1952, 1962-1963, 1983, 2010, 2017, 2021. Analistët thonë se, praktikisht, devijimi i Drinit prej shtratis të vjetër (sot Drini i Lezhës) drejt shtratis të lumit të Bunës ka çuar edhe në rigjallërimin e intensifikimin e përmbytjeve. Përllogariten gjithashtu se përmbytjet e vitit 1962-1963, kanë qenë më të mëdhatë e të gjitha përmbytjeve, që kanë ndodhur në Shqipëri përgjatë shekullit të XX-të e deri sot. Sipërfaqja e përgjithshme e përmbytur në të gjithë vendin shkon nga 65000 ha deri në 110 mijë ha; ndërkohë që prurjet maksimale shkojnë në 3650 m³/s në lumin Vjosë, dhe 5180 m³/s në lumen Drin, etj. Nëse u referohemi dëshmime historike, kronistit turk Sirri shkruante: “..ditën e enjte më 1.12.1854, u bë një përmbytje e madhe, dolën nga shtrati Buna dhe Drini, të cilët vërshuan në Shkodër në anë të Bahçellekut dhe të Tabakhanes, uji hyri nëpër shtëpi.

Uji gjithashtu hyri nder depo, magazina dhe dyqane deri në rrugët e pazarit. Bile në rrugën e Teqesë, që është më e lartë se rrugët e tjera, lundrat e ngarkuara me 2000 okë kripë erdhën, duke kaluar mbi rrugën e Teqesë. Kaiket shkonin e vinin mbi kalldrëmin e rrugës së Perashit e të Rusit. Dhjetë ditë vazhdimisht, ata që do të dilnin në pazar, duhet të kalonin nga rrugët e kodrave. Vërshimi më i madh këputi urën e Bunës dhe në

AKADEMIA
E SIGURISË

Konferencë
shkencore
ndërkombëtare:

« Fenomenet
ekstreme
të natyrës
dhe çështjet
e sigurisë »

²⁴ Rregullorja mbi detyrat e Policisë e vitit 1921 ka qenë vlerësuar si “akti normativ më i arrirë i policisë, deri në vitin 1921”. AQSH, Fondi 152, viti 1921.

²⁵ DPAQSH, Fondi dokumentar nr 152, viti 1921. (Hartuar nga Drejtori i Policisë juristi Ahmet Sinani në një rregullore me 4 nëndarje dhe 51 nene), nen. 17.

²⁶ Ramiz Fiçori, Fatkeqësitë e natyrës dhe mbrojtja prej tyre, Tiranë, 2016, faqe 75.

kazerna uji arriti tre pëllëmbë lartësi”²⁷. Ndërkohë që nga i njëjti autor gjejmë, për përmbytjen e datës 10.12.1860: “Kjo përmbytje është me e madhja sa s’ka ngjare ndonjëherë. Pazari, lagjia Bahçellek dhe Tabakhania mbetën nën ujë për 31 ditë. Dëmet në pazar i kalojnë të 500 qeset”²⁸. Ilustrime të kësaj natyre që flasin për përmbytjet si faktor ekstrem natyror janë të shumta dhe që janë edhe të sensit praktik, çfarë njerëzit, kanë parë, kanë përjetuar si dhe që rrallë kanë shkruar dhe dokumentuar.

Kjo duket edhe në statistikën reale të shtetit që përgjatë një shekulli kanë qenë të shkallës amatore. Më shumë dhe më të plotë mund të gjejmë në ditarët e intelektualëve të ndryshëm dhe të rrallë dhe që kanë qenë të lidhur sipas shkencave dhe fushave ku kanë shërbyer. Kështu ka ndodhur me përmbytjet në Shqipëri, por edhe me fenomenet e tjera të ekstremit natyror. E njëjta natyrë përmbytjesh ka qenë edhe në zona të tjera të Shqipërisë dhe që lidhen pikërisht me natyrën e egër të lumenjve që zbresin nga lartësiti e maleve dhe kodrave të vendit në drejtimin perëndimor drejt detit Adriatik dhe detit Jon. I tillë është lumi i Shkumbinit²⁹, i cili derdhet në Adriatik në veri të lagunës së Karavastasë, por që buron nga shpatet lindore të malit të Valamarës dhe të Gurit të Kamjes.

Shkumbini në pjesën e sipërme të rrjedhjes kalon nëpër një luginë të thellë, futet në krahinën e Mokrës dhe rrjedh në veriperëndim deri në Librazhd, ku merr ujërat e Rrapunit, rrjedh nëpër një luginë pak a shumë të ngushtë. Në fushën e Elbasanit shtrati zgjerohet dhe merr drejtim perëndimor deri sa del përfundimisht në Ultësirën Bregdetare. Degët kryesore të lumit Shkumbin janë përroi i Dushnës, i Radicinës, i Bushtricës, i Gostimës dhe lumi i Rrapunit. Por Shkumbini nga lashtësia ka edhe “historikun e tij të përmbytjeve” dhe që shkaktonte jo rrallë fenomenin ekstrem të natyrës të quajtur “përmbytje”. Por ujërat që përmbysnin mbanin edhe jetën në këmbë. Uji furnizonte mullinjtë. Kështu në testamentin e lënë nga Gjini Muzaka, kur përmendet emri i krahinës së Mokrës, shkruhet se “Mokër” do të thotë “vendi i mullinjve”, ku në shqip fjala “mokër” do të thotë “gur mulliri”. Por përtej Mokrës dhe vijës së ujit të mullirit, në shekuj Shkumbini ka shkaktuar dhe mjaft fatkeqësi natyrore me përmbytje të zonave fushore.

Elbasani³⁰, nga “Skampis”³¹ deri në ditët e sotme, në “kërthizë” të Shqipërisë, që sot njihet Elbasan, është ndër zonat që ka përballuar rrebeshe të përmbytjeve të vazhdueshme. Në një farë mënyrë bashkëshoqëruese për një pjesë të madhe të rrugës Egnatia³², kësaj veprë gjigante të antikitetit është në këmbët e saj edhe lumi i Shkumbinit. Ka qenë një gjetje inxhinierike romake. Lumi i Shkumbinit e ka grykëderdhjen në Vilë-Bashtovë. Nga studimet e fenomenit ekstrem të natyrës të përmbytjeve Shkumbini

²⁷ Sipas originalit të marrë me shënim nga Kytaphane, Harp Akademileri Komutanlığı, İstanbul, Yni Levente, Shënime udhëtimi të kronikanëve të ushtrisë osmane (Sirri), İstanbul, 2000, faqe 64.

²⁸ Po aty. Faqe 64-65.

²⁹ Lumi Shkumbin ndër lumenjtë më të mëdhenj të vendit, 181 km, sipërfaqe 2444 km², lartësi mesatare 753 m.

³⁰ Më 1466 Sulltan Mehmeti II ndërtoi kalanë si pikë mbështetjeje për trupat osmane, kala e tipit fushor ndër më të mëdhatë në Ballkan, që u emërtua “Elbasan”, por i pari që dëshifroi mbishkrimet në këtë kala dhe më pas emrin e saj ishte orientalisti Babinger. Orientalisti shqiptar Vehxhi Buharaja, thotë se “Elbasan” me prejardhje osmane, vërtetuar nga një mbishkrim i gjetur në muri i portës së kalasë, ku shkruhet “Elb-bas-an”, që ka kuptim el-dorë dhe basan, është një emër foljor veprues, sipas gramatikës së gjuhëve neolatine, që dmth shtypës, e kappa e shtypa e “vura në dorë”, e shtypa me një pëllëmbë.

³¹ Në vitin 1922 në muret e Kalasë së Elbasanit u zbulua një gur masiv (gur varri), ku ishte i gdhendur emri i qytetit Skamp, shekulli II-të i erës sonë; gjendet në muzeun Etnografik të Elbasanit si një dëshmi që vërteton vendndodhjen e lashtë të Skampis, Elbasanit. Historianët thonë se ky gur varri i përket legjionarit Mark Sabidi Emilia Maksimus. Sipas: <https://elbasani.gov.al/sq-al/Qteti/Pages/historikuqytetit.aspx>.

³² “Egnatia” përmendet nga Straboni 120 vjet para Krishtit, kalaja e Skampinit filloi të ndërtohej më 285 – 305 para Krishtit e mori formë të plotë nga rindërtimi i perandorit Justiniani I, në vitet 530 – 565 pas Krishtit.

është lumë “luftarak” e përmytës në dimër si dhe “paqësor” në verë. Por, po ashtu është edhe Vjosa:³³ një lumë i egër i Europës. Nga të dhënat studimore rezultojnë se gjatë viteve 1205-1370 në bregdetin e lindor të Adriatikut funksionoi edhe “Spinarica”, qytet-porti në grykëderdhjen e lumit Vjosa vetëm disa kilometra në jugperëndim të Apolonisë e cila gjatë mesjetës u shndërrua në një vendbanim të vogël rural që quhej “Polina”. “...Jo shumë larg ku derdhet sot, Vjosa, nga ana e vendit të quajtur Laçani ndodhet një kështjellë e vjetër që ndofta u nevojitej banorëve të Apolonisë”. Studiuesit flasin edhe për “Portin detar të Apolonisë”, i braktisur, sipas rrëfimeve gojëdhane të peshkatarëve dhe të barinjve, njerëzit në ato kohëra i lanë shtëpitë, i braktisën nga shkaku i shejtanëve të tmerrshëm, që emërtoheshin “Laço”. Nga ky emër i “Laçove” vendi u quajt Laçanë, kurora e lumi atje u quajt kurora e Laçanit dhe kisha filloi të thërretë po ashtu Shën e Premtja në Laçanë³⁴. Më vonë aludohej se, e keqja nuk vinte vetëm nga deti, por dhe përmytjet e përvitshme të lumit Vjosa, ujërat përziheshin bashkë me të detit dhe krijonin rreziqe reale për njerëzit, që ngritën legjenda derisa e braktisën qytetin.

Kjo histori ka vijuar në mijërvjeçarë në të gjithë dhe me të gjithë lumenjtë shqiptarë, që ishin sipas njerëzve “e mira” dhe “e keqja” e njerëzimit. Faktorët ekstremë të natyrës kanë çuar njerëzit deri në braktisje të plotë të qyteteve sikurse ndodhte edhe me “Spinarica”, e cila figuron e pabanuar apo e braktisur në dekadat dhe shekujt e mëvonshëm. Kështu bazuar në “Regjistrin Kadastral të Sanxhakut të Beratit, në vitin 1431-1432”,³⁵ përgjatë kësaj pjesë të bregdetit nuk gjendet asnjë vendbanim, si rezultat i përmytjeve të vazhdueshme. Kjo vërtetohet edhe nga arkeologu Neritan Ceka³⁶ dhe etnografi Mark Tirta³⁷. Qytetin e zhdukur buzë Vjosës ose ku takohet Vjosa me detin e përmend edhe Milan Shufflai kur shprehet se, “...Me banorët e saj u mbushën qytetet e vogla që gjenden rreth e qark, bazën e të cilave e përbënin kështjellat e vjetra bizantine. Kështu u formua “Spinarica”³⁸ e kohës së mesme mbi grykën e Vjosës...”³⁹. Edhe pse shembulli i një qyteti të humbur/të zhdukur/të përmytur trajtohet në kontekstin më të gjerë.

Fakt është se të parët që shpërngulën qytetin nga grykëderdhja e Vjosës nuk e dinin se kjo histori përmytjesh e katastrofash do të vazhdonte deri në shekullin e modernizmit. Krahas zhvillimeve historike gjejmë edhe dokumente që flasin për natyrën e lumenjve, vërshimet e përmytjet, por edhe mënyrën e shfrytëzimit të burimeve ujore e hidrike në funksion të ekonomisë së kohës. Kështu dikur lumi Buna njihej edhe si “lumi lundruer” sepse mbi të lundronin anije shumëtonëshe. Në 8 m ujë të Bunës do të hynin anije 8000 tonëshe dhe porti ishte mjaft ekonomik. Leverdinë e dikurshme ekonomike “si dikur” e vërteton historiani Tit Livi që shkruante: “*porti i Obotit ka 120 anije të punuara nga*

³³ Lumi Vjosa në Shqipëri është një nga lumenjtë e fundit të egër të Evropës me 270 km; Vjosa rrjedh e pandikuar në mënyrë të natyrshme, që formon kanione, rrjedha të rrëmbyeshme, ishuj dhe kthesa me gjarpërime dhe mbi të gjitha edhe i “pabesë”, sepse nga të dhënat e antikitetit Vjosa e ka ndërruar shtratin dhe derdhet nga zona e Nartës deri në zonën e Semanit, përfshi edhe pranë qytetit antic të Apolonisë. <https://issuu.com/help-cso/docs/faktedhetdhnaprvjosen>.

³⁴ Aristotel Mici, “Rreth Portit të Mundshëm Detar të Apolonisë”, Dielli, 16 gusht 2014.

³⁵ Halil Inalcik, Defter-i Sancak-i Arvanid, Hicri 835 Tarihi Suret-i, Türk Tarih Kurumu, Ankara, 1954.

³⁶ Neritan Ceka, Pirgu i Myzeqesë, Monumentet historike në vendin tonë, Sh. B. “8 Nëntori”, Tiranë 1979, faqe 68-71.

³⁷ Etnografia Shqiptare, nr. 13, Shtëpia botuese “Naim Frashëri”, Tiranë 1983, faqe 17.

³⁸ Kuptimi i “Spinarica” vjen nga venecianët që e quanin, për shkak të bimës aq përhapur të Zhukës (Juncus) që mbizotëron në këtë zonë, me gjeteth në formë gjembash. Në latinisht “spina” dmth Spinaricë, në shqip “gjëmbaç” - që të shpon.

³⁹ Milan Shufflai, Serbët dhe Shqiptarët”, Bargjini, 2001, faqe 82.

artizanët shkodranë e ulqinakë". Doriçeli, në shek XVI shkruan se portet e Shkodrës, Ulqinit e Vlorës mbizotërojnë Adriatikun dhe kanë 340 anije me rreth 4500 punonjës që lundronin në linjat Venedik – Raguzë (Dubrovnik)⁴⁰. Të dhënat flasin se Drini është bashkuar me Bunën, jo këtu ku është sot ky bashkim, por më tej, në vitin 1856. Drini njihet si një ndër lumenjtë më të "padijsiplinuar", që e ka ndryshuar shtratin tri herë dhe që ka ngelur kërcënues dhe problematik edhe për dekadat dhe kohët që rrodhën më vonë. Nëse sjellim në fokus dëmet e para një shekulli në Shqipëri që mundësohet nga skedat dokumentare të arkivave dhe të gazetave të BK-së, sikurse janë gazeta "Zëri i Korçës" të 9 dhe 23 janarit 1926, që dokumentojnë se: "Për liqenin e Shkodrës merret vendim nga Këshilli i Ministrave për ta kanalizuar e minimizuar përmbytjet"; ndërkohë që më 12 janar kjo gazetë shkruan:

"Liqeni i Shkodrës ka gjatësi 45 km, gjerësi 12 km, thellësi 12 m, ...Buna me 14 km". E njëjta problematikë shkruhet dhe në gazetën "Vullneti" e Tiranës për Drinin dhe Bunën⁴¹. Parë në këndshikimet e para një shekulli në shtypin shqiptar të kohës⁴², por edhe në dokumentacionin arkivor të viteve '20-'30-të rezultojnë shkresa që flasin për "hallet e qytetit të Shkodrës nga përmbytjet e furtunat", "për fatin e bardhë të lumenjve e liqenit", "për nevojën e dragave për të thelluar shtratin e grykat e lumenjve", "për raportet dëshpërues për përmbytjet në Shkodër dhe nevojat emergjente", "për historitë e përmbytjeve nga koha osmane", "përmbytjet" e shekujve, ku shpesh edhe investimet kanë shkuar në det për studime, projekte e zbatime të pjesshme. Në fokus historik përmbytjet ishin e përvitshmja problematike e shqiptarëve nga Veriu në Jug dhe anasjelltas nga Jugu në Veri.

Objekti dhe subjekti i përmbytjeve ka qenë pothuaj gjithnjë Ultësira Perëndimore shqiptare. Kështu në një prej përmbytjeve të shumta, më 31.12.1970-1.1.1971 lumi i Vjosës përmbyti 14000 hektarë. Përmbytja shkaktoi të njëjtat pasojë dhe dëmtime (dëmtime e shkatërrime të argjinaturave, kanaleve ujitëse, urave, stacioneve të pompimit etj.), madje në disa zona të përmbytjes dëmet u llogaritën dhe më të mëdha se ato të përmbytjeve që shkaktoi lumi i Vjosës më 1962-1963⁴³. Në raport me fenomenet ekstreme të natyrës duhet të rishikojmë marrëdhëniet e njerëzimit më historinë e ndodhjes së ngjarjeve pasi nëse do të përdorim një thënie të Robert A. Heinlein që thoshte se, "Një brez që injoron historinë, nuk ka të shkuar e as të ardhme", do të bënte që historia të përsëritej, dhe pasojat e pasigurisë kombëtare në aspektet e ndikueshmërisë së fenomeneve ekstreme të natyrës "përmbytje" të ishin katastrofale. Prandaj të gjithë brezat duhet të njohin historinë e lumenjve të tyre, sepse nuk ka lumë pa histori dhe këtu flitet për histori tragjike e të dhimbshme. Gjithë lumenjtë e Shqipërisë kanë historikë përmbytjesh, dëmsh e shkatërrime të shumta, ku vetëm në dy dekadat e fundit kanë shkaktuar rreth 2 miliardë dollarë dëme. "Disiplinimi" i lumenjve shqiptarë ka ardhur me vonesë me urbanizimin dhe disiplinimin e dëmeve dhe shkatërrimeve të faktorëve ekstremë të natyrës, "disiplinim", që kërkon vijimësi.

4. "Pushteti" i përmbytjeve, "gjuha e shifrave" dhe siguria kombëtare

Disa nga fenomenet ekstreme natyrore, për shqiptarët kanë qenë bashkudhëtarë të

⁴⁰ Po aty faqe 6.

⁴¹ Sipas të dhënave të gazetave "Zëri i Korçës" të 9 dhe 23 janarit 1926 dhe gazetës "Vullneti" e Tiranës e 16 dhe 31 tetor 1926 si dhe "Dita" e Tiranës, e datës 10 mars 2013.

⁴² Sipas gazetave "Zëri i Korçës", "Vullneti" etj, të viteve '20-të (BK).

⁴³ Plani Kombëtar për Emergjencat Civile në RSh. VKM nr. 855.dt.3.12 viti 2004, faqe 71.

historisë së tyre. Shqipëria ka qenë përmbytur si kur ishte katër vilajete, edhe kur ishte shtet i pavarur, një milion banorësh (1938), edhe kur ishte 4 milionëshe (1990), por edhe këto tre dekadat e fundit, vite ku është ndërtuar masivisht gjithçka por vetëm veprat kulluese, ujitëse, bonifikuese, hidrovore, stacionet e pompimit, veprat e artit, argjinaturat etj., kanë qenë me kursim. Kanë munguar edhe studimet e plota e të thelluara mbi gjendjen e digave të rezervuarëve, e rrjetit të kanaleve ujitës e kullues, veprat e marrjes së ujit, veprat e artit, argjinaturat, gërryerjet e tokave nga lumenjtë etj. Studimet për leverdinë për t'u ndërtuar, radha e ndërtimit të tyre, lidhur me mundësitë që ka shteti, por edhe me mundësinë e ndërhyrjes emergjente.

Tradita e fillesës së qëndresës përballë përmbytjeve ka qenë e paorganizuar dhe pa mbështetje të strukturave. Në shtetin e 12-ës, 20-ës, në republikën e parë të 25-ës, shtetin e Mbretërisë së 1928-ës ka pasur përpjekje fragmentare së pari për ta njohur problemin, por vlerën e vërtetë të një punë të madhe kolektive, të organizuar dhe në shumë raste edhe vullnetare i dedikohet përpjekjeve të pas LIIB. Pas vitit 1945 pati një "bum" ndërtimesh sistemimesh, kanalizimesh, digash, por përtej pritshmërisë, pasi ky ndërrim masiv digash, pritash dhe hidrocentralesh nuk kishte ndodhur asnjëherë në historinë e shtetit shqiptar.

Me kalimin e viteve e dekadave dhe veçanërisht me "erën demokratike", vendi ynë u "njoh" dhe u nxorën në pah edhe vlera e ujërave dhe kaltërsia e tyre, aq sa u konceptuan si "Zemra Blu" ballkaniko-europiane, kjo vetëm për turizmin ndërkohë që hallet e fenomenit ekstrem të natyrës sikurse është "përmbytja" si faktor kërcënues i përhershëm ka vazhduar me të njëjtin intensitet, herë-herë dhe e vrullshme. Në planin e përgjithshëm të studimit të ujërave, por edhe kërcënimeve që rrjedhin prej tyre lumenjtë ballkanikë quhen me të drejtë si "zemra blu", europiane, një vlerë të jashtëzakonshme ekologjike me biodiversitetin e saj specifik për Evropën.⁴⁴ Megjithëse "uria" për energji dhe kompleksiteti i zhvillimeve të brendshme ka çuar jo rrallë në vendime politike, përfshirjen e palëve të interesuara duke kapërcyer mbi çfarëdo parim e normë ekologjike duke mos u ndalur edhe përballë zonave "të ndaluara"⁴⁵ ose zonave "të mbrojtura". Rrjedhojat në këto raste janë të pritshme, por të padëshiruara.

Shqipëria ka ende shtrirjet më të mëdha të lumenjve me rrjedhje të lirë dhe të paprekur, krahasuar me të gjitha vendet e Ballkanit. Lumenjtë e mëdhenj si Vjosa⁴⁶, Semani me Devoll dhe Osum e Shkumbin ende nuk ndërpriten nga digat. Vetëm lumi Drin është shndërruar kryesisht në një zinxhir të tre hidrocentraleve dhe pritet të ndërtohet edhe i katërti, Skavica që pritet të jetë edhe rregullatori i disiplinimit të ujërave dhe eliminimit të përmbytjeve që vijnë si pasojë e prurjeve të lumit Drin⁴⁷. Gjithashtu majëmalet e larta të maleve mbi 2000 metra⁴⁸ krijojnë mundësi përqendrimi të ujërave për përmbytjeve në dimër. Shumë delta e grykëderdhje ende ofrojnë kushte të shkëlqyera hidromorfologjike⁴⁹. Por krahas pasurisë ujore, lumore e liqenore vendi

⁴⁴ Balkan Rivers – the blue heart of Europe, Euronatur, Vienna, 2012, page 14.

⁴⁵ Po aty, faqe 14.

⁴⁶ Lumi Vjosa është 272 km, buron nga mali i Pindit në lartësinë 1340 metra; përshkon 70 km në tokë greke dhe 200 km në tokën shqiptare, sipërfaqja e pellgut ujëmbledhës 6706 km², prej të cilit, 4365 km² janë brenda vendit tonë, ndërsa pjesa tjetër prej 2341 km² në territorin grek. Degët e Vjosës janë: Sarandopor, Drinosi dhe Shushica.

⁴⁷ Hidrocentrali i Skavicës ose "rregullatori i kaskadës së Drinit", u projektua në vitin 1963 të ishte hidrocentrali i parë, para Fierzës, me fuqi 350 megavat, por nuk u realizua. "Skavica Hydro Poëer Plant", parashikon një HEC-i me kapacitet 200 megavat, me kosto 247.5 milionë euro. Ndryshe quhet edhe rregullator i prurjeve të ujrave dhe ndalimit të përmbytjeve.

⁴⁸ Shqipëria ka 65 male nga 2000 - 2751 metra lartësi nga Jugu në Veri (Korabi -2751 m, Jezera-2694, Gramozi-2523, Papingut Nëmërçkë-2485, Tomor-2416, Lunxhëri- 2160, Çika-2045 m), si rezervat dëbore.

⁴⁹ Balkan Rivers – the blue heart of Europe, Euronatur, Vienna 2012, page 49.

ynë si gjithë Gadishulli Ilirik ka qenë gjithmonë i kërcënuar nga përmbytjet dhe sidomos humbjet e dëmet në njerëz, në gjë të gjallë, në financa ka qenë tepër i madh aq sa jo rrallë humbjet nga përmbytjet e kanë kaluar shumë herë atë të investimeve për mbrojtjen nga përmbytjet, duke shkaktuar dhe politika të paqarta me këtë fenomen vrastar ekstrem të natyrës, që jo gjithmonë të paralajmëron.

4.1. Në gjuhën e shifrave: “kështjella” ujore, apo “kështjellë” rreziqesh mbi sigurinë

Studimet hidrike janë të hershme për hapësirën e vendit tonë, edhe pse vështrimin historik mbi ujërat në hapësirën shqiptare i kanë bërë më parë austriakët dhe italianët. Shqipëria llogaritet për një nga vendet me rrjetin më të dendur hidrografik të Europës si dhe me një pasuri shumë të madhe ujore. Nga sasia e ujit për frymë, Shqipëria vjen menjëherë pas Zvicrës, që konsiderohet si “kështjella” ujore e Europës. Sipërfaqja hidrografike është 43.35 km², nga të cilat 28 550 km², brenda kufirit shtetëror. Rrjeti ujqor përbëhet nga 13 lumenj⁵⁰, që bashkë me degët e tyre dhe përrenjtë e mëdhenj me ujë të vazhdueshëm janë 152, nga katër liqene të mëdhenj dhe një numër i vogël liqenesh me sipërfaqe 1032 km², 5 liqene të mëdha artificial me 123 km², dhjetëra rezervuarë për vaditje, shumë laguna bregdetare, 200 burime nëntokësore me prurje nga 200 l/sekondë deri në 6 m³/sek. Por në dimër këta lumenj sjellin rreth 60 milionë tonë mbetje të ngurta si dhe që të gjithë vërshojnë dhe ndonjëherë përmbytin zota të tëra fushore⁵¹.

Dukuritë e përmbytjeve janë një histori e gjatë në Shqipëri dhe që policia⁵² ka pjesën e vet të përballjes. Arsyeja? E thjeshtë dhe e kuptueshme: “Polici është njeriu më kompetent i qytetit”, jo vetëm për sa i përket mënyrës rutinë të praktikës së tyre të punës, sepse janë “gjallesat” e dobishme dhe plotë vlerë të shoqërisë në veprim. Polici është rendi dhe siguria edhe në mot të mirë edhe në mot të keq; edhe për rastet kur kompani e departamente të komunitetave ekonomik mund t’i trajtojnë, qytetarët e tyre si “makina në këmbë”, ndërkohë që policia mbetet stoike dhe e përhershme përtej “kulturës së luftërave” me misionin e ligjit, rregullit, qetësisë, publikut, të betuar për t’i shërbyer flamurit edhe në çastet më komplekse të rreziqeve të natyrës ose të rreziqeve që vijnë nga teknologjitë.

Për sa i përket të dhënave mbi ujërat në botë, është e njohur se dy të tretat e planetit është e mbuluar me ujë, por zaptuesi i planetit janë ujërat e oqeanëve deteve e liqeneve të mëdhenj. Për ujërat janë zhvilluar luftëra për herë të parë para rreth 4500 vjetësh në zonat e civilizimit të Mesopotamisë. Por kur planeti “tokë” u shtua shumë demografikisht, u pakësuan ujërat nga konsumi i ujit që në vende të ndryshme është rritur deri në 200-300%. Ujërat janë kthyer në dekadat e fundit si burim konfliktesh e mosmarrëveshjesh ku në të gjithë botën përllogariten në mbi 400 mosmarrëveshje për ujërat, që në rreth 10% të tyre ka ndodhur edhe katastrofa të shkatërrimit të digave, që kanë qenë një burim fatkeqësish përtej fatkeqësive që mund të shkaktonin faktorët ekstremë të natyrës.

⁵⁰ Fjalor Enciklopedik Shqiptar, Vëllimi III, Tiranë, 2009, faqe 2543: Shqipëria ka këta lumenj kryesorë: Drini, Buna, Mati, Ishmi, Erzeni, Shkumbini, Semani, Devoll Osum, Vjosa, Kalasa, Pavla dhe Bistrica, të cilët derdhjen e tyre e kanë në detin Adriatik dhe detin Jon.

⁵¹ Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Fjalor Enciklopedik Shqiptar, Vëllimi III, Tiranë: “K-H”, 2009, faqe 2543.

⁵² Policia është institucion i administratës publike, strukturë e MB, që ka për mision të ruajë rendin dhe sigurinë publike. Në vitin 1999 mori status civil dhe u quajt “Policia e Shtetit”; në 2007 kaloi me status si institucion i administratës publike; në 2014 ka dalë ligji i ri për Policinë. Sipas Fjalor Enciklopedik Shqiptar, Vëllimi III, Botim i Akademisë së Shkencave e Shqipërisë, Tiranë: “Kristalina K-H”, 2009, faqe 2058.

Ndërsa “ujërat e ëmbla” janë objekt debati sepse 260 lumenjtë kryesorë të botës sonë kanë një ndarje të tillë që 175 rrjedhin përmes dy vendesh, 48 përmes tre vendesh dhe 37 përmes katër më shumë vendesh. Azia që është demografia më e madhe e globit me 2/3 e popullsisë ka në dispozicion nga resurset e ujit në botë vetëm 36% të ujërave të rinovueshme⁵³. Analiza rreth ujërave në botë, në Europë si dhe në rajonin Ballkanik dhe në Shqipëri na çon në konkluzionin se sikurse deri më sot do të jemi të kërcënuar nga ujërat, si një ndër fenomenet ekstreme të natyrës. Por duhet thënë se shpenzimet për mbrojtje e siguri⁵⁴ në vendet më të zhvilluara të botës janë marramendëse në raport me shpenzimet për ekonominë e ujërave për kanalizimin dhe disiplinimin e tyre, çka është element i rishikimit në programet buxhetore të së ardhmes. Pas LIIB në rreth katër dekada u ngritën 640 diga për vaditje, në “gjuhën” e shifrave, por në këndshikimin për sigurinë janë 640 kërcënime për sigurinë, ndërkohë që mbajtja nën kontroll i digave për vaditje të njohura si rezervuar ka pasur dhe ka veçoritë e veta, pasi kanë sasi prej 580 milion metër kub, që përballonin dikur 75% të popullsisë që jetonte në fshat dhe vadisnin 180 mijë hektarë. Digat janë të madhësive të ndryshme nga 15 deri në 50 metra ndërsa si volum deri në 60 milionë metër kub ujë është më i madhi, por mirëmbajtja e digave nga bashkitë është një barrë e madhe për forcat, mjetet dhe buxhetet që disponojnë këto institucione. Ndërkohë që kur ka shira të jashtëzakonshëm, duhet rishikuar veprat e shkarkimit, veçanërisht për vendet që kanë reshje 50-60 m/m shi dhe për rastet kur kalojnë 220 m/m shi. Është dokumentuar që në vitin 1948 për dy orë ka pasur reshje të “çmendura” dhe nëse përsëritet kjo sasi reshjesh, në Tiranë diga e Liqenit Artificial në Tiranë do të mbushet brenda dy orësh. Prandaj, masat e veprave të shkarkimit” janë nevoja imediate për të gjitha digat ku tejmbushja rrezikon komunitetet, sikurse janë një “minë me sahat”, që kërkon impenjim maksimal, pasi në to mbajnë një sasi të konsiderueshme uji⁵⁵.

Humbjet ekonomike të shkaktuara nga këto fatkeqësi midis 1974-2006, janë llogaritur mesatarisht në 68.7 milionë USD në vit, ose rreth 2.5% e PBB⁵⁶. Në sensin praktik ndërmjet viteve 1989 e 2006, përmbytjet⁵⁷ në Shqipëri zënë përkatesisht 17% dhe 31% të fatkeqësive⁵⁸. Është fakt se sistemi lumor ndërmjet muajve nëntor-mars, është një risk si fenomen ekstrem natyrorë pasi në Shqipëri bie rreth 80-85% e gjithë sasisë vjetore të shirave. Fenomenet ekstreme të natyrës në kategorinë “përmbytje” lidhet edhe me sistemin shqiptar të lumenjve nga vjen edhe kërcënimi real i rrezikut më të madh të përmbytjeve në vend. Fakt është se sipërfaqja ujëmbledhëse arrin në 43.305 km², nga të cilat 14.557 km², i takojnë pellgjeve të lumenjve Drini dhe Vjosa, të cilat përfshijnë pjesë të Greqisë, Maqedonisë së Veriut dhe Kosovës. Pasuria e madhe ujore e shteteve të Ballkanit na bën që të kemi edhe fate të përbashkëta dhe histori të kryqëzuara në lidhje me përmbytjet në rajonin tonë ballkanik. Kështu lumenj të shumtë ballkanik

⁵³ Revista “Policimi dhe siguria”, Nr. 19/2020, Tiranë, 2020, faqe 137.

⁵⁴ Shpenzimet për Mbrojtje e Siguri të vitit 2019 për vendet më kryesore të botës kanë qenë: SHBA 717 miliardë dollarë; Kina 177 miliardë; India 60 miliardë; Gjermania 53 miliardë; Arabia Saudite 51 miliardë; Britania e Madhe 49 miliardë; Franca 48 miliardë; Japonia 47 miliardë; Rusia 46,4 miliardë plus fondet e fshehura; Koreja e Jugut 42 miliardë etj. Sipas Army technology. Biggest military budgets world, sipas: www.army-technology.com/features/

⁵⁵ Kapaciteti i ujëmbledhësive: Paskuqani 15 milion m³ ujë, Gjakaj nr.2 = 3,5 milion m³ ujë, Sarkozë 500 mijë m³ ujë etj.

⁵⁶ Raporti i PNUD për vlerësimet e kapaciteteve të Shqipërisë, 2011; c) PKEC-2004, VKM i vitit 2004; si dhe d) “Analiza globale e rreziqeve – 2005”, të kryer nga Banka Botërore.

⁵⁷ Përlogaritjet me përfaqësi në 5 shekujt e fundit, rreth 5 milion njerëz kanë vdekur nga përmbytjet në botë, miliona kanë ngelur të pastrehë, miliona të tjerë të plagosur si dhe miliona të tjerë kanë humbur burimet e tyre ekonomike të jetesës. Ndërkohë që dhe Shqipëria ka pasur humbje të konsiderueshme.

⁵⁸ Po aty (Shih: Raporti i PNUD për vlerësimet e kapaciteteve të Shqipërisë, 2011).

e nisin “rrugëtimin” nga malet e njeri-tjetrit. Kështu Greqia përshkohet nga 27 lumenj me 2830 km, ku më të mëdhenjtë (Nestos, Evrosi, Strimona) burojnë nga Bullgaria. Burime ose përshkrime të lumenjve ndërmjet shteteve të rajonit janë të shumta, aq sa zgjidhjet e çështjeve të shumta të ujërave të ngelen procese që janë pjesë e zgjidhjeve në tavolinat e gjelbra diplomatike të vendeve ndërkufitare. Tetë lumenjtë kryesorë në Shqipëri janë grupuar në gjashtë pellgje ujëmbledhëse që e përshkojnë vendin nga lindja në perëndim. Shkarkimi i tyre mesatar vjetor është 1308 m³/sek, që korrespondon me shkarkimin e 30 m³/sek/km². Përmbytjet më masive u përkasin muajve nëntor-mars, kur vendi merr përqindjen më të madhe të reshjeve vjetore. Për shkak të modeleve topografike, këto përmbytje ndodhin shpejt pasi uji ka kaluar nëpër rrjetin kryesor hidrografik të lumit për rreth 8-10 orë dhe zona më e rrezikuar tradicionalisht ka qenë fusha perëndimore e rajoneve Shkodër-Lezhë. Përmbytja e Ultësirës Perëndimore sipas kujtesës historike dhe skenarëve të statistikave shtetërore prek rreth 20 rrethe, 110 komuna (aktualisht-njësi administrative), 341 fshatra, 85500 banesa (në rreth 7.9 milionë m²) rreth 565 mijë banorë⁵⁹. Në janar 2010, në rajonet Shkodër e Lezhë, u përmbytën rreth 14,000 hektarë dhe 1200 godina, ndërsa 12000 njerëz u desh të evakuheshin nga banesat. Në shkurt 2015 u përmbytën rreth 3000 ha dhe mbi 600 banesa në pjesën perëndimore e jugperëndimore të vendit. Nga këto përmbytje u prekën rreth 42000 persona, ndërsa rreth 600 familje u desh të evakuheshin⁶⁰. Në Shqipëri janë edhe rreth 630 sisteme rezervuarësh me diga në Shqipëri, prej të cilave, 307 konsiderohen ose me diga të larta (lartësia e”15 m) ose rezervuarë të mëdhenj⁶¹. Lëvizjet e lirë e popullsisë dhe zgjerimi i qyteteve ka çuar në rritjen e përqendrimit të popullsisë dhe vlerave materiale në rrjedhjet e poshtme të lumenjve. Përlllogaritjet inxhinierike parashikojnë se, shpërthimi i tetë digave të mëdha, në zonën qendrore të Shqipërisë, vlerësohet të prekë të gjithë qytetin e Elbasanit, Lushnjës e Divjakës (respektivisht mbi 100 mijë, 38 mijë dhe 10 mijë banorë)⁶².

Kërcënimet që vijnë nga dëbora i përkasin periudhës ndërmjet muajve nga nëntori në mars, në zonat malore të Veriut, Verilindjes, Juglindjes dhe Jugut. Problemet më tipike janë bllokimet e rrugëve, për shkak të gjendjes së keqe të rrugëve dhe mirëmbajtjes së pamjaftueshme dhe ortekët. Popullsia që banon në zona të tilla (rënie bore deri 30 cm) varion nga 12% ose 355 mijë banorë, në rreth 32%, ose rreth 1 milion banorë⁶³. Shqipëria është një nga vendet mesdhetare që preket më shumë nga zjarret, ndërkohë që pyjet zënë rreth 29% të sipërfaqes. Në vitin 2007, sipërfaqja totale e djegur, për shkaqe natyrore apo nga njeriu, arriti 127 mijë hektarë, por ishte ndjeshëm më e vogël në 2008, me rreth 19.254 hektarë⁶⁴. Megjithatë në shumicën e rasteve dora njerëzore në vend që të pengojë ka ndihmuar në përmbytjet e shumë zonave në forma të dukshme e të padukshme.

Studimet dhe krahasimet e prurjeve shqiptare të ujërave si dhe ato të fqinjëve si dhe

⁵⁹ <http://www.mbrojtja.gov.al/images/ec/Plani-Kombetar-EC.pdf>. (PKEC-2004), faqe 61.

⁶⁰ <http://www.agroweb.org/?id=10&l=273&ln=sq>

⁶¹ Sipas MPVC, “Shqipëria ka numrin më të madh të digave për 10 mijë banorë në botë. 524 diga kanë lartësinë 10-30 m. ⁷⁷ diga kanë lartësinë 30-60 m. Gjashtë diga janë mbi 60 m të larta, prej të cilave dy janë mbi 100 m (diga e Komanit 115 dhe e Fierzës 167 m). Diga e Fierzës është më e larta e këtij lloji në Evropë (shih <http://www.mbrojtja.gov.al/images/ec/Plani-Kombetar-EC.pdf>. (PKEC-2004), PKEC-04, faqe 62-63. Ndërkohë që në botë diga më e lartë është në Kinë 305 m e lartë dhe gjatësi 568 m (Jinping HEC-1) vënë në punë më 2014 në “Librin Gines të Rekordëve”.

⁶² <http://www.mbrojtja.gov.al/images/ec/Plani-Kombetar-EC.pdf>. (PKEC-2004), faqe 63.

⁶³ <http://www.mbrojtja.gov.al/images/ec/Plani-Kombetar-EC.pdf>. (PKEC-2004), faqe 67-68.

⁶⁴ <http://www.idmalbania.org/wp-content/uploads/2015/03.pdf>. faqe 4.

europianëve kanë qenë objekt i vijueshëm i studimeve. Kështu që “...më shumë se 30% e lumenjve të mëdhenj janë ende thuajse natyral dhe disa të paprekur nga dora e njeriut .. Në Shqipëri dhe Mal të Zi mbi 60%, ndërsa në Gjermani vetëm 10%, në Zvicër 7% dhe në Austri 6% e lumenjve janë në gjendje të lirë... 50% e lumenjve në Ballkan kanë ndryshuar pak ... Si përfundim, Ballkani është një nga rajonet e Europës me përqindjen më të lartë të lumenjve me vlerë të lartë konservuese”⁶⁵. Bilancet kombëtare dhe ndërkombëtare flasin qartë. Shqipëria rezulton ndër vendet më të prekura në rajon nga ngjarjet klimatike,⁶⁶ duke zënë vendin e 130-të në botë për humbjet e jetëve njerëzore për shkak të ngjarjeve ekstreme të motit në këto dy dekadat e fundit; ndërsa humbjet monetare vetëm nga “faktorë klimaterikë” për dy dekada përllogariten në rreth 114 mld. dollarë⁶⁷. Rreziku global i klimës, i përvitshëm nga “Global Watch”, është një analizë e bazua me dhëna të besueshme për ndikimet e motit ekstrem në botë. Shqipëria mund tju referohet përvojave të BE-së edhe në fushën e përmbytjeve. Kështu nëse marrim një rast praktik se si kanë vepruar europianët për përmbytjet është më se evident në teori, në praktikë, në direktiva dhe në strategji.

Kështu viti 2002 shënoi një valë përmbytjesh masive në Europën Qendrore e Lindore, kryesisht Austrinë, Gjermaninë, Poloninë, Çekinë, etj., që rezultoi me humbjen e mbi 100 jetëve, zhvendosjen e miliona banorëve, dëm ekonomik rreth 20 miliard Euro.⁶⁸ Pas kësaj goditje, Komisioni European ndërmoi masa konkrete: në 2006 i propozoi Parlamentit European Direktivën e Bashkimit European mbi Përmbytjet, strategji u miratua më 2007 dhe përcaktoi masa që duhet të ndërmerrete çdo shtet anëtarë deri më 2009. Menaxhimi i riskut të përmbytjeve ndahet në 5 faza: *parandalim, mbrojtje, përgatitje, reagim, rimëkëmbje*. Shpikjet shqiptare mund të quheshin luks, ndërkohë që sjellja dhe qëndrimi i europianëve ndaj fenomenit “përmbytje” është kornizuar në legjislacionin european,⁶⁹ që fenomenet dëmtuese mos të jenë të përsëritura.

Edhe në Shqipëri kur përmbytura është “e përsëritur”, mësimi i sensit praktik (sikurse vendet më të zhvilluara të perëndimit) nuk është kurrë i tepërt. Pra zhvendosja mund të jetë opsioni më i mirë, gatishmëria e pompave thithëse për bodrumet, “valvulat e kontrollit”, linjat kanalizuese, ruajtjen e shërbimeve të brendshme dhe pajisjeve të jashtme duke ngritur furrat, ngrohësit e ujit, sistemet elektrike (çelësat, bazat, ndërprerësit dhe instalimet elektrike), gjeneratorët dhe njësitë e kondicionimit të ajrit mbi nivelet e përmbytjes, izolimin e lagështirës etj.⁷⁰

5. Ndikimi i fenomenit “përmbytje”, në çështjet e sigurisë

Përmbytjet si fenomeni ekstrem natyror ndër më të popullarizuar në planetin tonë ndikon dhe lidhet drejtpërdrejtë me sigurinë njerëzore dhe sigurinë kombëtare. Lidhja

⁶⁵ Balkan Rivers – the blue heart of Europe, Euronatur, Vienna 2012, page 14

⁶⁶ Albania, the Netherlands, Greece, Montenegro & northern Macedonia bear the highest risk. WorldRiskReport 2019, p.50.

⁶⁷ Të dhënat janë marrë nga “raporti global për Riskun e Klimës 2020, studim i përvitshëm i Global Watch”. Vendet më të prekura në 2018 ishin Japonia, Filipinet, Gjermania. Për vitet 1999 - 2018 Puerto Riko, Myanmar, Haiti renditen më të lartat.

⁶⁸ Mr. Marco Massabò, Mrs. Emanuela Toto, “Historical Collection of Disaster Loss Data in Albania”, Cima Foundation;

⁶⁹ Direktivë e BE 2007/60/ datë 23.10.2007 “Mbi vlerësimin dhe menaxhimin e riskut të përmbytjeve”.

⁷⁰ <https://www.nrcd.org/stories/flooding-and-climate-change-everything-you-need-know>

e fenomenit ekstrem të natyrës “përmbytje”⁷¹ me sigurinë kombëtare konsiston në: pasojat dhe dëmet e jashtëzakonshme për njerëzit, gjënë e gjallë dhe pasurinë e tyre duke dëmtuar rëndë sigurinë publike dhe sigurinë kombëtare të vendit; dëme të konsiderueshme ekonomike materiale në gjithë zonën e përmbytjeve me pasoja të vijueshme shpesh edhe të pariparueshme për një periudhë të gjatë kohore; në dëmtimin veçanërisht rëndë ndërtimet e banimit dhe ato sociale që shtrihen anës së shtratit të lumenjve dhe në ultësirën bregdetare të shndërruar jo rrallë në zona të tëra nën “pushtetin” e ujërave duke sjellë cenim të sigurisë së komuniteteve që ka çuar në emergjenca kombëtare; dëmtim rëndë aktivitetin e pushtetit vendor dhe i detyron drejtuesit e tyre vendorë që gjithnjë e më shumë të shtrijnë dorën për ndihmë pushtetit qendror dhe organizmave të tjera brenda e jashtë vendit, mike e partnere, për pamundësinë e përballimit të situatës; çon në pasigurinë e zhvillimit të veprimtarisë ekonomike të zonave të përmbytura;

çon në rritje të fenomeneve kriminale, riaktivizim të botës kriminale, “të fjetura” si dhe kontingjenteve që kërkojnë të përfituar nga fenomeni i përmbytjes, ndonjëherë edhe duke kamufluar “ndihmën”, me pasoja kriminale; çon në humbje të bizneseve të zonave të përmbytura, shton radhët e papunësisë, por edhe aktivitetet e paligjshëm; shton pasigurinë publike, valët emigruese, braktisjen e zonave të përmbytura e për pasojë dëmtim rëndë imazhin e vendit në prag të integritetit europian, duke i bërë që partnerët europianë t’i shikojnë me skepticizëm zhvillimet shqiptare; dëmtim zhvillimit, projektet e perspektivën e zonave të përmbytura dhe sjell e mbjell mosbesim tek komunitetet buzë lumenjve si dhe në ultësirën e përhershme të përmbytjeve, ku ndonjëherë janë etiketuar si “zona të përhershme fatkeqësish”; nxjerr të pavlefshme mbjelljet e pranverës dhe të vjeshtës në një sipërfaqe të konsiderueshme duke kërkuar vit pas viti rimbursime e buxhete për mbijetesë;

kërkon në mënyrë të vijueshme rritje të financimit buxhetor lokal e qendror për zonën e përmbytur në mënyrë të paparashikuar duke i kapërcyer shifrat e planifikuara në ligjin për mbrojtjen civile; sjell pasiguri për të ardhmen, për burimet njerëzore, për gjënë e gjallë, për pronat; në rastet kur përmbytjet shoqërohen me viktima, ngordhje të bagëtive e shkatërtime, nga shtabet qendrore e operacionale kërkohet vendosje e linjave të komunikimit për informim real në kohë, pa abuzime, që mund të sjellin hapësirë paniku për publikun; rritet artificialisht vëllimi i punës së strukturave të policimit për vendosjen e rendit, sigurisë, qetësisë dhe parandalimin e kriminalitetit në zonat e përmbytjeve; vendos në pikëpyetje ndërtimet e deritanishme të pritave e digave si dhe përlllogaritjet e prurjeve të lumenjve në rastet kur organet kompetente shtetërore detyrohen të hapin digat veçanërisht në lumin Drin, që shpesh risjell përmbytje pas përmbytjesh në zonën e Shkodrës dhe Lezhës (por edhe në zona të tjera);

çon në mosbesueshmëri të komuniteteve të cilët janë vendosur që në vitet ‘90-të të ndërrimit të pushtetit, jashtë “zonave të verdha”, dhe kanë vuajtur përmbytjet e pothuaj tre dekadave të fundit, edhe për rastet kur banesat ose bizneset e ndërtesat sociale kanë qenë “brenda standardeve”; çon në dyshime mbi praktikatat e përdorura nga pushtetet vendore dhe nga mbështetjet që i ku dhënë pushteti qendror mbi ndërtimet gjë që çon në dëmtimin e rëndë të sigurisë komunitare në vendet me shtrirje pranë lumenjve dhe

AKADEMIA E SIGURISË

Konferencë
shkencore
ndërkombëtare:

« Fenomenet
ekstreme
të natyrës
dhe çështjet
e sigurisë »

⁷¹ Në lidhje me kërcënimet e sigurinë kombëtare në rastet e përballjes me fenomenin ekstrem të natyrës “përmbytje” janë mbajtur parasysh historiku dhjetëvjeçar i përmbytjeve të kanë ndodhur në Shqipëri dhe janë menaxhuar nga Qendra e Bashkuar Operacionale (QBO), ku grumbullohet gjithë informacioni mbi përmbytjet në Republikën e Shqipërisë. (Sha)

ultësirën bregdetar shqiptare; krijohet pasiguri dhe ankth, shtohet mundësia e kontrabandës ndërkufitare, kalime të paligjshme të kufijve, trafiku ilegal, trafiku prostitucioni, etj., pasi vëmendja kryesore e strukturave të shtetit fokusohet për drejtimin e zonave të përmbytura; problematika që shkaktojnë përmbytjet lidhet me fenomenin e emergjencave komunitare dhe sigurinë publike e sigurinë kombëtare që zgjat në kohë; në situatat e dëmtimeve masive nga përmbytjet si burim pasigurie mund të bëhen pre edhe të fenomeneve të ndikimeve ekstreme në zonat e përmbytjes me baza religjioze, ideologjike apo nacionaliste çka kërkon të futen në veprim organizmat e specializuara të strukturave shtetërore, që lidhen drejtpërdrejtë me sigurinë kombëtare, ndjekjen e parandalimin e kriminalitetit në vend.

5.1. Zonat e hartave të përmbytjeve, skedimi dhe kujtesa

Analizimi i zonave të rreziqeve nga përmbytjet në Shqipëri është në fokus të përhershëm të organeve të sigurisë për vetë natyrën kërcënuese mbi sigurinë publike dhe sigurinë kombëtare, një fenomen i përsëritshëm. Zonat e hartave të përmbytjeve janë të skeduar si rezultat i eksperiencave prej më shumë se një shekulli, sidomos në gjysmëshekullin e kaluar ku statistikatat janë më të plota dhe më të organizuara. Ndër vite Shqipëria është përballuar me përmbytje të madhësive të ndryshme, ku natyra, por dhe dora e njeriut ka bërë që lumenjtë të dalin nga shtretërit e tyre, e të marrin përpara gjithçka: toka bujqësore, banesa, bagëti, e gjithçka tjetër.

Në funksion të analizës studimore të fenomenit ekstrem të natyrës “përmbytje”, kemi ndërtuar një aneks me të dhëna si “*kujtesë për përmbytjet në Shqipëri*”⁷². Në pothuaj gjysmëshekullin e shkuar Shqipëria është goditur mesatarisht thujtase nga një fatkeqësi natyrore në vit, kryesisht përmbytje sepse sistemi lumor në Shqipëri paraqet riskun më të madh për përmbytjet. Në periudhën që lumenjtë dalin nga shtrati është vështirë të disiplinohen. Ndërkohë që sistemi i pompimit të ujërave për ultësirën bregdetare shqiptare ka dhënë zgjidhje provizore të problemit, pa harxhime të shumta në ngritje digash e pritash si dhe zgjerim dhe kanalizim të shtratit të lumenjve mbi bazën e studimeve të detajuara për sasinë e prurjeve të ujërave. Fakt është se bota e përparuar u ka dhënë zgjidhje problemeve dhjetëra herë më të vështira e komplekse se problemeve të përmbytjeve në Shqipëri. Në periudhën nëntor-mars bie rreth 80-85% e sasisë vjetore të shirave thonë studimet e gjysmëshekullit që ka kaluar⁷³.

Vetëm në vitet 1980 deri 2020, janë regjistruar njëmbëdhjetë përmbytje të përmasave të mëdha hidrometeorologjike, kryesisht në zonën veriore, por edhe atë jugore. Kjo për shkak të ngarkesës së intensifikuar të fenomeneve atmosferike. Më shumë se 88 % e territorit të vendit tonë është e ekspozuar nga dy a më shumë fatkeqësi natyrore. Fakt është se kompleksi ujqor “Lumi Drin, lumi Buna, Liqeni i Shkodrës”⁷⁴ përfaqëson një nga sistemet më të mëdha e më të komplikuar hidrografike të Shqipërisë, si dhe të krejt gadishullit ballkanik. Sistemi hidrografik në vendin tonë ka sjellë vazhdimisht në vite⁷⁵ problematikë serioze, edhe pse duhet thënë se kujtesa shqiptare ka qenë e shkurtër sepse përmbytjet janë përsëritur me dhjetëra herë në të gjithë territorin e vendit e veçanërisht në ultësirën bregdetare. Fakt është se në kaskadën e Drinit, u ndërtuan tre hidrocentrale, që prodhojnë miliarda lekë fitime të përvitshme, por “medalja” ka dy anë dhe është harruar se kur mbushen liqenët, ujët e tepërt tentojnë të kalojnë mbi digat

⁷² Për më tepër në aneksin: Tabela “Kujtesë për përmbytjet në Shqipëri” (në fund të temës studimore).

⁷³ Të dhënat janë marrë sipas raporteve të Institutit të Gjeoshkencës, Energjisë, ujit dhe Mjedisit në Shqipëri.

⁷⁴ Liqeni i Shkodrës është 45 km i gjatë, 12 km i gjerë, 15 metra i thellë.

dhe të shkaktojnë edhe katastrofa, pa folur për hapjen e detyruar, fryrjen e kanaleve dhe përmytjen e fushave. Ekosistemet kanë ndryshuar shumë, deti demonstroi “forcë” dhe rrëmben qindra hektarë në gjirin e Drinit, Bunës, Matit, Erzenit, Shkumbinit, Semanit, Vjosës. Projektet antipërmytje në disa dekada janë bërë më shumë deklarative dhe se fondet që akordohen në dimër, “nuk i zë behari”. Strukturat përgjegjëse në situatë të përmytjeve përmes qendrave operacionale bëjnë udhëzimet për mënyrën e sjelljes përgjatë përmytjeve duke nisur me njoftimet me anë të radios, televizionit dhe internetit e rrjeteve sociale, krijojnë vetëdije se përmytjet vërshuese janë të mundshme, të rrezikshme dhe kërkojnë kujdes maksimal. Nëse ekziston rreziku, menjëherë kalohet në katet më të larta, pa prituri për instruksione dhe udhëzime për këtë, instruktimi duhet të bëjë sigurinë e komunitetit duke qëndruar larg kabllave elektrike që janë burim i fatkeqësive dyfishe. Rol luan edhe degradimi mjedisor, si dukuri shqetësuese, keqpërdorimi i shtratit të lumenjve dhe hedhjet e inerteve, duke devijuar shtratin shekullor të lumenjve. Degradimi shfaqet edhe tek, “shtrirja kaotike e qendrave urbane, prerja masive e pyjeve, dëmtimi i tokave bujqësore, ndotja e lartë e baseneve hidrike dhe gërryerja e lumenjve”.⁷⁶ Ndërkohë që krahas përmytjeve një fenomen që “rrëmben” toka anës lumenjve dhe në rajonin bregdetar, është fenomeni “erozion”, që sipas SSK-së, “Shqipëria është e prekur dhe rrezikohet edhe në të ardhmen nga erozioni. Zonat më problematike janë ultësira perëndimore, luginat e lumenjve të mëdhenj dhe bregdeti i Adriatikut, ku vija bazë e detit po tërhiqet. Në brendësi të territorit, erozioni parashikohet të shkaktojë reduktim të tokës së punueshme dhe burimeve ujore”⁷⁷. Strukturat policore dhe operacionale evidentojnë, largojnë e sigurojnë komunitetin nga vendet të cilat janë të njohura për përmytje, erozion dhe shembje/rënie gurësh, duke krijuar lehtësi veprimi ekipeve të shpëtimit.

5.2. Policia, instrumentet e shtetit dhe parapërgatitja për përballje me përmytjet

Policia e Shtetit është prezent në të gjithë bashkëpunimin dhe koordinimin ndërinstitucional strukturor për planifikimin, menaxhimin dhe përballimin e emergjencave civile në çdo lloj fenomeni të ekstremit natyror. Treguesit e rezultateve janë aparati matës në kushtet e ndodhjes së fenomeneve ekstreme dhe që lidhet me masat paraprake të konsolidimit të instrumenteve menaxhues, për gjithë shtrirjen e popullsisë që mund të preket ose ndikohet nga fatkeqësitë; marrja e masave për zbatimin rigoroz të afateve dhe procedurave ligjore për dhënien e ndihmës së menjëhershme me synim konsolidim të strukturave për mbrojtjen dhe sigurinë publike, pasja në dispozicion e një baze të dhënash për burimet dhe mjetet e gatshme në rast emergjence; vlerësimet qendrore dhe lokale për rreziqet në të gjithë shtrirjen territoriale shqiptare; mundësimin e strukturave të vullnetarëve civilë; të stafëve të trajnuar për të qenë të përgatitur ndaj rreziqeve të dimrit, shtim i kapaciteteve njerëzore e logjistike në funksion të përballimit të emergjencave civile në të gjithë territorin. Përballja me përmytjet shikohet si nevojë jo vetëm nga agjencia, ushtria e strukturat e policimit, por mbarë populli kudo që të jetë. Për këtë arsye në faqen e web-it të MM-së ka një rubrikë: “Si të jemi të përgatitur në rast fatkeqësish natyrore”, që në fakt është një instruksion i gatshëm, që jep “receta”

⁷⁶ Fakt është se sistemi hidrografik ka sjellë edhe përmytjet të mëdha të viteve 1960, 1970, 1976, 1980, 1996, 1997, 2002, 2003, 2004, 2010, 2011, 2015, 2017, që nuk përjashtohet edhe ndodhja e tyre në të ardhmen.

⁷⁶ Strategjia e Sigurisë Kombëtare, Tiranë, 2014, faqe 21.

⁷⁷ Strategjia e Sigurisë Kombëtare, Tiranë, 2014, faqe 22.

mbi atë që duhet bërë para, gjatë dhe pas përmbytjeve⁷⁸.

Çfarë duhet të bëjmë para përmbytjes: “praktikojmë me familjen planet e emergjencës dhe evakuimit; përgatimis një paketë me ushqime, ujë dhe veshje rezervë për të gjithë pjesëtarët e familjes; mbajmë gjithmonë kutinë e ndihmës së shpejtë në vende të sigurta bashkë me dokumentet e rëndësishme për t'i marrë me vete në një moment rreziku; vendosim pajisjet elektrike dhe ushqimet e emergjencës në vende dhe katet e sipërme të ndërtesës ku nuk mund të preken nga përmbytja”. Masa të ngjashme janë të parashikuara edhe për periudhat “gjatë përmbytjes” dhe “pas përmbytjes”.⁷⁹ Fenomenet ekstreme të natyrës, si përmbytjet edhe pse tashmë strukturat e shtetit janë “të mësuara” me këtë fenomen gati të përvitshëm, kërkon që metodat reaguese, masat parandaluese, nuk mund të vlerësohen më me sloganet “të vjetra sa shoqëria njerëzore”, “të natyrshme”, por qasjet dhe zgjidhjet strukturore dhe jo vetëm edhe duke i dhënë rrugëzgjidhje dukurive reale dhe shqetësimit të mbarë shoqërisë. Ta njohësh, ta kuptosh, ta përkufizosh, të zbulosh shkaqet e fenomeneve kërcënues për sigurinë kombëtare si “përmbytjet”, nuk mjafton.

Forca reaguese, neutralizuese, përballuese e policisë, Forcave të Armatosura, komunitetit, pushtetit vendor e qendror është aspekti më i rëndësishëm dhe më i prekshëm. Zgjidhjet juridike, organizative dhe praktike për përballimin real të fenomenit “përmbytje” mund e duhet të jenë pjesë vendimtare e politikave, strategjive, projekteve e zgjidhjeve afatgjata. Projektet e së ardhmes antipërmbytje mund të fokusohen në analizimin e traditës së përballimit të përmbytjeve, të zhvillimin ekonomik, të mundësimit të rrugëzgjidhjeve të shumanshme, siç mund të jenë “Projekti⁸⁰ Buna me port”,⁸¹ “Skavica”, “Banja”, “Osumi” e deri tek Vjosa sipas eksperiencave mesdhetare e botërore për leverdi ekonomike, disiplinim ujërash dhe eliminim të përmbytjeve.

6. Ndërgjegjësimi për fenomenin ekstrem “përmbytje” – sfidë ndaj së ardhmes

Nuk ka forcë ekstreme natyrore, përfshi dhe “përmbytjet”, që nuk mund të “rrethohen” me skenar zgjidhjeje. Njeriu mund ta gjunjëzojë planetin Tokë, duke konceptuar drejtë të ardhmen, por në radhë të parë duke qenë vizionar për atë çfarë ka ndodhur, çfarë ndodh si dhe çfarë parashikohet të ndodhë. Natyrshëm vendet me kujtesë të fortë nuk mund të lejojnë që fenomenet ekstreme sikurse janë përmbytjet të përsëriten çdo vit në shekuj, dekada e vite. Është me leverdi investimi në diga, prita, zgjerime, hidrovore, kanale kulluese, drenazhimi, bonifikimi⁸² deri në eliminim të përmbytjeve se sa të “përmbytjen” fonde buxhetore të përvitshme, por që jo rrallë masa e dëmit tejkalon investimin. Fatkeqësitë e ekstremit natyror “përmbytje” nuk mund të quhen pafundësisht fatkeqësi “popullore”⁸³. “E ardhmja” është një nga sfidat për

⁷⁸ <https://www.mod.gov.al/index.php/ministria/strukturat/akmc/3327-si-te-jemi-te-pergatitur-ne-rast-fatkeqesish-natyrore>

⁷⁹ Po aty.

⁸⁰ “Thellimi i Bunës me 8 metra, në gjerësinë 200 metrash; shkurtimi i distancës nga 41 km në 25 km”, nismë e Institutit të Cilësisë për Integritet, me një kosto 1507000 euro, përballim i prurjeve 6000-7000 m³ ujë/sekondë”, ose kthim në identitet.

⁸¹ Ing. Ismet Teli, Si shmanget përmbytja në zonën e Shkodrës, publikuar të përditshme shqiptare, Tiranë, 31.10.2011. fq 5.

⁸² “Bonifikim” është italisht “bonificare”, që do të thotë: “shërimit përsëri”, “tharjes” ose përmirësimit të kushteve natyrore të tokave, shtimin e prodhimit bujqësor, parandalimin e përmbytjeve të mbjellave, banesave, natyrës në përgjithësi. (Sh.a)

⁸³ <https://theworldnews.net/al-news/ekstremet-e-klimes-cilat-jane-fatkeqesite-natyrore-qe-godasin-me-shpesh-vendin-tone>.

njerëzimin në botën tonë. Ndërgjegjësimi për rreziqet e kërcënimeve ndaj çdo lloji fenomeni ekstrem është “ta përgatisësh të ardhmen”, ndërkohë që një maksimum e popullit spanjoll dhe me të cilën mbyllet libri i Henry Kissinger-it,⁸⁴ “Diplomacia”: “Udhëtar, rrugë nuk ka. Rrugët janë bërë duke ecur!”⁸⁵ fokuson atë çfarë nevojitet në kaosin planetar sot. Për t’u “matur” me të ardhmen duhen taktika e strategji, politika e projekte, vëzhgime e studime, kërkime në shumë fusha, por edhe funksionim institucionesh, ridimensionim të futjes së “kujtesës së gjatë”, për gjithçka ka ndodhur si dhe pritshmërinë e së ardhmes, kërkesat financiare për eliminim të efekteve të mundshme të çdo lloji katastrofe dhe fenomeni ekstrem të natyrës, vlerësim real të kostos, parashikimin e një larmi skenarësh me ndikim hapësinor dhe demografik, rishikim i së ardhmes në barkodin “smart”, për t’i dalë përpara të nesërme, me masa specifike të pritshmërisë gjithëpërfshirëse. Institucionet prestigjioze të vendeve të zhvilluara thonë se, “...midis viteve 1999 dhe 2018, humbjet kanë qenë të mëdha vetëm nga fenomenet ekstreme të motit”⁸⁶.

Ndikimet për shkak të rritjes së nivelit të detit dhe ndikimet klimaterike shoqërohen me rreth trilionë dollarë⁸⁷. Analiza flet se, hendeuku midis financimit të nevojshëm për t’u marrë me klimën e shkaktuar, rreziqet dhe ndikimet janë edhe më të mëdha nga parashikimet. Veprimi i zgjeruar, “smart” për zbutjen e kufizimit të rritjes globale të temperaturës mund të shmangin kostot thelbësore dhe vështirësitë e njerëzimit përballë një “tërmeti” klimaterik, që kërkon vlerësim në kuadër të sigurisë rajonale, europiane e botërore. Në këtë pikëpamje analiza “si është planeti tonë sot?” përgjigjen e gjejmë në këngën e Michael Jackson: “Warth song”/Kënga e tokës, që vargëzon: “Crying earth with weeping shores/Tokë që qan me brigje që qajnë”; ndërkohë që Mahatma Gandhi thoshte: “Toka ka shumë për të kënaqur nevojat e çdo njeriu, por jo lakminë e çdo njeriu”. Kësaj i shërben “Marrëveshja e parë universale e klimës”⁸⁸. (Sipas Laurent Fabius, ish-ministër i jashtëm francez dhe President i COP21, i cili prezantoi projektligjin e marrëveshjes përfundimtare në seancë plenare, marrëveshja synon të jetë karakteristike, e drejtë, e qëndrueshme, dinamike dhe e balancuar dhe ligjërisht e detyrueshme)⁸⁹. Dritëshkurtësia dhe sjelljet pa vizion e liderëve botërorë paguhet shtrenjtë për ardhmërinë e njerëzimit përballë fenomeneve të pamëshirshme të kohës, natyrës, që nuk di të paralajmërojë, por ju jep njerëzimit në dorë “armët”, që të ndeshen me këto fenomene dhe sigurisht në ballë të tyre në Shqipëri dhe jo vetëm janë strukturat ruajtëse të sigurisë publike, policia dhe policimi.

“Barometri” matës i sigurisë publike nuk matet teorikisht as me përkufizime teorike ngado që të vijë ato. Psikiatri i njohur amerikan Scott Peck, dhe autor i suksesshëm

⁸⁴ Henry Kissinger (27.5.1923, Fürth, Gjermani) ish-sekretar amerikan i shtetit nën Richard Nixon, fitues i çmimit “Nobel” për Paqen në 1973 për marrëveshjet e Luftës në Vietnam. Profesor i Harvardit përpara se të drejtonte politikën e jashtme të SHBA. Kissinger është autor i lexuar në gjithë botën, mjaft aktiv në shtyp për çështjet e diplomacisë botërore.

⁸⁵ Henry Kissinger, Diplomacia, Tiranë: Shb “Leart”, 1999, faqe 835.

⁸⁶ Për dy dekadat e para të shekullit XXI, është bërë përlogaritja në rreth 495000 njerëz vdiqën në të gjithë botën dhe humbjet prej 3.54 trilion dollarë amerikanë, rezultat i dpd i mbi 12 mijë ngjarjeve ekstreme të motit. Proceset e fillimit të ngadalitë do të shtojnë një ngarkesë shtesë në të ardhmen. “Raporti i hapjes së përshtatjes së UNEP 2016” paralajmëron për rezultate në rritje e kostove të adaptimit global deri në 2030/2050 që ka të ngjarë të jetë shumë më e lartë se aktualisht pritet: “dy-tre herë më i lartë se vlerësimet aktuale globale deri më 2030, potencialisht 45 herë më i lartë deri më 2050”.

⁸⁷ Raportet dhe analizat tridhjetëvjeçare flasin për një kosto që shkon deri në 70 trilionë dollarë humbje, për shkak të fenomeneve ekstreme të natyrës.

⁸⁸ Marrëveshja e Parisit/Paris Agreement për ndryshimet klimatike u miratua nga 195 delegacionet më 12.12.2015 dhe hyri në fuqi më 4.11.2016. Nënshkrimi i marrëveshjes u mundësua nga 22.04.2016 deri 21.04.2017 në selinë e OKB-së. Traktati hyri në fuqi më 4.11.2016, tridhjetë ditë pas ratifikimit nga të paktën 55 shtete që përfaqësonin 55% të emetimeve të dyoksidit të karbonit.

librash shkruan: “e vetmja mënyrë për të pasur siguri në jetë është të njohësh pasigurinë”. Komplexiteti i termave “siguri” e “pasiguri”, ka një shtrirje mbarë globale: shkolla, koncepte, parime e ide, studime të pafundme, që fokusojnë pikërisht aspektet e sigurisë së brendshme të shteteve dhe që pas tyre “fshihet” përparësia që shtetet i japin shkollave, akademive të përgatitjes si dhe institucioneve që prodhojnë siguri e rregull, qetësi dhe prosperitet të shoqërive nën siglën: “siguri”. “Dora policore” e strukturave të policimit janë element serioz i strukturave të shtetit, me vetëveprim, brenda limiteve ligjore mundëson transformim “të vetvetes” si dhe si një partner serioz që mund të ndalë “dorën e rrezikut”, dhe për fenomenet ekstreme të natyrës sikurse është fenomeni “përmbetje”. Organizata e policisë, duke pasur në thelb, “që prej lashtësisë misionin e administrimit civil, janë ruajtës rendi, ruajtës qytetërimi, ruajtës të ligjit”⁹⁰. “Siguria publike”, është bërë strumbullari i legjislacionit në konsolidim, përfshi Shqipërinë veçanërisht në tre dekadat e fundit. Pikëpamja legjislative, “siguria publike”, edhe pse është pjesë e sigurisë kombëtare, ajo është e materializuar në formacione ligjorë e administrativë si ligji për Policinë e shtetit, “Kreu X, *Bashkëpunimi me komunitetin dhe subjekte të tjera*”, neni 76, *Bashkëpunimi me komunitetin* në pikën “1” thuhet se: “Policia bashkëpunon me komunitetin për garantimin e rendit dhe sigurisë publike për ushtrimin e plotë të lirive dhe të të drejtave të personave, për rreziqet që mund t’u kanosen nga situatat e fatkeqësive natyrore e atyre aksidentale”⁹¹.

Zbatueshmëria ligjore legjislative buron nga një nen i posaçëm që quhet: “Neni 5, *Parimet e veprimtarisë së Policisë së Shtetit*”, taksative të zbatueshme, si parimet bazë, mbi bazën e të të cilave udhëhiqet Policia e Shtetit në gjithë veprimtarinë e saj⁹². Koncepti “siguri” është i vjetër që nga “*Westfalia*”, por dhe një koncept i ri, që rrënjët i ka tek “shkaqet e pasigurisë” që fillojnë me tezat e kërcënimeve në shoqëri, shtete, rajone, sistemin global internacional, analizuar nga hartuesit e parimeve në qeveri, parlamente, analiza akademike, OJQ, korporata transnacionale dhe organizata ndërkombëtare; ku përgjigjet e tyre përcaktojnë cilësinë e paqes dhe stabilitetit në shek. XXI⁹³. Katër shekuj “eksperiencë” nuk është pak për çadrën e sigurisë së sovranitetit *Westfalia*-n, pavarësisht natyrës shoqërore, evoluimit kulturor dhe mentalitetit të solidaritetit rajonal dhe europian. Ndjeshmëria e cënueshmërisë sot është ndërgjegje nesër përballë vërshimeve përmbetje, në rrëshqitje të dheut, në kode standarde të ndërtimit, në parashikimin e aktiviteteve bujqësore pavarësisht klimës e uraganeve apo degradimit mjedisor, duke menduar për ekosistemin me pyllëzimin e zonave për ndryshimin e klimës, duke parashikuar rritjen e nivelit të detit dhe ndryshueshmërinë e regjimeve të reshjeve në të gjithë botën.

Analiza e menaxhimit të rreziqeve përmes studimeve është kërkesë për shtetin, institucionet përgjegjëse, por edhe për bashkërendim ndërmjet agjencive të OKB-së,

⁸⁹ Shqipëria e ka miratuar marrëveshjen me ligjin nr. 75/2016, “Për ratifikimin e marrëveshjes së Parisit, në kuadër të konventës kuadër të Kombeve të Bashkuara, për ndryshimet klimatike”, datë 14.7.2016, shpallur me dekret të Presidentit të RSh-së nr. 9710, datë 1.8.2016.

⁹⁰ Dr. Bilbil Memaj, Rev. “Policimi dhe Siguria”, Nr 4/2016: “Siguria publike arrihet me specialistë të shkolluar dhe inteligjentë”, Tiranë, 2016, faqe 12.

⁹¹ https://www.mb.gov.al/wp-content/uploads/2018/02/Ligji_i_policise_se_shtetit_2014.pdf, faqe 30.

⁹² Parimet bazë, të veprimtarisë së Policisë së Shtetit nga të cilat udhëhiqet në veprimtarinë e saj, bazë janë: a) ligjshmëria; b) mosdiskriminimi; c) respektimi i të drejtave dhe lirive themelore të njeriut; ç) proporcionaliteti; d) pavarësia operationale; dh) paanshmëria politike; e) integriteti, merita dhe profesionalizmi; ë) transparenca; f) ruajtja e informacionit të klasifikuar; g) kontrolli dhe llogaridhënia. https://www.mb.gov.al/wp-content/uploads/2018/02/Ligji_i_policise_se_shtetit_2014.pdf, faqe 2.

⁹³ Graeme P. Herd, “Siguria”, Kapitulli 1, “Çështjet politike në botën e sotme”, publikuar nga “D>N, MacIver”, Manchester: Shtypi i Universitetit të Manchester, Britani e Madhe, 2004, faqe 17.

OJQ-të, kompanitë e sigurimeve, instituteve të kërkimit shkencor duke ofruar gjithmonë zgjidhje me të dhëna adekuate, statistika, azhurnime, përputhshmëri e shkëmbim informacionesh, që gjithmonë “peshorja” e zgjidhjeve të ketë zgjidhje funksionale, përmes departamenteve dhe agjencive për ta pasur sigurinë publike plotësisht të sigurt. Në këto kushte faktorët ekstremë të motit duhet të gjenden përballë një “operacioni” të gatshëm për veprim ku Policia e Shtetit ka sferën e vet të veprimit në kuadrin e përgjithshëm të sigurisë kombëtare. Studimi do të sjellë klasifikim elastik dhe të përshtatshëm kombëtar dhe bashkëpunues rajonal me sisteme të qëndrueshme të informatizuar me politika e strategji kombëtare, rajonale e ndërkombëtare të rajonit, në kuadër të BE-së si dhe të Organizatës së Kombeve të Bashkuara për fenomenet ekstreme të natyrës.

Raportet, statistikat e informacionet, regjistrimet mund e duhen të përgatiten nga qendra kombëtare të kërkimit, universitete, akademi, institute; të cilat “sigurinë publike” ta kenë plotësisht të mbrojtur në kuadrin e sigurisë së përgjithshme të çdo shteti të rajonit. Infrastruktura në dispozicion mund e duhet t’u paraprijë projektimit, zbatimit, monitorimit dhe vlerësimit të përgjithshëm të politikave e strategjive për sigurinë publike.

Zotërimi i një game të gjerë të të dhënave bazë është e rëndësishme për një analizë të dokumentuar mirë me informacion të bollshëm për komunitetin, ekonominë, gjeografinë, programet qeveritare, koordinimin midis institucioneve të shteteve fqinjë etj, përfshi një shkëmbim të ndërsjellët në kohë me efikasitet dhe duke bashkëpunuar mes agjencish përgjegjëse për parandalimin dhe përgjigjen ndaj fenomeneve ekstreme të natyrës. Funksionaliteti deri në ekzekutim i gjithë sektorëve do të jetë zgjidhje sipas një kornize kombëtare të domosdoshme që të jetë e njohur dhe e zbatueshme për të gjitha nivelet e qeverisjes. Kërkesat e standardizuara për çdo fenomen ekstrem të natyrës do të lidhet në zgjidhjet mbi analizën e rrezikut e inventarizuar në nivel kombëtar, dhe duhet të ofrojë operativitet e lehtësi njohje e përdorimi të sistemeve, gjithpërfshirje, lehtësisht e kontrollueshme, e urbanizuar nga ana infrastrukturore, me administrim të qartë që ofrojnë zgjidhje procedurale të menjëhershme ndaj çdo fenomeni, por mbi të gjitha e planifikuar në kohë. Menaxhimi i informacionit gjatë një emergjence të fenomeneve ekstreme është një pjesë thelbësore e çdo operacioni efektiv duke bërë edhe koordinimin e urgjencës. Rrjeti menaxhues duhet të përfshijë komunitetin e prekur, agjencitë e ndihmës, pjesa e sistemit qeverisës qendror e vendor për të mbështetur vendimmarrjen e shpejtë në të gjitha nivelet. Sinergia e bashkëveprimit kombëtar e rajonal do ishte me shumë dobi kur shkëmbimi i përvojave dhe përpjekjeve të përbashkëta të organizatave të kontribuonin në sigurinë rajonale dhe globale.

Strukturat shtetërore të vendit tonë kanë gjithmonë një derë të hapur tek *Këshillit të Atlantikut të Veriut* (NAC), organizmi strukturor i NATO-s, që e ka për mision mbështetjen në planin bilateral, si dhe nëpërmjet Departamentit të Planifikimit të Emergjencave⁹⁴ koordinon dhe integron përpjekjet e përbashkëta, sipas listë kërkesave të vendeve që mund të kenë fatkeqësi nga faktorë ekstremë të natyrës, sikurse ka qenë mbështetja që ju dha Shqipërisë në rastin e përmbytjeve të vitit 2011, dhe tërmetet e vitit 2019. Në situatat ekstreme të faktorëve natyrorë policisë i shumëfishohet ngarkesa. Krahas zbulimit dhe goditjes së rreziqeve që i vijnë shoqërisë nga brenda si rezultat i veprimit të dorës së krimit, mbrojtjen e të drejtat e qytetarëve në kohë paqe, shmangies dhe parandalimit të veprave që cenojnë rendin publik dhe individin, brenda kufijve të ligjit, duhet të përballet edhe me sfidat e shtuara të emergjencave të përmbytjeve dhe

⁹⁴ Në original quhet “Civil Emergency Planning” (Sha).

sinkronizimin dhe sinergjizmin e shumë faktorëve për të vendosur qetësinë e prishur dhe ruajtjen e sigurinë publike në kohë përmbytjeje dhe jo vetëm. Polici profesionist, është inteligjenti me kulturë të re komunikues, psikolog, edukues, por kur situatë e detyron edhe përdorues dhune brenda në kufijtë e ligjit.

Për komunitetin e vendosur me e pa plan sipas parimit të “lëvizjes së lirë”, veçanërisht në këto tre dekadat e fundit marrin vlerë shpjegimet dhe parapërgatitjet për popullatën se çfarë duhet të bëjë para përmbytjes, gjatë përmbytjes si dhe pas përmbytjes. Problemi është që fenomenet ekstreme “përmbytje” të kanalizohen drejt zgjidhjeve. Fokusi kryesor është momenti i njoftimit dhe ndërgjegjësimit se çfarë duhet të bëjmë para përmbytjes dhe më konkretisht strukturat përkatëse duhet që: të praktikojnë me familjet planet e emergjencës dhe evakuimit për të qenë gjithmonë të gatshëm; të përgatisin një paketë me ushqime, ujë dhe disa veshje rezervë për të gjithë pjesëtarët e familjes; të mbajnë gjithmonë kutinë e ndihmës së shpejtë në vende të sigurta bashkë me dokumentet e rëndësishme për t’i marrë me vete në një moment rreziku; të vendosin pajisjet elektrike dhe ushqimet e emergjencës në vende dhe katet e sipërme të ndërtesës ku nuk mund të preken nga përmbytja⁹⁵. Masat paraprake praktike, prevalojnë kur rreziku është afër dhe që kërkojnë kuptueshmëri dhe ndërgjegjësim se një përmbytje e mundshme duhet perceptuar si e tillë. Faza tjetër kulmorja është gjatë përmbytjes dhe për këtë fazë masat janë të parashikueshme dhe evidente si: largimi nga shtëpia që rrezikohet dhe kur nuk mundemi të ngjitemi në pjesën më të lartë të saj.; ndihma ndaj fëmijëve dhe të moshuarve si dhe të sëmurët për të shpëtuar nga mbytja; qëndrimi larg vendeve të rrezikshme si puseta, kanale, ujëmbledhës, sepse vrulli i ujit mund të na marrë duke rrezikuar jetën tonë; rritja e kujdesit dhe të mos ecim përmes ujërave të rrëmbyeshëm; lajmërimi për evakuim duke dëgjuar me vëmendje dhe të zbatojmë këshillat dhe udhëzimet e autoriteteve që menaxhojnë emergjencat dhe të ndjekin menjëherë atë rrugë që kanë përcaktuar për evakuim; kur jemi duke përdorur mjetin ndalojmë dhe parkojmë në një vend ku nuk preket nga përmbytja⁹⁶. Faza përmbyllëse e përmbytjes është ajo “pas përmbytjeve”, e kthimit në banesë pasi të kenë urdhëruar drejtuesit e emergjencës; të mos takojmë asnjë çelës elektrik pa u bindur për sigurinë e rrjetit; vijimi i kontrollit të rrëzimit e mureve, shkallëve, dyerve apo kanalet e ndryshme të shkarkimeve të ujërave dhe të lajmërojmë autoritetet për dëmtimet e ndryshme të banesës; të mos përdorim ujin për pirje që vjen nga rrjeti i ujësjellësit sepse mund të jetë i infektuar; mos përdorimi i ushqimeve të lagura për të evituar sëmundjet; përdorimi i mjeteve rrethanore për të pastruar banesën nga uji ose kur keni mundësi mund të përdorim pompa dore ose motopompa, të ndihmuar nga specialistët të ardhura nga strukturat shtetërore dhe ato vullnetare.

Një shembull i mirë vjen nga pushteti vendor në Tiranë, mbi mënyrën e sjelljes praktike ndaj përmbytjeve nga ka dalë për qytetarët e vet, “Udhëzimet për parandalimin e përmbytjeve në rajonet e rrezikshme”,⁹⁷ që është një thirrje për përgjegjshmëri dhe detyrime qytetare, të shoqëruara me udhëzime përgjatë periudhës së përmbytjeve, në rastet e evakuimit, në rastet kur duhet braktisur banesa si dhe pas përmbytjes deri tek dokumentacioni për përfitim të qytetarëve në rast të fatkeqësive natyrore. E njëjta praktikë po përdoret aktualisht në sensin praktik të përballimit të fenomenit ekstrem të natyrës edhe në bashki e prefektura të tjera të vendit e deri në njësitë administrative të

**AKADEMIA
E SIGURISË**

*Konferencë
Shkencore
ndërkombëtare:*

« Fenomenet
ekstreme
të natyrës
dhe çështjet
e sigurisë »

⁹⁵ <http://www.mod.gov.al/index.php/ministria/strukturat-vartese/dpec/3328-permbytje>

⁹⁶ Po aty. (shih: “Çfarë duhet të bëjmë gjatë përmbytjes?”)

⁹⁷ <https://www.tirana.al/sherbimi/emergjenca-civile>.

cilat ose janë pranë fenomeneve ekstreme natyrore të përvitshme të përmbytjeve ose kanë shtrirjen në zonat e “kuqe” të veprimit të përmbytjeve dimërore, ku në shumicën e rasteve kanë të organizuar mënyrën e organizimit konkret të njoftimit, të alarmit, të planeve të evakuimit, të vendvendosjes dhe sipas kohëzgjatjes edhe programimet e rikuperimit dhe rikthimit në gjendjen fillestare.

Në kushtet e problematikave të shkaktuara nga faktorë ekstremë të natyrës institucionet dhe strukturat qendrore të mbrojtjes civile janë ato që i japin zgjidhjet të përgjegjshmërisë ligjore⁹⁸ çdo lloj problemi. Ligji ka parashikuar gjithashtu edhe strukturat operacionale të mbrojtjes civile⁹⁹, që angazhohen drejtpërdrejtë në përballimin e fatkeqësive natyrore ose fatkeqësive të tjera në vend, ku veç institucioneve të tjera dhe Policia e Shtetit ka një rol parësor në përballimin e këtyre emergjencave. Përmirësimi në shkallë të konsiderueshme, i këtyre elementëve do të jenë efektiv kur të jenë gjithëpranuar edhe në drejtimin e përballimit të fenomeneve ekstreme të natyrës me “standartet evropiane”.

7. Përfundime

Thelbi i përfundimeve dhe rekomandimeve në lidhje me përmbytjet lidhet në radhë të parë me mbrojtjen e jetës së banorëve, pronës, gjësë së gjallë e bizneseve të vendosura në “hartat e rrezikut” të përmbytjeve me qëllim t’i “ndalet dora” natyrës për fenomenet ekstreme të përmbytjeve, por edhe fenomenet e tjera ekstreme të natyrës që vendi ynë i ka me shumicë. Nuk ka fenomen ekstrem të natyrës si përmbytje, tërmete, orteke, rrëshqitje, dëborëra, ngrica, erozione, erëra të forta, bllokime rrugësh, nevoja imediate, ku nuk kërkohet ndërhyrje për qetësinë e përditshmërisë në jetën publike, nuk ka situatë emergjence, ku mbështetja e policimit është emergjencë e parë dhe kur ajo jepet me efikasitet, shpejtësi, kulturë institucionale respektimi edhe më i madh i uniformës së Policisë së Shtetit është në natyrshmëri dhe ajo që kërkon komuniteti. Në çdo ngjarje apo kompleks ngjarjesh të fenomeneve ekstreme të natyrës, shpëtimtarët e parë janë të kudondodhurit punonjësit e Policisë së Shtetit, të kudoshtrirë dhe të kudogjendur si institucion përgjegjës i sigurisë publike. Mbrojtja e jetës së qytetarit, në kohë emergjence lidhet me veprimin e policit, zjarrfikësit, ushtarakut, qytetarit, që shpëtimtarë në çdo rast fatkeqësie dhe emergjencë natyre, në luftë me krimin, me fenomene të njohura e të panjohura të ekstremeve të natyrës, që natyra jonë i ka me bollëk. Lumenjtë janë rreziku më i madh për përmbytjet, që prekin 130 000 hektarë tokë bujqësore, ndërkohë që rreth 7 000 hektarë tokë çdo vit përlllogaritet e përmbytur. Vetëm në përmbytjet e 33 viteve të fundit vendi ka pasur një një dëm ekonomik që vlerësohet në 2.3 miliardë dollarë¹⁰⁰. Bazuar në *Sistemin e Inventarit të Katastrofave* (DesInventar), që përmban informacione për rreth 4000 ngjarje midis 1851 dhe 2013 në Shqipëri 95% e qyteteve, fshatrave, ish-komunave, njësive administrative kanë qenë prekur nga të paktën një

⁹⁸ Institucionet dhe strukturat qendrore të mbrojtjes civile janë të përcaktuara tek neni 16 i Ligjit nr. 45/2019, “Për mbrojtjen civile” dhe më konkretisht janë: a) Kuvendi; b) Këshilli i Ministrave; c) Komiteti Ndërmnistror i Emergjencave Civile; ç) Komiteti i Mbrojtjes Civile (KMC), zyra përgjegjëse për situatën; d) ministri përgjegjës për mbrojtjen civile; dh) ministritë dhe institucionet qendrore; e) Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile; ë) komisioni teknik këshillimor; f) qendrat e mbrojtjes civile në qark (QMCQ).

⁹⁹ Neni 32 i Ligjit nr. 45/2019 parashikon: “Strukturat operacionale të mbrojtjes civile, që angazhohen në përballimin e fatkeqësive natyrore janë: a) Forcat e Armatosura; b) Policia e Shtetit; ç) Shërbimi i Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimt; dh) Shërbimi i Urgjencës Mjekësore dhe strukturat e tjera të shërbimit shëndetësor; d) Shërbimi i vullnetarëve për mbrojtjen civile”.

¹⁰⁰ <https://www.rec.org/project-detail.php?id=21>

përmbytjeje¹⁰¹.

Përmbytjet jo rrallë herë janë bërë kryelajme në Shqipëri, në rajon e më gjerë nëpër rajone të ndryshme të globit. Të krijon përshtypjen e fundit të botës. Asnjë sistem nuk ka mundur të “bëjë pakt” dhe përballat me natyrën, për të ndaluar egërsinë e furisë zemërake të natyrës “përmbytje”. Qindra e mijëra shërbyes të zellshëm të shtetit, ushtarë, policë, zjarrfikës, punonjës bashkëish në raste përmbytjesh në vend kanë treguar sa lartë qëndron “steka” e përkushtimit në detyrë përfshi çmimin e sakrificave. Por të gjitha së bashku nuk kanë mjaftuar dhe nuk mjaftojnë. Prandaj gjykojmë se përfundimet rreth kësaj teme plotësojnë studimin mbi “përmbytjet” si fenomen ekstrem natyror i mundshëm për t’u kontrolluar, përballuar, disiplinuar dhe minimizuar humbjet në njerëz, gjë të gjallë dhe prona e biznese.

- Shmangia e skenarëve të kërcënimit të fenomenit “përmbytje” duhet të tejkalojnë veprimet ambicioze të klimës me angazhim, politika e strategji antipërmbytje, si dhe angazhime për përmbushjen e detyrimeve që rrjedhin nga *Marrëveshja e Klimës* (Paris).

- Përvoja botërore shërben për të paraprirë rreziqet e kërcënimit e përmbytjeve duke punuar për të parashikuar të ardhmen. Përvoja jonë rezultoi me shumë humbje e dëmtime për mungesë planesh, politikash, strategjish koordinimi e bashkëpunimi institucionale. Të disiplinosh të sotmen do të thotë të minimizosh kërcënimet e përmbytjeve në të ardhmen.

- E ardhmja lidhet me kooperimin ndërinstitutional për të njohur fenomenet ekstreme të natyrës të përmbytjeve, duke shfrytëzuar dhe të dhënat që vijnë nga fqinjët, europianët, partnerët strategjikë dhe institucionet prestigjioze të botës në lidhje me përmbytjet, ndryshimet klimaterike, erozionet, etj.

- Përfshirja në sistem e edukimit akademik të sigorisë të Fenomeneve Ekstreme të Natyrës, përmbytjet, dhe jo vetëm, duke rritur kulturën e përgjithshme të njohurive, duke studiuar fenomenet më ekstreme në botë dhe duke i ballafaquar me ato shqiptare si studime për rastet analogjike, duke u fokusuar në bashkëpunimin shumëdisiplinor me qëllim që vendimmarrja dhe vendimmarrësit të bazohen në shkencë.

- Nxjerrja e mësimave mbi fenomenin “përmbytje” përmes statistikave të plota, të cilat mund të shfrytëzohen nga organet kompetente shtetërore, duke përfshirë edhe Policinë e Shtetit, strukturat e mbrojtjes dhe strukturat e tjera ligjzbatuese.

- Politikat dhe strategjitë e deritanishme në lidhje me fenomenin ekstrem të natyrës “përmbytje” kanë provuar paefekshmërinë e sistemit standard të deritanishëm si dhe mosfunksionim të sistemit bashkëpunues e koordinues nga nivelet qendrore e lokale.

- Deri më sot është provuar ajo që thotë Robert A. Heinlein, se: “Një brez që injoron historinë, nuk ka të shkuar e as të ardhme”, dhe kjo bën që historia të përsëritet, edhe në problemin e pazgjidhur të përmbytjeve, dhe pasojat e pasigurisë kombëtare dhe veprimit të fenomenit “përmbytje” shkaktojnë deri në humbje katastrofale.

- Politikat dhe strategjitë për minimizimin e dëmeve nga fenomeni përmbytje nuk janë një “ishull”, dhe që as mund të zbatohen nga një institucion i vetëm, por kërkon bashkëpunimin dhe kooperimin ndërinstitutional.

- Në kushtet e shfrytëzimit barbar të natyrës, nga njerëzit për prishjen e ekosistemeve, por edhe në kushtet e ngrohjes dhe ndotjes së mëtejshme globale, kërkohet rritja e rolit të shtetit si përgjegjësi i parë i sigorisë publike duke ngritur e menaxhuar veprim efektiv energjik në shërbim të komuniteteve që shtrihen në zonat më problematike që kanë

¹⁰¹ Po aty.

përmbytje të përvitshme dhe më tej për të eliminuar migrimin nga efekti i rënies së standardit të jetesës në mënyrë drastike¹⁰². Fakt është se në dy dhjetëvjeçarët e fundit, klima i ka kushtuar shumë njerëzimit¹⁰³.

- Raca njerëzore ka qenë përballur gjithmonë me fenomenet ekstreme të natyrës dhe sërisht “forcat ekstreme natyrore”, të përmbytjeve nuk e “falin” njerëzimin, prandaj skenarët e zgjidhjes ngelen detyrim për strukturat kompetente të shtetit; ndërkohë që sfida përballë këtyre fenomeneve parashikohet se do të vijojë.

- Studimi mbi fenomenet ekstreme të natyrës, e kryesisht atyre të fenomenit përmbytje është referencë e parë e sigurisë si substance e jetës njerëzore, që e kërkon policimin sa më pranë komunitetit njerëzor, që të kuptojë filozofinë e policimit në komunitet, mendësinë, kulturën e menaxhimit, ndërtimin e partneritetit, përmirësimin e infrastrukturës, dhe në fund të fundit krijimin e një imazhi të ri për Policinë e Shtetit, që ofron besim dhe që policimin e çon gjithnjë e më pranë njerëzve.

- Fenomenet e natyrës ekstreme të përmbytjeve të vendosen përballë forcës njerëzore dhe mençurisë së tij se, çdo lloj elementi “forcë ekstreme natyrore”, të mund të neutralizohet me skenar zgjidhjeje në interes të sigurisë njerëzore duke ecur jo më në rrugë të pashkelura, por vetëm në “korsinë europiane”.

- Progresi legjislativ, përafrimi me ligje të BE-së duhet i dukshëm, praktik, i menaxhueshëm, institucional, bashkëpunues, i udhëhequr nga përvojat e mira europiane.

- Përballë faktorëve ekstremë natyrorë “të verbër” të pamëshirshëm, të mundësohet kundërpërgjigje institucionale me strategji, plane, programe, buxhet financiar, tejpamësi për të sfiduar të ardhmen e mundshme të ripërsëritshme të përmbytjeve (rreziku më i madh për Shqipërinë vjen nga tërmetet, por fakt është se 72% e humbjeve ekonomike i kemi nga përmbytjet¹⁰⁴), me qëllim që, *humbjet masive financiare që vijnë nga përmbytjet të mos jenë shumëfishi i financave të planifikuara për të ndalur përmbytjet*.

- Bashkërendimi dhe bashkëpunimi me partnerë të BE-së, NATO-s, SHBA-së, OKB-së, do të lehtësojë menaxhimin e përbashkët të krizave e katastrofave të përmbytjeve me kosto të përbalueshme, ku shtetet ndërkufitare të administrojnë përgjegjësitë me prezencë në fatkeqësitë natyrore të njeri-tjetrit.

- Planet, programet dhe objektivat afatlargëta të Ministrisë përgjegjëse për arsimin, në lidhje me “një strategji të re”, që parashikohet integrimi në programin shkollor i elementëve të përgatitjes ndaj fatkeqësive ekstreme të natyrës, të mos jenë vetëm në plane teorike. Ekzekutimi konkret kërkon kohë, impenjim, ndërgjegjësim, partneritet strategjik dhe bashkëpunim.

- Aktualisht ligji¹⁰⁵ që fokusohet tek “Arsimimi”¹⁰⁶ dhe “Kryerja e trajnimeve”,¹⁰⁷ në një model të ri të erës europianiste në legjislacionin shqiptar, për përballimin e faktorëve ekstremë të natyrës si përmbytje dhe siguri publike sipas modelit euroatlantik është qasja më reale teorike dhe praktike për zgjidhjen e problemeve edhe në fushën e

¹⁰² Parashihet që deri në fund të këtij shekulli do të ketë 2 miliardë “refugjatë të klimës” dhe “migrantë mjedisorë”. Nga një popullsi e parashikuar prej 11 miliardë deri në vitin 2100, kjo është pothuajse 1/5 e njerëzve në tokë. Shumica e këtyre njerëzve do të kenë jetuar përgjatë vijave të bregdetit. Sipas <https://sciencing.com/impact-natural-disasters-5502440.html>;

¹⁰³ https://cpo.noaa.gov/sites/cpo/Projects/SARP/Extreme_Weather_Factsheet_Compendium.final7.19.13.pdf

¹⁰⁴ (sipas raportit botëror të riskut në botë). Kundzewicz Z. W, Jun X., “Towards an Improved Flood Preparedness System in China”, Hydrological Sciences Journal, Vol. 49:6, 2009, page 941-944.

¹⁰⁵ Ligj nr.45, dt.18.7.2019, Permbrojtjencivile.

¹⁰⁶ Sipas Kreu X, “Arsimimi dhe Trajnimi”, Neni 62, Arsimimi, sipas ligj nr.45, dt. 18.7.2019, Per mbrojtjen civile, faqe 30.

¹⁰⁷ Sipas Kreu X, “Arsimimi dhe Trajnimi”, Neni 63, Kryerja e trajnimeve, ligj nr. 45, dt. 18.7.2019, Per mbrojtjen civile, faqe 30.

emergjencave.

- Buletinet paralajmëruese që lidhen me përmbytjet mund e duhet të dalin nga anonimiteti dhe të jenë më pranë komuniteteve veçanërisht komuniteteve me rrezik përmbytjeje. Fakt është se “Buletini i paralajmërimit meteorologjik” i dedikohet parashikimit të reshjeve, në Shqipëri, mbulon periudhë 36-orëshe, duke filluar nga mesdita e ditës aktuale deri në fund të ditës së ardhshme, për çdo qark të Shqipërisë. Për çdo qark jepet mesatarja e reshjeve, duke vlerësuar sidomos tejkalimin me 45 m/m në 3 orë (mundësi për stuhi). Modeli bazë meteorologjik “COSMO LAM17”(menaxhuar: ARPA Bolonja, Itali)¹⁰⁸.

8. Rekomandime

Bazuar në realizimin e temës “Përmbytjet në Shqipëri faktor ekstrem kërcënues i sigurisë” si dhe të përfundimeve lidhur me fenomenin “përmbytje” me qëllim minimizim të dëmtimeve dhe kërcënimeve mbi sigurinë publike e kombëtare rekomandojmë:

I. Strukturat e posaçme ligjzbatuese rekomandohen të fokusohen tek planet speciūke sektoriale për ndalimin e përmbytjeve, realizim të informacionit periodik sipas fushës së përgjegjesisë; mbajtjen në gatishmëri të kapaciteteve përgjegjëse për kundërpërgjigjen ndaj përmbytjeve; monitorimin sistematik të rreziqeve që vijnë si rezultat i përmbytjeve; planet, programet, skenarët e situatave të përmbytjeve, masat mbrojtëse e parandaluese për përmbytjet, nevojat për trajnim të personelit, studime të mirëfillta lidhur me shkaqet dhe faktorët që shkaktojnë përmbytjet; efektivitetin dhe nivelin e zbatimit të PKEC¹⁰⁹ për përmbytjet; rikrijimi i hartave të përmbytjeve që përcaktojnë sipërfaqet/zonat me rrezik përmbytjeje, dokumentimi efikas i fushatave të ndërgjegjësimit publik dhe edukimit për përgatitjen e mbrojtjen nga përmbytjet, ushtrim kontrollesh për zbatimin e masave mbrojtëse e parandaluese për përmbytjet, risaktësimi i detyrimeve të ndërsjella të strukturave përgjegjëse për parandalimin, mbrojtjen dhe gatishmërinë ndaj përmbytjeve.

II. *Plani kombëtar për emergjencat civile* si dokumenti kryesor i politikave të shtetit për emergjencat civile të rekomandohet të mundësojë reformatimin e qartë të objektivave mbi domosdoshmërinë e ngritjes dhe funksionimit të strukturave që nxisin bashkëpunimin dhe qasjet me fokusim parandalimin dhe mbrojtjen nga përmbytjet, studimi i faktorëve që rëndojnë situatat e përmbytjeve, krijimi i hartave kombëtare të përmbytjeve duke marrë parasysh: *Direktivën* e BE 2007/60/ datë 23 tetor 2007 “Mbi vlerësimin dhe menaxhimin e riskut të përmbytjeve”.

III. Rekomandojmë risaktësim detyrash e përgjegjësish me gjithë ministrinë e linjës dhe institucionet shtetërore, ristrukturim e përpunim planesh e programesh në organizim të personelit të emergjencave civile si institucioni kryesor në menaxhimin e përmbytjeve, sensibilizimin dhe ndërgjegjësimin e strukturave përgjegjëse sipas fushave të përgjegjesisë, për situatat kërcënuese të fenomeneve të përmbytjeve për ushtrinë dhe për Policinë e Shtetit.

IV. Rekomandohet rritja e bashkëpunimit të agjencisë përgjegjëse Agjencia

¹⁰⁸ <https://www.geo.edu.al/newweb/?fq=cimady&gj=gj1> dhe <https://www.geo.edu.al/cima/meteo.pdf>. Instituti i Gjeoshkencave, Energjisë, Ujit dhe Mjedisit – IGJEUM & Qendra Ndërkombëtare për Kërkimin dhe Monitorimin në Mjedis - CIMA (Itali)

¹⁰⁹ Plani Kombëtar për Emergjencat Civile (PKEC) është dokumenti kryesor i politikave të shtetit shqiptar në fushën e Emergjencave Civile, që reflekton përvojën për një sërë dukurish të mundshme rreziku, kapacitetet dhe vështirësitë në përballimin e EC në Shqipëri.

Kombëtare e Mbrojtjes Civile me aktorë e faktorë ndërkombëtarë për marrje të eksperiencave e tyre për forcimin e sistemit të mbrojtjes civile shqiptare dhe zvogëlimin e riskut nga fatkeqësitë, por dhe duke u përgatitur për bashkimin me *Mekanizmin e mbrojtjes civile të BE-së*¹¹⁰.

V. Rekomandim për të mos “shkelur në rrugë të pashkelura” në fushën e përmbytjeve, por të ndoqën shembujt më të përparuar të botës në lidhje me masat kundër përmbytjeve. Shfrytëzimi i përvojave botërore shumëshekullore në administrimin e ujërave, me prita dallgëthyes, diga, kanale, hidrovorë, pompa, zgjerim të shtretërve të lumenjve e deri në krijime të shtretërve artificialë, rishikimi i instituteve shkencore për pyjet dhe ujërat, rritja e ndërgjegjësimit popullor dhe krijimi i një forumi ndoshta të “të urtëve ekologjikë”.

VI. Rekomandohet që të rishikohet, pse jo edhe të ashpërsohet sistemi legjislativ e penal për ndërtimet që prekin zona tradicionale të përmbytjeve duke eliminuar “ankesat” që vijnë për përmbytje pasi ndërtojnë pa leje në pjesët e pasurive publike e kombëtare dhe që kërkojnë dëmshpërblim nga taksat e shqiptarëve.

VII. Rekomandohet njohje në detaje të fenomenit “përmbytje”, duke depërtuar në specifika për lumenjtë “luftarakë” shqiptarë, duke synuar mundësim të “disiplinimit hidrik” me masa antipërmbytje me qëllim që “komandën” mbi sistemet hidrike ta mbajë faktori “njeri”.

VIII. Mundësim të përmirësimeve ligjore, vendimeve, udhëzimeve, politikave, strategjive, taktikave, angazhimeve, projekteve, buxheteve, zgjidhjeve, kodifikimeve mbi sigurinë komunitare dhe sigurinë kombëtare për eliminimin e fenomenit “përmbytje”, me qëllim që “e nesërmja mos të qeshë të sotmen” dhe eliminimin sa më shumë që të jetë e mundur të dëmeve që vijnë nga përmbytjet.

IX. Rekomandojmë ruajtjen e kujtesës institucionale, përf forcimi i kapaciteteve njerëzore e teknologjike, pranimit dhe ofrimi reciprok i ndihmës dhe asistencës ligjore, trajnuese, praktike, materiale dhe garantimi i sigurisë publike përballë fenomeneve ekstreme të natyrës.

X. Rekomandim për mundësimin e politikave dhe strategjive për mbrojtje ndaj kërcënimeve të fenomenit “përmbytje”, duke bërë koordinim ndërsektorial të strukturave të shtetit përballë fenomeneve në rritje të ekstremit natyror, duke i dhënë përparësi buxheteve afatgjata si dhe “mjekim” afatgjatë të plagëve të përmbytjeve, që lidhen me aspektet njerëzore, mjedisore, infrastrukturore, shëndetësore etj., duke parë realisht strukturat operacionale direkte¹¹¹ (struktura e policimit)¹¹², agjencitë¹¹³, donacionet e burimet e ligjshme.

XI. Kundërpërgjigje energjike për gjithë fatkeqësitë ekstreme natyrore: përmbytje, tërmete, zjarre, thatësira, rrëshqitje dherash, ndotjet mjedisore, pandemi etj., duke bërë

¹¹⁰ Në Shqipëri aktiviteti i pestë në nivel kombëtar, që shënon fillimin e programit “IPA Floods and Fire (IPA FF)/ Instrumenti për ndihmën e para pranimit, për përmbytjet dhe zjarret”, Konsorciumi IPA FF është themeluar nga departamenti italian i Mbrojtjes Civile, si koordinator, bashkë me AMC të Suedisë, Sllovenisë, Rumanisë, Brigadës së Zjarrit dhe Shpëtimit të Rajonit të Moravian-Silesian, të Republikës Çeke, Fondacionit të Qendrës Kombëtare Rumune për Menaxhimin e Fatkeqësive dhe Fondacionit Italian CIMA. Sipas <https://www.mod.gov.al/index.php/newsroom-2/4827-nis-ne-shqipëri-aktiviteti-i-programit-ipa-ff-per-përmbytjet-dhe-zjarret>

¹¹¹ Ligji përfshin: a). Forcat e Armatosura; b). Policia e Shtetit; c). Shërbimi i Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimit; ç). Shërbimi i Urgjencës Mjekësore dhe strukturat e tjera të shërbimit shëndetësor; d). shërbimi vullnetar për mbrojtjen civile.

Kuvendi i Shqipërisë, Ligj nr. 45/2019, “Për mbrojtjen civile”, Neni 35, Tiranë, 2019, faqe 18.

¹¹² Policia e shtetit veprimtarinë në kuadër të ligjit “Për mbrojtjen civile”, i zgjidh bazuar në “nenin 35” Policia e Shtetit, ku detajohen detyrimet ligjore institucionale. Policia e shtetit si një ndër pesë strukturat që përfshihen në kushtet kur ndodhin fenomenet ekstreme të natyrës zgjidhin këto probleme: “Pika 2”, “mbrojtjen e zonës së emergjencës civile, ruajtjen e rendit publik, procesin e identifikimit dhe të informimit rreth të dëmtuarve dhe viktimave, largimin e tyre nga zona e emergjencës, si dhe detyra të tjera që dalin në zbatim të legjislacionit në fuqi për Policinë e Shtetit e më gjerë.

mbulim me vëzhgim gjithë zonave dhe xhëpave të terrenit të konsideruar të “vdekur” nga pushtetit vendor dhe strukturave operacionale dhe krijimin e gjendjes së shëndetshme për sigurinë komunitare. Çështjet e shëndetit publik sipas eksplorimeve e analizave të instituteve të ndryshme në botë janë ndër problemet më të ngutshme pas çdo fatkeqësie të ekstremimit natyror të përmbytjeve dhe fenomeneve të tjera, fenomene që mund të shoqërohen me çështje të higjienës së ujit, depozitimi i mbeturinave njerëzore si rrezik për shëndetin publik, të higjienës së ushqimit, bakteret patogjene dhe vektorët e tjerë të sëmundjeve përfshi dhe sëmundjet kronike dhe për të gjitha këto rekomandohet zgjidhja e bashkëorganizuar e strukturave shtetërore nën drejtimin e një shtabi qendror si domosdoshmëri.

XII. Rekomandohet mirëinformimi për situatat e kërcënimeve reale që vijnë nga faktorë ekstremë natyrorë, duke arsyetuar të domosdoshme zanafillën e edukimit, arsimimit e trajnimeve për policim e siguri publike, si faktor kyç për siguri publike, për kundërpërgjigje ndaj situatave specifike, duke parashikuar edukimin si kulturë për vështirësive ekstreme me të cilat mund të përballët shoqëria, formacionet shtetërore dhe gjithë shoqëria.

Aneke dhe tabela

**Përmbytjet në Shqipëri,
harta e zonave të rrezeqeve,
dëmet, shkaqet**

Zonat e përmbytjeve janë skeduar për më shumë se një shekull, veçanërisht në gjysmëshekullin e kaluar ku statistikisht janë edhe më të plota dhe më të organizuara. Shqipëria në dekada është përballuar me përmbytje të madhësive të ndryshme, ku natyra dhe dora e njeriut ka bërë që lumenjtë të dalin nga shtrati, e të marrin përpara gjithçka: toka bujqësore, banesa, bagëti, e gjithçka tjetër.

Koha e përmbytjeve	Lumenjtë që dalin nga shtrati	Vendi i përmbytur	Dëmtimet	Shkaku i përmbytjes
Dhjetor 1962 dhe Janar 1963	Lumi Drin dhe Buna	Niveli i ujit ishte rreth 80 cm edhe në qytet. Nënshkodra, Shkodra dhe Lezha ishin plotësisht të përmbytura	U përmbytën 70 mijë ha toka bujqësore dhe të gjitha qendrat e banuara që ndodheshin në këto zona, Shkodër, Lezhë, mbi 10 mijë njerëz u evakuuan	Prurjeve të shumta të lumenjve Drin, Buna si dhe gjithë lumenjtë e tjerë në veri.
Shtator 1995- Janar 1996	Gjithë lumenjtë e Shqipërisë nga Jugu në Veri të vendit	Zonat Shkodër, Lushnjë, Krujë, Laç, Durrës, Lezhë dhe fshatrave përreth tyre ndjehen pasojat e mëdha të përmbytjeve.	Përmbytjet në mbi 20 mijë hektarë të herëpashershme. U shndërruan në gërmadha shumë shtëpi banimi, në raste të veçanta duke marrë edhe jetë njerëzish evakuime të shumta	Prurje të shumta të të gjithë lumenjve të Shqipërisë në veri dhe në Jug të vendit.
22-30 Shtator 2002	Drini, Buna dhe Ishmi	Reshtet e shumta, krijuan një situatë të rëndë për Milotin, Lezhë, Torovioë, Zadrime e Shkodër.	U përmbytën mbi 16.000 ha tokë bujqësore dhe u prekën 7500 familje. U evakuuan shumë familje nga zonat e përmbytura.	Rreshet e shumta në të gjithë zonën veriore të Shqipërisë
Shkurt-mars 2004	Drini, Buna, Ishmi	Zonat në Veri të Shqipërisë kanë pësuar dëme e vështirësi rikuperimi për vite me radhë	U përmbytën qindra hektarë tokë dhe u dëmtuan rreth 400 banesa	Rreshe të shumta në të gjithë zonën veriore të Shqipërisë
Dhjetor 2005,	Dalja nga shtrati e lumit Vjosa	Preku kryesisht në zonat Jugore të Shqipërisë.	U përmbytën rreth 7000 hektarë dhe u dëmtuan rreth 350 banesa, biznese dhe qendra sociokulturore	Reshtje të shumta në të gjithë zonën veriore të Shqipërisë
2010 - 2011	Lumi Drin dhe Buna	Niveli i ujit ishte mbi 1 metër në qytet. Nënshkodra, Shkodra dhe Lezha ngjani si Venecia	Situata u përsërit dy vjet rresht, ku të përmbytura do të rezultinin mbi 14000 hektarë tokë, 1200 godina e mbi 12 mijë njerëz u dëshën të evakuohen	Prurjeve të shumta në Drin të hidrocentralit, Fierza, Komani, Vau i Dejës, dëstruan të hapnin portat e shkakimit
Shkurt 2015	Lumi Vjosë me burime nga Mali i Pindit në Jug si dhe lumenjtë Devoll, Osum Seman	Ishatrat përgjatë rrjedhës së poshtme të Vjosës, si Mifol, Novoselë, Bishan, Filtore e Poro do të mbulohehin nga uji.	9992.6 hektarë tokë, e përmbytur, 709 banesa të dëmtuara plotësisht apo pjesërisht nga vërshimi i Vjosës, 300 biznese, 16 shkolla dhe 10 ura të dëmtuara, 3500 bagëti të mbytura	Shkak kanë qenë rreshtet e mëdha që prej maleve të Pindit e deri përgjatë gjithë luginës së Drinos dhe Luginës së Përmetit, Tepelenë, Mallakastër e Vlorë
29 nëntor 2017	Lumi Vjosë me burime nga Mali i Pindit	Ishatrat përgjatë rrjedhës së poshtme të Vjosës,	10622 hektarë tokë, 4700 banesa, 41 biznese, u dëmtuan 56 shkolla dhe 65 ura në të gjithë Shqipërinë.	Shkak kanë qenë rreshtet e mëdha që prej maleve të luginave si dhe vërshimit të të gjithë lumenjve e përranjëve më të vegjël që mbushin Vjosën

**AKADEMIA
E SIGURISË**

*Konferencë
shkencore
ndërkombëtare:*

« Fenomenet
ekstreme
të natyrës
dhe çështjet
e sigurisë »

Aneksi:
Kapacitetet dhe
burimet
kombëtare
për t'ju përgjigjur
fenomeneve
ekstreme natyrore
në kuadër
të përballimit reagues
të Emergjencave Civile
kombëtare shqiptare

Instytucioni reagues ndaj FEN/Emergjencave	Specialiteti	Kapaciteti i mundshëm
Batalioni i Mbrojtjes Civile/KM/SHP/MM	Për kërkim-shpëtimin për përmbylljet; për kërkim-shpëtimin për tërmetet; për kërkim-shpëtimin për zjarret; për ndodjet kimike; për kërkim-shpëtimin për terrene malore. Për hapjen e rrugëve nga bora dhe rëshqitjet e dherave	Për çdo lloj specialiteti nga 2 grupe në gatishmëri, ndërsa për hapjen e rrugëve nga bora dhe rëshqitjet e dherave janë 3 grupe në gatishmëri.
Shërbimi i kërkim-shpëtimin Komanda e Forcave Ajrore/SHP/MM	Shërbimi kombëtar i kërkim-shpëtimin për transportin ajror.	56 persona dhe 7 helikopterë; 2 AB-205 dhe 5 AB-205 me një kapacitet transportues 30 veta
Batalioni i Operacioneve Speciale FLD/SHP/MM	Kërkim-shpëtimin për aksidentet detare dhe ajrore Kërkim-shpëtimin në det dhe ujrat brendshme	1 grup 6 motoveheta 2 polumbarë
Batalioni i mbrojtjes kundër kimike, bakteriologjike dhe nukleare/SHP/MM	Për shpëtimin në raste të mundshme të fakteve kimike, bakteriologjike dhe nukleare.	1 grup 25 specialistë
Spitali Ushtrarak (Spitali i Traumës)/MM	Urgjencë kirurgjike (secili i përbërë nga një kirurg, një traumatolog, një reanimator dhe tre ndihmës. Për sëmundjet infektive (përbëhet nga një infeksionist, një epidemolog, një higienist dhe dy ndihmës)	2 grupe 1 grup
Batalioni komando/batalioni special/KFT/SHP/MM	Për kërkim-shpëtimin jo të specializuar.	200 + 200 foror efektive, veprim në çdo lloj terreni, mod.
Instituti i Fizikës Bërthamore	Për zbulimin e rrezatimit	1 grup
Për probleme të specializuara Ministria e Bujqësisë	Inspektorati i Ushqimit në të gjithë vendin	114 specialistë
Ministria e Industrisë dhe e Energjetikës dhe Ministria e mjedisit	Për sigurinë e mjedisit Për inspektim në miniera Për rehabilitim dhe mbrojtje mjedisit Për përgjigjen në raste të emergjencave në furnizimin me energji elektrike Për inspektimin e karburanteve.	2 specialistë 52 specialistë 53 specialistë 60 specialistë (KESH) 22 specialistë
Spitali Ushtrarak, Tiranë (MM)	Për Laborator kimik të specializuar	20 specialistë
Ministria e Transportit dhe Telekomunikadort	Kapacitete transporti hekurudhor	25 lokomotiva, 64 vagona pasagjerësh, 220 vagonë mallrash
Ministria e Turizmit dhe e Rregullimit të Territorit.	Transport uji Transport mbeturinash (flekalesh). Për saldim dhe preje Për lëvizje dherash	6 autobote 5 autobote 5 mjete 1 mjet fadromë.
Batalioni i Mbrojtjes Civile/KM/SHP/MM	Për transportues (për njerëz). Për transportues (për mallra). Për transport inertelesh, mallrash. Për transport inertelesh (vetëshkarkues). Për lëvizje, shtyje, materiale, dherash në distancë të shkurtër, dhe Për pastrimin e rrugëve nga dëbora. Mob-barka; Për MNZ. Për prodhimin e energjisë elektrike. Për degazim. Për saldim dhe preje.	16 Kamionë (Gjithsej 469 Persona). 27 Kamionë (Gjithsej 134 T) 2 Copë Me 32 T Secili. 8 Copë (Gjithsej 100 T). 5 Copë (Gjithsej 250 M3) 6 Buldozërë Me Zinxhirë (Gjithsej 200 M3). 3 Copë 6 Copë Gjithsej 80 Persona 14 Copë Për Mallra; 2 Copë; 8 Copë; Gjithsej 396 Kë; 1 Copë 3 Copë
Batalioni i Xhenos/KM/SHP/MM	Për ndërtim riparime etj. Transport materialelesh (vetëshkarkues). Për ngarkim materialelesh, lëvizje dherash. Për ngarkim shkarkim.	50 specialistë 5 copë 8 copë eskavatorë dhe 5 copë buldozërë me zinxhirë. 1 copë me kapacitet 15 ton
Kompani e mbrojtjes kimike, bakteriologjike dhe nukleare/KM/SHP/MM	Për dezinfektim dhe për degazim	4 mjete dezinfektuese
Rezervat e Shtetit, MM	Transport materialelesh	20 kamionë nga 10 ton secili.
Kryqi i Kuq Shqiptar	Transport	4 kamionë me tonazh të lartë, makina të lehta në 12 degjet në qarqe
Për shërbime ndihmëse nga Batalioni i Mbrojtjes Civile/KM/SHP/MM	Për operacione të ndryshme. Për trajtim shëndetësor. Për furnizim me ujë të pijshëm. Për pastrim uji. Për prodhim buke. Për gatim ushqimi. Për strehim masiv. Për higjienë personale	170 persona 1 spitali fushor me 50 shtrëtarë, 4 dhoma trajtimi. 7 autobote (gjithsej 67 mt) dhe 11 pompa (kapaciteti gjithsej 12 m3/orë). 2 copë (gjithsej 5.000 Litore). 2 copë (gjithsej 2.400 kg/ditë). 12 kuzhina fushore (gjithsej 3000 racione /ditore) dhe 1 automjet-kuzhinë me kapacitet 300 racione në ditë Çadra për 17000 persona. 2 dushe fushore (gjithsej 200 persona/ditë)
Ministria e Shëndetësisë	Transport me Helikopter Për ndërhyrje kirurgjike Për transport me autoambulancë (Tirana) Për shtrime në rast emergjence	2 helikopter 2 - 3 grupe 6 autoambulanca dhe personel shoqëruar 50% e kapaciteteve të QK "Nënë Tereza"
PMNZSH	Për fikjen e zjarrit Për ngjitje në lartësi Për kërkim-shpëtim Për transport të denturarisht Personel zjarfikës në të gjithë vendin	80 mjete zjarfikëse 6 autoskafala 2 mjete shpëtimi 2 autoambulanca 670 persona
Rezervat e Shtetit/KMMM	Për strehim të përkohshëm në objektet të përshesha Çadra hapësira për magazinime për materiale të ngurta. Hapësira për magazinime karburante.	28.000 m2 për rreth 6000 njerëz Për 30.000 persona 43.000 m2 14 000 ton
Kryqi i Kuq Shqiptar.	Racione Ushqimore Mësimet për strehim të përkohshëm. Mundësi për kontakte familjare.	Për 8000 persona, për 1 muaj Për 2000 persona. Nëpërmjet shërbimit dhe sistemit ndërkombëtar të Kryqit të Kuq ndërkombëtar.

AKADEMIA
E SIGURISË

Konferencë shkencore
ndërkombëtare:

« Fenomenet
ekstreme
të natyrës
dhe çështjet
e sigurisë »

Aneksi:

Tabela e shifrave dhe kapaciteteve reaguese shqiptare për Reduktimin e Rreziqeve e Fatkeqësive (RRF), për përballimin e fatkeqësive natyrore në mënyrë të menjëhershme

Nr	Sasia e mjeteve të veprimit të menjëhershëm, në tokë, ajër, det	Kapaciteti transportues	Shënime e plotësime mbi kapacitetet
1	Për evakuim: 16 kamionë	(500 veta/një rejs);	
2	Për evakuim: 17 helikopterë 63 (të vegjël, të mesëm)	Rreth 90 veta/rejs);	
3	Për evakuim: 65 motobarka të vogla	Rreth 600 vetë	
4	Strehim: Tenda për 17 mijë njerëz (nga FASH) plus tenda të siguruar nga KKSH.	Rreth 17.000 vetë	
5	Evakuim mjekësor: 178 autoambulanca (nga MSH, të shpërndara në 36 qarqe, ku janë edhe spitalet, 11 prej tyre në Tiranë)	Kapaciteti rreth 200 vetë	Plus 12 autoambulanca nga FASH.
6	Ushqim: me pjekje – 2 njësi mobile	(2400 kg bukë/ditë);	
7	Ushqim me gatim – 12 njësi mobile	(3000 racione/ditë	plus 3 autokuzhina (900 racione/ditë).
8	Ujë i pijshëm: 7 autobote (total 67 ton)	11 pompa (total 12m3/orë)	Pastrim uji: 2 njësi (6,000 litra/orë)
9	Higjienë personale: 2 njësi dushesh (200 veta/ditë,	plus mjedise stacionare	Ngrihen jashtë zonës së prekur, 72 orë pas shpalljes emergjencës)
10	SAR (kërkim-shpëtim): 6 njësi 65 për situata tërmeti, përmbajtje, zjarre.	2 helikopterë (nga FASH) për aksidente ajrore apo në det.	4 anije (nga FASH) për aksidente në det.
11	Mbrojtje/dezinfektim: 6 njësi/automjete (dedektim).	1 njësi (25 veta) për dezinfektim	
12	Hospitalizim: 1 spital fushor (50 shtretër nga FASH		Plus 50% e kapacitete lokale spitalore (rreth 1000 shtretër).
13	Transport: 90 kamionë	(përfshi vetëshkarkuese, në total 600 ton/rejs) nga FASH.	
14	Shuarje zjarri: 74 automjete zjarrfikëse	738 veta (prej të cilëve 107 në Tiranë) plus 12 zjarrfikëse nga FASH.	12 në Tiranë
15	Pastrim bore 13 njësi (total 650 m3)	11 buldozerë me zinxhirë (total 350 m3).	
16	Kryqi i Kuq Shqiptar (KKSH), me rreth 90 mijë anëtarë.	Rreth 2500 vullnetarë të trajnuar për operacione në rast fatkeqësish,	Organizata më e madhe vullnetare në Shqipëri.
17	KKSH ka krijuar kapacitete për të ndihmuar në rast emergjence 8,000 njerëz për 30 ditë. 39 grupe vullnetare për emergjencat, secili me përbërje rreth 25-30 veta.	Veprimi KKSH për një muaj dhe në vijimësi.	Kur kapacitetet e tij rezultojnë të pamjaftueshme, KKSH mund të lëshojë apel për ndihmë nga Federata Ndërk. e Kryqit të Kuq.
18	KKSH është i pajisur me sisteme radio-komunikimi dhe disponon tre qendra trajnimi në nivel lokal dhe një të tillë në nivel qendror.	zotëron një depo qendrore materiale (2,200 m2)	tre të tjera në nivel lokal (secila 300 m2)
19	Gjenerator energjie: 8 njësi	(nga FASH, total 1400 Kw).	
20	OJQ të tjera si Karitas, Organizata "Nënë Tereza", etj,	janë fokusuar kryesisht në sigurimin e ndihmave materialeve	


AKADEMIA E SIGURISË

Konferencë shkencore ndërkombëtare:

« Fenomenet ekstreme të natyrës dhe çështjet e sigurisë »

Aneks:

Strukturat e gatishmërisë për kundërpërgjigje ndaj fenomeneve ekstreme të natyrës siç është fenomeni "përmbytje"



Bibliografia

1. Harp Akademileri Komutanlığı, İstanbul, Yni Levente, Shënime udhëtimi të kronikanëve të ushtrisë osmane (Sirri), İstanbul, 2000.
2. VKM nr. 663, datë 18.12.2002 "Për përbërjen, funksionimin dhe përgjegjësitë e Komisionit Teknik Këshillimor të Specialistëve për Emergjencat Civile";
3. VKM nr. 965, datë 02.12.2015 "Për bashkëpunimin ndërinstitucional të strukturave të drejtimit në rastet e Emergjencave Civile dhe Krizave";
4. Plani-Kombëtar-per emergjencat Civile EC ne RSh. VKM nr. 855.dt.3.12viti2004.pdf.
5. Ligj nr. 75/2016, "Për ratifikimin e marrëveshjes së Parisit, në kuadër të konventës OKB-së, për ndryshimet klimatike"
6. Wirtz, A., Krone, W. Low, P. and M. Steuer, 2014. The need for data: natural disasters and the challenges of database management. Natural Hazards 70:135-157 . DOI 10.1007/s11069-012-0312-4.
7. De Groeve, T., Poljansek, K and D. Ehrlich, 2013. Recording Disaster Losses-Recommendations for an European Approach. JRC Scientific and Policy Reports.
8. Gazeta "Zëri i Korçës", 11 dhe 26.1.1926. & "Vullnetari", Tiranë, 16 dhe 31.10.1926. (Bibliot.Kombëtare).
9. Ramiz Feçori, Fatkeqësitë e natyrës dhe mbrojtja prej tyre, Tiranë, 2016.
10. Graeme P. Herd, "Siguria", Kapitulli 1, "Çështjet politike në botën e sotme", publikuar nga "D>N, MacIver", Manchester: Shtypi i Universitetit të Manchester, Britani e Madhe, 2004.
11. Balkan Rivers – the blue heart of Europe, Euronatur, Vienna 2012.
12. Ligj nr. 45/2019, "Për mbrojtjen civile", Tiranë, 2019.
13. Etnografia Shqiptare, nr. 13, Shtëpia botuese "Naim Frashëri", Tiranë, 1983.
14. Milan Shufli, Serbët dhe Shqiptarët", Shtëpia botuese "Bargjini", Tiranë, 2001.
15. Pëllumb Xhufi, Dilemat e Arbërit, SHB Pegi, Tiranë, 2006.
16. Halil Inalcik, Defter-i Sancak-i Arvanid, Hicri 835 Tarih-i Suret-i, Türk Tarih Kurumu, Ankara, 1954.
17. Neritan Ceka, Pirgu i Myzeqesë, Monumentet historike në vendin tonë, Sh. B. "8 Nëntori", Tiranë 1979.
18. Ligj nr. 75/2016 "Për ratifikimin e Marrëveshjes së Parisit, në kuadër të konventës kuadër të kombeve të bashkuara, për ndryshimet klimatike".
19. Strategjia Kombëtare për Menaxhimin e Integruar, Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujrave, Tiranë, 2017.

**AKADEMIA
E SIGURISË**

Konferencë
shkencore
ndërkombëtare:

« Fenomenet
ekstreme
të natyrës
dhe çështjet
e sigurisë »

Burime nga interneti:

1. "DesInventar" (<https://www.desinventar.net/>); <http://www.fjalori.shkenca.org/>
2. <https://www.cia.gov/library/publications/the-world-factbook/geos/al.html>
3. <http://www.worldbank.org/en/country/albania/overview> & <http://www.emdat.be/classification>
4. <https://www.balkanweb.com/permybtjet-ne-shqiperi-nje-veshtrim-i-shkurter-historik-dhe-siguria-komunitare/>
5. <https://theworldnews.net/al-news/permybtjet-ne-shqiperi-nje-veshtrim-i-shkurter-historik-dhe-siguria-komunitare>
6. <https://theworldnews.net/al-news/ekstremet-e-klimes-cilat-jane-fatkeqesite-natyrore-qe-godasin-me-shpesh-vendin>
7. https://issuu.com/milieukontakt/docs/d_met_e_shkaktuara_nga_fatkeq_site_
8. https://reliefweb.int/sites/reliefweb.int/files/resources/WorldRiskReport-2019_Online_english.pdf
9. <https://www.heritagedaily.com/2020/07/study-analyses-500-years-of-floods-in-europe>
10. <https://www.rec.org/project-detail.php?id=21>
11. <https://www.mod.gov.al/index.php/politikat-e-sigurise/-mm/projekte-te-financuara-nga-be/4043-programi-pro-news>

Shkurtime

RRK	Reduktimi i riskut të katastrofave
ENVSEC	Nisma për Mjedisin dhe Sigurinë
ShISH	Shërbim i integruar shpëtimi
OSBE	Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë
REC	Qendra Rajonale Mjedisore për Evropën Qendrore dhe Jugore
UNDP	Programi i Zhvillimit të Kombeve të Bashkuara
UNECE	Komisioni Ekonomik për Evropën i Kombeve të Bashkuara
UNEP	Programi Mjedisor i Kombeve të Bashkuara
EC	Emergjencia Civile
KKSH	Kryqi i Kuq Shqiptar
QKO	Qendra Kombëtare Operacionale
QBO	Qendra e Bashkuar Operacionale
UNDRR	The United Nations Office for Disaster Risk Reduction
IGJEUM	Instituti i Gjeoshkencave, Energjise, Ujit dhe Mjedisit.
PKEC	Plani Kombëtar për Emergjencat Civile
KM	Komanda e Mbështetjes
SHP	Shtabi i Përgjithshëm
MM	Ministria e Mbrojtjes
MB	Ministria e Brendshme
FNSH	Forca e Ndërhyrjes së Shpejtë.
CIMA	Qendra Ndërkombëtare për Kërkimin dhe Monitorimin në Mjedis (Itali).
COP21	Konventa Kuadër e Organizatës së Kombeve të Bashkuara për ndryshimet klimatike.

AKADEMIA E SIGURISË

*Konferencë
shkencore
ndërkombëtare:*

« Fenomenet
ekstreme
të natyrës
dhe çështjet
e sigurisë »

Planifikimi dhe menaxhimi i fatkeqësive natyrore, në Republikën e Kosovës



■ **Msc. Daut ZENELI**
Instituti kërkimor
për Siguri Publike në Kosovë
daut.zeneli@gmail.com



■ **Dr. Bajram IBRAJ**
Kolegji Dardania,
Prishtinë, Kosovë
bajramibraj@yahoo.com

Abstrakt

Ashtu si i gjithë Ballkani Perëndimor, edhe Kosova është një vend i cili është mjaft i rrezikuar nga fatkeqësitë natyrore. Fatkeqësitë natyrore janë bërë tashmë një fenomen shqetësues ku dekadat e fundit kanë pasur pasoja dhe dëme të konsiderueshme. Si rezultat i këtyre fatkeqësive natyrore, komuniteti në Kosovë është prekur dhe dëmtuar duke pasur pasoja si për biznesin, ekonominë e shtetin, edhe për individët, familjet dhe për komunitetet respektive e shoqërinë. Ndër fatkeqësitë natyrore të cilat e kërcënojnë më shumë Kosovën janë: tërmetet, – për faktin se Kosova shtrihet në një zonë sizmike me një aktivitet mjaft të lartë tektonik, ku në të kaluarën jemi ballafaquar me fatkeqësi natyrore të cilat kanë shkaktuar, nga dëme materiale deri tek humbja e jetëve njerëzore; përmbytjet, – sepse në vendin tonë shtrihen një varg lumenjsh të cilët pas reshjeve të mëdha dalin nga shtretërit e tyre, dhe arrijnë deri në situata, ku përmbyten zona të caktuara në afërsi të rrjedhës së tyre. Si pasojë e këtyre përmbytjeve, kemi pasur shumë dëme materiale e shpesh janë rrezikuar edhe jetët njerëzore; ortejë janë një fatkeqësi natyrore mjaft kërcënuese për Kosovën, sidomos për pjesën jugore të vendit. Nga këto dukuri natyrore në të kaluarën përveç dëmeve materiale kemi pasur edhe humbje të jetëve njerëzore. Në Republikën e Kosovës janë hartuar ligje, politika, strategji, programe dhe plane veprimi për menaxhimin dhe përballimin e fatkeqësive natyrore, por mbetet akoma shumë për t'u bërë, në drejtim të implementimit të përvojave më të mira të vendeve të zhvilluara evropiane, me qëllim planifikimin dhe përfshirjen më të mirë të së gjithë aktorëve publikë dhe privatë me qëllim shfrytëzimin më të plotë edhe të burimeve e kapaciteteve të tjera private dhe të profileve të veçanta më rëndësi jetike, veçanërisht, në ato drejtime ku evidentohen më shumë nevojat që ka shteti. Në këtë punim do të trajtojmë dhe analizojmë mjedisin ku janë më të pranishme emergjencat civile në Kosovë, politikat dhe legjislacionin në fuqi në fushën e emergjencave civile, planifikimin dhe menaxhimin e situatave emergjente të shkaktuara nga fatkeqësitë natyrore dhe dhënien e përfundimeve dhe rekomandimeve në lidhje me menaxhimin e emergjencave civile dhe mbrojtjen e popullsisë nga dëmet dhe pasojat e tyre.

Fjalëkyçe:

fatkeqësitë natyrore, Republika e Kosovës, planifikimi, menaxhimi, legjislacioni.

1. Hyrje

Kosova, ashtu sikurse edhe të gjitha vendet e Ballkanit Perëndimor nuk është immune ndaj kërcënimeve nga fatkeqësitë natyrore, përkundrazi i ka të gjitha premiset që të jetë një vend mjaft i kërcënuar dhe me një shkallë të lartë të rrezikut. E gjithë këtë e bën fakti që Kosova ka një shtirje gjeografike ku janë të përfshira të gjitha veçoritë e mundshme të cilat mund të sjellin kërcënime nga me të ndryshmet nga fatkeqësitë natyrore.

Fakti që në Kosovë kemi një gërshetim të veçorive kryesore të natyrës, duke pasur kodra të larta, lumenj të cilët kanë një sasi të madhe të ujit dhe të cilët janë pëllgje të shumë lumenjve më të vegjël, si dhe fakti që vendi ynë ka një shtrirje përgjatë një zone sizmike e cila ka një aktivitet mjaft të lartë të lëkundjeve tektonike, bën që të futemi në rangun atyre shteteve të cilat janë mjaft të kërcënuara nga fatkeqësi të ndryshme natyrore.

Pothuajse çdo vit, gjatë sezonit të dimrit në disa lokacione, pothuajse gjithandej në territorin e Kosovës, ku janë të shtrirë disa lumenj, ballafaqohemi me situata të vërshimeve të mëdha si pasojë e daljes së lumenjve nga shtretërit e tyre dhe kemi pasur disa herë dëme të konsiderueshme materiale deri tek kërcënimi me vite i njerëzve. Pastaj, fakti që kemi një reliev mjaft të ngritur në disa pjesë të Kosovës dhe posaçërisht në pjesën jugore të saj në të kaluarën jemi ballafaquar edhe me aktivitetin e shtuar të ortekeve, ku kemi pasur edhe humbje të jetëve njerëzore. Në gjithë këtë mjedis me aktivitete mjaft të shtuara të kërcënimeve nga fatkeqësitë natyrore, kërcënimin e bën edhe më të madh fakti që Kosova ka një shtrirje në një zonë sizmike me një aktivitet mjaft të shtuar të lëkundjeve tektonike, ku si pasojë e kësaj, në të kaluarën ka pas lëkundje të një shkallë mjaft të lartë e për pasojë të tyre, ka pasur dëme të konsiderueshme materiale deri të rrezikimi direkt i jetëve të njerëzve. Gjithashtu, në vazhdimësi jemi ballafaqua me lëkundje me të lehta të cilat nuk kanë shkaktuar ndonjë dëm të madh, mirëpo kjo është

**AKADEMIA
E SIGURISË**

*Konferencë
shkencore
ndërkombëtare:*

**« Fenomenet
ekstreme
të natyrës
dhe çështjet
e sigurisë »**

një shenjë se në të ardhmen, mund të kemi ndonjë lëkundje të një shkalle më të madhe, ku mund të përballemi me humbje të shumë jetëve njerëzore dhe me shkatërrim të infrastrukturës në vend.

2. Mjedisi ku janë me të pranishme dhe llojet e fatkeqësive natyrore në Kosovë

Fatkeqësitë natyrore si çështje, nuk mund të themi që janë trajtuar vetëm në politikat e kohës moderne. Kjo çështje është trajtuar qysh në kohërat e hershme e madje ka zënë një vend jashtëzakonisht të rëndësishëm. Kjo si çështje madje, është trajtuar edhe në shkrimet e para, të njohura si *Hieroglifët*, pastaj në librat e shenjtë si, *Bibla* dhe po ashtu edhe në tregime e gojëdhëna të ndryshme. Mirëpo një organizim i mirëfilltë kundrejt fatkeqësive natyrore filloj të realizohej vetëm në kohërat moderne. Kuptimi i historisë së menaxhimit të emergjencave është i rëndësishëm sepse, në kohë të ndryshme, konceptet e menaxhimit të emergjencave janë zbatuar ndryshe¹.

Fatkeqësitë në përgjithësi ngjarje apo pjesë ngjarjeje të shkaktuara nga forca madhore të natyrës apo forca të tjera të pakontrolluara, të cilat rrezikojnë jetën e njerëzve, kafshëve dhe pronave, shkaktojnë dëme të trashëgimisë kulturore e mjedisit, në përmasa të atilla që kërkojnë ndërmarrjen e masave dhe dislokimin e forcave e resurseve të veçanta². Si të tilla, janë një kërcënim permanent për sigurinë njerëzore, ekologjike, por edhe ekonomike. Ndërsa fatkeqësitë natyrore, në një ndarje më specifike, janë: tërmetet, vërshimet, rrëshqitjet e dheut, ortekët, erërat e fuqishme, reshjet me breshër, dëbore me shi, acar, thatësi, zjarr fushor, shpërthim i sëmundjeve infektive që ndikojnë në njerëz, kafshë ose bimë dhe fatkeqësitë e tjera të shkaktuara nga forcat natyrore³.

Fatkeqësitë natyrore, nëse i referohemi të gjitha llojeve të mundshme që kërcënojnë Republikën e Kosovës, janë të pranishme pothuajse në gjithë territorin e saj, bazuar në specifikat e tyre; janë të pranishme në lokacione të caktuara, në varësi të natyrës së kërcënimit. Në varësi të natyrës së fatkeqësisë natyrore, kërcënimet nga këto fatkeqësi, siç janë vërshimet, janë koncentruar kryesisht në pjesën qendrore, jugore dhe jugperëndimore të territorit të Kosovës. Kjo, për arsye se në këto zona ka një numër më të madh lumenjsh, të cilët rrjedhën e tyre e kanë të drejtuar kryesisht në drejtim të jugut. Kosova është e ndjeshme ndaj vërshimeve dhe ato ndodhin shpesh. Pothuajse të gjitha komunat e Kosovës, ku më shumë e ku më pak, janë të prekura nga rreziku i vërshimeve, të cilat manifestohen në formën e:

- vërshimeve pas stuhive në zonat malore;
 - vërshimeve pas shirave të vazhdueshme në zonat fushore;
 - vërshimeve pas shkrirjes së dëborës të shoqëruara ose jo me mot të keq.
- Vërshimet sipas pellgjeve lumore:
- Drini i Bardhë: 50%,
 - Ibri: 24%,
 - Lepenci: 20%,
 - Morava e Binçës: 6%⁴.

AKADEMIA E SIGURISË

Konferencë
shkencore
ndërkombëtare:

« Fenomenet
ekstreme
të natyrës
dhe çështjet
e sigurisë »

¹ Introduction to Emergency Management - Third Edition, George D. Haddow, Jane A. Bullock, Damon P. Coppola.

² Ligji nr. 04/I-027 "Për mbrojtje nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera", Neni 3, pika 1.4.

³ Po aty, Neni 3, pika 1.5.

⁴ Vlerësimi i rreziqeve nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera, Prishtinë, Korrik 2016, faqe 34.




Figura 1: Zonat e prekura nga vërshimet ne Kosovë.⁵

Pastaj, kemi pjesët jugore, që janë kryesisht të kërcënuara nga rrëshqitja e dëborës, pasi kemi një reliev të ngritur dhe bjeshkë të zhveshura nga vegjetacioni e si pasojë e kësaj, herë pas here gjatë stinës së dimrit, ballafaqohemi me situata ku na shkaktohen ortekë, dhe si pasojë e tyre, në të kaluarën kemi pasur edhe viktimë e dëme materiale.

Një kërcënim tjetër dhe mjaft serioz janë edhe tërmetet, ku bazuar në të dhënat sizmike, Kosova ka një shtrirje përgjatë një zone me aktivitet mjaft të lartë të aktivitetit tektonik. Në zoonimin sizmik mbarëbotëror, Kosova zë vend në brezin sizmik alpin-mesdhetar, një zonë e gjerë kontakti midis pllakave të litosferës të Afrikës dhe të Euro-Azisë, që nga ishujt Azore deri në kufirin lindor të basenit mesdhetar. Koncepti i aktivitetit tektonik të pllakave është veçanërisht i komplikuar në këtë zonë për shkak të pranisë së një numri të madh blloqesh, si dhe mënyrës së çlirimit të energjisë së akumuluar gjatë procesit të deformimit plastik në pjesën më të madhe të saj⁶.

Nga pikëpamja sizmologjike, territori i Kosovës paraqet një rajon me aktivitet sizmik relativisht të lartë, i cili është goditur në të kaluarën dhe mund të goditet edhe në të ardhmen nga tërmetet autoktone shumë të forta, të cilët i kanë vatrat të cekëta, që gjenden në koren e tokës, maksimumi 15-20 km thellë në nëntokë⁷.

Duke u bazuar në hartën e rrezikut sizmik të Republikës së Kosovës, rajoni përëndimor i saj karakterizohet nga një aktivitet sizmik relativisht i lartë, ku në të shkuarën kanë ndodhur tërmete të forta, vatrat e të cilëve në përgjithësi evidentohen të cekët: 15-20 km. Zonat kryesore burimore sizmike në Kosovë janë si më poshtë:

1. zona sizmologjike Prizren-Pejë;
2. zona sizmologjike Ferizaj-Viti-Gjilan;
3. zona sizmologjike e Kopaonikut.

Dhe si pasojë e kësaj, në periudhën 2002-2013, territori i Kosovës u godit tri herë me Mag. 4.8-5.7 shkallë të Rihterit:

1. tërmeti i Gjilanit, 24.4.2002, Mag. 5.7;
2. tërmeti i Istogut, 10.3.2010, Mag. 5.2;
3. tërmeti i Vushtrrisë, 18.11.2013, Mag. 4.8⁸.

Të gjitha llojet e rasteve që u përmendën më lart janë të përcaktuar në mënyrë specifike në politikat të cilat janë nxjerra si përcaktim ndaj ballafaqimit me situata të tilla; prandaj, edhe legjislati në fuqi në Republikën e Kosovës i ka përcaktuar

⁵ Po aty, faqe 34.

⁶ Vlerësimi i rreziqeve nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera, Prishtinë, Korrik 2016, faqe 40.

⁷ Po aty.

⁸ Po aty, faqe 44.

fatkeqësi natyrore.

3. Politikat, strategjitë dhe legjislacioni në fushën e emergjencave civile

Republika e Kosovës edhe pse një shtet i ri ka arritur t'i trajtojë në kontekstin e politikave dhe të strategjive çështjet me vitale, të cilat ndikojnë drejtpërsëdrejti funksionimin normal të saj. Në kuadrin e kësaj, ka filluar t'i trajtojë edhe fatkeqësitë natyrore, madje duke iu dhënë edhe një fokus jashtëzakonisht të veçantë. Këtë fokus mund ta hasim që nga legjislacioni primar, ku janë miratuar disa ligje të cilat janë në funksion të mbrojtjes së qytetareve nga fatkeqësitë eventuale natyrore; dhe në këtë kontekst, mund të themi se janë marrë disa masa relativisht të menjëhershme. Ekziston edhe një pikëpamje dhe një plan konkret se si të reagojmë në rast të situata fatkeqësish natyrore, ku rrezikohet jeta e qytetarëve të Kosovës.

Në këtë kuadër të politikave, legjislacion kryesor kemi ligjin nr. 04/-L-027 "Për mbrojtje nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera"⁹ i cili përveç përcaktimit të fatkeqësive natyrore paraqet një pikëpamje të qartë, në funksion të përballjes dhe menaxhimit me fatkeqësitë natyrore.

Në kontekstin e përkufizimit të fatkeqësive natyrore, ky ligj shprehet se: *"Fatkeqësi është një ngjarje apo pjesë të ngjarjes të shkaktuar nga forcat madhore të natyrës apo forcat tjera të pakontrolluara, të cilat rrezikojnë jetën e njerëzve, kafshëve dhe pronave, shkaktojnë dëme në trashëgiminë kulturore dhe mjedis, në përmasat e atilla që kërkojnë ndërmarjet e masave dhe dislokimin e forcave dhe resurseve të veçanta. Ndërsa fatkeqësi natyrore janë: tërmetet, vërshimet, rrëshqitjet e dheut, orte, erë e fuqishme, breshër, borë me shi, acar, thatësi, zjarr fushor, shpërthim i sëmundjeve infektive që ndikojnë në njerëz, kafshë ose bimë dhe fatkeqësitë e tjera të shkaktuara nga forcat natyrore."*¹⁰

Përveç përcaktimit të fatkeqësive natyrore, në këtë ligj janë përcaktuar edhe detyrat themelore të sistemit të mbrojtjes nga fatkeqësitë natyrore, janë përcaktuar qartë përgjegjësitë e institucioneve për menaxhimin e situatave të tilla, si dhe bashkëpunimi ndërkombëtar në fushën e menaxhimit të situatave të fatkeqësive natyrore. Gjithashtu, janë të përcaktuara edhe mënyrat e angazhimit në situata të menaxhimit emergjent, e gjithashtu edhe pjesëmarrja vullnetare në këto aktivitete¹¹.

Në kuadrin e politikave për përballën dhe menaxhimin e fatkeqësive natyrore kemi edhe Ligjin Nr. 04/L-230 "Për Agjencinë e Menaxhimit Emergjent", i cili kryesisht e trajton menaxhimin e fatkeqësive natyrore dhe emergjencat civile. Me anën e këtij ligji kemi edhe ngritjen e Agjencisë së Menaxhimit Emergjent dhe janë përcaktuar detyrat dhe përgjegjësit e këtij agjencioni¹².

Në kuadrin e përgjegjësive, ky agjencion kryesisht merret: me vlerësimin rreziqeve, me hartimin dhe propozimin e strategjive dhe plan programeve të menaxhimit të fatkeqësive natyrore, përgatitjen dhe aftësimin profesional të kuadrove në menaxhimin e fatkeqësive natyrore, koordinimin e aktiviteteve dhe monitorimin e tyre, si dhe realizon koordinimin ndërkombëtar për menaxhimin e tyre¹³.

AKADEMIA
E SIGURISË

Konferencë
shkencore
ndërkombëtare:

« Fenomenet
ekstreme
të natyrës
dhe çështjet
e sigurisë »

⁹ Ligj nr. 04/I-027 "Për mbrojtje nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera".

¹⁰ Po aty neni 3, pika 1.4 dhe 1.5.

¹¹ Po aty.

¹² Ligj Nr. 04/L-230 "Për Agjencinë e Menaxhimit Emergjent".

¹³ Po aty, Neni 15 dhe 16.

Pastaj kemi Planin e Reagimit Kombëtar i cili përbën tërësinë e organizimit operativ të menaxhimit me fatkeqësi natyrore, përcaktimin e reaguesve sipas specialitetit dhe trupave të ndihmës. me anën e këtij plani janë të definuara saktë dhe në mënyrë koncize detyrat e secilit nga agjencionet të cilat brenda tyre kanë trupa profesionale në funksion të menaxhimit të ndonjë situatë fatkeqësie natyrore¹⁴. Përveç këtyre që u përmendën me lart kemi edhe politika të tjera si ligji për Policinë e Kosovës¹⁵, Ligji për Forcën e Sigurisë së Kosovës¹⁶ etj., të cilat prekin fusha të caktuara në kuadër të përgjegjësiave të tyre në menaxhimin e fatkeqësive natyrore.

4. Masat që kanë marrë institucionet shtetërore për planifikimin dhe përballimin e emergjencave natyrore në Kosovë

Institucionet e Republikës së Kosovës kanë bërë disa hapa konkretë në marrjen e masave për planifikimin dhe përballimin me fatkeqësitë natyrore dhe emergjencat civile, e gjithë kjo është përfshirë nëpër politika, strategji, plane si dhe dokumente të tjera me rëndësi, të cilat japin kontributin e tyre në favor të menaxhimit të fatkeqësive natyrore.

Kur jemi tek politikat dhe strategjitë, institucionet e Kosovës kanë nxjerr një sërë ligjesh të cilat e qartësojnë në mënyrë shumë të qartë funksionimin e institucioneve dhe agjencive të caktuara në funksion të menaxhimit të fatkeqësive natyrore, pastaj janë nxjerrë edhe disa strategji dhe plane të veprimit, janë bërë vlerësime relativisht të detajuara për rreziqet të cilat e kërcënojnë sigurinë njerëzore, ambientale dhe ekonomike. Këtyre dokumenteve iu jemi referuar në pjesët e mësipërme të këtij punimi, por kemi edhe strategji konkrete të cilat janë nxjerrë e kanë dhënë një pikëpamje të qartë të përballjes së kërcënimeve dhe të mënyrës se ballafaqimit me to.

Dokument konkret strategjik, është *Strategjia për zvogëlim të rrezikut nga fatkeqësitë dhe Plani i veprimit 2016-2020*, të cilët kanë për qëllim zvogëlimin e rreziqeve ekzistuese dhe parandalimin e rreziqeve të reja, fuqizimin e qëndrueshmërisë, - duke përfshirë përgjegjësinë primare të shtetit për të parandaluar dhe zvogëluar rrezikun nga fatkeqësitë, angazhimin e tërë shoqërisë dhe institucioneve shtetërore¹⁷.

Në këtë strategji janë trajtuar në mënyrë shumë të mirë rreziqet nga fatkeqësitë natyrore, dhe janë dhënë rekomandime e pikëpamje se si të ballafaqohemi me këto kërcënime. Ky është një tregues shumë i rëndësishëm i cili rrëfen se çështja e fatkeqësive natyrore është deri diku, relativisht e trajtuar, dhe se institucionet, po ashtu edhe aktorë të tjerë, e kanë trajtuar këtë çështje duke i dhënë një prioritet mjaft të rëndësishëm.

Nëse dëshirojmë që të heqim një paralele ndërmjet Kosovës dhe vendeve të rajonit, Kosova, duke qenë një vend ende në transicion, si pasojë e luftës 1998-1999, me zhvillim më të ulët ekonomik e social, ka më shumë sfida për sa i përket zvogëlimit të rrezikut nga fatkeqësitë. Në dallim nga vendet e rajonit, si Shqipëria, Maqedonia, Mali i Zi, Serbia apo Bosnje Hercegovina, Kosova ka ngritur institucione të reja shtetërore të cilat, vetëm në periudhën e pasluftës kanë nisur kryesisht të vlerësojnë më shumë çështjen e rrezikut nga fatkeqësitë natyrore. Në tërësi, siç u përmend, për shkak të zhvillimit të

¹⁴ Plani i Reagimit Kombëtar, Vendimi i Qeverisë së Kosovës Nr. 06/150, i datës 23.12.2010.

¹⁵ Ligji Nr. 04/L-076 "Për Policinë".

¹⁶ Ligji Nr. 06/L-123 Për Forcën e Sigurisë së Kosovës".

¹⁷ Strategjia për zvogëlim të rrezikut nga fatkeqësitë dhe plani i veprimit 2016 – 2020, faqe 3.

ulët ekonomik, shoqëror dhe mjedisor, rreziku nga fatkeqësitë natyrore për Kosovën është i konsiderueshëm për shkak të probabilitetit të lartë të preksshmërisë së popullatës¹⁸.

Çështja e fatkeqësive natyrore është trajtuar edhe në një dokument tjetër strategjik, që është *Analiza e rishikimit strategjitë të sektorit të sigurisë*. Në këtë dokument është konstatuar se Kosova duke pasur një klimë kontinentale, dhe e gjendur në një zonë aktive sizmike, ballafaqohet me katastrofa natyrore, përfshirë dridhje të tokës, vërshime, dhe borë në zona të thella rurale. Nganjëherë, katastrofat natyrore janë përtej kontrollit të institucioneve të Kosovës¹⁹.

Gjithashtu, edhe nxjerrja e ligjit për Agjencinë e Menaxhimit Emergjent dhe miratimi i *Planit të reagimit kombëtar* i kanë dhënë disi një drejtim të trajtimit të çështjes së fatkeqësive natyrore. Mirëpo edhe ekzistenca e gjithë këtyre politikave, strategjive e planeve të ndryshme, nuk vërteton se Kosova ka bërë mjaftueshëm. Në fakt mbetet ende shumë për t'u bërë dhe në fakt, kemi një rrugë të tërë para nesh drejt qasjes ndaj një kornize politikash të mirëfillta të ballafaqimit me fatkeqësitë natyrore.

5. Fatkeqësitë natyrore dhe çështjet e sigurisë

Fatkeqësitë natyrore, janë pa dyshim një tregues shumë i rëndësishëm i cenimit të sigurisë. Ato prekin në mënyrë të drejtpërdrejtë çështjet e sigurisë njerëzore, ambientale, ekonomike etj. Si të tilla, në asnjë mënyrë nuk mund t'i trajtojmë si të ndara njëra me tjetrën sepse ato, për nga natyra, janë të lidhura shumë ngushtë mes tyre. Të gjitha ato lloje të fatkeqësish natyrore, të cilat i kemi trajtuar në këtë punim, madje duke i trajtuar më shumë në kontekstin e politikave, kemi vërejtur se domosdoshmërisht, në një formë apo në një tjetër, janë të lidhura ngushtë edhe me çështjet e sigurisë.

Përmbytjet, janë një ndër fatkeqësitë natyrore që godasin vendin tonë pothuajse çdo vit, në periudha të caktuara kohore, përkatësisht gjatë sezonit të vjeshtës dhe në përfundim të sezonit të dimrit ose në pranverën e hershme. Dhe, nëse ndalemi e analizojmë këtë dukuri natyrore, shumë lehtë e vërejmë ndikimin që ka ajo tek siguria. Duke u nisur nga siguria njerëzore, ku si pasojë e përmbytjeve rrezikohen jetët e njerëzve, dhe nga përvoja e së kaluarës, kemi pasur raste ku edhe është cenuar ky aspekt i sigurisë. Si pasojë e përmbytjeve, preket edhe siguria ambientale, pasi si pasojë e tyre, shumë burime të ujit të pijshëm ndoten dhe mund edhe të vijnë deri tek ndonjë sëmundje ngjitëse e cila pastaj mund të na kthehet *bumerang*, e në ndonjë kërcënim akoma më të madh: në ndonjë epidemi.

Në kontekstin e sigurisë ekonomike, kjo dukuri vërehet më së shumti tek dëmtimet të cilat mund t'i shkaktohen tokave bujqësore dhe banesave. Ne jemi dëshmitarë që sipërfaqe të tëra bujqësore janë shkatërruar si pasojë e vërshimeve, pastaj kemi dëme të konsiderueshme të banesave dhe bizneseve të cilat si pasojë e përmbytjeve kanë pësuar dëme të mëdha. Një shembull konkret, vjen nga një raport i nxjerrë nga Komisioni për vlerësimin e dëmeve në ekonomi familjare nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë e tjera, në Komunën e Podujevës, i datës 15.2.2021, i cili e vlerëson dëmin në 38 shtëpi banimi me vlerën 35 143 00 euro²⁰. Ky është vetëm një raport i një pjese të vogël të dëmit që përmbytjet mund të shkaktojnë, mirëpo nëse analizohet në nivel vendi, atëherë

¹⁸ Strategjia për zvogëlim të rrezikut nga fatkeqësitë dhe plani i veprimtimit 2016 – 2020, faqe 15

¹⁹ Analizë e Rishikimit Strategjik të Sektorit të Sigurisë së Republikës së Kosovës, Mars 2014, Pika 4.4.1.

²⁰ Raport nga Komisioni për vlerësimin e dëmeve në Ekonomi familjare nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë e tjera në Komunën e Podujevës, me nr. Prot:02-016/01-0012470/21, i datës 15.02.2021.

kjo shifër e dëmeve do të jetë disa herë më e madhe.

Përveç përmytjeve, një fatkeqësi natyrore e cila e prek drejtpërsëdrejti sigurinë, janë tërmetet, të cilët kërcënojnë sigurinë njerëzore, sepse jemi dëshmitarë të humbjes së shumë jetëve njerëzore si pasojë e lëkundjeve tektonike që kanë ndodhur në të kaluarën. Përveç ndikimit kryesor, që tërmetet zakonisht e kanë tek jetët e njerëzve, ndikimi që vjen menjëherë pas tij, e që ndihet më së shumti, është dëmtimi i infrastrukturës, banesave dhe shumë bizneseve; kjo mandej, ka ndikim të konsiderueshëm edhe te siguria ekonomike.

Rreziku nga ortelet është edhe një tjetër fatkeqësi natyrore e cila ka ndikim te drejtpërdrejt në çështjet e sigurisë. Sigurisht, kjo fatkeqësi, ndikim kryesor e ka tek siguria individuale pasi nëse i referohemi ngjarjeve të së kaluarës në veçanti, është ende i freskët kujtimi nga ngjarja tragjike në një fshat të Komunës së Dragashit, në fshatin Restelic, ku në vitin 2012, si pasojë e një ortelet i cili përfshiu një pjesë të këtij fshati patëm humbjen e dhjetë jetëve njerëzore dhe fatmirësisht autoritetet arritën të shpëtonin një vajzë të vogël. Përveç humbjes së atyre jetëve, si pasojë e atij ortelet, kishim edhe dëme të konsiderueshme materiale të disa shtëpive. Në kontekstin e rrezikut të përgjithshëm, ai rajon është nën kërcënimin e vazhdueshëm të këtij fenomeni pasi në ato pjesë kemi male të larra dhe relativisht të zhveshura nga bimësia. Kjo gjë e bën kërcënimin akoma më të madh dhe mund të presim ngjarje të njëjta edhe në të ardhmen, nëse nuk merren masa për pyllëzimin e atyre vendeve. Në kontekstin e përgjithshëm të analizës së ndërlidhjes së fatkeqësive natyrore me çështjet e sigurisë, themi se prania e kërcënimit nga fatkeqësitë natyrore është një kërcënim direkt për sigurinë në përgjithësi. Mosarritja e menaxhimit të mirëfilltë të këtyre fenomeneve përbën një cenim direkt edhe për sigurinë kombëtare.

6. Përfundime dhe rekomandime

1. Duke i ditur të gjitha këto kërcënime ne duhet t'i analizojmë më shumë kujdes këto kërcënime dhe të japim rekomandime të qarta në drejtim të ballafaqimit dhe menaxhimit të situatave të mundshme të tilla, të cilat mund të na çojnë drejt një kolapsi ekologjik, social dhe ekonomik. Në këtë kuadër duhet të hartojmë, miratojmë dhe zbatojmë strategji, politika dhe plane akoma më konkrete se deri tani, me qëllim që të jemi më të përgatitur për veprimet dhe mundësitë sesi të përballemi në të ardhmen me situata të tilla fatkeqësish.

2. Kosova ka planifikuar zhvillimin e strategjive dhe politikave konkrete, të cilat futen në funksion të menaxhimit sa më të mirë të situatave të tilla ku rrezikohet të kemi nga dëme materiale deri tek humbje jetësh njerëzore; dhe paskëtaj, vendi mund të shkojë drejt një kolapsi ekologjik e social-ekonomik. Megjithatë, pa marrë parasysh zhvillimin e këtyre politikave të caktuara mbetet akoma për t'u bërë në funksion të afirmimit të këtyre politikave e strategjive drejt një infrastrukture të mirëfilltë, e cila duhet t'i përshtatet mjedisit kërcënues brenda vendit.

3. Në gjithë këtë kuadër, përveç afirmimit të politikave duhet të zhvillojmë një plan shumë të detajuar të shfrytëzimit të resurseve ekzistuese; si ato të sektorit publik, me të gjitha specifikat dhe specialitetet që zotëron, dhe domosdoshmërisht duhet të kemi një plan konkret, që krahas resurseve të sektorit publik të shfrytëzojmë edhe resurset nga sektori privat, sepse në një shoqëri moderne, ky sektor është mjaft i pajisur dhe ka kapacitete të cilat mund të na hyjnë në punë në situata të caktuara fatkeqësish. Në këtë

**AKADEMIA
E SIGURISË**

*Konferencë
shkencore
ndërkombëtare:*

« Fenomenet
ekstreme
të natyrës
dhe çështjet
e sigurisë »

kontekst, është shumë e nevojshme që të bëhet një analizë e kapaciteteve që zotëron vetëm sektori publik, me gjithë gamën e institucioneve e agjencive të cilat kanë për mision menaxhimin dhe ballafaqimin me fatkeqësitë natyrore. Gjithashtu, është e nevojshme një analizë dhe identifikim i resurseve dhe kapaciteteve të cilat sektori privat i ka në dispozicion, dhe krijimi i një plani të detajuar i shfrytëzimit të këtyre kapaciteteve. E gjithë kjo, arrihet vetëm me një bashkëpunim të vazhdueshëm mes institucioneve publike dhe aktorëve përkatës privatë.

4. Hartimi i një raporti të detajuar, ku janë të identifikuara të gjitha zonat që janë të rrezikuara nga fatkeqësitë e mundshme natyrore, të vendosen stacione të lëvizshme në ato zona të cilat do të mundësonin reagimin më të shpejt dhe në kohë, ndaj këtyre dukurive; dhe kjo, do ta bënte më të lehtë menaxhimin e situatave, sepse një ndërhyrje e shpejtë dhe efikase mund të mënjanojë shumë dëme materiale, e sidomos do të evitonte rrezikun e humbjes së jetëve njerëzore.

Bibliografia

1. Ligj nr. 04/L-027 "Për mbrojtje nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera".
2. George D. Haddow, Jane A. Bullock, Damon P. Coppola, "Introduction to Emergency Management - Third Edition".
3. Vlerësimi i rreziqeve nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera, Prishtinë, Korrik 2016.
4. Ligj nr. 04/L-230 "Për Agjencinë e Menaxhimit Emergjent".
5. Plan i Reagimit Kombëtar, Vendimi i Qeverisë së Kosovës Nr.06/150, i datës 23.12.2010.
6. Strategjia për zvogëlim të rrezikut nga fatkeqësitë dhe plani i veprimit 2016 – 2020.
7. Ligji nr. 04/L-076 "Për Policinë".
8. Ligji nr. 06/L-123 "Për Forcën e Sigurisë së Kosovës".
9. Analizë e Rishikimit Strategjik të Sektorit të Sigurisë së Republikës së Kosovës, Mars 2014.
10. Raport nga Komisioni për vlerësimin e dëmeve në Ekonomi familjare nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë e tjera në Komunën e Podujevës, me nr.Prot:02-016/01-0012470/21, i datës 15.02.2021.



AKADEMIA E SIGURISË

*Konferencë
shkencore
ndërkombëtare:*

**« Fenomenet
ekstreme
të natyrës
dhe çështjet
e sigurisë »**

Arkitektura në përballje me katastrofat natyrore



■ **Dr. Silvana SUKAJ**
Universiteti Europian i Tiranës
Silvana.Sukaj@uet.edu.al

Abstrakt

Domosdoshmëria e sigurisë mjedisore është dokumentuar në historinë e arkitekturës aq shumë sa që mund të gjurmohet në rrënjët e argumenteve "pse", "si" dhe "ku" duhet të ndërtojmë. Nga tipologjia e hershme e kështjellave, te ndërtimet e sotme moderne, arkitektura krijon lidhje harmonike të pandërprera me sigurinë mjedisore dhe njerëzore. A kanë lidhje arkitektët me katastrofat natyrore? Fatkeqësitë po ndodhin me frekuencë e intensitet më të madh, dhe është përgjegjësi e arkitektëve që të mbrojnë shëndetin, sigurinë dhe mirëqenien e komunitetit. Arkitektët mund të marrin role thelbësore pas katastrofash natyrore, siç janë zjarret, tërmetet apo përmbytjet. Ata thirren shpesh për të vlerësuar dëmet dhe për të siguruar planifikim, ndihmë në hartimin dhe rindërtimin e shtëpive, bizneseve dhe komuniteteve. Gjatë historisë, njerëzit kanë kërkuar të kontrollojnë mjedisin e tyre natyror. Në kohët moderne, krijimi i qyteteve të reja dhe zgjerimi i qyteteve të mëdha ekzistuese dhe industrializimi i mëtejshëm i fuqisë punëtore, kanë çuar në një interes në mënyrë të fortë për sigurinë e mjedisit duke e vendosur atë në ballë. Shumë koncepte përplasen dhe shumë mundësi krijohen në marrëdhëniet midis modelit arkitektonik dhe sigurisë së mjedisit. Padyshim që shkelja e këtyre marrëdhënieve mund të shkojë deri në atë që njihet sot si krim mjedisor përmes modelit arkitektonik. Ky punim ofron një proces të marrëdhënieve midis ndërtimit dhe mjedisit fillon nga faza e njohjes, studimit dhe dizajnit deri në realizimin e tij të plotë. Nëse kërkesat plotësohen në një mënyrë optimale harmonike, krijohet një marrëdhënie e drejtë dhe gjithmonë e qëndrueshme midis mjedisit dhe njerëzve. Përndryshe, marrëdhëniet antagonistike janë të pashmangshme. Siguria duhet të trajtohet si një sfidë e dizajnit që nga fillimi i procesit, ndërsa zgjidhja e duhur si një mundësi që shoqëria të harmonizohet me natyrën.

AKADEMIA
E SIGURISË

Konferencë
shkencore
ndërkombëtare:

« Fenomenet
ekstreme
të natyrës
dhe çështjet
e sigurisë »

Fjalëkyçe:

katastrofat natyrore, arkitektura, siguria njerëzore, siguria mjedisore, projektimi arkitektonik

1. Hyrje

Sa herë që shihni lajmet, duket sikur një tjetër katastrofë natyrore godet në çdo cep të botës. Nga përmbytjet e mëdha, te tërmetet e te zjarret, katastrofat natyrore po bëhen gjithnjë e më të zakonshme. Katastrofat nuk janë një dukuri e re, por shpeshtësia e tyre shkakton dëme deri në disa qindra milionë euro. Në përgjigje të përhapjes dhe kostos në rritje të katastrofave natyrore, edhe arkitektët po kërkojnë një pozicion sa më dinamik për projekte që mund t'i rezistojnë ngjarjeve të tilla. Mjafton të kujtojmë, se sipas OBSH-së, 1 dollar amerikan (USD) i investuar sot në njohjen dhe zbutjen e katastrofave, barazohet deri me 13 dollarë (USD) nesër, në kohën e katastrofës. Shqipëria është një ndër vendet që preket më tepër nga katastrofat me burim natyror apo dhe nga ato të shkaktuara nga dora e njeriut. Ato janë nga më të ndryshmet, të tilla si: përmbytjet, tërmetet, rrëshqitjet e tokës, epidemitë, zjarret në pyje etj. Sipas "Raportit të rrezikut botëror për vitin 2014", Shqipëria renditet e 37-ta nga 171 vende të botës, për rrezikun ndaj fatkeqësive natyrore. Ndonëse janë fatkeqësi natyrore, ekziston mundësia për t'u mbrojtur ndaj tyre duke i parandaluar, apo duke u përballuar me to, me sa më pak pasoja.

"Pse jemi kaq të papërgatitur pas çdo katastrofe? Reagimi ynë është më shumë befasi sesa gatishmëri. Një ndërtim i keq mund të përkeqësojë edhe më tej krizën. Të mbijetuarit dhe të tjerët, kanë nevojë për ekspertë për t'i udhëzuar ata drejt zgjidhjeve të sigurta, afatgjata, të përshtatshme. Në të ardhmen duhet të bëjmë shumë, shumë më tepër më shumë, shumë më pak". Kështu shprehet Bryan Bell, themeluesi i *Design Corps*¹. Arkitektura nuk është as një rikrijim i evolucionit kulturor dhe as një kritikë për

¹ Brian Bellis, Professor of the Practice of Architecture at Georgia Institute of Technology.

gabimet që mund të kenë ndodhur, pasi arkitektura dhe planifikimi lëvizin jo gjithmonë në të njëjtin drejtim me natyrën. Natyra në vetvete është origjinale e bukur, me një larmi të pafund formash, ngjyrash dhe specimesh, që jetojnë së bashku në një mënyrë të përsosur, logjike e të padiskutueshme. Ndaj edhe e vetmja mundësi për të jetuar me natyrën është respekti reciprok.

Në fillim të ekzistencës së njeriut, ekzistonte më shumë se çdo kohë tjetër afërsia me natyrën, ku një marrëdhënie e afërt dhe e kuptueshme çoi në bashkëveprim harmonik ose të paktën të ekuilibruar. Me kalimin e kohës, njerëzit u rritën në numër dhe në njohuri. Si pasojë, raportet dhe qëndrimet ndryshuan. Krenarë dhe të verbuar nga ndjenjat e epërsisë dhe fuqisë, njerëzit u kthyen padashur në armiq të natyrës duke nisur dhe një konflikt që vjen duke u përshkallëzuar në përmasa që nuk flitet për harmoni, por për siguri dhe mbijetesë.

2. Çfarë i lidh arkitektët me katastrofat natyrore?

Fatkeqësitë po ndodhin me më shumë frekuencë dhe intensitet dhe është përgjegjësia e arkitektëve për të mbrojtur shëndetin, sigurinë dhe mirëqenien e publikut. Arkitektët mund të marrin role thelbësore pas një katastrofe natyrore siç janë zjarret, tërmetet ose përmbytjet. Shpesh, arkitektët thirren për të vlerësuar dëmtimet dhe për të siguruar planifikim, ndihmë për dizajnin dhe rindërtimin e shtëpive, bizneseve dhe komuniteteve. Pas ndodhjes së katastrofave, ekziston një nevojë kritike që arkitektët të ndihmojnë komunitetet të kuptojnë se çfarë ka ndodhur me ndërtesat e tyre dhe të ndihmojnë viktimat e fatkeqësive me përpjekjet e rimëkëmbjes dhe rindërtimit.

Arkitektura nuk ka të bëjë vetëm me tulla dhe llaç, por edhe koordinimin e të gjitha elementëve. Nga *mikro* në *makro*, konsideratat e saj dhe vendimet përfundimtare do të ndikojnë të gjitha në “hapësirën” e saj². Uraganet, stuhitë, tërmetet dhe përmbytjet përbëjnë histori rrënojash dhe mbetjesh. Ato janë histori që vazhdojnë të përsëriten në kohë dhe vende të ndryshme. Megjithatë, ajo që është gjithmonë e zakonshme në këto ngjarje është agresiviteti i mënyrës në të cilën natyra zbulon të kaluarën. Ne priremi të anashkalojmë vendimet që kanë shkaktuar efektin. Akti, ka të bëjë me atë që ka hequr. Vendimi, mbështetet tek ata që formojnë mjediset e ndërtuara në të cilat jetojmë. Kur përpiqemi të përcaktojmë arsyet e një katastrofe natyrore, pyetjet zakonisht shoqërohen me pasojat e saj, siç janë nevoja e dukshme për strehim dhe rigjenerimi i komuniteteve të prekura. Arkitektët nga e gjithë bota kanë qenë të përfshirë në mënyrë krijuese me konceptin e strehës së përkohshme që ofron alternativa të zgjuara. Ndërkohë, arkitektët të famshëm si Renzo Piano, Shigeru Ban dhe Alejandro Aravena kanë punuar në projekte për rikuperimin e katastrofave që përqendrohen në restaurimin e zonave të goditura.

Në përgjithësi supozohet se ne jemi kryesisht të interesuar të hetojmë arkitekturën pas katastrofës natyrore, dhe jo të parashikojmë arkitekturën, për katastrofën natyrore. Pra, është shumë e rëndësishme të kthehemi rreth diskursit dhe të përqendrohemi më shumë në ndërveprimet e mundshme që fenomenet ekstreme natyrore mund të kenë me arkitekturën që na rrethon. Kështu, është mjaft intriguese të pyesësh se çfarë lloj sistemesh, strukturash, morfologjie ose estetike, do të sugjeronte një arkitekturë për katastrofë dhe përfundimisht, se si këto sugjerime do të sfidonin normat arkitektonike.

Tema me të vërtetë vë në pikëpyetje pse ndërtojmë në fund të fundit. Lë të shohim simbolin e “kasolles primitive” nga Marc Antine Laugier. Thjesht, ai diskuton origjinën

² “Vision for Change.” Mercy Corps. N.p., n.d. Web. <http://www.mercycorps.org/>

dhe praktikën e arkitekturës. Marrëdhënia midis njeriut dhe natyrës mund të konsiderohet si një bazë themelore për krijimin e arkitekturës³. Ne u kthehemi këtyre nocioneve vetëm për të kuptuar se shqetësimi kryesor i arkitektit-njeri ka qenë gjithmonë vendosja e kornizave mbrojtëse midis tij dhe natyrës. Kështu, një qëllim i thjeshtë i praktikës arkitektonike është nevoja për strehim, por adresimi i rrethanave të emergjencave duke u ofruar njerëzve thjesht strehimore është vetëm një zgjidhje e përkohshme dhe jo një përparim i problematikës.

Natyra mund të jetë armiqtore dhe të veprojë në agresivitet ekstrem. Ekziston një shprehje që 'dhuna sjell dhunën si përgjigje', në aspektin arkitektonik, përgjigjja e dhunshme është zbatimi i strukturave, formave dhe materialit të ngurtë. Ndërtesa fillestare prej betoni është bashkuar në tokë me fibra karboni për të siguruar mbrojtjen nga tërmeti. Kultura jonë ka evoluar përmes anashkalimit të natyrës dhe përmes rezistencës ndaj kufizimeve që zbatohen nga rendi natyror. Ndërtesat e para janë të lidhur me kokëfortësi në tokë kundër të gjitha forcave të fshehura të natyrës. Pyetja thelbësore është me vlerë të lartë filozofike dhe është e vështirë për t'u përgjigjur. A duhet të shkojmë përsëri kundër natyrës apo të shkojmë së bashku me të? Po sikur të miratonim këto shfaqje ekstreme plot ngjarje të natyrës dhe të ndiqnim rrugën e saj në vend që të parandalonim natyrën të kërkonte përsëri tokën e saj? Po sikur gjatë krijimit të arkitekturës të përfshijmë në konceptin tonë të dizajnit idenë e vdekjeve të menjëhershme eventuale të mundshme të vetë artefaktit.

Mënyra se si ne merremi me pasojat e një katastrofe natyrore përcakton ndikimin e ardhshëm. Qasja më absolute e harmonizuar me vlerësimet dhe analizat e mëparshme të pranimit do të ishte zhvendosja në vende më të sigurta, duke e trajtuar katastrofën si një mundësi të pastër. Rrënojat e qytetit të braktisur u kthyen në një monument arti peizazhi të tërmetit nga Alberto Burri⁴. Pra, duket se na duhet kujtimi i një ngjarjeje katastrofike. Fenomenet ekstreme natyrore kanë qenë gjithmonë duke reformuar peizazhin e mjedisit tonë. A duhet të lejojmë që një katastrofë natyrore të lërë gjurmë apo të transformojë rrugët dhe ndërtesat e qyteteve, qyteteve dhe fshatrave tona?

Një qasje e moderuar për një arkitekturë në rast katastrofë është e mundur dhe mund të shprehet duke modeluar arkitekturë në gjendje transitore të ekzistencës. Përsëri, është përgjegjësia e atyre në mjedisin e ndërtuar për të gjetur zgjidhje dhe për të parashikuar dështimin e një ndërtese për t'i rezistuar. Qëllimi është të sugjerojmë një arkitekturë që ndërthur dy parimet e arkitekturës elastike dhe ato të strehës. Përmirësimet teknologjike në strukturë dhe materiale mund të sigurojnë mundësinë e krijimit të një bërthame thelbësore të jetesës (pjesa elastike) që mbyll komponentët kritikë si uji dhe furnizimi me energji elektrike. Strukturat dhe materialet e harxhueshme që janë propozuar tashmë nga projekti i arkitekturës së strehës do të plotësonin një arkitekturë në transicion. Përkatësisht një arkitekturë për katastrofën mund të imitojë këto parime duke përfshirë dy pjesë dalluese. Së pari, një parim elastik, duke kornizuar kalimtarin, të përkohshmen; dhe, së dyti, mbi atë që prishet dhe realizohet pas një tërmeti katastrofik. Arkitektura specifike ngulit në modelin e saj nocione: ose kalimtarin, ose të durueshmen.

3. Arkitektura si element i shoqërisë

Gjatë historisë, arkitektura është vendosur si një përfaqësim i shoqërisë, duke

³ Miller, G. Tyler, Jr. *Sustaining the Earth*. Edited by Jana Davis Suzannah Alexander. 6th ed. Pacific Grove, California:

⁴ Lipton, Michael, and Martin Ravallion. *Poverty and Policy*. Policy Research. Department. World Bank. April 1993. pp 1.

pasqyruar vlerat, sukseset dhe rënien eventuale të civilizimeve me kalimin e kohës. Nga strukturat monumentale te rezidencat dhe ndërtesat që përbëjnë strukturën e një qyteti, ne mund të mësojmë shumë se kush ishin njerëzit që banonin në to shumë para kohës sonë. Duke studiuar mjedisin e ndërtuar të së kaluarës, të kombinuar me kërkime moderne mbi psikologjinë dhe mjedisin, ne arrijmë të kuptojmë efektet e arkitekturës tek njerëzit në mënyra krejtësisht të reja, gjë që shtrën pyetjen: *Si ndikon arkitektura në shoqëri?*

Në rrënjët e saj, arkitektura ekziston për të krijuar mjedisin fizik në të cilin jetojnë njerëzit, por arkitektura është më shumë sesa thjesht një ndërtim, ajo është gjithashtu një pjesë e kulturës sonë. Ajo qëndron si një përfaqësim i mënyrës se si e shohim veten, si dhe sesi e shohim botën. Ndërsa koncepti i strehimit paraqitet mjaft i thjeshtë, stili i ndërtesave fillimisht u formua nga klima e një vendi specifik, nga cilat materiale ishin në dispozicion, si dhe nga vlerat e shoqërisë që i ndërtonte ato. Ndërsa bota bëhej gjithnjë e më e lidhur, stilet evoluuan, por edhe në ndërtimin modern, ka ende rëndësi vlerësimi i nuancave kulturore në mjedisin e ndërtuar. *Ndërsa ndodhin këto evolucione në shoqëri dhe dizajn, ekziston pyetja se çfarë të bëjmë me ndërtesat e vjetra, të dalë jashtë kohës apo edhe të shkatërruara. Disa janë modifikuar për të marrë funksione të ndryshme, ndërsa të tjerat janë shkatërruar, duke u konsideruar se nuk mund të riparohen.* Ekziston gjithashtu mirëkuptimi, që arkitektura është një disiplinë brenda vetes, dhe mund të argumentohet se është po aq e rëndësishme që arkitektët të vazhdojnë të zgjerojnë kufijtë e ndërtimeve në mënyra të reja, pa u shmangur nga ligjet themelore të profesionit.

4. Arkitektura në harmoni me sigurinë njerëzore

Arkitektura jo vetëm që ndikon në shoqëri në një nivel të lartë, por edhe në një nivel më të drejtpërdrejtë, ajo mund të ketë një ndikim të thellë tek banorët e saj. Gjithçka, nga paraqitja e hapësirës deri tek përfundimet e materialit mund të kontribuojnë drejt shëndetit, mundësisë dhe produktivitetit të banorëve. Duket se njerëzit që punojnë në hapësira të dizajnuara mirë marrin më pak trajtime mjekësore, janë më të përqendruar dhe në përgjithësi kontribuojnë më shumë në punën e tyre. Në të kundërt peizazhet sterile, betoni dhe ndërtesat pa imagjinatë janë burime për nivele më të larta stresi. Projektimi i ndërtesave, si dhe i qyteteve, për ta luftuar këtë, qoftë ajo e arkitekturë e bukur apo frikësuese, apo edhe thjesht një lidhje e direkt me natyrën, i ndihmon njerëzit të ndihen më të çlodhur, të lumtur dhe më të sigurt. Arkitektura e projektuar mirë dhe lidhja që kanë njerëzit me të nuk është diçka që përcaktohet lehtësisht. Sidoqoftë, të gjithë e dimë ndjenjën e të ecurit në një hapësirë që ndihet mirë, nuk është vetëm funksionale, por rikumbon me ju në një nivel tjetër, të nënndërgjegjshëm. Ndërsa dizajni për funksionin është sigurisht thelbësor, është e rëndësishme të shfrytëzohet edhe ajo lidhje emocionale, pasi që të dy flasin për sensin e përjetimit të arkitekturës. Nuk është vetëm një kuptim intelektual, por një lidhje midis përdoruesit dhe vetë hapësirës në një mënyrë emocionale.

5. Si përballet arkitektura me sfidat e reja

Arkitektura është art dhe shkencë, duke u mbështetur dhe ndërthurur me sigurinë, psikologjinë, sociologjinë, ekonominë, politikën, por edhe më shumë. Në mjaft debate intelektuale procesi i dizajnit përfshin një kohe të konsiderueshme jo vetëm për të

kuptuar klientin/kërkesën, por edhe raportet e komunitetin me mjedisin në të cilin do të jetë projekti përpara se të fillojnë ndonjë skicim. Një projekt i suksesshëm vjen nga të ideja se hapësirat dhe objektet, që dëshirojmë më shumë ngjallin ndjenja tek ne që nuk janë të lehta për tu vlerësuar, por janë krijuar nga procesi i mbledhjes dhe zbatimit të gjithë këtij procesi njohurie dhe kërkimi.

Teknologjia gjithashtu kontribuon në praktikën e arkitekturës dhe ndikimin e saj në shoqëri. Aksesi në të dhëna globale, prova kërkimore dhe aftësia për të komunikuar në çast me këdo kudo në botë kanë ndryshuar në mënyrë drastike profesionin. Arkitektët mund të marrin projekte e sugjerime në kontinente krejtësisht të ndryshme dhe të marrin edhe forcë pune në të gjithë botën, duke lejuar një gamë të gjerë të ideve dhe ndikimeve kulturore për të përcaktuar një projekt. Teknologjia gjithashtu ka ndryshuar mënyrën e dizajnit: ndihma nga kompjuteri, modeli dhe realiteti virtual, për të përmendur disa, e kanë bërë shumë më të lehtë urën midis vizionit dhe realitetit, krijimin e formave unike dhe komplekse dhe përcjelljen e informacionit në mënyra që nuk janë parë asnjëherë më parë.

Duke parë drejt së ardhmes së arkitekturës dhe ndikimit të saj në shoqëri, ne parashikojmë që teknologjia të vazhdojë të ketë një ndikim të madh, por besojmë se është e domosdoshme që ne të vazhdojmë të kuptojmë marrëdhëniet njerëzore me mjedisin e ndërtuar. Për shembull, si ta adresojmë diferencimin në rritje midis komuniteteve të ndryshme ekonomikisht brenda qyteteve? Ose si t'i përdorim teknologjitë e reja për t'iu përgjigjur shpejt fatkeqësive natyrore ose nevojave urgjente? Si të menaxhojmë rritjen e vazhdueshme të popullsisë në botë dhe të sigurohemi që qytetet tona reflektojnë një lidhje me mjedisin natyror? Të gjitha këto dilema na lidhin në një formë a tjetër edhe me sfidat e sigurisë humane.

Ka mënyra të panumërta që arkitektët mund të vazhdojnë të evoluojnë raportin midis natyrës, shoqërisë dhe arkitekturës dhe t'i përgjigjen nevojave në ndryshim të shoqërisë sonë. Thjesht nuk duhet t'u shmangemi sfidave duke besuar se jemi të aftë për ti përballuar ato.⁵ Si duhet ta vendosë një arkitekt punën e tij përkundrejt mjedisit natyror? Në shekullin e 21-të, kjo pyetje është bërë me një urgjencë të jashtëzakonshme. Projektet arkitektonike më të vlerësuar sot nuk mund të jenë vetëm estetikisht të bukura dhe të efektive, por ta konsiderojnë natyrshëm mjedisin e tyre natyror dhe të jenë plotësisht të integruar në mjedisin e tyre natyror, duke vepruar si pjesë e një ekosistemi më të madh, pra në mbrojtje të natyrës dhe sigurisë humane.

Kuratori [kujdestar muzeu ose koleksionesh], shkrimtari dhe dizajneri holandez Uilliam Myers, në librin e tij shpjegon se sot ka një presion në rritje ndaj projektuesve për të njohur përgjegjësinë tonë për të mbrojtur brishtësinë e natyrës dhe përgjegjësinë tonë për brezat e ardhshëm⁵. Më tej autori iu kërkon projektuesve të marrin pjesë me filozofitë e tyre të dizajnit, duke bërë përpjekje të marrin në konsideratë rrethanat natyrore rreth projekteve të tyre dhe të shfrytëzojnë proceset biologjike të mjedisit: që idealisht i ngjan asaj që ndodh në ekosisteme, në të cilat mbeturinat eliminohen dhe gjithçka që hyn në një proces mund të hyjë në mënyrë të sigurt në një tjetër cikël të mbyllur, ose të rivendoset përsëri në mjedis. Arkitektja dhe teoricienja e urbanizmit, e njohur ndërkombëtarisht, Diana Agrest është një figurë e tillë që po zhvendos ligjërimin modern për ndërtimin në harmoni me botën natyrore, duke i konsideruar si të ndërthurur në vend që të jenë në kundërshtim. Me studion e saj të përparuar të kërkimit

**AKADEMIA
E SIGURISË**

*Konferencë
shkencore
ndërkombëtare:*

« Fenomenet
ekstreme
të natyrës
dhe çështjet
e sigurisë »

⁵ Uilliam Myers *Bio Art: Altered Realities* (2015).

në *The Cooper Union*, ku Agrest është profesoreshë, ajo ka adresuar mungesën e natyrës nga diskursi urban për gati 50 vjet⁶.

Pikërisht, në librin e saj më të ri *Arkitektura e Natyrës/Natyra e Arkitekturës*, Agrest paraqet një analizë për projekte në të cilat forcat gjeologjike përfaqësohen me të njëjtën vëmendje në detaje dhe mjete si ato që i kushtohen arkitekturës, duke e konsideruar natyrën si një objekt të studimit brenda fushës së arkitekturës. Filozofia unike arkitektonike e Agrest kërkon një çlirim të natyrës nga grupe binare të kundërshtimit në të cilat është përcaktuar tradicionalisht: njeriu kundër natyrës, njeriu kundër kulturës, natyra kundër arkitekturës, etj. Në këtë mënyrë, projekti bëhet vetë një objekt radikal i lirë ku studimi në kohë dhe hapësirë në marrëdhëniet e tij me arkitekturën krijon hapësirë të transformojë disiplinën pozitivisht. Libri i saj paraqet përballje mbi një numër temash bashkëkohore, të tilla si arkitektura e vështruar në përputhje me hipotezën *Gaia* dhe teorinë e dizajnit urban utopik.

“Natyra ka luajtur një rol kyç në historinë dhe teorinë e arkitekturës perëndimore, duke u shfaqur si një motiv i vazhdueshëm në tekstet arkitektonike që nga fillimet e saj me *Vitruvius* në Alberti dhe deri në *Qytetin rrezatues* të Le Corbusier⁷. Shihet si një element themelor në zhvillimin e teorisë dhe parimeve arkitektonike, por ky bashkëveprim merr një pozitë të spikatur në momentin aktual.” – shprehet Agrest në një intervistë me *Architect*. Me kalimin e kohës, arkitektura po zhvendoset nga shikimi drejt natyrës si një model vizual, në studimin e funksionalitetit të saj. “Arkitektura e frymëzuar nga *bio*” është një term më i gjerë që merr parasysh funksionet e natyrës në kuptimin shkencor, dhe mënyrën se si proceset e saj mund të studiohen drejt inovacioneve arkitekturore në qëndrueshmëri.

Edhe në kohët moderne arkitektura ka ndeshur me sfida të shumta e shpesh paradoksale, por që në një formë a tjetër tregojnë lidhjen e arkitekturës me sigurinë humane që në një formë a tjetër mund të jetë ekonomike, mjedisore, shëndetësore apo edhe politike. Në 1991, arkitekti Mick Pierce u ndesh me një sfidë të dizajnit kur një grup investimesh në Zimbabve i kërkoi atij që të projektonte një qendër tregtare dhe bllok zyre, por pa një sistem të kondicionuar ajri: një detyrë në dukje e pamundur në klimën e nxehtë të Zimbabve. Si përgjigje, Pierce u kthye në një frymëzim të vështirë: zgjuarsia e termitit të vogël dhe tumave të tij të larta. Qendra *Eastgate* në Harare u krijua për tu ftohur dhe ventiluar në të njëjtën mënyrë. Duke u larguar nga projekti “bllok i madh qelqi” për zyra, të cilat janë të shtrenjta për t’u mbajtur në një temperaturë të rehatshme, Pierce krijoi një mrekulli arkitekturore që arrin 90 për qind kontroll pasiv të klimës duke marrë ajër të freskët në ndërtesë gjatë natës dhe duke nxjerrë nxehtësi gjatë gjithë ditës.

6. Arkitektura dhe siguria mjedisore

Ndërsa njeriu u largua nga origjina tradicionale, mjaft forma të tjera të evolucionit zëvendësuan format e mëparshme. Përkundër këtij trendi fatkeq përsëri ekziston ende një ndjenjë dhe dëshirë e zjarrtë për natyrën dhe madje edhe duke e vizituar atë. Njerëzit shkojnë në parqe, pyje, male, liqene dhe e shohin këtë ambient stërgjyshor të bukur dhe autentik, ndërsa mjedisin ku jetojnë përditë e perceptojnë të falimentuar dhe të rremë.

⁶ Diana Agrest *Architecture of Nature*, Applied Research & Design, 2019.

⁷ Po aty

Evolucioni gradualisht vazhdon përmes ndryshimeve të vogla të pranura gjenetikisht. Mençuria natyrore është vite drite përpara nesh në përvojë, sisteme dhe struktura; tre miliardë vjet përvojë në krahasim me teknologjinë, ende në foshnjëri, e bën këtë të pashmangshme. Edhe modeli më modest i natyrës do të na ofronte kushte më të përshtatshme për kënaqësinë e njeriut. Arti antik u frymëzua nga modelet natyrore, megjithëse kjo tendencë gradualisht dhe pak nga pak është humbur. Ekziston një përpjekje minimale për të orientuar pikëpamjet njerëzore të natyrës duke synuar rivendosjen e ekuilibrit të humbur përmes zhvillimit të shpejtë teknologjik. Ideali duhet të jetë, në të ardhmen e afërt, riintegrimi i shkencës, teknologjisë dhe humanizmit, duke rivendosur një marrëdhënie të ekuilibruar me natyrën dhe duke zvogëluar sforcimet e burimeve natyrore,⁸ – shprehet Senosiain.

7. Në thelb të idesë së harmonisë

Ekzistojnë përkufizime dhe pikëpamje të ndryshme të shprehura mbi një model harmonie edhe për shkak se ka edhe shumë profesione të përfshira në një modelim. Alexander (1977) dha një përkufizim universal të modelit si fillimi i ndryshimit në gjërat e bëra nga njeriu⁹. Booker (1966) përcakton modelin si simulim i asaj që duam të bëjmë para se ta bëjmë atë sa herë që mund të jetë e nevojshme të ndihemi të sigurt në rezultatin përfundimtar¹⁰. Nga ana tjetër, Asimow¹¹ (1962) përcaktoi modelin si një vendimmarrje përballë pasigurisë, me ndëshkime të larta për gabim. Heery (1975 f. 84) e shikon modelin si atë që “përcakton shkallën e përfitimeve pothuajse afatgjata të programit të ndërtimit”, suksesi i të cilit është rezultat i “mendjeve krijuese”, zgjidhjes së problemeve të dhëna të funksionit dhe të mjedisit: është gjithashtu një mekanizëm përshtatës me të cilin pjesëtarët e racës njerëzore janë në gjendje të përballen me mjedisin dhe me vështirësitë e ndryshimit.

Përveç sa më sipër arkitektura është gjithashtu marrëdhënie midis një pjese të një komuniteti fshati, qendre, qyteti me pjesët e tjera dhe bashkëveprimi midis mjedisit tonë në zhvillim, vlerave, pritjeve dhe burimeve të njerëzve. Ndërsa theksi vihet në rregullimin e përgjithshëm të masave dhe pajisjeve të ndërtimit në tre dimensione, përkufizimi ofron një pamje më të detajuar pasi lidh me projektin, aktivitetet njerëzore me burimet e njerëzve. Termi dizajn sot është bërë një emër i përgjithshëm për biznese të ndryshme. Prandaj, me të drejtë, ose gabimisht, gjen shprehje në modelin e modës në skicimin e veshjeve, në modelin e përbërësve në fabrikat e prodhimit, në modelimin e mobileve në ndërmarrje, në modelin arkitektonik në firmat e ndërtimeve të ndërtesave etj. Vlen të përmendet se zakonisht shoqërohet me përpjekje njerëzore që kërkojnë risi në praktikatat e tyre operacionale.

8. Koncepti i “projektimit arkitektonik”, në sfidë të vazhdueshme

Arkitektura ka funksion të sigurojë një mjedis të banueshëm dhe të përmirësojë

⁸ Senosiain, J. (2003) Bio-Architecture. Architectural Press. An Imprint of Elsevier Linacre House, Jordan Hill, Oxford

⁹ Asimow, M. (1962). Introduction to Design New York, NY. Prentice Hall.

¹⁰ Booker, L. (1996). Conference on teaching of Engineering Design. London.

¹¹ Po aty

cilësinë e peizazhit fizik për t'i shërbyer njerëzimit. Arkitektura është një profesion; që përfshin një shkallë të lartë të trajnimit të specializuar që i jep të drejtë një profesioni. Arkitektura është një art; ai i përgjigjet problemeve të shfaqura në kontekst duke ofruar zgjidhje të reja përmes projektimit, ndërtimit dhe teknologjisë në industrinë e ndërtimit. Si shkencë, arkitektura u nënshtrohet teorive të ligjeve natyrore dhe merr vazhdimisht informacion dhe të dhëna nga gjetjet e kërkimit shkencor. Dizajni arkitektonik paraqitet një detyrë themelore për të rregulluar artikulluar dhe paraqitur në mënyrë racionale atë që është midis objektit dhe ta harmonizojë atë me mjedisin për të krijuar rregull në rrjedhën e hapësirës dhe për të përmbushur kërkesat estetike, dhe jetësore. Ndikohet vazhdimisht nga presionet e jashtme të tilla si standardet e sigurisë, trendët, financat, teknologjia dhe materialet dhe më e rëndësishmja nga gjendja e siguria e mjedisit.

Dizajni arkitektonik është pra një proces i zgjidhjes së problemeve teknike dhe humane. Përvoja tregon se problemet nuk kanë gjithmonë saktësisht të njëjtat parametra të dimensioneve; prandaj zgjidhja e problemeve arkitektonike nuk mund të jetë e njëjtë. Zgjidhjet zakonisht janë specifike për klientët, kushtet e vendosjes dhe qasjen e projektuesit. Është shumë e rëndësishme në këtë fazë, të theksohet se arkitektët duhet të kuptojnë mirë kushtet e vendit, për të ofruar zgjidhje të përshtatshme për sfidat e veçanta. Është e nevojshme të sensibilizohen arkitektët për nevojën e përfitimit të zgjidhjeve arkitektonike të dizajnit që nuk do të jenë kontradiktore me natyrën. Zgjidhja e arritur duhet të inkurajojë praninë e natyrës krah për krah me zgjidhjen përfundimtare.

9. Përfundime dhe rekomandime

Për sa më sipër afruam disa mendime për një lidhje midis natyrës, arkitekturës dhe sigurisë humane. Edhe pse siguria njerëzore është primare, ajo asnjëherë nuk mund të shkëputet nga mjedisi dhe mënyra se si i afrohemi asaj (arkitekturës). Largimi i përkohshëm i njeriut nga natyra nuk ka qenë periudha më e lavdërueshme e tij, përkundrazi qëndrimi ende larg saj, do ta bëjë më të vështirë bashkekzistencën midis tyre. Funksionimi efikas i ekosistemit, cilësia e mjedisit, krijimet e ambienteve natyrore apo harmonizimi i ndërtimit me mjedisin fizik, ndërgjegjësimi i komunitetit, zvogëlimi i substancave ndotëse mjedisore në projektin arkitektonik janë mjetet kryesore për të arritur një ekuilibër midis njeriut dhe natyrës dhe sigurisë përreth tij.

Në përgjithësi, dizajni arkitektonik është një problem i zgjidhur dhe një disiplinë e orientuar drejt shërbimit social e cila lëviz me kohën dhe kështu i nënshtrohet ndryshimeve. Këto ndryshime nuk duhet të rrisin në asnjë mënyrë hendekun midis njeriut dhe natyrës; në vend të kësaj ndryshimet duhet të ngushtojnë hendekun, që të dy të bashkëjetojnë në harmoni. Përpjekjet e përbashkëta të së gjithë aktorëve të përfshirë duhet të jenë bashkëpunimi, konsultimi, dhe jo konfrontimi e konkurrenca.

Bibliografi

1. Asimow, M. (1962). Introduction to Design New York, NY. Prentice Hall.
2. Booker, L. (1996). Conference on teaching of Engineering Design. London
3. Brandon, P.S. and Powel, J.A (1984). Quality and Profit in Building Design, London, E & F.N. Spon.
4. Broadbent, G. (1973): Design in Architecture, John Willy&Sons LTD.
5. Carmona, M. (1996): Controlling Urban Design- Part 1: A possible Renaissance? In Journal of Urban Design Vol. 1.
6. Department of Environment (1999): Quality in Town and Country Campaign, London.
7. Edward, B. (1999): sustainable Architecture-European directives and building design. Architectural Press, Oxford, U.K
8. Farmer J. (1996): Green Shift: Toward a Green sensibility in Architecture, Architectural Press, Oxford.
9. Heery, G. T. (1975). Time, cost and Architecture, NewYork, McGraw-Hill Book Company.
10. Jones, J. C. (1981): Design methods: seeds of human futures, (1980 edn). NewYork: John Wiley&Sons.
11. Moore, G. T. (1974). "Environment- behavior studies", in J. C. Synderand A. J. Catanese (eds) Introduction to Architecture.
12. Senosiain, J. (2003) Bio-Architecture. Architectural Press. An Imprint of Elsevier Linacre House, Jordan Hill, Oxford.
13. Steven, W. (2004): Design, the Art and Science involved in the planning and making of a Product, Tool, Artifact, Building or service. Microsoft Encarta premium suite.
14. "Vision for Change." Mercy Corps. N.p., n.d. Web. <http://www.mercycorps.org/>
15. Miller, G. Tyler, Jr. *Sustaining the Earth*. Edited by Jana Davis Suzannah Alexander. 6th ed. Pacific Grove, California.

Fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë e tjera: preventivat për mbrojtje nga fatkeqësitë



■ Dr. Enver GËRGURI

Akademia e Kosovës për Siguri Publike
enver.gerguri@rks-fsk.org

Abstrakt

Me qëllim të mbrojtjes së jetës dhe shëndetit të njerëzve, kafshëve, pronës dhe të mirave materiale nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera, shtetet organizojnë mekanizma mbrojtës respektivisht institucione (policia, ushtria, shërbimet mjekësore, shërbimet zjarrfikëse dhe të shpëtimit, organizata qeveritare dhe joqeveritare, shoqata të ndryshme etj.). Por jo në të gjitha rastet e fatkeqësive natyrore dhe fatkeqësive të tjera këta mekanizma munden të arrijnë me kohë në vendin e fatkeqësisë prandaj është e një rëndësie të jashtëzakonshme që qytetarët të jenë të njoftuar për llojet e fatkeqësive, për mënyrën se si ato godasin, për pasojat dhe masat që duhet ndërmarrin për të krijuar preventiva mbrojtëse. Pikërisht, duke u bazuar në këtë që u tha, në këtë punim shkencor bëhet një përmbledhje e disave prej fatkeqësive natyrore dhe teknologjike, të cilat mund të na godasin në çdo moment, dhe jepen udhëzime se si duhet të sillet popullsia në tri fazat kryesore: para ndodhjes së fatkeqësisë, gjatë fatkeqësisë dhe pas ndodhjes së fatkeqësisë. Jam i vetëdijshëm që nuk do të mund t'i përmbledh të gjitha fatkeqësitë që mund të ndodhin dhe nuk mendoj se do të mund t'i ofroj të gjitha këshillat e nevojshme në rast se përballemi me këto situata emergjente, por shpresoj që të kem arritur sado pak, që të ofroj njohuri themelore që nevojiten për t'u përballur me sukses me këto situata. Po ashtu, do të isha i lumtur sikur të arrij me këtë punim të jap kontributin tim në sensibilizimin e opinionit për domosdoshmërinë për të bërë një fushatë të organizuar të institucioneve për rëndësinë e edukimit në masat parandaluese të fatkeqësive dhe mënyrat e përballjes me to.

Fjalëkyçe:

shëndeti, institucionet, fatkeqësitë, masat mbrojtëse.

AKADEMIA
E SIGURISË

Konferencë
shkencore
ndërkombëtare:

« Fenomenet
ekstreme
të natyrës
dhe çështjet
e sigurisë »

1. Hyrje

Për fatkeqësitë natyrore, fatkeqësitë tjera dhe masat mbrojtës për mbrojtje nga fatkeqësitë është folur, diskutuar dhe shkruar mjaft deri tani, dhe kjo temë, çdoherë ka vëmendje të posaçme në të gjitha dikasteret e shtetit. Masat për mbrojtje nga fatkeqësitë janë gjërat themelore që duhet ndërmarrin institucionet shtetërore, si në nivelin lokal po ashtu edhe në nivelin qendror. Duke pasur parasysh se fatkeqësitë mund të jenë të paparashikueshme, gjithmonë duhet të kemi kujdes që paraprakisht të marrim edhe masat për parandalimin e tyre respektivisht duhet të bëjmë preventivat për mbrojtje nga të gjitha llojet e fatkeqësive. Zhvillimet aktuale në aspektin e infrastrukturës dhe dëmtimet e natyrës me qëllim nga popullata kanë bërë që fatkeqësitë të marrin një zhvillim të ndryshëm, respektivisht të shkaktojnë dëme të ndryshme në hapësirat e banueshme. Në këtë punim jam munduar sadopak të paraqes një realitet për trajtimin e gjendjes para fatkeqësisë, gjatë fatkeqësisë dhe pas fatkeqësisë si dhe marrjes së masave preventive për të parandaluar fatkeqësitë. Fillimisht kam paraqitur tërmetet, vërshimet, cunamet si pasojë e vërshimeve dhe tërmeteve, vullkanet, zjarret dhe pandemitë.

2. Tërmetet

Tërmetet¹ apo dridhjet e tokës paraqiten si lirim i papritur i energjisë në litosferë, e që krijon valë sizmike. Tërmetet mund të jenë të dobëta dhe të mos ndjehen fortë, dhe tërmete të forta të cilat shkaktojnë dëme të mëdha materiale dhe humbje jetësh njerëzore, si tërmeti i fundit në vendin tonë, në nëntor të vitit 2019. Forca e tërmeteve matet me

¹ Doracak për situatat emergjente, faqe 22, "Kolegji "Biznesi", Prishtinë.

sizmometa në stacionet sizmologjike, magnituda është shkallë e matjes lokale e cila shpeshherë referohet si shkalla e magnitudës *Richter*. Tërmetet janë të llojeve të ndryshme:

a) *Dridhjet e tokës (Earthquake strikes)*: janë ato tërmete të cilat shkaktohen kur kemi rrëshqitje të masave të tokës; p.sh. kur shembet ndonjë shpellë. Janë tërmetet më të dobëta dhe kanë rreze veprimi prej afro 100 km. Vetëm 3 % e gjithë tërmeteve që ndodhin janë tërmete me dridhje².

b) *Tërmetet vullkanike*: zakonisht paraprihen nga erupsioni vullkanik, pra janë tërmete që shkaktohen nga veprimi i aktiviteteve vullkanike. Për nga intensiteti dhe fuqia e lëkundjeve vijnë të dytat pas tërmeteve tektonike. Rreth 7% e gjitha tërmeteve janë tërmete vullkanike.

c) *Tërmetet tektonike*: janë lëkundje të fuqishme dhe përfshijnë sipërfaqe të mëdha të tokës.

Vatra e këtij tërmeti gjendet në rreth 70 km në thellësi të tokës e në disa raste edhe më thellë. Janë më të shpeshtat, rreth 90% të gjitha tërmeteve janë tërmete tektonike. Shfaqen rreth 80 000 tërmete tektonike në vit e prej tyre rreth 10 janë shumë të fuqishme.

d) *Tërmetet artificiale*: zakonisht shkaktohen artificialisht nga njeriu, p.sh. nga eksplozimi i eksplozivëve gjatë hapjes ose shpimit të shpellave, nga bombardimet e ndryshme ushtarake nëpër luftëra, ushtrimeve ushtarake me armë të rënda etj. Mund të kenë fuqi të ndryshme, varësisht nga sasia e eksplozivit të përdorur.

e) *Tërmete me origjinë natyrore*: shumica e tërmeteve me shkaqe natyrore janë pasojë e ndërtimit tektonik të tokës. Këto tërmete quhen edhe tërmete tektonike. Litosfera e tokës është si një qilim i përbërë nga shumë pllaka tektonike të cilat lëvizin ngadalë, por në mënyrë të vazhdueshme nën ndikimin e nxehtësisë së mantelit dhe bërthamës së tokës. Tërmetet e ulin potencialin energjetik dhe energjinë termike të tokës, por këto humbje janë të papërfillshme.

2.1 Masat preventive mbrojtëse nga tërmetet

Tërmetet janë të parashikueshme se kur mund të ndodhin dhe ku do të ndodhin. Megjithatë janë disa rregulla se si të sillemi para tërmetit, gjatë tërmetit dhe pas tërmetit, të cilat janë shumë të dobishme; respektivisht të dimë se si të marrim masat preventive para ndodhjes së tërmetit.

Para një tërmeti³

- Vëzhgoni me kujdes vendin ku kaloni kohën më të gjatë. Identifikoni vende të sigurta si nën një pjesë të fortë të mobileve ose një muri të brendshëm në shtëpinë, zyrën ose shkollën tuaj, në mënyrë që kur fillon tërmeti, të uleni në tokë, mbulonit kokën dhe qafën me krahët tuaj dhe nëse një vend më i sigurt është afër, zvarrituni deri aty.

- Për të reaguar shpejt duhet të praktikosh shpesh. Ju mund të keni vetëm pak sekonda për të mbrojtur veten në një tërmet.

- Para se të ndodhë një tërmet, sendet e ndryshme të forta mund të bien dhe të shkaktojnë plagosje (p.sh., rafte librash, pasqyra, ndriçime të lehta) prandaj siguro që ato të mos bien në raste tërmeti. Ruani furnizimet kritike (p.sh., uji, barnat) dhe dokumentet.

- Planifikoni se si do të komunikoni me anëtarët e familjes, duke përfshirë metoda të

² Po aty faqe 24

³ Kudisi Lame, Menaxhimi i Emergjencave, faqe 49

shumta duke bërë një plan komunikimi për emergjencat familjare.

- Kur zgjedh shtëpinë ose biznesin tuaj (për të blerë ose marrë me qira), kontrolloni nëse ndërtesa është rezistuese ndaj tërmeteve sipas standardeve të ndërtimit.

Gjatë një tërmeti nëse ndodheni brenda objektit/shtëpisë⁴:

- Qëndroni aty ku jeni deri sa tundja të ndalojë; mos dilni jashtë; mos hyni në derë pasi kjo nuk siguron mbrojtje nga objektet e rënies ose fluturimit dhe ju nuk mund të qëndroni;

- uluni poshtë në duart tuaja dhe në gjunjë, kështu që gjatë tërmetit të mos rrëzoheni; uluni në tokë (para se tërmeti të ju ulë!);



fig. 1. tavolina si mjet mbrojtës⁵

- mbulo kokën dhe qafën me krahët për të mbrojtur veten nga rënia e objekteve të ndryshme;

- nëse jeni në rrezik nga objektet në rënie dhe mund të lëvizni në mënyrë të sigurt, zvarrituni për mbulim shtesë nën një tavolinë të fortë;

- nëse ka mobile të ulët ose një mur apo qoshe të brendshme pranë, dhe rruga është e qartë, këto gjithashtu mund të ofrojnë një mbulesë shtesë;

- qëndroni larg qelqit, dritareve, dyerve dhe mureve të jashtme, dhe çdo gjë që mund të bjerë, si varëse të lehta ose mobile;

- qëndroni aty ku jeni deri sa tundja të ndalojë.

Nëse mbrojtja në dysheme nuk është e sigurt⁶

Identifikoni një kënd të brendshëm të dhomës larg dritareve dhe objekteve që mund të bien mbi ju. Njerëzit që përdorin karrike me rrota ose pajisje të tjera të lëvizjes duhet të bllokojnë rrotat e tyre dhe të qëndrojnë të ulur derisa dridhja të ndalojë. Mbroni kokën dhe qafën me krahët, një jastëk, një libër, ose çfarëdo që është në dispozicion.

Nëse jeni në shtrat kur ndjeni tërmetin

Nëse jeni në shtrat, qëndroni aty dhe mbulon kokën dhe qafën me një jastëk. Natën, rreziqet dhe mbeturinat janë të vështira për t'u parë dhe për të shmangur; përpjekjet për të lëvizur në errësirë do të rezultojë me lëndime më të shumta të mundshme, sesa po të rrini në shtrat.

Nëse jeni jashtë kur ndjeni tërmetin

Nëse jeni jashtë kur fillon lëkundja, largohuni nga ndërtesat, rrugët dhe telat e shërbimeve. Qëndro atje derisa dridhja të ndalojë. Kjo mund të mos jetë e mundur në një qytet, kështu që mund t'ju duhet të futeni brenda një ndërtese për të shmangur mbeturinat në rënie.

Nëse jeni në një automjet në lëvizje kur ndjeni tërmetin

Nëse jeni në një automjet në lëvizje, ndaluni sa më shpejt dhe në mënyrë të sigurt të

⁴ Kudisi Lame "Menaxhimi i Emergjencave" faqe 59/60

⁵ Doracaku për situatat emergjente nga Kolegji Biznesi, faqe 22, Prishtinë 2015

jetë e mundur dhe qëndroni në automjet. Shmangni ndalimin pranë ose nën ndërtesa, pemë, mbikalime dhe telat e shërbimeve. Vazhdoni me kujdes kur tërmeti të jetë ndalur. Shmangni rrugët, urat ose rampat që tërmeti mund të ketë dëmtuar.

Pas një tërmeti:

- kur dridhja ndalet, shikoni përreth. nëse ka një rrugë të qartë për sigurinë, largohuni nga ndërtesa dhe shkoni në një hapësirë të hapur larg zonave të dëmtuara;

- nëse jeni të bllokuar, mos lëvizni.;

- nëse keni një telefon celular me vete, përdorni atë për të thirrur ose shkruani për ndihmë.

- trokitni lehtë mbi një tub ose mur ose përdorni një bilbil, nëse keni një, në mënyrë që shpëtuesit të mund t'ju lokalizojnë;

- pasi të jetë sigurt, monitoroni raportet lokale të lajmeve nëpërmjet radios, televizorit, medias sociale dhe njoftimeve me tekstin e celularit për informacione dhe udhëzime emergjente⁷.

3. Vërshimet/përmytjet⁸

Vërshimet (përmytjet) janë ndodhia/dukuria kur një sasi jashtëzakonisht e madhe e ujit gjendet në një vend të caktuar ku zakonisht është tokë e thatë (pa ujë), për shkak të forcave natyrore (reshjeve të shumta, shkrirja e shpejtë) ose shkaqe të tjera të tilla si rrjedhje e digës, etj.

3.1 Si ndahen vërshimet

Sipas shkaqeve të përmytjeve, vërshimet mund të ndahen në:

- vërshime e shkaktuar nga reshjet atmosferike të mëdha,
- vërshime të shkaktuara nga akumulimi i akullit në lumenj,
- vërshimet e shkaktuara nga rrëshqitjet e tokës apo tërmetet,
- vërshime të shkaktuara nga dështimi digës.

Duke pasur parasysh kohën e formimit të valës së ujit, përmytjet mund të klasifikohen në:

- vërshime të qeta: përmytjet në lumenj të mëdhenj, ku për formimin e valëve të mëdha të ujit, ajo merr kohë dhjetë orë e më tepër,
- vërshime të rrëmbyeshme: përmytjet në rrjedhat malore në të cilat për të formuar një valë të madhe të ujit merr kohë më pak se dhjetë orë,
- vërshimet aksidentale: përmytjet në të cilat formojnë valë momentale (të shpejtë), të mëdha të ujit, duke shkatërruar kultura bujqësore dhe objekte të ndryshme.

3.2 Masat themelore të sigurisë, preventivat ndaj vërshimeve⁹

- Duhet shmangur ecjen (lëvizjen) ose vozitjen nëpër ujin që ka vërshuar. Vetëm 15 cm ujë mundet të rrëzojë njeriun në lëvizje kurse 30cm ujë mundet të bartë automjetin.
- Nëse ka gjasa për vërshime të papritura, lëvizni menjëherë në vende më të lartë. Vërshimet e shpejta janë shkak më i shpeshtë i vdekjeve.
- Nëse ujërat e vërshuara ngrihen rreth makinës suaj, por uji nuk lëviz, braktis

⁶ Kudisi Lame , Menaxhimi i Emergjencave , Prishtinë 2013

⁷ Menaxhimi i Emergjencave , Kudisi Lame , faqe 39

⁸ Po aty , faqe 62

⁹ Po aty , faqe 67

makinën dhe lëviz në tokë më të lartë.

- Duhet shmangur kampingun ose parkimin përgjatë përrënjeve, lumenjve dhe kodrave gjatë reshjeve të mëdha. Këto zona mund të përmblyten shpejt dhe pa paralajmërim.

Përgatitjet për mbrojtjen e shtëpisë

- Mobilet që ndodhen jashtë shtëpisë të futen brenda kurse gjërat më të rëndësishme të dërgohen në katet e larta përkatësisht tavanin e shtëpisë në mënyrë të mbrohen nga uji nëse futet brenda.

- Të ndërpritet energjia elektrike dhe të mos preken pajisjet që janë në ujë nëse ende janë të furnizuara me energji elektrike.

- Duhet ndërprerë gazin (nëse ekziston) në valvulën kryesore për të penguar zjarrin eventual ose shpërthimet.

Kthimi në shtëpi pas evakuimit

- Në shtëpi duhet kthyer vetëm pasi që autoritetet e sigurisë njoftojnë që është i sigurt kthimi,

- Duhet pasur kujdes në zonat e përmblytura, ujërat shpesh sjellin dhe pas tërheqjes lënë mbeturina e po ashtu gërryejnë tokën (rrugët dhe shtigjet).

- Nuk duhet provuar vozitjen nëpër zonat që janë ende të mbuluara me ujë,

- Duhet shmangur ujërave të qeta sepse mundet me pasur përçues elektrik të shkëputur nën ujë.

4. Cunamet¹⁰

Cunami është një seri valësh gjigante që ndodhin pas lëvizjes nënujore për shkak të ngjarjeve natyrore si tërmetet, shpërthimet vullkanike, rrëshqitjet e dheut etj. Cunamet paraqiten në një distancë kohore të shkurtër menjëherë pas ndonjë goditje nëndetare e cila shkakton tërmet të fuqishëm, ose prej ndonjë tjetër fuqie, rrëshqitje e ndonjë mase të madhe të tokës, ose brenda në oqean prej ndonjë shpërthimi (erupsioni) vullkanik. Studimet shkencore në këtë drejtim kanë qenë të shumëllojta, ndaj edhe me kalimin e kohës kanë lindur shumë hipoteza e teori të cilat kanë ardhur në një përfundim të përbashkët, se lëvizjet që paraqiten në koren e Tokës janë si pasojë e fuqive të brendshme, nuk përjashtohet mundësia edhe e atyre të jashtme. Edhe këto të fundit mund të krijojnë cuname, por, kuptohet, me përmasa më të vogla.

Para një cunami

Këto janë gjërat që mund (duhet) të bëhen për të mbrojtur veten, familjen dhe pronën nga efektet e një cunami:

- Për të filluar përgatitjen, duhet të sigurohet një kuti (çantë) emergjence dhe të krijohet një plan komunikimi familjar, të bisedoni me anëtarët e familjes ngase njohja mund të të shpëtojë jetën. Të krijohet dhe praktikohet një plan evakuimi për familjen.

- Nëse jeni turist, njihuni me protokollet lokale të evakuimit të cunamit. Nëse jeni të shqetësuar se nuk do të jeni në gjendje të arrini një vend të sigurt në kohë, kërkoni zyrën tuaj lokale të menaxhimit të emergjencave për evakuimin vertikal. Nëse ndodh një tërmet dhe jeni në një zonë bregdetare, ndizni radion tuaj për të mësuar nëse ka paralajmërim për cunami.

Gjatë cunamit:

- ndiqni urdhrin e evakuimit të lëshuar nga autoritetet dhe largohuni menjëherë;

**AKADEMIA
E SIGURISË**

*Konferencë
shkencore
ndërkombëtare:*

« Fenomenet
ekstreme
të natyrës
dhe çështjet
e sigurisë »

¹⁰ Preventivat për mbrojtje nga fatkeqësitë, faqe 16, Kolegji "Biznesi" Prishtinë 2017

- lëvizni në tokë të lartë ose në brendësi dhe larg nga uji menjëherë;
- rritni larg plazhit; mos shkoni kurrë në plazh për të parë hyrjen e cunamit; ruaj veten, jo pasurinë tënde;
- mos harroni të ndihmoni fqinjët tuaj të cilët mund të kërkojnë ndihmë të veçantë: foshnje, njerëz të moshuar dhe individë me qasje ose nevoja funksionale.

Pas cunamit:

- kthimi në shtëpi të bëhet vetëm pasi zyrtarët lokalë të thonë se është e sigurt;
- duhen shmangur zonat e fatkeqësive;
- duhet kontrolluar vetja për lëndime për të marrë ndihmën e parë sipas nevojës, para se të ndihmohen personat e plagosur ose të bllokuar.
- nëse dikush duhet të shpëtohet, duhen thirrur profesionistët me pajisje të duhura për të ndihmuar;
- duhen ndihmuar njerëzit që kërkojnë ndihmë të veçantë;
- për të shmangur dëmtimet, duhen veshur rroba mbrojtëse dhe duhet pasur kujdes gjatë pastrimit.


5. Vullkanet¹¹

Janë forma të ngritura në Tokë, paraqiten si një dukuri sipërfaqësore në formë kupe. Vullkanet janë gryka, ku materiali i zjarrtë shkëmbor del nga brendësia e tokës. Magma duke u nisur nga vatra e vullkanit, e cila gjendet në tryzni të madhe është e lëvizshme. Magma kur ngurtësohet në brendi të korës së Tokës formon shkëmbinj të brendshëm magmatik ose të shpërthejë e të derdhet në sipërfaqe. Si produkt kryesor i erupsionit vullkanik është llava, me një temperaturë 1000-1300 gradë celsius, dendësinë zakonisht e ka si të magmës dhe varet nga përbërja kimike, e në rend të parë nga përbërja e silicit.

Tipat e vullkaneve

Varësisht nga përbërja dhe mënyra e derdhjes së lavës, dallojmë shumë tipa të vullkaneve, por më kryesorë janë: tipi i Vezuvit, i Havait dhe Monpelesë. Vullkanet, përveç formimit të trajtave relievore të ndryshme vullkanike, kanë rëndësi të madhe në sajimin e pasurive mineralogjike të një rëndësie të madhe ekonomike. Mirëpo shkaktajnë edhe dëme të mëdha materiale dhe viktima në njerëz.

Fig. 2 Vullkani



1. Baza e vullkanit
2. Fundamenti i tokës
3. Kanali (pipe) i brendshëm
4. Baza e vullkanit
5. Ndërprerja e kanalit
6. Kanali anësor
7. Shtresat e hirit të krijuara nga erupsioni
8. Flank
9. Shtresat e llavës të krijuara nga erupsioni
10. Fyti i vullkanit
11. Koni parazitik
12. Zvarritja e llavës
13. Dalja e llavës
14. Krateri
15. Tym vullkanik

Para një vullkani

Për të mbrojtur veten, familjen dhe pasurinë duhet të bërë këto gjëra:

- Të përgatitet një çantë furnizimi emergjent, i cila përfshin pikat si ushqimi që nuk prishet, uji, një radio me bateri, bateritë rezervë, llambë ndriçuese e dorës etj. Kjo çantë duhet të përfshijë gjithashtu një palë syze dhe maskë të disponueshme të frymëmarrjes për secilin anëtar të familjes.

- Duhet të përgatitet një *plan emergjent i familjes*. Familja nuk mund të jetë së bashku kur godet fatkeqësia, prandaj është e rëndësishme të dihet se si do të kontaktojë njëri-tjetrin, si të ktheheni së bashku dhe çfarë do të bëhet në rast emergjence.

6. Zjarret¹²

Zjarri është një dukuri e djegies e shoqëruar me nxehtësi të lartë, tym dhe dritë në formë flakësh përcëlluese. Kontrollimi i zjarrit ishte një hap i rëndësishëm në lindjen e kulturës njerëzore. Drita vjen nga dy burime:

- një pjesë e këmbimit të elektroneve mes kompozimeve gjatë reagimit kimik;¹³
- rrezatime të tjera emetojnë çdo organ të sjellë në temperaturë të lartë¹⁴.

Dobia nga zjarri

Që nga kohërat e lashta njeriu ka vërejtur se zjarri është i dobishëm për shumë arsye: përgatitja e ushqimit, pastrimi, shkrirja e metaleve, mbrojtja, zjarri si mjet lufte etj.

Dëmet nga zjarri

Zjarret e pa kontrolluara kanë qenë dhe mbeten një sfidë e vazhdueshme për njerëzimin. Zjarri shkakton dëmet të cilat mund të klasifikohen në dy grupe: dëme direkte dhe dëme indirekte.

Masat prventive për mbrojtje nga zjarri¹⁵

Dihet, se për t'u krijuar zjarri duhen tre elemente kryesore: lënda djegëse, temperatura dhe oksigjeni të cilat përbëjnë të ashtuquajturin trekëndëshi i zjarrit. Në masat parandaluese primare është që të pengojmë që këto tri elemente të jenë të lidhura mes tyre, në një reaksion zinxhir, ose së paku njëri element të mungojë.

Zjarret fushore/malore

Zjarret fushore/malore janë shumë të shpeshta sidomos në pikun e stinës së verës atëherë kur temperaturat janë shumë të larta dhe bimët janë në kulmin e pjekjes. Këto zjarre janë shumë të vështira për ti vënë nën kontroll respektivisht për ti shuar për shkak të konfiguracionit të terrenit dhe mungesës së burimit të ujit në afërsi të duhur, pastaj erërat e shpeshta mund ta shpërndajnë zjarrin me një shpejtësi marramendëse.

Preventivat e mbrojtjes nga zjarret fushore-malore¹⁶

Masat parandaluese që duhet ndërmarrë janë:

- a. nuk duhet ndezur zjarr në male apo fusha;
- b. nuk duhet hedhur cigare e ndezur;
- c. në piknik zjarri mundet të ndezët në tokë të thatë pa barishte, larg drunjtëve të imtë dhe të thatë dhe duhet të jetë zjarr i vogël dhe lehtë i kontrollueshëm;
- d. pas korrje shirjes duhet që arat të lëvrohen pjesë-pjesë duke krijuar tamponë në

¹¹ Mnaxhimi i Emergjencave, Kudisi Lame, faqe 140.

¹² Izet Shehu dhe Miftar Mehani, Mjetet, paisjet dhe metodat për shuarjen e zjarrit, Prishtinë 2013

¹³ Kudisi Lame, Menaxhimi i Emergjencave, faqe 92

¹⁴ Po aty, faqe 94

¹⁵ Kudisi Lame, Menaxhimi i Emergjencave faqe 95

¹⁶ Doracaku për situatë emergjente, faqe 14/15

mënyrë që zjarret e papritura të kenë materie djegëse të kufizuar;

e. malet po ashtu duhen ndarë në sektorë ku në mesë të sektorëve të ketë hapësirë të zhveshur në mënyrë që zjarret eventuale të pa kontrolluara të përfundojnë aty.

Zjarret në vendbanime

Në kohën e sotme kur si rezultat i shtimit të popullsisë kemi rritje të vendbanimeve ku shtëpitë janë të ngjitura njëra me tjetrën zjarret në vendbanime paraqesin rrezik dhe për jetën dhe shëndetin e njerëzve dhe janë shumë vështira të shuhen. Shumica e zjarreve në vendbanime ndodhin në kuzhinë gjatë përgatitjes së ushqimit/gatimit, si gatimi i pambikëqyrrur.

Zjarret në vendbanime mund të shkaktohen aksidentalisht ose si rezultat i një ndezjeje të paparashikuar, për shembull nga një proces elektrik, mekanik ose kimik. Zjarret gjithashtu mund të rezultojnë nga një shkak natyror si tërmetet ose vetëtimat. Problem të veçantë në menaxhimin e këtyre zjarreve paraqesin rastet kur si rezultat i erës dhe dendësisë së vendbanimeve zjarret masivizohen dhe ekipet zjarrfikëse janë të mbi ngarkuara prandaj intervenimi në shuarjen e zjarrit dhe shpëtimit vështirësohet maksimalisht.

7. Pandemitë¹⁷

Me fjalën *pandemi* (nga greqishtja *πάλη* [pandemia]: që i përket popujve) kuptohet përhapja një sëmundje ngjitëse e cila i kalon kufijtë e shteteve dhe kontinenteve. Në krahasim nga epideminë, pandemia nuk është e kufizuar në një pjesë të caktuar. Sipas OBSH-së kur plotësohen tri kushte, mund të themi që kemi pandemi:

- kur në një popullatë kemi të përhapur deri atëherë një sëmundje të panjohur,
- shkaktarët infektojnë njerëzit dhe lënë pasoja të rënda,
- shkaktarët shtrihen shpejtë dhe qëndrojnë te njerëzit.

Sëmundja nuk konsiderohet si një pandemi, sepse ajo është e përhapur, ose ka shkaktuar vdekjen e shumë njerëzve, sepse ajo duhet të jetë ngjitëse për të nisur një pandemi. Për shembull, kanceri është përgjegjës për një numër të madh të vdekjeve në mbarë botën, por nuk është konsideruar si një pandemi, sepse ajo nuk është ngjitëse.

Gjatë gjithë historisë së rasteve të raportuara njihen pandemia e murtajes, pandemia e kolerës, tifoja, gripi, AIDS, fruthi, tuberkulozë, lebra, malaria, ethet e verdha, dhe tash së fundi pandemia shumë e rrezikshme COVID 19.

Para një pandemie:

- duhet siguruar një furnizim dy javor me ujë dhe ushqim;
- duhen kontrolluar periodikisht barnat e rregullta për të siguruar një furnizim të vazhdueshëm;
- barnat më të shpeshta që duhen siguruar janë kundër dhembjeve, kundër dhembjeve të stomakut, kundër temperaturës, lëngje me elektrolite, vitamina etj.;
- duhet biseduar me anëtarët e familjes dhe të dashurit për mënyrën se si duhet kujdesur për ta në qoftë se ata u sëmurën, apo atë që do të jetë e nevojshme për t'u kujdesur për ta në shtëpinë;
- duhet bashkëpunuar me autoritetet lokale për të ndihmuar në përballjen me situatë emergjente.

Gjatë pandemisë:

- kufizimi i përhapjes së bakteve për të parandaluar infeksionet;
- duhen shmangur kontaktet e afërta me njerëz të cilët janë të sëmurë; kur ju jeni të sëmurë, mbani distancë tuaj nga të tjerët për t'i mbrojtur të tjerët;
- i sëmuri duhet të rrijë në shtëpi që të mbroj të tjerët mos të sëmuren;
- gjatë kollitjes apo teshtimës është e preferuar mbulimi i gojës dhe hundës me maskë mbrojtëse apo një leckë që mos të përhapet virusi tek të tjerët;
- larja e duarve shpesh ndihmon mbrojtjen nga mikrobet;
- duhet shmangur preken e hundës, gojës dhe syve;
- duhet praktikuar veset e mira e të shëndetshme si, gjumi i mjaftueshëm, marrja e ushqimit me vitamina, konsumimi i lëngjeve etj.¹⁸

Pas pandemisë

- shmangja e kontakteve me njërës në grupe të mëdha;
- gjithmonë të kihet parasysh që edhe për një kohë duhet bartur maska si preventivë.

8. Përfundime¹⁹

Duhet pranuar, e kështu thonë edhe ekspertët që merren veprimtaritë e ndryshme në menaxhimin e emergjencave të ndryshme, që kur ballafaqohemi me ndonjë situatë të jashtëzakonshme, të gjithë pjesëmarrësit në emergjencë qofshin ata viktimat (popullata) apo ekipet për menaxhim të emergjencave dhe shërbimet tjera profesionale veprojnë në kushte të rënduara psikologjike. Ekipet emergjente përveç që janë të ngarkuar me stres, punën ua vështirësojnë edhe viktimat (popullata) të cilët i kaplon frikë, panik, shpeshherë në mungesë të informacioneve të mjaftueshme përhapen edhe dezinformime të ndryshme. Në shumë vendbanime sidomos në vendet rurale ekipet e shpëtimit munden të vonohen në ofrimin e ndihmave, kuptohet për shkaqe objektive prandaj është e domosdoshme dhe shumë e preferuar që secili qytetar të ketë njohuri elementare për fatkeqësitë e ndryshme që mund ta godasin, që të jetë në gjendje të ndihmojë veten dhe të tjerët. Sa më mirë që qytetarët individualisht dhe kolektivisht që të jenë të përgatitur qofshin në familje, rrugë apo institucione të ndryshme do të kontribuojnë që pasojat të jenë më të vogla. Duke pasur këtë parasysh qëllimi i këtij punimi ishte që ti vejë në pah disa nga fatkeqësitë që munden të ndodhin dhe të ofroj këshilla se si duhet reaguari qytetari në shtëpi përkatësisht familje apo në shoqëri me qëllim vetë ndihmës dhe ofrimin e ndihmës të tjerëve.

Bibliografia

1. Kudusi Lama, Menaxhimi i Emergjencave, Prishtinë, 2013.
2. Doracak për Situata Emergjente, "Kolegji Biznesi", Prishtinë, 2015.
3. Ibush Luzha, Praktika Planifikuese në Emergjencë, Prishtinë, 2018.
4. Izet Shehu, Miftar Mehani, Mjetet Pajisjet dhe Metodat për Shuarjen e Zjarrit, Prishtinë 2013.
5. Adem Musliu, Materiet kimike dhe biologjike, Prishtinë 2011.
6. Ligji Nr. 02/L-109 Për parandalimin dhe luftimin e sëmundjeve ngjitëse.

¹⁸ Menaxhimi i emergjencave, faqe 109.

¹⁹ Ibush Luzha, Praktikat planifikuese në emergjencë, Prishtinë 2018.



AKADEMIA E SIGURISË

*Konferencë
shkencore
ndërkombëtare:*

« Fenomenet
ekstreme
të natyrës
dhe çështjet
e sigurisë »

~ Sesiioni IV ~

Kuptimi, veçoritë, specifikat dhe metodat e hetimit
të fatkeqësive natyrore dhe të emergjencave civile

**AKADEMIA
E SIGURISË**

*Konferencë
shkencore
ndërkombëtare:*

« Fenomenet
ekstreme
të natyrës
dhe çështjet
e sigurisë »

Mbrojtja civile dhe rrugëtimi drejt anëtarësimit në Mekanizmin e Mbrojtjes Civile Evropiane (UCPM)



■ **MSc. Valbona LIKAJ**
Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile
likajvalbona@gmail.com



■ **MSc. Fatjona XHAFERI**
Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile
fatjona.xhaferi@mod.gov.al

Abstrakt

Ky punim u konceptua duke pasur parasysh rritjen e ndjeshme të numrit të fatkeqësive natyrore dhe atyre të shkaktuara nga dora e njeriut në vitet e fundit dhe nga rritja e ndërgjegjësimit që fatkeqësitë e ardhshme do të jenë më ekstreme, më komplekse dhe me pasoja afatgjata, si rezultat i ndryshimit të klimës, cenueshmërisë, ekspozimit dhe ndërveprimit potencial midis disa rreziqeve natyrore dhe teknologjike. Në këto kushte, një qasje e integruar ndaj menaxhimit të fatkeqësive është gjithnjë e më i rëndësishëm. Qeverisja e mirë, duke përfshirë edhe ligjet e duhura, rregulloret, përgjegjësitë e përcaktuara, bashkëpunimin dhe shqyrtimin e problematikave, është thelbësore për të menaxhuar rrezikun nga fatkeqësitë, prioritet veprimi ky, i “Kudrit Sendal”. Çdo vend duhet të shqyrtojë qasjen e tij në reduktimin e rrezikut nga fatkeqësitë, në përshtatje me kontekstin e vet dhe për këtë arsye, është e rëndësishme që të jenë vendosur role dhe përgjegjësi të qarta për të gjitha palët e interesuara nga niveli kombëtar në atë lokal, të gjitha të harmonizuara në një kuadër ligjor efektiv dhe gjithëpërfshirës. Nga çdo vend pritet të krijohet një platformë kombëtare për mekanizmin koordinues të reduktimit të riskut nga fatkeqësitë dhe të caktohet një ministri apo agjenci, si pikë qendrore të reduktimit të riskut nga fatkeqësitë.

Fjalëkyçe:

fatkeqësi natyrore, reduktimi i rrezikut, “Kudri Sendal”, mekanizëm, mbrojtje civile.

1. Hyrje

Shqipëria është një vend i prirë ndaj fatkeqësive. Katër rreziqet kryesore që cenojnë vendin janë: tërmetet, përmbytjet, zjarret në pyje dhe rrëshqitjet e tokës. Baza e të dhënave ndërkombëtare të fatkeqësive (EM-DAT)¹ tregon se, gjatë viteve 1979-2019, përmbytjet llogariteshin si pjesa më e madhe e ngjarjeve të fatkeqësive (38%), të ndjekura nga tërmetet (15%). Sipas “Raportit vjetor të rrezikut botëror” (BEH-IFHV, 2019)², i cili llogarit *indeksin e rrezikut nga fatkeqësitë* për 180 vende, bazuar te ekspozimi, ndjeshmëria, cënueshmëria dhe aftësitë përballuese e përshtatëse, Shqipëria renditet e para në Evropë dhe e 61-ta në botë. Humbjet e mundshme në Shqipëri nga një fatkeqësi, me një periudhë mesatare 250-vjeçare, vlerësohen në 2.08 miliardë euro për tërmetet dhe, 1.18 miliardë euro (145.2 milionë lekë) për përmbytjet (Banka Botërore, 2014)³. Shqipëria e ka rrezikshmërinë të lartë nga zjarret në pyje, veçanërisht në sezonin e thatë të verës. Më shumë se 95% e ngjarjeve nga zjarri janë të vogla (më pak se 100 ha të djegura) dhe përbëjnë më shumë se 40% të zonës totale të djegur, ndërsa ngjarjet e mëdha janë relativisht të rralla (5% e sipërfaqes totale të djegur). Shqipëria karakterizohet nga paqëndrueshmëria e tokës, e shkaktuar kjo nga faktorë natyrorë dhe antropogjenë. 33.6% e territorit të saj është relativisht e qëndrueshme, dhe 9,8% është e paqëndrueshme (UNDP, 2003)⁴.

¹ EM-DAT. The Emergency Events Database, Université Catholique de Louvain (UCL) - CRED, D. Guha-Sapir, www.emdat.be, Brussels, Belgium

² Bündnis Entwicklung Hilft and Ruhr University Bochum – Institute for International Law of Peace and Armed Conflict (IFHV), *World Risk Report 2019*, Gjermani, fq 50, 57

³ BEH-IFHV, (2019), *World Risk Report 2019*, ISBN 978-3-946785-08-8, <http://www.WorldRiskReport.org>

⁴ UNDP, (2003), *Disaster Risk Assessment in Albania, Executive Summary Report*. • World Bank, (2014), *AL-DRMAP Project* ICR, <http://documents.worldbank.org/curated/en/313781468193510916/pdf/ICR29910P110840C0disclosed050210140.pdf>

Ngjarjet që pasuan tërmetin, treguan, se ekziston një nevojë urgjente për të forcuar gatishmërinë ndaj fatkeqësive dhe aftësitë e menaxhimit të rreziqeve, për të miratuar sisteme dhe procedura të përshtatshme reagimi dhe, për të përmirësuar kapacitetin institucional për koordinimin dhe ndërveprimin e menaxhimit DRR midis niveleve publike të qeverisë, me ato private, si dhe me aktorë të shoqërisë civile. Qasja gjithëpërfshirëse lokale, kombëtare, rajonale dhe globale në menaxhimin e rreziqeve nga fatkeqësitë, dhe e vetë fatkeqësive, sikurse trajtimi i të gjithë spektrit të rreziqeve, janë disa nga sfidat bashkëkohore të cilave, ne po demonstrojmë për ditë e më shumë se jemi të gatshëm t'u përgjigjemi veçmas, apo edhe duke bashkuar kapacitetet tona.

Këta, por edhe shumë tregues të tjerë, të lidhur me rrezikun, cënueshmërinë, ekspozimin, kapacitetet përballuese dhe ato përshtatëse ndaj fatkeqësive, referuar edhe “Kuatrit Sendai”, kanë bërë që qeveria shqiptare t'u japë përparësi politikave të reduktimit të rrezikut nga fatkeqësitë, në politikat e saj kombëtare.

Në kuadrin e sfidave që hasëm në përballimin e fatkeqësive natyrore, si dhe të nevojës së menjëhershme për reformimin e sistemit të mbrojtjes civile, qeveria dhe Parlamenti Shqiptar, kanë miratuar ligjin nr. 45, datë 18.7.2019, “Për mbrojtjen civile”. Ligji në fjalë, parashikoi ngritjen e Agjencisë Kombëtare për Mbrojtjen Civile, si person juridik publik qendror, në varësi të ministrit përgjegjës për Mbrojtjen Civile, që përgjigjet për zvogëlimin e rrezikut nga fatkeqësitë dhe për mbrojtjen civile, dhe parashikon një strategji kombëtare për reduktimin e rrezikut nga fatkeqësitë, i cili është hapi i madh i radhës; dhe, përgatitja për hartimin e saj ka filluar.

Ligji gjithashtu, është në përputhje të plotë me “Kuatrin Sendai për reduktimin e rrezikut nga fatkeqësitë”, sikurse përaftron një sërë direktivash dhe vendimesh të BE-së, dhe do të ndihmojë në përmbushjen e kushteve për anëtarësimin e Shqipërisë në Mekanizmin e Mbrojtjes Civile të Bashkimit Evropian. Për anëtarësimin në *Mekanizëm*, para së gjithash, do të duhet një vullnet politik i autoriteteve kompetente shqiptare. Ky vullnet politik do të duhet të shoqërohet paralelisht me angazhimin për rritjen e kapaciteteve njerëzore të AKMC-së, si dhe me rritjen e kapaciteteve operative për parandalimin dhe menaxhimin e fatkeqësive në Shqipëri.


2. “Kuatri Sendai”

“Kuatri Sendai për reduktimin e rrezikut nga fatkeqësitë, 2015-2030”, i miratuar në konferencën e 3-të botërore të OKB-së “Për reduktimin e rrezikut nga fatkeqësitë”, në mars 2015, në Sendai të Japonisë, dhe i miratuar nga Asambleja e Përgjithshme e OKB-së në qershor të vitit 2015, u ka ofruar aktorëve të menaxhimit të rrezikut nga fatkeqësitë, një seri udhëzimesh të reja⁵. Ai thekson rolin dhe rëndësinë e platformave rajonale për reduktimin e rrezikut nga fatkeqësitë, dhe të mbështetjes rajonale, për përpjekjet kombëtare dhe lokale. Gjatë konferencës botërore, shtetet deklaruan gjithashtu angazhimin e tyre, për të trajtuar uljen e rrezikut nga fatkeqësitë, ndërtimin e aftësisë ripërtëritëse ndaj fatkeqësive, brenda një kuptimësie të ripërtëritë të urgjencës, brenda kontekstit të zhvillimit të qëndrueshëm e çrrënjësjes së varfërisë, për të integruar siç duhet, reduktimin e rrezikut ndaj fatkeqësive e ndërtimin e aftësisë ripërtëritëse në politika, plane, programe e buxhete në të gjitha nivelet dhe, për t'i trajtuar të dyja

⁵ United Nations, Kuatri Sendai për Reduktimin e Riskut nga Fatkeqësitë 2015-2030, Marrë nga https://www.preventionweb.net/files/43291_sendaiframeworkfordrren.pdf


brenda kornizave përkatëse.

“Kuari Sendai”, trajton në mënyrë specifike, adaptimin ndaj ndryshimeve klimatike, duke u përqendruar në veprime të nevojshme për të trajtuar udhëzuesit (“drivers”) themelorë të rrezikut ndaj fatkeqësive, të tilla si pasojat e ndryshimeve klimatike, dhe ndryshueshmërisë, ndër të tjera. Ai, përcakton më tej parimet udhëzuese, të cilat përfshijnë zhvillimin, forcimin dhe zbatimin e politikave, planeve, praktikave dhe mekanizmave që nxisin koherencën ndërmjet ndryshimeve klimatike dhe ndryshueshmërisë, menaxhimin e mjedisit dhe agjendat e reduktimit të rrezikut ndaj fatkeqësive. Forcimi i qeverisjes së rrezikut të fatkeqësive kërkon bashkëpunim të gjithë mekanizmave globale dhe rajonale, dhe institucioneve për zbatimin dhe koherencën e instrumenteve të mjeteve përkatëse në reduktimin e rrezikut nga fatkeqësitë, të tilla si, për ndryshimet klimatike, përshtatjen klimatike, dhe zhvillimin e qëndrueshëm.



2.1 Qëllimi

Qëllimi i “Kuarit Sendai” është që të parandalojë rreziqet e reja nga fatkeqësitë dhe t’i reduktojë ato ekzistueset përmes zbatimit të masave të integruara dhe gjithëpërfshirëse ekonomike, strukturore, ligjore, sociale, shëndetësore, kulturore, arsimore, mjedisore, teknologjike, politike e institucionale, të cilat parandalojnë dhe reduktojnë ekspozimin ndaj rrezikut dhe cenueshmërinë ndaj fatkeqësive; të rrisë gatishmërinë për përgjigje dhe rimëkëmbje, dhe të forcojë në këtë mënyrë aftësinë ripërtëritëse.



AKADEMIA
E SIGURISË

Konferencë
shkencore
ndërkombëtare:

« Fenomenet
ekstreme
të natyrës
dhe çështjet
e sigurisë »

2.2 Objektivat globalë të “Kuatrit Sendai”

“Kuatri Sendai” ka si synim të ulë ndjeshëm:

- vdekshmërinë në nivel global gjatë katastrofave,
- numrin e personave të prekur,
- humbjen e drejtpërdrejtë të ekonomisë në raport me PBB-në globale,
- dëmet në infrastrukturën kritike dhe ndërprerjen e shërbimeve bazike.

Ka si synim të rrisë ndjeshëm:

- numrin e vendeve me strategji për DRR deri në 2020 në nivel lokal dhe kombëtar,
- rrisin bashkëpunimin ndërkombëtar për vendet në zhvillim,
- disponueshmërinë dhe qasjen në sistemet e paralajmërimit të hershëm, dhe
- vlerësimet e informacionit për reduktimin e rrezikut nga fatkeqësitë.

2.3 Prioritetet për veprim

Më poshtë kemi në formë tabelore, katër prioritetet e veprimit dhe shtatë objektivat globale të “Kuatrit Sendai”. Ekziston nevoja për veprim të përqendruar brenda dhe midis sektorëve në nivel lokal, kombëtar, rajonal dhe global në katër fushat e mëposhtme parësore.

Prioriteti 1	Kuptimi i rrezikut nga fatkeqësitë Menaxhimi i rrezikut nga fatkeqësitë duhet të jetë i bazuar te kuptimi i rrezikut nga fatkeqësitë në të gjitha dimensionet e cënueshmërisë, kapacitetit, ekspozimit të personave dhe pasurive, karakteristikave të rrezikut dhe mjedisit.
Prioriteti 2	Forcimi i qeverisjes së rrezikut nga fatkeqësitë, për të menaxhuar rrezikun nga fatkeqësitë Qeverisja e rrezikut nga fatkeqësitë në nivel kombëtar, rajonal dhe global është jetike për menaxhimin e reduktimit të rrezikut të fatkeqësive në të gjithë sektorët dhe sigurimin e kohencës së kornizave kombëtare e lokale të ligjeve, rregulloreve e politikave publike që, me përcaktimin e rroleve dhe përgjegjësisë, udhëzojnë, inkurajojnë e stimulojnë publikun dhe sektorin privat, për të ndërmarrë veprime dhe për të trajtuar rrezikun ndaj fatkeqësive.
Prioriteti 3	Investimi në zvogëlimin e rrezikut nga fatkeqësitë për aftësinë ripërtëritëse Investimet publike dhe private në parandalimin e rrezikut nga fatkeqësitë dhe reduktimin përmes masave strukturore dhe jostrukturore, janë thelbësore për të rritur aftësinë ripërtëritëse ekonomike, sociale, shëndetësore dhe kulturore të personave, komuniteteve, shteteve dhe burimeve të tyre, si dhe të mjedisit. Këto mund të jenë shkatërruese të inovacionit, zhvillimit dhe krijimit të vendeve të punës. Masa të tilla janë me kosto efektive dhe instrumentale për të shpëtuar jetën, parandaluar dhe për të zvogëluar humbjet dhe për të siguruar rikuperim efektiv dhe rehabilitim.
Prioriteti 4	Rritja e përgatitjes në rast fatkeqësish, për përgjigje efektive, dhe për “Build Back Better” (“Rindërto më mirë”) rimëkëmbje, rehabilitim e rindërtim Përvoja tregon se duhet të forcohet gatishmëria për përgjigje më efektive, dhe për të siguruar se ekzistojnë kapacitetet për rikuperim efektiv. Fatkeqësitë, kanë treguar gjithashtu, se faza e rimëkëmbjes, rehabilitimit dhe rindërtimit, të cilat duhet të jenë të përgatitura përpara fatkeqësisë, është një mundësi për të rindërtuar më mirë “Build Back Better” me integrimin e masave për uljen e riskut fatkeqësive. Gratë dhe personat me aftësi të kufizuara duhet të udhëheqin dhe promovojnë publikisht qasjet e barazisë gjinore te të drejtat universale, gjatë fazës së përgjigjes dhe të rindërtimit.

Tabela nr. 1. Prioritetet e “Kuatrit Sendai”⁶

⁶ United Nations, Kuadri Sendai për Reduktimin e Riskut nga Fatkeqësitë 2015-2030, https://www.preventionweb.net/files/43291_sendaiframeworkfordrren.pdf

2.4 Parimet udhëzuese

1	Përgjegjësia parësore e shteteve për të parandaluar dhe për të zvogëluar rrezikun nga fatkeqësitë, duke përfshirë bashkëpunimin.
2	Përgjegjësi e përbashkët e qeverisë qendrore dhe e autoriteteve kombëtare, sektorëve dhe e palëve të interesuara, sipas rastit, në rrethanat kombëtare.
3	Mbrojtja e personave dhe e pasurisë së tyre, ndërsa promovojnë dhe mbrojnë të gjitha të drejtat e njeriut, duke përfshirë edhe të drejtën për zhvillim.
4	Angazhimi i gjithë shoqërisë.
5	Angazhimi i plotë i të gjitha institucioneve shtetërore të një natyre ekzekutive dhe legjislative në nivel kombëtar dhe lokal.
6	Fuqizimi i autoriteteve dhe komuniteteve lokale përmes burimeve, stimujve dhe përgjegjësisë së vendimmarrjes sipas rastit.
7	Vendimmarrja të jetë gjithëpërfshirëse dhe e informuar për rrezikun, duke përdorur një qasje trajtimi shumërrazikshmërie.

Tabela nr. 2. Parimet udhëzuese të "Kudrit Sendai"

3. Mekanizmi i Mbrojtjes Civile të Bashkimit Evropian (UCPM)⁷

Legjislacioni i Bashkimit Evropian (BE) për mbrojtjen civile vendos një theks shumë më të madh në parandalimin e fatkeqësive, menaxhimin e rreziqeve dhe gatishmërinë ndaj fatkeqësive, duke përfshirë atë grup vullnetarësh që kanë kapacitete për t'u përgjigjur, të regjistruar paraprakisht në Qendrën e Koordinimit të Përgjigjes Emergjente (ERCC), pra të paraangazhuar. Baza ligjore e Mekanizmit të Mbrojtjes Civile Evropiane është vendimi nr. 1313/2013, i cili për shkak të pandemisë së COVID-19 ka pësuar disa ndryshime të tjera dhe pritet miratimi i tij, në maj 2021. Kur shkalla e një emergjence kapërcen aftësitë e reagimit kombëtar, Mekanizmi i Mbrojtjes Civile të Bashkimit Evropian mundëson një ndihmë të koordinuar nga shtetet e tij pjesëmarrës. Në Mekanizmin e Mbrojtjes Civile të BE-së marrin pjesë 28 shtete anëtare të BE-së si dhe, Islanda, Norvegjia, Serbia, Maqedonia e Veriut, Mali i Zi, Turqia; në total, 34 shtete.


Bashkimi Evropian duhet të nxisë solidaritetin dhe duhet të mbështesë e lehtësojë koordinimin e veprimeve të shteteve anëtare në fushën e mbrojtjes civile me synim përmirësimin e efektshmërisë së sistemeve për parandalimin, përgatitjen dhe përgjigjen ndaj fatkeqësive natyrore dhe atyre të shkaktuara nga njeriu.

Mbrojtja që do të sigurohet në kuadrin e Mekanizmit të Mbrojtjes Civile të Bashkimit Evropian ("Mekanizmi"), duhet të mbulojë kryesisht njerëzit, por gjithashtu mjedisin dhe pronën, duke përfshirë trashëgiminë kulturore, kundrejt të gjitha llojeve të fatkeqësive natyrore dhe të shkaktuara nga njeriu, duke përfshirë fatkeqësitë mjedisore, ndotjen detare dhe emergjencat akute shëndetësore, që ndodhin brenda apo jashtë Bashkimit Evropian.

Mbrojtja civile dhe ndihma të tjera urgjente në kuadrin e *Mekanizmit* mund të kërkohen në të gjitha këto fatkeqësi për të plotësuar aftësitë e reagimit të vendit të prekur. Lidhur me fatkeqësitë e shkaktuara nga aktet e terrorizmit, aksidentet bërthamore apo radiologjike, Mekanizmi duhet të mbulojë vetëm nivelin e përgatitjes

⁷ DECISION No 1313/2013/EU OF THE EUROPEAN PARLIAMENT AND OF THE COUNCIL of 17 December 2013 on a Union Civil Protection Mechanism, <https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/PDF/?uri=CELEX:32013D1313&from=EN>

dhe veprimet e reagimit brenda fushës së mbrojtjes civile. *Mekanizmi* duhet të përfshijë një politikë të përgjithshme, që synon përmirësimin e vazhdueshëm të nivelit të gatishmërisë e sistemeve të mbrojtjes civile.



***Skema e funksionimit të "Mekanizmit"**

Parakushtet për anëtarësimin e një vendi në "Mekanizëm":

1. funksionimi 24/7 i qendrave operacionale të emergjencave civile/"emergency operations centre" (EOC);
 2. EOC me staf të trajnuar dhe me njohuri shumë të mira të gjuhës angleze;
 3. vendosja e sistemit të komunikimit e të informimit të emergjencave/"Common Emergency Communication and Information System" (CECIS) sTESTA;
 4. zhvillimi i sistemit të lajmërimit të hershëm;
 5. shpërndarja e informacionit në të gjitha vendet anëtare;
 6. hartimi i dokumenteve si, *Vlerësimi i rrezikut; Strategjia e DRR; Plani i emergjencave civile;*
 7. hartimi i planeve të menaxhimit të rrezikut;
 9. pagesa vjetore e kontributit financiar.
- 3.1 Qendra e Koordinimit të Përgjigjes Emergjente (ERCC)

ERCC-ja ofron një kapacitet të plotë 24/7 [24 orë çdo ditë të javës] për të monitoruar dhe t'u përgjigjur ndaj fatkeqësive. Qendra mbledh informacione në kohë reale për fatkeqësitë, monitoron rreziqet, përgatit planet për dislokimin e burimeve (ekspertë, ekiye dhe pajisje) nga grupi i vullnetarëve (*Pool of Experts*). ERCC-ja punon me shtetet anëtare për të planifikuar burimet në dispozicion dhe koordinon përpjekjet e BE-së për përgjigjen ndaj fatkeqësive. Më e rëndësishmja, qendra ka lidhje të drejtpërdrejtë me mbrojtjen civile dhe autoritetet e ndihmës humanitare në shtetet pjesëmarrëse, duke

siguruar një përgjigje koherente evropiane ndaj fatkeqësive.

Për të aktivizuar *Mekanizmin* nuk është e nevojshme të jesh vend anëtar. *Mekanizmi* lidhet me të gjitha llojet e fatkeqësive, por në rastin e fatkeqësive nukleare, faza e parandalimit është pjesë e strukturave të tjera që lidhen me aksidentet industriale. Mekanizmi i Mbrojtjes Civile aktivizohet kur një shtet dërgon kërkesë tek ERCC për të përballuar një fatkeqësi natyrore apo fatkeqësi të shkaktuar nga dora e njeriut, për shkak se përmasat e fatkeqësisë janë shumë të mëdha, duke kapërcyer kapacitetet kombëtare. Në momentin që një kërkesë për ndihmë dërgohet tek ERCC-ja, kjo kërkesë shpërndahet në të gjitha vendet, për t'i ardhur në ndihmë vendit të prekur.

Kjo qendër funksionon nëpërmjet sistemit CECIS, sistem informacioni dhe komunikimi. Pas aktivizimit të *Mekanizmit*, vende të tjera dërgojnë informacion tek ERCC-ja. Sistemi CECIS përdoret midis vendeve anëtare në *Mekanizëm* për të komunikuar dhe shpërndarë informacion midis tyre. Me vendet që nuk janë anëtare të mekanizmit komunikohet me faks, e-mail, telefon.



***Pamje nga trajnimet në Qendrën e Koordinimit të Përgjigjes Emergjente (ERCC) të ekspertëve të AKMC-së**

Hapat për t'u bërë pjesë e "Mekanizmit":

- nënshkrimi i marrëveshjes midis BE-së dhe vendit kandidat;
- sistemi i aprovimit të brendshëm të vendit që ka aplikuar;
- komunikimi me kanalet diplomatike;
- ratifikimi i marrëveshjes;
- pagesa vjetore e kontributit financiar.

Pjesë të *Mekanizmit* janë:

1) ERCC-ja.
2) "European Emergency Response Capability"/"Kapaciteti Reagues Evropian ndaj Emergjencave" tani quhet *Pool*-i i mbrojtjes civile evropiane [(EERC – often referred to as the "voluntary pool")/shqip, do të ishte "forca vullnetare"], që vazhdon të jetë pjesa qendrore e kapaciteteve të përgjigjes.

3) *resceEU* është elementi më i rëndësishëm i *Mekanizmit*. Është një shërbim mbi kapacitetet e mbrojtjes civile në nivel evropian që mund të përdoret si burimi i fundit. Është një rezervë e kapaciteteve të mbrojtjes civile evropiane; kur vendet anëtare nuk mund të përballojnë një fatkeqësi, ato kërkojnë ndihmën e Bashkimit Evropian si dhe, kur kapacitetet ne *Pool* janë të pamjaftueshme për t'u përgjigjur ndaj një fatkeqësie. Në këtë situatë, Komisioni Evropian dhe ERCC-ja vendosin të dislokojnë kapacitetet *resceEU* për të mbështetur vendet anëtare.

**AKADEMIA
E SIGURISË**

*Konferencë
shkencore
ndërkombëtare:*

**« Fenomenet
ekstreme
të natyrës
dhe çështjet
e sigurisë »**

4) Trajnimet për *Mekanizmin*.

5) *Peer reviews* [vlerësimi i punës nga një ose më shumë njerëz me kompetenca të ngjashme] ose grup i ekspertëve, njihet si një element esencial për përmirësimin e kapaciteteve të menaxhimit të riskut për vendet anëtare.

4. Konkluzione dhe rekomandime

Shqipëria është një hap larg për t'u bërë vend anëtar në BE. Pas hyrjes në fuqi të ligjit nr. 45/2019 dhe ngritjes së strukturës së Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile, kanë mbetur disa detyra të tjera për t'u realizuar dhe, duke iu referuar studimit të mësipërm, rekomandohet si më poshtë:

1. harmonizimi i legjislacionit të mbrojtjes civile shqiptare në përputhje me direktivat e Bashkimit Evropian dhe rregulloret e tjera;

2. njohja e institucioneve përgjegjëse dhe organeve më të larta qeveritare në vend; me funksionimin e *Mekanzimit* (aktivizimin e *Mekanzimit*, përbërjen, logjistikën, trajnimet, misionet etj.);

3. forcimi i kapaciteteve kombëtare për parandalimin, gatishmërinë, përgjigjen dhe koordinimin e emergjencave civile të shkaktuara nga fatkeqësi të ndryshme;

4. konsolidimi dhe trajnimi i kapaciteteve njerëzore dhe logjistike, me synim mobilizimin e menjëhershëm të tyre sipas procedurave përkatëse të *Mekanizimit*, kur kërkohet dhe ofrohet asistencë ndërkombëtare;

5. komunikimi i hershëm dhe i vazhdueshëm me ERCC-në gjatë gjithë kohës;

6. shkëmbimi i informacionit me objektiv promovimin dhe inkurajimin e bashkëpunimit midis Shqipërisë dhe Sistemit të Mbrojtjes Civile Evropiane;

7. angazhimi i Shqipërisë dhe i AKMC-së për të përfituar sa më shumë nga programet dhe projektet IPA-a si dhe iniciativa të tjera ndërkombëtare në fushën e mbrojtjes civile, ku përfshihen në mënyrë direkte dhe indirekte.

Bibliografi

1. EM-DAT. The Emergency Events Database, Université Catholique de Louvain (UCL) - CRED, D. Guha-Sapir, www.emdat.be, Bruksel, Belgjikë
2. Bündnis Entwicklung Hilft and Ruhr University Bochum – Institute for International Law of Peace and Armed Conflict (IFHV), *World Risk Report 2019*, Gjermani
3. BEH-IFHV, (2019), *World Risk Report 2019*, ISBN 978-3-946785-08-8, <http://www.WorldRiskReport.org>
4. UNDP, (2003), *Disaster Risk Assessment in Albania*, Executive Summary Report.
5. World Bank, (2014), *AL-DRMA Project*ICR, <http://documents.worldbank.org/curated/en/313781468193510916/pdf/ICR29910P110840C0disclosed050210140.pdf>
6. United Nations, Kuadri Sendai për Reduktimin e Riskut nga Fatkeqësitë 2015-2030, https://www.preventionweb.net/files/43291_sendaiframeworkfordrren.pdf
7. DECISION No 1313/2013/EU OF THE EUROPEAN PARLIAMENT AND OF THE COUNCIL of 17 December 2013 on a Union Civil Protection Mechanism, <https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/PDF/?uri=CELEX:32013D1313&from=EN>
8. Ligji nr. 45, datë 18.7.2019, "Për Mbrojtjen Civile"
9. Plani Kombëtar i Emergjencave Civile
10. https://ec.europa.eu/echo/what/civil-protection/emergency-response-coordination-centre-ercc_en
11. https://ec.europa.eu/echo/what/civil-protection/mechanism_en



Shënim i redaktorit:

Fjala "risk", e përdorur nga autorët në këtë shkrim, është zëvendësuar me fjalën "rrezik". Nuk është bërë kjo gjë, vetëm në rast citimi të drejtpërdrejtë të një burimi. Gjej me vend të sqaroj, se ky shënim po vendoset për shkak se autoret, kanë përdorur një gjuhë e stil të shkruari korrekt. Për më tepër, në lidhje me këtë term, mund të lexohet në fund të vëllimit të parë të botimit të punimeve kësaj konferencës.

AKADEMIA E SIGURISË

*Konferencë
shkencore
ndërkombëtare:*

**« Fenomenet
ekstreme
të natyrës
dhe çështjet
e sigurisë »**

Analizë shkencore, mbi reshjet e muajit janar 2021, dhe përmbytjet e vrojtuar në Shqipëri



■ **Prof. Dr. Petrit ZORBA**
Departamenti i Klimës dhe
Mjedisit, IGJEUM, UPT
petrit.zorba@gmail.com



■ **Dr. Elvin ÇOMO**
Departamenti i Klimës dhe
Mjedisit, IGJEUM, UPT
elvincomo1@gmail.com



■ **MSc. Gazmir ÇELA**
Departamenti i Klimës dhe
Mjedisit, IGJEUM, UPT
gazmircela11@gmail.com

Abstrakt

Bazuar në përdorimin e informacioneve nga sistemi kombëtar i monitorimit meteorologjik, burimeve satelitore dhe të platformave profesionale evropiane, me të cilat institucioni ynë bashkëpunon, dhe ka ekskluzivitetin për përdorimin e produkteve të tyre, është vlerësuar për vendin tonë situata e reshjeve të muajit janar 2021, që u shoqërua dhe me përmbytje në zona të ndryshme të vendit. Në përputhje me standardet e OBM-së, janë analizuar tregues të ndryshëm të reshjeve, intensitetet e tyre dhe shpërndarja në hapësirë dhe kohë për muajin janar 2021 për territorin e Shqipërisë. Përdorimi i SIG-së dhe programeve të tjerë profesionalë, mundësoi një thellim të mëtejshëm në studim, jo vetëm mbi karakterin e reshjeve të vrojtuar: raportin, reshje shiu me reshje dëbore, por dhe të ndikimeve të përcjella nga ndryshimet klimatike dhe veprimtaria njerëzore në vitet e fundit. Në këtë material bëhet dhe një analizë e veçorive të përbashkëta dhe të veçanta të përmbytjeve në vitet e fundit për faktorët e shkaktit të tyre. Përgatitja dhe shpërndarja në kohë e vlerësimeve parashikuese meteorologjike dhe hidrologjike nga IGJEUM, përbën një ndihmesë në punën e infrastrukturës së emergjencave civile, pushtetit lokal e qendror në menaxhimin e situatës, duke ndikuar në minimizimin e pasojave negative.

Fjalëkyçe:

reshjet, përmbytjet, ngjarjet meteorologjike, SIG, ndryshime klimatike.

AKADEMIA
E SIGURISË

Konferencë
shkencore
ndërkombëtare:
« Fenomenet
ekstreme
të natyrës
dhe çështjet
e sigurisë »

1. Hyrje

Reshjet intensive që përcollën përmytje të shoqëruara dhe me dëme ekonomike gjate muajit janar 2021, ishin objekt i studimit, analizës së thelluar shkencore dhe nxjerrjes së disa përfundimeve me rendësi për minimizimin e ndikimeve negative në të ardhmen. Në këtë artikull përmbledhen dhe pasqyrohen në mënyrë grafike dhe nëpërmjet hartave, duke aplikuar SIG dhe programe të tjera kompjuterike, një sere treguesish mbi reshjet e shiut dhe dëborës, intensitetin e tyre dhe shpërndarjen në hapësirë, të vrojtuar dhe përpunuara sipas standardeve të OBM-së.

Gjithashtu një vëmendje e veçantë i kushtohet nxjerrjes së atyre veçorive dalluese dhe të përbashkëta me dukuritë e tjera të ngjashme të vrojtuar në të shkuarën. Rritja e dukurisë së përmytjeve në vitet e fundit është e lidhur ngushte dhe me ndikimin që përcjellin ndryshimet klimatike në regjimin dhe karakterin e reshjeve. Duhet thënë se dukuria e përmytjeve në hapësirën e vendit tonë nuk lidhet vetëm me reshjet e rëna brenda territorit të Shqipërisë, por edhe me ato jashtë kufirit shtetëror. Sipërfaqja ujëmbledhëse e Shqipërisë është rreth 44 mijë km² dhe në mjaft raste situatat e përmytjeve në vend kanë qenë efekt i reshjeve të shumta si intensitet, por dhe si sasi në pjesën e fillimit të rrjedhjes së lumenjve Drin, Vjosë, Bunë, etj., që ndodhen jashtë territorit të vendit tonë.

2. Reshjet e muajit janar 2021

Frontet atmosferike mbizotërues gjatë muajit janar 2021 mbi hapësirën e vendit tonë. Muaji janar 2021 u karakterizua nga një seri frontesh atmosferike që përcollën një situatë të paqëndrueshme në shkallë rajonale, e për rrjedhojë një mot me vranësira e reshje. Pikërisht ky është një fakt i ndryshëm nga situata të tjera të mëparshme

**AKADEMIA
E SIGURISË**

*Konferencë
shkencore
ndërkombëtare:*

**« Fenomenet
ekstreme
të natyrës
dhe çështjet
e sigurisë »**

përmblytjesh. Përveç këtij fakti është shumë e rëndësishme të evidentohet se kur trajtohen dhe analizohen reshjet e muajit janar 2021 në lidhje me situatën e përmblytjeve, duhet thënë se ato vijnë pas një jave me reshje, po ashtu intensive të muajit dhjetor 2020.

Në vijim në *figurën nr. 1* jepen dy harta me situatën e reshjeve dhe anomalive të tyre në shkallë kontinentale për periudhën 26 dhjetor 2020 deri 1 janar 2021, ku dukshëm evidentohet një situatë e veçantë dhe me reshje e anomali me të larte pikërisht për hapësirën e Shqipërisë dhe zonave pranë¹.

Për muajin janar 2021 pasqyrohen nëpërmjet disa prej hartave të përzgjedhura situatat sinoptike në shkallë kontinentale për datat 1, 11, 21 dhe 31 janar 2021, të cilat janë paraqitur në *figurën nr. 2* (me presion të lartë atmosferik – “High” dhe të ulët – “Low”). Muaji janar është karakterizuar nga situata sinoptike të paqëndrueshme. Pothuajse gjatë gjithë muajit janar kontinenti evropian është mbizotëruar kryesisht nga prania e qendrave barike të presionit atmosferik të ulët, të cilat në pjesën më madhe të muajit mbizotëruan edhe mbi vendin tonë. Më konkretisht përgjatë dekadës së parë të muajit ishin të pranishme qendrat barike të presionit atmosferik të ulët me origjinë mesdhetare. Një situatë e tillë sinoptike u shoqërua nga reshje të shumta atmosferike që mbuluan të gjithë territorin. Përgjatë dhjetëditëshit të dytë të muajit janar situata ishte e paqëndrueshme me alternim të qendrave barike të presionit atmosferik të lartë dhe të ulët.




Figura nr. 1. Reshjet (në mm) për periudhën 26 dhjetor 2020 deri 1 janar 2021 në kontinentin evropian (majtas) dhe anomalitë kundrejt periudhës 1981+2010, sipas NOAA-s (djathtas).




Figura nr. 2. Situatat sinoptike të datave: 1, 11, 21 dhe 31 janar 2021.

Kjo situatë solli në vetëm në pak ditë të caktuara situatë me mot të kthjellët dhe pa reshje në pjesën të ndryshme të territorit. Ne tërësi duhet thënë se ecuria e paqëndrueshme që vijoi deri në fund të janarit, bëri që në pjesën më të madhe të vendit të vërojtoshin reshje të shumta atmosferike, me përjashtime të pak ditëve me mot relativisht të kthjellët apo vetëm më pak dëbore në lartësi.




Figura nr. 3. Situata e vranësirave për muajin janar 2021.

2.1 Të dhënat meteorologjike dhe satelitore mbi situatën e reshjeve të pritshme dhe të vërtetuara, të analizuar në kohë e hapësirë, jo vetëm për Shqipërinë.




Figura nr. 4. Vlerësimi i reshjeve të pritshme çdo ditë, për 24 orët në vijim sipas platformës "SEEFFG" për muajin janar 2021 (6.00 UTC).

AKADEMIA
E SIGURISË

Konferencë
shkencore
ndërkombëtare:

« Fenomenet
ekstreme
të natyrës
dhe çështjet
e sigurisë »

Procesi i rianalizimit është me mjaft interes kur bëhet fjalë për të riparë e analizuar një situatë të shkuar. Në *figurën nr. 4* jepen të dhënat e parashikimit ditor për muajin janar 2021 për reshjet 24orëshe. Natyrën frontale dhe mbizotëruese në shkallë të gjerë të kësaj situatë evidentohet dhe në hartën e dhënë në vijim në *figurën nr. 5*, ku siç shihet e gjithë zona e Mesdheut karakterizohet me reshje, të cilat për këtë muaj janar 2021 shënojnë vlera 200 deri 400% kundrejt normës sipas NOAA-s, jo vetëm për vendin tonë.




Figura nr. 5. Reshjet në % për muajin janar 2021 në kontinentin european kundrejt normës.

2.2 Prezantimi, nëpërmjet përdorimit të SIG-ut, në harta, i treguesve kryesorë të reshjeve

Por, një analizë më e detajuar për reshjet, intensitetin e tyre dhe numrin e ditëve me reshje e marrim në informacionin e përpunuar, duke ju referuar mbi 90 vendmatjeve meteorologjike të SKMM; të cilat pasi u digjitalizuan, kontrolluan dhe u përpunuan, më tej janë paraqitur në vijim në grafikun nr. x si dhe në hartën nr. x për Shqipërinë.




Figura nr. 6. Lartësia e reshjeve për disa vendmatje meteorologjike të muajit janar 2021 për Shqipërinë.

Gjithashtu dhe në kontekstin kontinental reshjet e vrojtuar në territorin e Shqipërisë evidentohen si më të lartat duke u shoqëruar dhe me anomali të theksuara përkundrejt pjesës tjetër të kontinentit. Një tablo e kësaj situatë jepet dhe në hartat e dhëna në figurën nr. x.




Figura nr. 7. Reshjet për muajin janar 2021 në kontinentin europian dhe anomalië kundrejt periudhës1981-2010, sipas NOAA-s.

Analiza e reshjeve dhe raporti i tyre në% kundrejt normës si për kontinentin ashtu dhe më e detajuar për vendin tonë paraqitet në figurën nr. 9. Natyrisht këto reshje të shumta u vrojtuan dhe në një numër ditësh me reshje më të lartë se norma. Në grafikun e dhënë në figurën nr. 10 paraqiten vlerat e këtij treguesi për disa vendmatje meteorologjike të përzgjedhura, ndërsa në hartat e dhëna në figurat nr. 13. A, e nr. 13. B jepet shpërndarja e treguesit të numrit të ditëve me reshje mbi pragun 0.0 mm dhe mbi pragun 20.0 mm për Shqipërinë për muajin janar 2021.

Qartazi këto vlerësime nxjerrin në pah jo vetëm zonat se ku ka pasur më shumë ditë me reshje dhe ku evidentohet në pjesën VP e P, por nga ana tjetër sa i takon treguesit të ditëve me reshje mbi pragun 20.0 mm dallojnë vetëm pjesën veriore të vendit tonë.




Figura nr. 8. Lartësia e reshjeve (në mm) për muajin janar 2021.




Figura nr. 9. Reshjet ne % për muajin janar 2021 në kontinentin european kundrejt periudhës1981+2010, sipas DWD dhe ato të Shqipërisë sipas IGJEUM .




Figura nr. 10. Numri i ditëve me reshjeve mbi pragun 1.0 mm për disa vendmatje meteorologjike për muajin janar 2021 për Shqipërinë

Reshjet maksimale 24-orëshe (në mm) janë vlerësuar dhe paraqitur në figurën nr. 15, ndërsa dita me më shumë reshje në mbarë vendin e vrojtuar në datë 24 janar 2021 është dhënë në figurën nr. 14. Gjithashtu një rendësi të veçantë ka dhe vlerësimi i reshjeve me kohëzgjatje 48 dhe 72-orëshe. Në këtë rast të dhënat u përpunuan dhe u vlerësuan edhe nëpërmjet aplikimit të SIG dhe për këto dy tregues vlerat përkatëse janë paraqitur në hartën nr. 16 e nr. 17. Shpërndarja hapësinore e këtyre treguesve evidenton pjesën veriore të vendit si me të prekur dhe vlera më të larta të reshjeve të vrojtuar. Periudha më ditë me reshje të njëpasnjëshme është paraqitur në grafikun e dhënë në figurën nr. 11, ndërsa shpërndarja e tyre në hartën e paraqitur në figurën nr. 12.

AKADEMIA
E SIGURISË

Konferencë
shkencore
ndërkombëtare:

« Fenomenet
ekstreme
të natyrës
dhe çështjet
e sigurisë »




Figura nr. 11. Numri i ditëve me reshje të njëpasnjëshme pa ndërprerje për disa vendmatje meteorologjike për muajin janar 2021 për Shqipërinë.




Figura nr. 12. Numri i ditëve me reshje te njëpasnjëshme për muajin janar 2021 për Shqipërinë.





Figura nr. 13. - Numri i ditëve me reshjeve (e*0.0 mm) A dhe (>20.0mm) B për muajin janar 2021 për Shqipërinë.





Figure Nr. 14
Reshjet në datë: 24.01.2021

Figure Nr.15 - Reshjet maksimale 24 orësh për muajin janar 2021.

AKADEMIA
E SIGURISË

Konferencë
shkencore
ndërkombëtare:

« Fenomenet
ekstreme
të natyrës
dhe çështjet
e sigurisë »




Figure Nr. 16 - Reshjet maksimale 48 orëshe gjatë muaj janar 2021.

3. Disa veçori të përbashkëta dhe dalluese të përmbajtjes së muajit janar 2021 në lidhje me përmbajtje të tjera në të shkuarën

Pikësëpari duhet thënë se përmbajtja e janarit dhe reshjet e shumta të këtij muaji u paraprinë dhe nga reshje të javës së fundit të dhjetorit, por ajo çka vlen të theksohet është se pjesa tjetër e mëparshme e dhjetorit dhe për më shumë muaji nëntor 2020 u karakterizuan me reshje të pakta. Kaq e theksuar ishte mungesa e reshjeve në nëntor 2020 sa që filluan të evidentoheshin dukuritë e thatësisë hidrologjike¹. Ndaj reshjet e dhjetorit në veçanti ato të fundit të këtij muaji, dhe deri diku dhe pjesa e parë e reshjeve të janarit 2021 ndihmuan në ri balancimin e situatës hidrike dhe mbushjen e rezervuarve, liqeneve si dhe ngritjen e niveleve të rëna të ujerave nëntokësore.

Së dyti duhet thënë se për këtë arsye në këtë situatë reshjesh të shumta, nuk u shtua dhe nuk u mbivendos dhe faktori i shkarkimeve më të larta nga tre hidrocentralet e kasketës së Drinit, pasi ato siç më sipër u theksua kishin kapacitete ende të lira.

Se treti duhet thënë se masa më të ngrohta ajrore që shoqëruan muajin janar me temperatura rreth 1.5°C më të larta se norma përcollën një përmbajtje më të lartë lagështie si për shkak të origjinës së formimit të këtyre masave e po ashtu dhe për shkak të kapacitetit më të lartë për mbajtje uji në forme avujsh që lidhet me temperaturat më të larta duke mundësuar dhe pasur një kapacitet më të lartë ujëmbajtës, të cilin do ta

humbitnin menjëherë në ndeshje me sipërfaqe të ftohta në kontakt me zonat malore apo dhe për shkak të ndryshimeve adiabatike dhe detyrimit përlëvizje e lartësi në kushte orografike të Ballkanit Perëndimor apo sistemet të maleve VP JL që ka Shqipëria duke i ulur kapacitetet e tyre për mbajtje uji dhe lëshimin e kësaj mase në forme reshjesh shiu, por për sa të temperaturave relativisht më të larta e pak dëbore se sa në të shkuarën.

Së katërti duke qenë në këto kushte, duhet sjellë në vëmendje dhe fakti së në vitet e fundit kemi një ndryshim të raportit të reshjeve të shiut me ato të dëborës. Pikërisht kjo u përcoll dhe përgjatë këtij muaji, ku siç tregohet dhe ne hartat dhe grafikun e dhënë në figurën nr. 19 dhe nr. 20 u vrojtuan disa ditë por me pak dëbore edhe ne zonat e larta te vendit.



Figura nr. 18. Pamje satelitore e mbulesës me dëborë në datë 15.1.2021, në Shqipëri.

Një ndër arsyet kryesore të përmbytjeve në vitet e fundit në vendin tonë është e lidhur edhe me faktin e ndryshimit të raportit të reshjeve të shiut me ato të dëborës. Në figurën nr. 18 paraqitet një pamje satelitore e datës 15 janar 2021 e territorit të vendit tonë të mbuluar e dëbore, ndërkohë që duhet thënë fakti shumë i rëndësishëm se

**AKADEMIA
E SIGURISË**

*Konferencë
shkencore
ndërkombëtare:*

« Fenomenet
ekstreme
të natyrës
dhe çështjet
e sigurisë »

lartësia e saj është ulët dhe siç dëshmohet dhe në disa të dhëna të paraqitura në figurën nr. 20 këto vlera të moderuara ose mjaft të ulëta të kësaj shtresë dëbore nën efektin edhe të temperaturave mesatare më të larta se norma nuk qëndruan gjatë dhe ju nënshtruan procesit të shkrirjes. Kjo dukuri e analizuar dhe pasqyruar më tej në pamjet e figurës nr. 20 me të dhënat e pritshme në mm për shkrirjen e dëborës ishte një arsye më shumë dhe një faktor ndihmës në përshpejtimin dhe shtimin e rrjedhjes sipërfaqësore në rrjetin hidrografik. Për rrjedhojë kjo u pasua menjë rritje të zonave me përmbytje, disa prej të cilave janë ilustruar me figurat nr. 21 – 24.




Figura nr. 19. Lartësia maksimale e dëborës (në cm) të vërtetuar për disa vendmatje meteorologjike të Shqipërisë për muajin janar 2021.




Figura nr. 20. Shkrirja e dëborës sipas vlerësimit të bazuar në platformën e SEEFFG për çdo 4 ditë (në mm/4 ditë) për Shqipërinë për muajin janar 2021.

Në kushte e ndryshimeve klimatike me masa ajrore gjithnjë e më shumë të pranishme me temperatura më të larta duhen shtuar dhe disa faktorë të tjerë që lidhen si me ndryshimet klimatike ashtu dhe veprimtarinë e njeriut. Në vijim disa pamje me përmblytjet e muajit janar 2021.



Figure nr. 21. Pamje nga përmblytjet në datë 28 janar 2021, në zonën e Dajçit, Shkodër, Shqipëri / View of Dajç flooding area, Shkodër, on date January 28, 2021, Albania.



Figure nr. 22. Pamje nga nivelet e lumit Mat, në datë 10 janar 2021, ne Klos, Shqipëri / View of river Mat leve on date January 10, 2021, at Mat, Albania (Foto: E. Hoxha).



Figure nr. 23. Pamje nga nivelet e lumit Shkumbin, në datë 10 janar 2021, pranë Elbasanit, Shqipëri / View of river Shkumbin leve on date January 10, 2021, near Elbasan, Albania (Foto: G. Çela).



Figure Nr. 24. Pamje nga nivelet e lumit Vjosë, në datë 13 janar 2021, Tepelenë, Shqipëri / View of Vjosa river leve on date Janury 13, 2021, Tepelenë, Albania (Foto: A. Hasimi).

4. Ndryshimet klimatike dhe veprimtaria e njeriut

Direkt ose indirekt si dhe në gërshetim me njëra-tjetrën disa ndërtime siç janë hidrocentralet në hapësirën e lumit Drin ku në veçanti do te veçohej liqeni i Fierzës duhet thënë se objektet et tilla ujore kanë ndikimin e tyre dhe në mjedisin rrethues dhe karakteristikat e mikroklimës. Një basen ujqor me sipërfaqe ujore jo të vogël dhe mbi 2 miliardë m³ujë, natyrisht shoqërohet dhe në një impakt sa i takon bilancit të shkëmbimit të energjisë me masën e ajrit në kontakt në zonë. Siç dihet masa ujore është një rezervuar i mirë i ruajtjes së energjisë dhe lëshimit të saj me ngadalë, përkundrajt karakteristikave të masës së ajrit. Për rrjedhojë zona e gjithë rrjedhës së Drinit deri në digën e Fierzës tashmë ka një klimë me të butë për shkak të efektit zbutës që ka ndikimi i liqenit. Kjo dukuri është e njohur shkencërisht dhe përbën një ndër 9 faktorët e formimit të klimës së një zonë të caktuar. Kjo ka përcjellë dhe disa pasoja që lidhen me faktin që në se në të shkuarën masat ajrore në këto kur lëshonin reshje atje ndeshnin në një atmosferë dhe sipërfaqe kontakti më të ftohtë dhe reshjet e dëborës ishin më të larta dhe qëndronin më gjatë. Ndërkohë në ditë e sotme edhe kur ato vrojtohen janë me të pakta dhe koha e qëndrimit të tyre është me shkurtër e për rrjedhojë krijojnë rrjedhë sipërfaqësorë më të

AKADEMIA
E SIGURISË

Konferencë
shkencore
ndërkombëtare:

« Fenomenet
ekstreme
të natyrës
dhe çështjet
e sigurisë »

shpejtë duke iu shtuar rrjedhës natyrale prej reshjeve të shiut dhe përbejnë një faktor shumë ndihmues në zmadhimin e dukurive të përmbytjeve.

Një faktor tjerë shumë i rëndësishëm në mbarë vendin janë dhe pyjet. Masat pyjore kanë një rendësi shumë të madhe jo vetëm për ato çka ofrojnë, por dhe në aspekti klimatik. Masat pyjore janë një element tjetër klimëformues me rendësi të veçantë kur është fjala për reshjet dhe mbajtje në tyre, e ngadalësimin e rrjedhës sipërfaqësore të reshjeve. Në mungesë të tyre çdo reshje direkt përfundon me shpejtësi në rrjetin hidrografi, ndërkohë prania e tyre jo vetëm e zvogëlon këtë, por mënjanon dhe minimizon dukuritë e erozionit.

4.1 Parashikimi i reshjeve dhe dukurive ekstreme meteorologjike nëpërmjet buletinit ditor të IGJEUM

Shpërndarja në kohë e produkteve të IGJEUM në lidhje me parashikimin e dukurive ekstreme është i një rëndësie parësore. Por problemi nuk është thjesht për të zgjidhur e marrë masa në një kohë të shkurtër dhe për të kapërcyer veç një situatë një apo disa herë në vit në zona të ndryshme të vendit. Problemi është për të marrë mendim shkencor dhe minimizuar këtë dukuri për periudha më afatgjatë, që nënkuptojnë marrjen në konsideratë të mendimeve analizave dhe gjetjen e rrugëzgjdhjeve që këto dukuri edhe kur të vrojtohen të ketë impakte sa më të kufizuara dhe me dëme sa më të pakta.

5. Përfundime

- Reshjet e janarit 2021 u karakterizuan me një kohëzgjatje të lartë, me një numër ditësh me reshje rekord me vlera 250% kundrejt normës, ndërsa si sasi rreth 262% kundrejt vlerës mesatare shumëvjeçare.

- Moti me temperatura më të larta se norma kushtëzoi një proces shkrirje më të shpejtë duke shtuar rrjedhën sipërfaqësore dhe favorizuar dukurinë e përmbytjeve.

- Si pasojë e një natyre frontale të motit të paqëndrueshëm mbizotërues në mbarë vendin, këtë herë përmbytjet nuk ishin të lokalizuara vetëm në një zonë të vendit, siç ka ndodhur në shumë raste më parë, por ato preken pothuajse të gjithë vendin, duke e bërë më të vështirë dhe ndërlikuar ndërhyrjen dhe mbështetjen me mjete, për minimizimin e ndikimeve negative nga kjo dukuri dhe problematikat e tjera.

- Njoftimi në kohë nga IGJEUM natyrisht ishte një ndihmëse për institucionin e emergjencave civile, për të informuar në kohë pushtetin lokal dhe ndërhyrë në kohë me mjetet e disponueshme.

- Për të minimizuar ndikimet e përmbytjeve në të ardhmen duhet të realizohen politika të reja në lidhje me gjithë hapësirat dhe individët e prekshëm, duke i zhvendosur nga zonat e prekshme siç veprohet kudo në vendet e përparuara, duke i përfshirë në politikat e sigurimit, duke krijuar xhepat me hapësira të destinuara për përmbytje si mikrobasene rezerve për të grumbulluar ujin e tepërt në momente kritike kohore, si dhe mbi të gjitha zbatimin e standardeve tekniko shkencore duke marre kurdoherë mendimin shkencor nga institucionet shkencore.

- Kjo përmbytje ishte pasojë e një ndikimi, më shumë nën efektin natyror, se sa nga ndikimi prej shkarkimeve prej hidrocentraleve, siç situata të shkuara kanë evidentuar edhe këtë faktor.

**AKADEMIA
E SIGURISË**

*Konferencë
shkencore
ndërkombëtare:*

**« Fenomenet
ekstreme
të natyrës
dhe çështjet
e sigurisë »**

- Reshjet e muajit janar vijonin një periudhë me reshje të javës së fundit të dhjetorit 2020 që ishte mjaft e lartë duke veçuar në shkallë kontinentale hapësirën e vendit tonë dhe zonave përreth që janë pjesë e pellgut ujëmbledhës të Shqipërisë.

- Gjithashtu një faktor ndihmues është dhe dëmtimi i pyjeve, ndaj duhet ndërmarre në politike e re në mbrojtjen e tyre, pasi ato jo vetëm mbrojnë tokën nga erozionet, japin prodhimet tyre për popullatën lokale duke ruajtur dhe një flore e faune të caktuar, por ndikojnë deri në ushqimin, zhvillimin si dhe mbajtjen afër të peshqve pranë vijës bregdetare duke ndihmuar dhe sektorin e peshkimit, pa folur për një mikroklimë tjetër në zonat pranë.

Bibliografia

1. Buletini Mjor Klimatik Nr. 49, 2021, Tirane, UPT - IGJEUM.
2. Grup autorësh, "Atlas Klimatik i Shqipërisë", IHM, Tiranë, 1984
3. Grup autorësh, "Klima e Shqipërisë" - IHM, Tiranë, 1972
4. Grup autorësh, "Veçoritë klimatike dhe hidrologjike të Ultësirës Perëndimore", Hidmet, Tiranë, 1985.
5. Isidorov G. Cvetko, "Klima e Shqipërisë" - ISH, DSHH, Tiranë, 1955
6. Mandili, T. "Klima dhe kulturat bujqësore", Botim i shtëpisë së propagandës bujqësore, Tiranë, 1975
7. ZORBA Petrit, ÇELA Gazmir, "Vlerësimi i Treguesit Klimatik Turistik për Ultësirën Perëndimore të Shqipërisë", Buletini Mjor Klimatik Nr.31, 2019 Tiranë, UPT-IGJEUM
8. ZORBA Petrit, MEHMETI. Ilir, ÇOMO Elvin, HOXHA Elsuida, "Weinberger Chilling Hours model applied for Korça area - Albania, as a source of information for winter period and the determination of the fulfillment of biological needs of some orchards", Buletini Mjor Klimatik Nr. 43, 2020, Tiranë, UPT-IGJEUM.
9. Zorba Petrit, "Energjia e erës në Shqipëri", Buletini Mjor Klimatik Nr. 14, 2018, Tiranë, UPT-IGJEUM.
10. Zorba Petrit, "Klimatologjia", albPAPER, Tiranë 2009



AKADEMIA E SIGURISË

*Konferencë
shkencore
ndërkombëtare:*

**« Fenomenet
ekstreme
të natyrës
dhe çështjet
e sigurisë »**

COVID-19, kërcënim global për paqe e siguri, dhe sfidat e menaxhimit të tij në Kosovë



■Prof. Asc. Dr. Bejtush GASHI
Akademia e Kosovës për Siguri Publike
bejtushg2002@yahoo.com

Abstrakt

Shpejtësia, hapësira globale dhe ndikimi i përhapur i pandemisë së fundit të korona virusit (COVID-19), e kanë bërë menaxhimin e krizave një përparësi kryesore të të gjitha shteteve, sepse ajo vendosi në udhëkryq kritik institucionet dhe shoqëritë. Shtetet, organizatat dhe aleancat, u gjenden pa strategji dhe kapacitete të përballimit për një sfidë të tillë. Aktualisht shtetet përballën me një amulli apo edhe lëndim të një mori procesesh, sepse janë shkaktuar dëme të mëdha ekonomike, sociale e politike. Kufijtë shtetërorë janë të mbyllur, ekonomitë janë në ngecje, gjendjet e jashtëzakonshme janë futur në të gjitha vendet, qytetarët ende janë në izolim dhe pandemia ende paraqet kërcënim vdekjeprurës për njerëzit. Shumëçka është e paqartë sepse kostot njerëzore, politike, sociale dhe ekonomike të pandemisë mbeten të paqarta, kurse një gjë është e qartë se nuk ka gjasa për kthim të shpejtë në gjendje para pandemisë ¹.

Për përballimin e pandemisë COVID-19, Qeveria e Kosovës ka ndërmarrë masa të shumta të kufizimit të lirisë së lëvizjes e deri edhe tek izolimi i personave të infektuar, që kanë rezultuar me një kosto të madhe si në aspektin ekonomik, sociopsikologjik, politik, etj. Masat e ndërmarra kanë pasur implikime jo vetëm buxhetore, por njëkohësisht ato shpërfaqën edhe dobësitë e sistemit shëndetësor. Jo vetëm Kosova, por të gjitha shtetet, organizatat dhe aleancat ndërkombëtare, u gjenden pa strategji dhe kapacitete të përbashkëta për një sfidë të tillë, ndërsa Bashkimi Evropian nuk përmbushi synimin për atë që ishte krijuar. Tronditja ekonomike dhe sociale e pandemisë ka bërë shumë më tepër për mbylljen e kufijve, për de-globalizimin, ndërprerjen e zinxhirëve të furnizimit dhe marginalizimin e institucioneve shumëpalëshe, se gjithë përpjekjet më të zjarra të nacionalistëve populistë kudo në botë. Mirëpo, nisur nga përvoja në vende të ndryshme, ndikimi negativ në treguesit ekonomikë ndodh më së shumti në terma afatshkurtër, ndërsa në terma afatgjatë këto efekte janë kalimtare dhe të papërfillshme për ekonominë dhe buxhetin e shtetit.

AKADEMIA
E SIGURISË

Konferencë
shkencore
ndërkombëtare:

« Fenomenet
ekstreme
të natyrës
dhe çështjet
e sigurisë »

Fjalëkyçe:

COVID-19, sfidat, mundësitë, menaxhimi, qeveria, IKSHP.

1. Hyrje

Pandemia COVID-19 është një nga krizat më të mëdha globale që nga Lufta e Dytë Botërore, e cila në fakt ka përfshirë me këtë virus 193 vende të botës, ndërsa agresori (virusi) u shfaq aq papritur sa pothuaj të gjithë vendet (veç e veç) u gjendën të papërgatitura dhe pa strategji të reagimit dhe vetëm po përpiqen të gjejnë mënyra për t'u mbrojtur. Në këto kushte sfiduese të gjitha shtetet janë në luftë. Qeveritë në mbarë botën kanë ndërmarrë masa të paprecedentë për t'u përballur me sfidat e pandemisë, si dhe për të kufizuar rreziqet e saj mbi jetën dhe shëndetin. Këtu nuk bëhet dallim midis fuqive të mëdha apo vendeve të vegjël, sepse edhe strukturat e krijuara, organizatat ndërkombëtare apo edhe aleancat e mëdha u kapën në befasi e pa agjendë. Çdo vend tani po lufton luftën e vet pa arritur të bashkohet në një front të vetëm. Mungesa e strategjisë dhe e kapaciteteve minimale për këtë lloj lufte ka kthyer si qëllim reduktimin e humbjeve, aq sa fitore konsiderohet mënjanimi, izolimi dhe larja e duarve, në pritje të një vaksine magjike. Ndryshe nga sa mendohej që vendet të afroheshin, të bashkoheshin e të krijonin kapacitete për ta luftuar bashkërisht këtë armik, ato ngritën gardhet e vjetra: kufijtë.

Shpejtësia e përhapjes dhe hapësira e ndikimit të pandemisë COVID-19 ka shkaktuar frikë, ankth dhe shqetësime të tjera tek qytetarët në vende të ndryshme të botës, ndërsa menaxhimi i saj është bërë përparësi kryesore. Shpërthimi i COVID-19, ndonëse u shpalo si emergjencë shëndetësore, ka pasur dhe do të vijojë të ketë pasoja të rënda afatshkurtra deri afatgjata socioekonomike dhe financiare në të ardhmen, duke përfshirë edhe ndërlikime morale e etike dhe të demokracisë. Sidoqoftë, niveli i shqetësimeve

**AKADEMIA
E SIGURISË**

*Konferencë
shkencore
ndërkombëtare:*

« Fenomenet
ekstreme
të natyrës
dhe çështjet
e sigurisë »

¹ Ballkani Perëndimor në Kohërat e Pandemisë Globale, The Balkans in Europe Policy Advisory Group, 2020, f. 5.

supozohet të jetë ndikuar nga rrethanat e krijuara për shkak të izolimit social dhe faktorëve të tjerë personal, mungesën e qasjes në teknologji, si dhe vështirësitë ekonomike.

Në lëmin e mësimdhënies, sfidat themelore lidhen me cilësinë e realizimit të mësimin në distancë (*online*), për shkak të nivelit të njohurive dhe shkathtësive të tyre për përdorimin e teknologjisë, qasjes në teknologji, dhe izolimit në shtëpi. Këto shqetësime kanë qenë të shprehura më shumë se shtetet në të cilat është i ulët niveli i përdorimit të teknologjisë në procesin e mësimdhënies. Nevoja për të zhvendosur mësimin në formatin në distancë ose online është vlerësuar si e domosdoshme, mirëpo për të arritur zhvillimet në fushën e edukimit digjital, në rrethana të tjera do të nevojiteshin vite të tëra. Prandaj, metoda e imponuar online e mësimdhënies ka rezultuar të jetë tejet sfiduese, dhe për një kohë të shkurtër të aplikimit të saj lë mjaft për të dëshiruar.

Integrimi i përdorimit të teknologjisë në institucionet edukativo-arsimore është promovuar dhe mbështetur tani e shumë vite më parë në vende të ndryshme të botës. Zhvillimet e teknologjisë informative dhe të komunikimit dhe përdorimi i tyre në proceset mësimore, përveç se ofron mundësi më të mëdha për realizimin e mësimin fleksibël, njëkohësisht ky mësim bëhet më i hapur, përmes të cilit synohet që studentët të jenë më të pavarur dhe të vetëpërcaktuar, përgjegjës për të nxënit. Në të ardhmen e afërt do të përdoret modeli *Hologram*, ku mësimdhënësit mund të jenë të pranishëm në formë virtuale para studentëve të tyre, i cili mendohet të rezultojë më i efektshëm si model, në krahasim me platformat *Moodle*, *Zoom*, *Google Meet*, etj., të cilat kanë pasur mangësi dhe nuk kanë qenë të përkryera në shumicën e rasteve dhe aspak nuk afrohen me ligjërimin tradicional me prezencë fizike. Pra, transformimi digjital jo vetëm që ndryshon mënyrën e mësimdhënies të ditëve të sotme, por krijon në vazhdimësi mundësi të reja për rritje dhe prosperitet për të gjitha segmentet e sistemit të arsimit. Transformimi digjital e bën të mundur përdorimin e teknologjisë, njerëzve dhe proceseve për të çuar procesin e mësimdhënies dhe mësimnxënies përpara.

Pathuajse të gjitha shtetet dhe organizatat janë të përgatitura për modele të tjera kërcënimesh dhe kanë ngritur kapacitete për të pasur sukses në atë lloj lufte. Kërcënimet vlerësohen si konvencionale dhe hibride ose simetrike dhe asimetrike. *Strategjitë e deritanishme*, – thotë Joseph Ney, themeluesi i teorisë neoliberale, – *përqendrohen në konkurrencën, dhe balancën e fuqisë, pak e ndryshuar që nga 1815, në Koncertin Evropian*. Mirëpo, COVID-19 po tregon se kjo strategji është e pamjaftueshme. Sigurisht që çdo vend ka parësor interesin e tij kombëtar, por pandemia tregoi për nevojën e një harmonie me sigurinë rajonale e globale. COVID-19 tregoi paaftësinë e modeleve aktuale të strategjisë për të parashikuar në këtë botë të re. Pra, mungesa e strategjisë dhe e kapaciteteve të organizatave i ktheu ato thjesht në makineri burokratike.

2. Reagimi i qeverisë së Kosovës gjatë emergjencës së COVID-19

Sistemi i menaxhimit të emergjencës shëndetësore dhe institucioni shoqëruar i vendosur kur përcaktohet një situatë krize, është shumë i ndërlikuar dhe kompleks. Në Republikën e Kosovës, kjo nuk ishte kriza e vetme që po zhvillohej. Njëkohësisht, Kosova po merrej me një situatë tejet të paqëndrueshme politike dhe institucionale, të shkaktuar nga pandemia, rrëzimi i qeverisë, e cila çoi në shpërndarjen e Kuvendit dhe formimin e qeverisë. Kosova ishte ndër vendet e rralla në botë ku qeveria u rrëzua në kohë pandemie. Pra, kur institucionet në të gjitha vendet u bashkuan dhe bashkërenduan

aktivitetet dhe përpjekjet e tyre për t'u përballur me virusin e panjohur, në Kosovë më shumë është diskutuar ligjshmëria dhe kushtetutshmëria e vendimeve shtetërore për të parandaluar pandeminë, sesa roli që ato vendime kishin në mbrojtjen e jetës së qytetarëve të vendit. Qasja e Kosovës në përballje me COVID-19 u sfidua nga mungesa e qasjes parandaluese dhe përgatitore ndaj situatave emergjente, mungesa e bazës së qartë ligjore për vendimet e qeverisë, kufizimet në resurse dhe kapacitetet e stafit, si dhe mungesa e një sistemi të qartë, transparent dhe konsistent për komunikim me publikun.

Planet e kufizuara strategjike për menaxhimin e pandemisë, si dhe mungesa e kornizave ligjore për të adresuar në mënyrë të duhur krizën, e komplikuan më tepër situatën aktuale. Mungesa e ligjit anti-COVID-19, i cili u votua në Kuvend pas katër muajsh, ishte një ndër sfidat që ndikoi te institucionet e zbatimit të ligjit në efikasitetin e zbatimit të masave shtetërore kundër pandemisë. COVID-19 sfidoi sistemin e shëndetësisë në Kosovë si pasojë e kapaciteteve njerëzore për t'u përballur me pandeminë apo sëmundjet e tjera. Gjithashtu, u shpërfaq mungesa e një sistemi kualitativ shëndetësor e shtetëror dhe koordinimi institucional, për t'u përballur me kriza shëndetësore të kësaj natyre. Këto sfida të sistemit janë rezultat i mosinvestimeve adekuate shtetërore në sistemin shëndetësor publik. Kjo ka ndikuar që vendi të ketë një sistem dhe infrastrukturë shëndetësore të brishtë, duke ndikuar drejtpërdrejt në rrezikimin e jetës së qytetarëve. Gjithashtu, edhe miratimi i ligjit për rimëkëmbjen ekonomike është përballur me probleme të njëjta, si pasojë e mungesës së konsensusit politik, ndërsa aprovimi i tij me kohë do të ishte ndihmesë e madhe për sektorin privat i cili është goditur rëndë nga pandemia.

Institucionet e Republikës së Kosovës, situatën e krijuar si pasojë e pandemisë COVID-19 e kanë menaxhuar dhe udhëhequr mbështetur në direktivat që burojnë nga *dokumentet strategjike në fuqi* të aprovuara në vitin 2010, si: *Plani i reagimit kombëtar* (PRK) dhe *Sistemi i integruar i menaxhimit emergjent* (SIME), *Ligji për mbrojtje nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera*. Aktualisht, mbështetur në *Planin e reagimit kombëtar*, kryeministri është autoriteti që e udhëheq vendin në reagimin efektiv dhe siguron që resurset e domosdoshme të angazhohen shpejt dhe me efikasitet të plotë tek të gjitha incidentet (krizat) e karakterit kombëtar. Gjatë incidenteve aktuale apo të mundshme të karakterit kombëtar, bashkërendimi i të gjitha aktiviteteve qendrore të menaxhimit të incidentit bëhet nëpërmjet Ministrisë së Punëve të Brendshme. Ministri i Punëve të Brendshme është përgjegjës për koordinimin e operacioneve qendrore brenda Kosovës për t'u përgatitur, reaguari dhe rimëkëmbur nga fatkeqësitë natyrore, teknologjike dhe të shkaktuara nga faktori njeri. Ai është *"koordinatori qeveritar"* për menaxhimin e incidenteve vendore. Ministrinë dhe agjencitë e tjera qeveritare, autoritetin dhe përgjegjësitë e tyre për menaxhimin e incidenteve dhe të reagimit emergjent e bartin brenda kësaj kornize bashkërenduese. Bashkërendimi i menaxhimit të incidentit dhe ndërtimi i kursit të veprimeve të nivelit strategjik, ndihmohet nga GNMI (Grupi Ndërinstitucional për Menaxhimin e Incidentit), i cili gjithashtu shërben si trup këshillëdhënës për ministrin e Punëve të Brendshme.

Në fillim të vitit 2020, Kosova u godit nga pandemia e COVID-19, e cila e pati zyrtarisht zanafillën në Kinë në dhjetor të 2019-s dhe u përhap gradualisht në mbarë botën. Kosova përmes mekanizmave shtetërorë dhe bazës ligjore në fuqi me qëllim të ngritjes së gatishmërisë, dhe aktivizimit të kapaciteteve profesionale dhe mekanizmave shtetërorë, për t'u përballuar me situatën, ndërmori veprime parandaluese me ngritjen në shkallë të lartë të gatishmërisë operacionale dhe vënien në veprim të atyre

**AKADEMIA
E SIGURISË**

*Konferencë
shkencore
ndërkombëtare:*

**« Fenomenet
ekstreme
të natyrës
dhe çështjet
e sigurisë »**

mekanizmave relevantë shtetërore në fuqi. Në muajin shkurt 2020, ende pa u shfaqur asnjë rast infektimi me virus COVID-19, por me shpërthimin epidemik në Itali dhe pas paralajmërimit të një pandemie nga OBSH-ja, ndërmerren veprime konkrete të aktivizimit të Komitetit Ndërinstitucional për Parandalimin e Sëmundjeve Ngjitëse, pranë Institutit Kombëtar të Shëndetit Publik të Ministrisë së Shëndetësisë. Brenda këtyre institucioneve shëndetësore, diskutohen dhe planifikohen kurset e veprimit të mëtejshëm dhe masat që duheshin ndërmarrë. Rrjedhimisht, me zhvillimet e situatës formohet komitetet pranë Institutit të Shëndetit Publik dhe Ministrisë së Shëndetësisë së Kosovës, me pjesëmarrjen e të gjithë aktorëve relevantë vendorë, përfaqësues të ministrive dhe agjencive përkatëse shtetërore për menaxhimin sa më efikas dhe profesional të situatës. Me rekomandimet e përfaqësuesit të Agjencisë së Menaxhimit Emergjent në Komitetin për Koordinimin dhe Vlerësimin e Situatës Epidemiologjike në kuadër të Ministrisë së Shëndetësisë, Instituti Kombëtar i Shëndetit Publik në Kosovë, përcjell kërkesën për ngritjen e nivelit të lartë të gatishmërisë dhe shpalljen e gjendjes *emergjente sektoriale*, gjegjësisht, *Emergjencën e shëndetit publik* në Kosovë.

Rasti i parë me COVID-19 në Kosovë u raportua zyrtarisht në 13 mars 2020³. Qeveria e Kosovës, me kërkesë të Ministrisë së Shëndetësisë, me vendimin nr. 01/11 dhe plotësim dokumentin e këtij vendimi⁴, datë 15.3.2020 shpalli gjendjen e emergjencës për shëndetin publik në vend⁵. Me këtë vendim, obligohen institucionet e qeverisë së Republikës së Kosovës të veprojnë në harmoni me *Planin e reagimit kombëtar* dhe aktivizimit të funksionit mbështetës emergjent.

Mbështetur në nenin 84 të *Kushtetutës së Republikës së Kosovës*, Presidenti vendos për shpalljen e gjendjes së jashtëzakonshme, në konsultim me Kryeministrin⁶, mirëpo aktualisht në zbatimin praktik ka dykuptimësi ligjore, veçanërisht në aspektin e përcaktimit të rrethanave që justifikojnë ose kërkojnë deklarimin e një emergjence mbarëkombëtare apo të roleve institucionale për kundërpërgjigjen ndaj saj. Këto paqartësi u shfaqen në përpjekjet për shpalljen e gjendjes së jashtëzakonshme gjatë COVID-19, pasi që ekziston një hendek ligjor në lidhje me situatat e emergjencave, përkatësisht, kërkohet të sqarohen kompetencat e palëve kyçe të interesit për të siguruar që vendimet e marra janë ligjore dhe legjitime. Pra, Kuvendi i Kosovës nuk ishte në gjendje të kontribuojë në procesin e vendimarrjes gjatë krizës dhe as të kryejë rolin e tij mbikëqyrës, si pasojë e mosmarrëveshjeve në mes të qeverisë dhe partive opozitare për strategjinë e menaxhimit të pandemisë. Gjithashtu, sfidat e menaxhimit të pandeminë COVID-19 shpërfaqën nevojën për hartimin e legjislacionit shtesë, përkatësisht, aprovimin e një ligji për gjendjen e jashtëzakonshme dhe legjislacionit shtesë që do të ndihmojë për sqarimin e kushteve themelore për procedimin me shpalljen e emergjencave, si dhe kriterëve për ndryshime në masat e marra gjatë emergjencave. Më e rëndësishmja është se legjislacioni shtesë duhet të jetë në përputhje me frymën e kushtetutës.

Masat konkrete të ndërmarra, në pajtim me situatën epidemiologjike, trendin dhe

³ "Koronavirusi mbërrin në Kosovë, konfirmohen dy rastet e para, një italian 20 vjeçar dhe një i moshuar". *BalkanWeb.com*. 13 mars 2020.

⁴ <https://www.amchamksv.org/wp-content/uploads/2020/03/Vendimi-per-shpalljen-e-emergjences-per-shendetin-publik-2.pdf>.

⁵ Ligji nr. 04/L-027 për Mbrojtje nga Fatkeqësitë Natyrore dhe Fatkeqësitë e Tjera, 22 shtator 2011, Neni 94, paragrafi 4; <https://kryeministri-ks.net/qeveria-e-kosoves-miraton-vendimin-per-shpalljen-e-emergjences-per-shendetin-publik/>.

⁶ Kushtetuta e Republikës së Kosovës, neni 84.

zhvillimin e situatës në terren, detyruan institucionet përkatëse që në raport me gjendjen për fazën e parë të muajit shkurt dhe fillimin e muajit mars 2020, por edhe me qëllim të parandalimit të sëmundjes, të ngritin kapacitetet e gatishmërisë për përballimin e situatës së krijuar. Efekte pasuese ishin të drejtuara në marrjen e vendimeve përkatëse të institucioneve përgjegjëse shtetërore, bazuar në *Planin e reagimit kombëtar*, mekanizmi i ngritur, Grupi Ndërinstitucional për Menaxhimin e Incidentit (GNMI), në *Fazën I*, vendosi si më poshtë:

- anulimi i fluturimeve nga vendi dhe në drejtim të në Kosovës, përjashtuar kthimet ose vajtjet e domosdoshme dhe emergjente për riatdhesim;

- mbyllja e kufijve tokësorë si mase parandaluese “në importimin” e infeksionit me të gjitha vendet, përveç qarkullimit të mallrave dhe shërbimeve esenciale, si dhe personat e riatdhesuar në pranim dhe dërgim;

- kontrolli i hyrje-daljeve në vijat ajrore dhe tokësore, si dhe karantinimi i personave të riatdhesuar në vend për 14 ditë në qendrat me kapacitetet profesionale shëndetësore të përshtatura për ruajtjen e shëndetit të tyre dhe mospërhapjes së sëmundjes tek të tjerët;

- dy aspektet e veprimeve drejt qëllimit të përbashkët ishin: vendimi për aktivizimin e Planit të Reagimit Kombëtar (PRK), në kuadër të të cilit themelohet Grupi Ndërinstitucional i Menaxhimit të Incidentit (GNMI) dhe MSH-ja (për më tepër shih vendimin në referencë)⁷;

- *Grupi Ndërinstitucional i Menaxhimit të Incidentit, koordinonte të gjithë mbështetjen e duhur qeveritare për zbatimin e masave të marra për parandalim të infeksionit me COVID 19, ndërsa;*

- Ministria e Shëndetësisë me Institutin Kombëtar të Shëndetit Publik, hartonte kafen e veprimit profesional drejt vendimmarrjes së qëndrueshme, për pengimin e infeksionit me COVID 19. Në rastin konkret dhe bazuar në PRK, *MSH-ja me IKSHPK-në ishin udhëheqëse të situatës në menaxhim;*

- rrjedhimisht, MSH-ja në mënyrë të organizuar bënte identifikimin e kapaciteteve shtesë spitalore nga sektori publik dhe privat, dhe vënia në dispozicion e atyre kapaciteteve në formë të organizuar për skenarin më të keq;

- ndalim qarkullimi brenda vendit në dy etapa brenda 24 orëve, si dhe sensibilizimi i popullatës për distancë fizike deri në 2 metra, mbajtja e higjienës personale si dhe ndalimi i të gjitha organizimeve shoqërore pa asnjë përjashtim;

- aktivizimi i *Planit të reagimit kombëtar*;

- ngritja e mekanizmave shtetërorë për koordinimin e situatës dhe dhënia e mbështetjes për Ministrinë e Shëndetësisë, përmes *Planit të reagimit kombëtar*, aktivizimi i Funksionit Mbështetës Emergjent ESF 5, themelimi i GNMI-së dhe aktivizimit të qendrave emergjente (për më shumë shih Vendimin)⁸;

- grupimi dhe operacionalizimi i Qendrave Operative Lokale me Komitetet për Mbrojtje dhe Shpëtim- Shtabet e krizës në gjitha komunat e Kosovës;

- koordinimi i veprimeve, masave dhe mbështetjes nga të gjitha strukturat vendore përmes sistemit të Qendrave Operative Emergjente - QOE 112 në Kosovë;

- vendimi i Ministrisë për vazhdimësinë e vlefshmërisë së dokumenteve personale, qëndrimit të huajve dhe dokumenteve për automjete dhe të regjistrimit civil⁹;

⁷ [https://mpb.rks-gov.net/Uploads/Documents/Pdf/AL/257/Vendimi%20112%20per%20PRK%20\(3\).pdf](https://mpb.rks-gov.net/Uploads/Documents/Pdf/AL/257/Vendimi%20112%20per%20PRK%20(3).pdf)

⁸ [https://mpb.rks-gov.net/Documents/\(ENG\)%20Vendimi%20159.pdf](https://mpb.rks-gov.net/Documents/(ENG)%20Vendimi%20159.pdf)

⁹ [https://mpb.rks-gov.net/Documents/\(ENG\)%20Vendimi%20159.pdf](https://mpb.rks-gov.net/Documents/(ENG)%20Vendimi%20159.pdf)

- ngritja dhe grupimi i QOE 112 në nivel rajoni, të cilat koordinojnë ndihmën qeveritare autoriteteve lokale në menaxhim me situatën e krijuar.

Faza II, është periudha mars-prill 2020, pas paraqitjes së rastit të parë të sëmundjes me COVID-19, e cila u pasua me një sërë masash dhe veprimesh të ndërmarra në raport me situatën e krijuar¹⁰. Ndër të tjera në këtë fazë kufizimi i lëvizjes u caktua deri më 4 maj 2020, pas të cilës datë parashikohej modifikimi i masave dhe veprimeve.

Më datë 25.4.2020 Kosova numëronte 669 të infektuar, 19 humbje jetësh, 159 të shëruar, ndërsa në aspektin e përgjithshëm rregullimi i operimit të sektorit publik dhe ekonomik u vendos me kategorizime dhe specifika të lejes së lëvizjes dhe operacioneve ekonomike brenda vendit.

Faza III, është muaji maj 2020 dhe vazhdimësia në përballje me sëmundjen kur kërcënimi nga pandemia arriti pikun më të lartë të lakores (kurbës) së përhapjes sipas ekspertëve të IKSHPK-së, dhe me të cilën situatë vlerësohej krijimi i kushteve për zbatimin e masave të relaksimit gradual. Kjo gjë u vendos bazuar në vlerësimin e situatës nga mekanizmat shtetërorë për analizën e gjendjes për muajin qershor 2020: *Trendi i menaxhimit me situatë COVID-19 në muajin qershor 2020, reflektonte në raport me komunikatën e MSH-IKSHPK*¹¹. Ajo pasqyrore ndryshimin për kalimin e lirë të qytetarëve në pika kufitare pa pas nevojë të kenë kryer analizën e testit brenda 4 ditëve, ndërsa kontrollet zbatoheshin në nivelin e Qendrave Kryesore të Mjekësisë Familjare QKMF të komunave përkatëse i njohur ne sistemin shëndetësorë të Kosovës si kujdesi primar shëndetësor.

Mekanizmat e vënë në veprim të cilat dalin nga *Ligji për mbrojtje nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë e tjera, Plani i reagimit kombëtar dhe Sistemi i integruar i menaxhimit emergjent*, mbesin funksionale bazuar në direktivën e ministrit të Punëve të Brendshme, ndërsa funksionet e mbështetjes me fokus ruajtjen e shëndetit publik. MSH-ja dhe IKSHPK-janë në këtë fazë rekomandojnë masa të reja në periudhën e hapjes graduale, dhe këtu parashihet ndihma psikologjike për të traumatizuarit dhe familjet e prekura nga COVID-19, që ndihma t'u ofrohet përmes konsultave *online* në numrin kontaktues të publikuar në faqen e MSH-së. Ndërveprimi i organizatave dhe shoqatave në ndihmë dhe përkrahje për të përballuar situatën, vazhdon sikurse që nga fillimi i pandemisë, duke respektuar rekomandimet e OBSH-së dhe MSH-së.

Aktualisht, Kosova po përjeton një rritje tjetër të rasteve, ndërsa sistemi shëndetësor po mbingarkohet dhe stafi mjekësor është i stërmunduar. Në planin afatshkurtër, kjo tregon se koha relative e qetësimit mes valëve të ndryshme të infektimit nuk ishte e mjaftueshme që sistemet shëndetësore publike të përvehtësonin ose zbatonin masa domethënëse për të përmirësuar kapacitetet e tyre. Në planin afatgjatë, do të jetë sfiduese të gjenden strategji të parandalimit të shpërthimeve të tjera.

Përhapja e shpejtë e pandemisë COVID-19 në të gjitha vendet e botës ngriti shqetësime në lidhje me mungesën e koordinimit mes vendeve për t'u mobilizuar kundër COVID-19, duke marrë e vendimeve të tilla si ndalimi i BE-së për eksport të pajisjeve mjekësore, si dhe sistemet e shpërndarjes të vaksinës. Vonesat në sigurimin e vaksinave janë si pasojë e infrastrukturës së mangët, por edhe mungesës së mjeteve financiare për të siguruar blerjen e saj.

¹⁰ Për më shumë rreth masave të ndërmarra në Fazën II, shih: <https://msh.rks-gov.net/en/msh-lanson-platformen-on-line-per-covid-19-kosova-health/>.

¹¹ Për më shumë shih: <https://msh.rks-gov.net/adresimi-i-ministrit-te-shendetesise-ne-konferencen-e-sotme-per-media/>

¹² QS e KSK <https://kryeministri-ks.net/documents/sekretariati-i-keshillit-te-sigurise-se-kosoves-qendra-e-situatave-shpalle-te-lire-kete-vend-te-punes-i-nje-1-zyrtar-i-larte-per-grumbullimin-dhe-perpunimin-e-teum/>



Figura 1. Statistika e gjendjes me pandemi në Kosovë, 13 mars 2020-13 mars 2021¹²

2.1 Reagimi në nivel komune ndaj emergjencës; masat dhe veprimet e ndërmarra, si dhe mbështetja në nivel vendor

Komunat janë qeverisje lokale sipas organizimit administrativ dhe politik të vendit, dhe si hallkë bazike në jetën shoqërore, organet drejtuese dalin si rezultat i votës së drejtpërdrejt nga qytetarët. Mbështetur në këtë statut legal, organet komunale zbatojnë edhe kujdesin për jetën dhe shëndetin e qytetarëve, ndërsa në sistemin e menaxhimit me kriza dhe incidente si ky me COVID 19, duhet dhe kanë zbatuar detyrimin ligjor, aktivizimin e shtabeve të krizave dhe qendrave operative emergjente lokale për zonën e përgjegjësisë.




Figura 2. Statistika e gjendjes me pandemi në komunat e Kosovës, 13 mars 2020-13 mars 2021

AKADEMIA E SIGURISË

Konferencë shkencore ndërkombëtare:

« Fenomenet ekstreme të natyrës dhe çështjet e sigurisë »

Masat praktike të ndërmarra përveç aktivizimit të shtabeve emergjente ose të krizës, përmes mekanizmave lokal, të gjitha komunat përcillnin dhe zbatonin masat e rekomanduara dhe të kërkuara nga niveli i pushtetit qendror, gjegjësisht, nga GNMI-ja përmes QO MPB dhe QOE 112 në nivel vendi.

Ndihma dhe mbështetja ndaj komunitetit, e sidomos për grupet e marginalizuara dhe komunitetet pakicë, zbatohet përmes grupeve të vullnetarëve të organizuar në degët e Kryqit të Kuq të Kosovës, Caritas Kosova, dhe shoqatave ose asociacioneve të krijuara edhe për këtë situatë. Nga mekanizmi koordinues qeveritar GNMI, kërkohej ndihma dhe përkrahja në vazhdimësi për mbështetje, duke filluar nga mjetet dhe pajisjet mbrojtëse për reagues dhe vullnetarë, po ashtu, edhe për zona të afektuara dhe zyrtarë komunalë të cilët vepronin në terren: si ato të kujdesit primar shëndetësor, po ashtu, edhe zyrtarë ndërlidhës, transport ose furnizime. Në faza të caktuara të shtrirjes së pandemisë, kujdesit primar shëndetësor iu bart përgjegjësia e trajtimit fillestar, ose triazhimit¹³ të të infektuarve nga zonat e prekura, dhe transportin në kujdesin sekondar dhe terciar të sistemit shëndetësor në Kosovë.

Trendi i menaxhimit me situatën COVID-19 në muajin qershor 2020, reflektonte në raport me komunikatën e MSH-IKSHPK-së dhe pasqyronte ndryshimin për kalimin e lirë të qytetarëve në pika kufitare pa pasur nevojë të kenë kryer analizën e testit brenda 4 ditëve, ndërsa kontrollet zbatoheshin në nivelin e qendrave kryesore të mjekësisë familjare (QKMF-ve) të komunave përkatëse.

2.2 Komunikimi dhe bashkëpunimi me qytetarët dhe palët e tjera të interesit

Komunikimi me publikun në fillimin e gatishmërisë, u strukturuar në tri rrafshë efektive, dhe atë në:

1. Ofrimin e ndihmës dhe përkrahjes për qytetarë, përmes platformës online nga aplikacioni Kosovahealth,¹⁴ përmes të cilës qytetarët 24/7 mund t'ju qaseshin mekanizmit përgjegjës për ndihmë dhe përkrahje;

2. Menaxhimin e situatës dhe udhëheqjes me të, përmes qendrës operative në nivel qendror dhe atij lokal, përmes numrave thirrës dhe pa pagesë me numrin emergjent evropian 112, pastaj edhe numrat e tjerë, si 192 (Policia e Kosovës), 193 (Shërbimi i Zjarrfikës dhe Shpëtimit), 194 (Shërbimi urgjent i kujdesit primar shëndetësorë), dhe

3. Bashkëpunim ndërkombëtar, e sidomos me atë të mekanizmit evropian të mbrojtjes civile, përmes ERCC – anglisht *Emergency Response Coordination Center*, dhe shqip QKRE – Qendra e Koordinimit dhe Reagimit Emergjent Evropian.

Ndihma psikologjike për grupet në nevojë, gjithashtu u aktivizua nga institucionet përgjegjëse për ndihmë psikologjike dhe në dispozicion të qytetarëve në nevojë.

2.3 Sfidat: shërbimet, financat, cënueshmëria dhe efektet socioekonomike

Pandemia COVID-19 ishte dhe vazhdon të mbetet sfida globale, ndërsa hallkat përgjegjëse dhe llogaridhënese vendore, u ballafaquan edhe me një situatë për të cilën nuk kishin përvoja nga e kaluara. Ky fakt nxori në pah domosdoshmërinë e të menduarit dhe përgatitjes së shoqërisë edhe për skenarë bazuar në supozime, të cilët në botën e planifikueseve njihet si “Përgatitja për skenarin më të keq me pasoja më të rënda”, në

¹³ Procesi i klasifikimit të pacientëve sipas prioriteteve të tyre për të marrë trajtim mjekësor, evakuim dhe transportim njihet me emrin “tirazh”.

¹⁴ <https://kosova.health/en/>

mënyrë që të ngrihen kapacitetet vendore për t'u përballur në mënyrë efikase.

Cenueshmëria e komunitetit vërtetoi se varet dukshëm nga sistemi i udhëheqjes me vendin dhe kapaciteti ekzistues. E njohur dhe vërtetuar edhe përmes situatës me pandemi, cenueshmëria e komuniteteve rritet eksponencialisht me nivelin e zhvillimit, edhe pse diametralisht si dukuri të kundërta, por rritjen eksponenciale e përcjellin secila në rrafshin e vet.

Efektet socioekonomike do të vërehen pasi situata të marrë epilogun përfundimtare, dhe pastaj fillojnë dhe dalin në sipërfaqe të metat, humbjet, dështimet, ose nevoja për rimëkëmbje në secilin aspekt dhe jo vetëm në atë ekonomik.

2.4 Nevojat në të ardhmen

Edhe pse si të tilla ato paraqiten në përfundime dhe rekomandime, disa të veçanta si në vijim:

- aplikimi i përvojave të nxjerra nga veprimi në terren në fazat e caktuara të zhvillimit të pandemisë me COVID-19, duke e trajtuar procesin nga e panjohura - në fazën fillestare, menaxhimi i kapacitetit vendor në të gjitha aspektet e trajtimit të dukurisë si komunikimi, koordinimi dhe bashkëpunimi ndërinstytucional në dy nivelet e qeverisjes;

- sistemi i rishikuar dhe i plotësuar i menaxhimit emergjent, i besueshëm, i njohur për të gjitha hallkat publike dhe private të vëna në veprim, përmes ushtrimeve dhe praktikës së roleve e përgjegjësi në ushtrime me skenarë në kriza, edhe si kjo me pandemi COVID-19;

- komunikim ndërinstytucional përmes hallkave të dëshmuara, komunikimi me publikun përmes zëdhënies së unifikuar, ndërsa me grupet e interesit të sinkronizuar dhe aktualizuar me situatën;

- ndërveprim i përhershëm dhe i besueshëm me mekanizmat vendorë dhe ndërkombëtarë nga fushat specifike, përmes kanaleve të mirënjohura nga të gjithë aktorët relevant vendorë, lokalë dhe qendrorë. QOE-ja e institucioneve si MPB, MSH dhe të tjera, të cilat janë bartëse të funksioneve mbështetëse emergjente, mbështetur në *Planin e reagimit kombëtar*.

3. Përfundime

Kosova nuk ishte e përgatitur mjaftueshëm për këtë kërcënim të ri ndaj popullatës, i cili sfidoi shërbimin e kujdesit shëndetësor të Kosovës, ekonominë dhe çështje të tjera të lidhura me to. Pandemia COVID-19 nxori në pah sfidat e komunikimit ndërinstytucional dhe një qasje gjithëpërfshirëse në kohë krize, andaj institucionet qendrore dhe lokale duhet të përmirësojnë sistemin e koordinimit dhe menaxhimit, të promovojnë një kulturë të gatishmërisë, si dhe të përmirësojnë planifikimin e reagimit në kriza.

COVID-19 ishte tregues se Republika e Kosovës ka mungesë të kapaciteteve për t'u përballur me kërcënimet dhe rreziqet që shkaktohen nga katastrofat natyrore, epidemitë apo kërcënimet tjera që cenojnë sigurinë e përgjithshme. Sfidat e shfaqura në menaxhimin e pandemisë faktuan se Kosovës i mungon një sistem kualitativ i sistemit shëndetësor e shtetëror dhe koordinim institucional për t'u përballur me kriza shëndetësore të kësaj përmase.

Qeveria duhet të përgatisë, dhe Parlamenti duhet të miratojë, *Strategjinë e sigurisë kombëtare*, si dhe *Planin e veprimit për zvogëlimin e rrezikut nga fatkeqësitë*, si dokument i rëndësishëm për ndërtimin dhe koordinimin programeve të punëve dhe

AKADEMIA
E SIGURISË

Konferencë
shkencore
ndërkombëtare:

« Fenomenet
ekstreme
të natyrës
dhe çështjet
e sigurisë »

aktiviteteve të së gjitha subjekteve në nivel lokal, qendror, si dhe donatorëve të huaj dhe vendas, për parandalimin dhe zvogëlimin e rreziqeve nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë e tjera.

Korniza aktuale strategjike për menaxhimin e emergjencave, përkatësisht, *Plani i reagimit kombëtar* duhet të rishikohet, ndërsa *Sistemi i integruar i menaxhimit emergjent* duhet të plotësohet, bazuar edhe në përvojën e menaxhimit të pandemisë COVID-19. Duhet të hartohet strategjia e re e sigurisë së Kosovës, 2021-2030, e cila u botua në nëntor 2020 si një draft i dokumentit nga Këshilli i Sigurisë i Kosovës për konsultim publik¹⁵.

Duhet të hartohet një ligj mbi gjendjen e jashtëzakonshme në mënyrë transparente dhe pjesëmarrëse, duke marrë parasysh përvojën e fundit. Ligji për gjendjen e jashtëzakonshme duhet të mundësojë një qasje për të gjithë qeverinë, duke përfshirë shkallëzimin e mekanizmave të reagimit ndaj emergjencave në të gjithë sektorët.

Bibliografia

1. "Balkans in EuropePolicy, Balkans in EuropePolicy, 2020. Page 5.
The experts were engaged with key interlocutors at key decision-making level, experts and specialists to understand the town infrastructure for PwD. As it is seen in *Graphic 7*, only 7% responded that there was an emergency access for PwD in residential areas whereas 27% responded to lack of access and 46% only partially.



¹⁸ Decision 117 date 24.12.2019 of the Municipality Council on approval of the number of employees of Kolonja Municipality and its enterprises and the level of salaries for 2020.



Graphic 7. Emergency Access for PwD.

On the same question for public buildings 34% of the responders said there was access for PwD and other 33% confirmed that most of the buildings had access. However, 13% stated there was no access followed by another 20% who confirmed of minimal access.

Graphic 8. Existence of Ramp in public buildings and infrastructure



Graphic 9. Existence of Loud Audio Signal in Kolonja Municipality.

AKADEMIA E SIGURISË


Konferencë shkencore ndërkombëtare:
« Fenomenet ekstreme të natyrës dhe çështjet e sigurisë »

In the following questions, the respondents were asked about the existence of supportive infrastructure such as ramps, audio signal, illuminated emergency exist and visible writing. The data which was mostly validated from the inspectors was the existence of basic ramps in main public infrastructure. However, none of them had supportive handrails for PwD. Despite the fact that 9 respondents answered that there was loud system, the inspectors were not able to witness any.

3.5.4 Financial capacities

The total budget of the municipality (local revenues and the state budget transfer)

for 2020 is 345.928.573 All, of which earmarked for civil emergencies and DRR in the municipality is around 5.000.000.¹⁹ The law for civil emergencies no. 45/2019 stipulates that the budget for civil emergencies and DRR should be 4% of total local budget, whereas the actual allocation from Kolonja municipality is only 1.4%. The interview with the deputy mayor revealed that due to COVID pandemic the budget earmarked for civil emergencies had increased to nearly 3%.




Graphic 10. Local budget earmarked for civil protection in Kolonja.

The local responders had a vague understanding of the dedicated budget for DRR and civil protection as illustrated in Graphic 10. Indeed, one of the main criteria which was broadly discussed during COVID-19 pandemic was the increase of local emergency budget. Based on the analysis of the 2020 Kolonjamunicipal budget, there were no funds planned for public awareness, training or skills development regarding DRR and dedicated to PwD.This fact is also acknowledged in the draft local DRR, where one of the main strategic measures was to achieve the target of 4% dedicated budget for civil protection and DRR in compliance with law 45/2019 on civil protection.²⁰

3.5.5 Information and awareness

Based on the interviews with the municipal officials, coordination among stakeholders on DRRM initiatives is very important and at the same time very challenging. It affects mainstreaming of DRRM issues in regular development works and further re-tards the vision on building resilient communities and infrastructure in a high disaster risk municipality such as Kolonja. 60% of the local officials responded that dedicated awareness session for PwD are organized 2 times per year and 20% replied that aware-ness raising activities are taking place at least once per year. (See Graphic 11)

¹⁹ Decision 114/12/2019 “On the approval of Kolonja Municipality Budget for 2020; accessed at <https://www.vendime.al/wp-content/uploads/2020/01/vendimet-1141.pdf>
²⁰ Municipality of Kolonja. Local Disaster Risk Reduction Strategy. Draft Document, August 2020.p. 20



Graphic 11. Awareness raising activities for PwD in Kolonja.

The interviews with key officials showed that there was no programme for information or awareness raising activities dedicated for PwD. This fact was also confirmed by the current draft documents for the draft DRR strategy and the Action Plan for Civil Protection at local level, where no provisions were planned for PwD and special need. Training on building awareness on the key legislative changes for DRRM, risk assessment that includes multi hazards, exposure and vulnerability along with trainings for firefighting, and awareness/training session on disaster response are the municipality's interest areas

4. Conclusions and recommendations

Reviewing the findings from the local assessment of DRR management capacities of Kolonja Municipality, in relation to the PwD, in line with the provisions of the Constitution of Albania, strategies and existing laws, the following recommendations have been identified to build capacity of the municipal governments.

Recommendation

Strategies/Plan/Actions

- The Municipality should revisit the draft local DRR strategy to integrate specific measures concerning People with Disabilities needs. The review would greatly benefit the prior consultation with the PwD including blind people, physical disabled, persons with disabilities

- Empower and include persons with disabilities during planning consultation events. The engagement of PwD and other categories like persons with sight impairments, physical impaired persons would greatly increase the quality and planning in terms of response preparedness during DRR activities in the area.

- Identify and address the disability-specific needs of PwD, specifically categorized for men, women and children with disabilities, as well as type of disability. Acknowledgment

edging the specific challenges faced by women with disabilities following disasters, the municipality should collaborate with women with diverse disabilities to develop and implement disaster risk reduction strategies which support their safety and inclusion.

- The municipality needs to develop risk assessment and develop risk maps and how they impact PwD.

Early Warning System

- The municipality of Kolonja and its disaster managers need to improve their EWS for PwD and incorporate assisted devices for various categories who have sight impairment, hearing and speaking barriers, physical and cognitive disabilities. The challenges faced by persons with disabilities, is ensuring that there is an early warning system that will be able to hear/see/understand and identify as a hazard warning.

- Warning might vary from the posting of a notice at a community centre, public schools, to the hoisting of a red flag, to broadcasting warnings on television and radio to a word of mouth (door-to-door) information programme.

Preparedness and Response

- The Municipality of Kolonja needs to use research, mapping, and other data collection activities as an opportunity to gather disaggregated data on persons with disabilities. Existing data collection tools, or tools yet to be developed, could be used to identify disability data needs, particularly risk information.

- Consult with people with disability, with a diverse range of disabilities to identify differential risk and develop strategies which address barriers to meaningful participation in disaster risk reduction and response initiatives. Particular attention must be paid to preparedness and the provision of accessible evacuation information, infrastructure, and strategies which ensure people evacuate safely with their assistive devices.

- Active participation of communities should be explored to ensure reporting and assisting during the emergency response in cooperation with the local government and respective agencies.

Local Infrastructure

- The critical public infrastructure in Kolonja Municipality needs to be strengthened through provision of access for PwD apart from Ramps. Other supportive infrastructure needs to be qualitatively placed in shelters, toilets, access service, stairs, and hand-rails.

- The Rescue and Fire Service sector needs to be equipped properly to manage emergency response for PwD.

Capacity and Training needs

- The Civil Emergency Unit needs to develop into a full directorate within the organigram of the municipality.

- The new directorate of civil emergencies should be fully staffed, resourced and supported to first be trained and deliver training for local commission of civil protection, local administration, heads of villages and all the chain of civil emergency in the municipality;

- A special tailored programme and curricula needs to be developed for all civil emergency structures at local level for inclusive DRR for PwD;

Financial capacities

- The pandemic COVID-19 highlighted the importance of having a dedicated civil emergency budget at local level. The Municipality should put more work to meet the 4% threshold indicated in the law no.45/2019;

**AKADEMIA
E SIGURISË**

*Konferencë
shkencore
ndërkombëtare:*

« Fenomenet
ekstreme
të natyrës
dhe çështjet
e sigurisë »

- Preparation of a detailed and budgeted plan which would assist the early warning, preparedness, access, capacity needs and training for the local commission of civil protection and engagement of PwD in planning, consultation and decision-making of plan and local strategies.

Literature

1. BEH-IFHV, (2019), World Risk Report 2019, ISBN 978-3-946785-08-8, www.WorldRiskReport.org
2. CIMA (2104), Historical Collection of Disaster Loss data in Albania, ISBN/ISSN/DOI 97888906 06847, https://www.preventionweb.net/files/36736_historicalcollectionofdisasterlossd.pdf
3. DCM N. 835/2004, (2004), "On the Approval of the National Plan for Civil Emergencies," Official Gazette N.101, December 2004
4. DCM N. 348/2015 "On the adoption of the National Strategy for Development and Integration 2015 – 2020," Official Gazette N. 86, May 2015
5. DCM N. 9/2019, (2019), "On addressing the consequences of natural disasters," Official Gazette of the Republic of Albania, N. 172, December 2019
6. DCM N. 747/2019, (2019), "On the organisation and functioning of the National Civil Protection Agency," Official Gazette of the Republic of Albania, N. 159, November 2019
7. Law N. 45/2019, (2019), "On Civil Protection," Official Gazette N. 113, August 2019
8. MoHSP (September 2019) National Strategy for Social Protection (rev. 2022)
9. Republic of Albania, (2014), National Strategy for Disaster Risk Reduction and Civil Protection.
10. UNDP, (2003), Disaster Risk Assessment in Albania, Executive Summary Report.
11. World Bank, (2014), AL-DRMAP Project-ICR, <http://documents.worldbank.org/curated/en/313781468193510916/pdf/ICR29910P110840C0disclosed050210140.pdf>
12. World Bank GPurl D-RAS Team, (2019), M6.4 Albania Earthquake Global Rapid Post Disaster Damage Estimation (GRADE) Report
13. WB, UN, EU &CoM (2020). Albania Post Disaster Needs Assessment. Volume B. Report, February 2020
14. URI. Telephone Based Survey. Internal draft report.



AKADEMIA E SIGURISË

*Konferencë
shkencore
ndërkombëtare:*

**« Fenomenet
ekstreme
të natyrës
dhe çështjet
e sigurisë »**

Analizimi i kushteve hidrologjike dhe meteorologjike, në lëshimin e alarmit për përmbytje, nga Qendra Kombëtare për Parashikimin dhe Monitorimin e Rreziqeve Natyrore, në Shqipëri



■ **Dr. Entela VAKO**
*Instituti i Gjeoshkencave,
Energjisë Ujit dhe Mjedisit*
entelavako@gmail.com

■ **MSc. Klodian ZAIMI**
*Instituti i Gjeoshkencave,
Energjisë Ujit dhe Mjedisit*

■ **MSc. Elona ABAZI**
*Instituti i Gjeoshkencave,
Energjisë Ujit dhe Mjedisit*

■ **MSc. Anlra GJONI**
*Instituti i Gjeoshkencave,
Energjisë Ujit dhe Mjedisit*

Abstrakt

Në këtë punim jepet një analizë e detajuar e kushteve hidrologjike dhe meteorologjike, që karakterizojnë një pellg lumor në një periudhë të caktuar, të cilat janë vendimtare në zhvillimin e dukurisë së përmbytjes. Analizimi i tyre, si dhe ndjekja e procedurave standarde të punës nga parashikuesi i Qendrës Kombëtare për Parashikimin dhe Monitorimin e Rreziqeve Natyrore, është shumë i rëndësishëm përpara se të jepet alarmi për përmbytje. Njohja e hidrologjisë së pellgut lumor, si dhe historiku i përmbytjeve, së bashku me karakteristikat fizike, si forma e basenit, lartësia mbi nivelin e detit, topografia etj. ndikojnë në cilësinë e alarmit. Parametrat kryesorë meteorologjikë në zhvillimin e dukurisë së përmbytjes janë reshjet dhe temperatura. Intensiteti i reshjeve, kohëzgjatja dhe shpërndarja e tyre mbi pellgun ujëmbledhës përcaktojnë mundësinë e përmbytjes. Gjithashtu faktorët e tjerë si lagështia relative, era etj., ndikojnë në zhvillimin e përmbytjes. Kombinimi i këtyre parametrave janë baza e modelit evropian të parashikimit të përmbytjeve i cili informon disa ditë më parë për sasinë e reshjeve që pritet të bien në një territor të caktuar, si dhe tendencën dhe probabilitetin në përqindje, për përmbytje lumore, përmbytje vërshuese apo rrëshqitje të dherave. Mbi këtë bazë, mbështetet puna e parashikuesit për të dhënë alamin nëpërmjet Buletinit të rreziqeve natyrore. Por, marja e këtij informacioni nga modeli, në ndonjë rast, do të ishte mbivlerësim apo nënvlerësim i situatës nëse nuk do të njihen specifikat e dinamikës së pellgut lumor krahas zhvillimit urban, apo problemeve të menaxhimit të pellgjeve lumore.

Fjalëkyçe:

dukurla e përmbytjes, parashikimi i përmbytjes, parametrat hidrologjikë dhe meteorologjikë, zhvillim urban, dinamika e pellgut lumor

1. Hyrje

Përmytja është një nga rreziqet natyrore më të shpeshta në Shqipëri, madje ajo është një dukuri e zakonshme dhe renditet e dyta pas zjarreve si katastrofa natyrore më e zakonshme në Tokë. Përmytja nga lumenjtë (River Flood) është një nga pesë tipat e përmytjeve. Sipas studimit të “CIMA” Foundation, dega Shqipëri, për periudhën 1851-2013, të gjithë rrethet kanë pasur të paktën një përmytje në territorin e tyre. Rrethet me më shumë përmytje dhe përmytje të shpejta janë Shkodra (160 ngjarje) dhe Lezha (117 ngjarje)¹. Gjithashtu, sipas përmbledhjes në studimin “Vlerësimi i rreziqeve në Shqipëri”, përmytja me mundësi përsëritjeje 100 vjet do të prekte 20 rrethe, 110 komuna, 341 fshatra, 85,500 godina me 7 900 000 m² sipërfaqe ndërtimi dhe 565 000 banorë².

Gjithashtu një tip i përmytjeve është edhe përmytja e shpejtë (*Flash Flood*). Përmytja e shpejtë është nga më të rrezikshmet. Ajo ndodh për shkak të reshjeve intensive dhe të menjëhershme dhe kur toka nuk mund të thithë shiun me shpejtësinë që bie. Kështu, gjatë viteve 2015-2017, përmytjet dhe përmytjet e shpejta në Evropën Juglindore prekën më shumë se 2 milion njerëz dhe rezultuan në më shumë se njëqind viktima. Ajo është nga fatkeqësitë natyrore me më tepër se 5000 jetë të humbura në vit dhe me ndikim të madh social, ekonomik dhe mjedisor³.

Studimet e shumta në vite të ish-Institutit Hidrometeorologjik sot Instituti

¹ Toto Emanuela, Deda Miranda dhe Massabò Marko, “Mbledhja e të dhënave historike të humbjeve nga fatkeqësitë në Shqipëri”, CIMA Foundation-Dega Shqipëri, f 51

² Plani Kombëtar për emergjencat civile-2004, f 71

³ Petra Mutic et al. “South East Europe Flash Flood Guidance System SEEFFGS, User Guide”, WMO 2017, f 1

Gjeoshkencave Energjisë Ujit dhe Mjedisit (IGJEUM), në fushën e hidrologjisë kanë treguar se parashikimi i përmbytjeve në kohë reale nuk ka qenë i mundur për shkak të kufizimeve të kohës si zhvillimi i teknologjisë, mungesa e sistemit të lajmërimit të hershëm apo mungesa e informacionit në kohë reale. Masat paraprake që merreshin për minimizimin e ndikimit në jetën e njerëzve, ekonomi apo mjedis ishin të karakterit të inxhinierisë.

Në vitin 2010, me ngritjen e Qendrës Kombëtare të Parashikimit dhe Monitorimit të Rreziqeve Natyrore pranë ish-Institutit të Energjisë Ujit dhe Mjedisit (INEUM), si dhuratë e qeverisë italiane, në kuadër të një projekti të *Mbrojtjes Civile Italiane* dhe Ministrisë së Jashtme të Shqipërisë, është bërë e mundur për herë të parë krijimi i sistemit bashkëkohor të parashikimit dhe lajmërimit të hershëm në Shqipëri, të rreziqeve natyrore të tilla, si të përmbytjeve dhe të zjarreve.

Kështu, në botë parashikimit të motit i jepet rëndësi e veçantë duke e quajtur atë, pjesë të ekonomisë. Për shembull, në 2009-n, SHBA-ja shpenzoi afërsisht 5.1 miliardë dollarë në parashikimin e motit, duke marrë përfitime, të vlerësuara në gjashtë herë më shumë⁴.

Platforma EFAS (*European Flood Awareness System*) është pjesë e zhvillimit të teknologjisë moderne për t'u informuar mbi situatën hidrologjike të pellgjeve lumore në Evropë. Ai është sistemi i parë operacional që parashikon dhe monitoron ngjarjet e përmbytjeve në të gjithë Evropën dhe u siguron partnerëve të tij, siç janë shërbimet kombëtare ose rajonale hidrologjike dhe Qendrën Evropiane të Reagimit dhe Bashkërendimit (ERCC), një gamë të gjerë informacionesh paralajmëruese duke përfshirë mundësinë e rrezikut nga përmbytjet deri në 10 ditë përpara. Është një platformë ueb e ndërtuar mbi bazën e *modeleve meteorologjike dhe hidrologjike* që informon shkallën e alarmit për përmbytje në pellgjet lumore të vendit. Në të është përfshirë dhe EFAS *Flash Floods* e cila lidhet me përmbytjet në rrjetet lumore, por duke mos përfshirë përmbytjet në zonat urbane.

Gjithashtu Platforma SEEFFGS (*South East European Flash Flood Guidance System*) e krijuar dhe zhvilluar në të gjithë botën nga HRC (*Hidrologic Research Center*, San Diego, USA) në bashkëpunim me WMO (*World Meteorological Organization*), USAID/OFDA (*US Agency for International Development Office of Foreign Disaster Assistance*) dhe NOAA (*US National Oceanic and Atmospheric Administration*). Ky sistem dhe produktet e tij iu vjen në ndihmë Shërbimeve Kombëtare Hidrometeorologjike të parashikojnë dhe lëshojnë në kohë lajmërimin⁴.

Qëllimi i këtij punimi është të shpalosë bazat e punës parapërgatitore në analizimin e faktorëve lokale hidrologjike dhe meteorologjike për hartimin e *Buletinit të parashikimit të përmbytjeve*. Analizimi i këtyre faktorëve për pozicione të ndryshme gjeografike bëhet në përputhje me ndarjen e territorit të vendit në katër zona klimatike kryesore dhe tre nënzona⁵.

Buletini është produkt i Qendrës Kombëtare për Parashikimin dhe Monitorimin e Rreziqeve Natyrore, pranë Institutit të Gjeoshkencave Energjisë Ujit dhe Mjedisit (IGJEUM). Informacioni që përmban *Buletini* i përcillet nëpërmjet email-it drejtorisë

⁴ https://en.wikipedia.org/wiki/Weather_forecasting

⁵ Instituti Hidrometeorologjik, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, "Klima e Shqipërisë", 1974

së emergjencave civile në Ministrinë e Mbrojtjes dhe të gjitha ministrive të interesuara për parashikimin në mënyrë që të merren në kohë masat paraprake për menaxhimin e situatës që mund të krijohet në rastin e ngjarjeve jo të zakonshme meteorologjike dhe hidrologjike. Është një punë me rregulla dhe standarde të përcaktuara më parë, e cila duhet të përfundojë brenda një kohë të caktuar (para orës 12 në situatë normale dhe më herët në situatë jo të zakonshme) për lajmërimin në kohë për rrezikun nga përmbytja. Gjithashtu, përveç dërgimit në kohën e duhur, saktësia e tij është veçanërisht e rëndësishme.

2. Veçori të përgjithshme meteorologjike dhe hidrologjike të vendit tonë

Në vendin tonë si vend mesdhetar, përmbytjet ndodhin për shkak të reshjeve të shumta dhe për një kohë të gjatë, stuhitë e vazhdueshme apo kombinimi i reshjeve me shkrirjen e dëborës. Ato krijohen kur nivelet e ujit të lumit kapërcejnë brigjet e tij duke filluar që nga përrenjtë e vegjël deri të lumenjtë me të mëdhenj. Reshjet janë elementi kryesor të vendosjen e regjimit hidrologjik të lumenjve dhe për rrjedhim të zhvillimit të dukurisë së përmbytjes. Duke pasur parasysh karakteristikat e rrjetit hidrografik dhe relievit të vendit tonë, veçoria kryesore e përmbytjeve në vendin tonë është që për shkak të karakterit të theksuar malor të lumenjve, pjerrësisë së madhe të shpateve të tyre si dhe drejtimit të njëjtë të rrjedhjes së tyre nga lindja në perëndim, plotat lumore ndodhin pothuaj njëkohësisht në të gjithë territorin e vendit⁶.

Faktorët kryesore që ndikojnë në sasinë dhe shpërndarjen e reshjeve janë pozicioni gjeografik dhe relievi. Pozicioni gjeografik i vendit tonë bën që vendi ynë të ketë një klimë mesdhetare ku shpërndarja e reshjeve brenda vitit është tipike mesdhetare, me reshje të shumta gjatë gjysmës së ftohtë të vitit dhe me reshje të pakta gjatë gjysmës së ngrohtë të vitit⁷.

3. Mbledhja e informacionit dhe analizimi i karakteristikave të atmosferës

Për të realizuar *Buletinin e parashikimit të përmbytjeve*, kryhet një punë paraprake intensive nga grupi i parashikuesve. Puna e tij mbështetet fort si në të dhënat satelitore paraprake për orët në vazhdim ashtu dhe në të dhënat e vëzhgimit më të fundit apo siç quhet "Nowcasting". Mbi këtë bazë, parashikuesi në detyrë, apo operatori, duke bërë një analizë të drejtë të karakteristikave të atmosferës, si rrjedhim do të japë një parashikim të saktë për periudhën në vijim.

Që në fillim të punës së tij, parashikuesi në detyrë njihet me gjendjen e vrojtuar të atmosferës për një periudhë pesëditore. Kështu me anë të hartës përkatëse (figura 1), të lëshuar nga *Met Office* (UK)⁸, merret informacion për zhvillimin në sipërfaqe të presionit atmosferik, fronteve të motit si dhe për drejtimin apo shpejtësinë e erës. Kështu, operatori krijon idenë fillestare nëse do të ketë një mot të qëndrueshëm ose jo të territorin e vendit dhe të Evropë.

⁶ Selenica Agim, "Përmbytjet nga lumenjtë dhe parandalimi i dëmeve", Revista Ushtarake Nr. 2/2010, f 13

⁷ Bardhyl Shehu, Koco Karanxha "Hidrologjia inxhinierike 1", Shtëpia Botuese e Librit Universitar, Tirane 2003, f 160-161

⁸ <https://www.metoffice.gov.uk/weather/maps-and-charts/surface-pressure>




Figura 1: Njohja me gjendjen e parametrave të atmosferës

Ndërsa, uebsajti Windy.com⁹ (ICON-EU) (figura 2) me një rezolucion prej 7 km na jep një pasqyrë të parametrave meteorologjike si reshjet, dëborën, temperaturën, erën. Madje, informacion ky edhe i detajuar për pesë ditë në vazhdim, të përmbledhura të meteogramën përkatëse për një pike të caktuar, si dhe duke bërë krahasimin me modelet e tjera meteoglobale të parashikimit përfshirë në këtë uebsajt. Por gjithmonë duhet pasur parasysh: sa më e afërt periodua e parashikimit aq më e madhe saktësia e tij.




Figura 2: Njohja me parametrat meteorologjike të territorit vendit

Ndërsa me parashikimin dhe zhvillimin e stuhive në rajon dhe për rrjedhojë në territorin e vendit tonë, informohemi nga modeli evropian i parashikimit të stuhive ESTOFEX¹⁰ (figura 3).

⁹ <https://www.windy.com/>

¹⁰ <https://www.estofex.org/>

¹¹ <http://www.meteoalarm.eu/>

European Storm Forecast Experiment




Figura 3: Njohja me parashikimin për zhvillimin e stuhive në Europë

Nëpërmjet këtyre modeleve jepet rreziku apo niveli i alarmit me probabilitetin përkatës të përqindje nga stuhitë për 24 orët në vazhdim si dhe një përmbledhje “Synopsis” e stuhive të rajonin e Evropës dhe për rrjedhojë në vendin tonë. Vlen të përmendet që është shumë i rëndësishëm ky informacion, sepse është pikënisja për mundësinë e zhvillimit të ngjarjeve jo të zakonshme.

Gjithashtu në punën për njohjen e nivelit të alarmit për dukuri të ndryshme të vendet e rajonit dhe me gjerë, na ndihmon uebsajti “Meteoalarm”¹¹ (figura 4) ku jepet niveli i rrezikut për sot dhe nesër, me ngjyrën dhe shenjen përkatëse për dukuri të ndryshme hidrologjike apo meteorologjike për 36 shtete të Evropës.




Figura 4: Njohja me nivelin të alarmit të shtetet e rajonit

AKADEMIA
E SIGURISË

Konferencë
shkencore
ndërkombëtare:

« Fenomenet
ekstreme
të natyrës
dhe çështjet
e sigurisë »

Pra, pas njohjes së situatës të mënyrë vizuale me parametrat meteorologjike të vendit llogariten të dhënat numerike për reshjet. Operatori nëpërmjet llogaritjeve nga modeli i *con-EU* merr informacion për sasinë e reshjeve në mm që pritet të bjerë në të gjitha qarqet e vendit për 36 orët në vazhdim, kohë e cila përkon edhe me vlefshmërinë e *Buletinit*. Në rast situatash të ngarkuara, kjo punë përsëritet në fund të ditës për të parë prirjen e sasisë së reshjeve.

Por ajo që është me e rëndësishme, është llogaritja e reshjeve të akumuluarra për pesë ditët në vazhdim, në mënyrë që të dimë sasinë e reshjeve që pritet të bien në të gjitha qarqet e vendit, për të gjykuar paraprakisht mbi rrezikun për ngjarje të mundshme meteorologjike apo hidrologjike në territorin e vendit. Pas njohjes me kushtet meteorologjike dhe hidrologjike bëhet analiza e tyre nga parashikuesi duke u mbështetur në disa parime bazë. Faktori kryesor meteorologjik të zhvillimin e dukurisë së përmbytjes janë reshjet, intensiteti dhe kohëzgjatja e reshjeve si dhe shpërndarja e tyre mbi pellgun. Gjithashtu po kaq të rëndësishëm janë dhe faktorët e tjerë si temperatura, lagështia relative, era, stina e vitit, apo tipi i sistemit atmosferik.

Ndërkohë njoftimi që ka ardhur në qendër nga Qendra Evropiane e Lajmërimit të Përmbytjeve nëpërmjet modelit EFAS që disa ditë më parë, bën që të rritet shkalla e ndërjegjegjësimiit dhe mobilizimit të parashikuesit në detyrë dhe të gjithë stafit të parashikuesve të qendrës për kushtet hidrologjike të pellgjeve lumore të vendit. Vlerësimi i kushteve hidrometeorologjike të sipërpërmendur bëhet gjithmonë duke krahasuar paralelisht të dhënat e parashikimit të modeleve me të dhënat e marra *online* si dhe ato manuale nga stacionet hidrologjike dhe meteorologjike.

Por, të ndonjë rast të dhënat satelitore mund të mbivlerësojnë apo të nënvlerësojnë sasinë e reshjeve. Kështu njohja e hidrologjisë së pellgut lumor së bashku me karakteristikat fizike të pellgut, si forma e tij, lartësia mbi nivelin e detit, topografia, gjeomorfologjia, bimësia, tipi i tokës si dhe lagështia e tokës krahas historikut të përmbytjeve është mjaft e rëndësishme. Kombinimi i këtyre parametrave hidrologjike dhe meteorologjike është baza e *Modelit EFAS* të parashikimit të përmbytjeve, i cili informon disa ditë më parë për sasinë e reshjeve që pritet të bien në një territor të caktuar, në një periudhë të caktuar si dhe prirjen në përqindje për përmbytje, probabilitetin në përqindje për përmbytje të lumenjve, për përmbytje të shpejta apo për rrëshqitje të dherave.

Modeli EFAS përcakton indeksin e përmbytjeve bazuar në të dhënat e modelit meteorologjik COSMO-LEPS si dhe lagështirës së tokës, bazuar në modelin hidrologjik LISFLOOD. Modeli jep të pika të ndryshme të baseneve ujore të sinjalizuar për rrezik përmbytjeje, me përqindje të ndryshme sigurie.

Gjithashtu këtu është i përfshirë dhe modeli EFAS *Flash Floods* i cili lidhet me përmbytjet e shpejta në rrjetet lumore, duke mos përfshirë përmbytjet në zonat urbane. Përmbytjet e shpejta nuk gjenerohen thjesht nga një reshje intensive shiu por edhe nga proceset hidrologjike të sipërfaqes së tokës në të cilën ndodhin reshjet. Ato janë rezultat i ndërveprimit midis hidrologjisë dhe meteorologjisë së një zone të caktuar. Pikërisht marrëdhëniet komplekse midis lagështisë së atmosferës, terrenit, lagështisë së tokës dhe gjeomorfologjisë mund të rezultojnë në rritjen e potencialit të rrjedhje vetë reshjeve të shiut të një ngjarje të caktuar duke rritur mundësinë e ngjarjes se një përmbytjeje të shpejtë¹².

Gjithashtu, për informacion me të detajuar për përmbytjen e shpejtë, shfrytëzohen

produktet që na ofron platforma ueb SEEFFGS (*South East European Flash Flood Guidance System*). Ndër to, përveç parashikimit nëpërmjet të dhënave satelitore të reshjeve (FMAP) për të gjitha nën-pellgjet lumore, për 24 orët në vijim, nga disa modele meteorologjike të përfshira në të, mund të përmendim reshjet orare të ndërshtëna nga stacionet e caktuara të vrojtimit (Gauge MAP), lagështinë mesatare të tokës (ASM) si dhe riskun e përmbytjeve të shpejta (FFR) nga secili prej modeleve.

Pra, pas mbledhjes së gjithë këtij informacioni vizual dhe numerik, detyra kryesore e mbikëqyrësit të qendrës dhe parashikuesit apo operatorit në detyrë është përshtatja e nivelit të alarmit të rekomandojnë platformat EFAS apo SEEFFGS për një pellg lumor apo prefekturën të rrezik. Kjo gjë arrihet jo vetëm duke njohur mire pellgun nga ana hidrologjike por edhe gjendjen e terrenit ku pritet të ndodhë ngjarja dhe specifikat e zhvillimit dinamik të pellgut lumor në kohë reale.

Kështu, një ndikim të madh të zhvillimit të dukurisë së përmbytjes ka dhe urbanizimi i qyteteve krahas faktorëve të tillë, si zhvillimi urban i pakontrolluar, mosrespektimi i rregullave dhe kriterëve për ndërtime, mosfunksionimi i strukturave të mirëmbajtjes së kanaleve të kullimit, hidroforëve, mospastrimi i grykëderdhjeve të lumenjve, mosrehabilitimi i argjinaturave të dëmtuara në brigjet e lumenjve, mossistemimi i lumenjve në vendet ku urat janë të ngushta dhe të parikonstruktura.

Pra, pas përpunimit të këtij informacioni të vlefshëm për të gjitha pellgjet dhe nënpellgjet lumore, hartohet *Buletini mbi rreziqet natyrore* (Figura 5)¹³, për pjesën e dytë të ditës në vijim dhe ditën e nesërme. Ai përbëhet nga pjesa përshkruese dhe treguese ku në krye jepet “Parashikimi për përmbytje” si dhe “Parashikimi meteo” në lidhje me reshjet (shiun dhe dëborën), temperaturën dhe erën.

BULETINI MBI RREZIQET NATYRORE (Bulletin on Natural Hazards) Qendra Kombëtare për Parashikimin dhe Monitorimin e Rreziqeve Natyrore Facebook page : Instituti i Gjeoshkencave, Energjisë, Ujit dhe Mjedisit, Webpage: www.geo.edu.al	
Buletini Nr. 7/ 2021, 07-01-2021	Parashikimi nga 07-01-2021, ora 12:00 deri më 08-01-2021, ora 23:59.

PARASHIKIM PËR PËRMBYTJE Sipas llogaritjeve të IGJEUM, përgjatë datave (7 -11 Janar 2021) priten reshje shumë intensive, pothuajse në të gjithë territorin. Nga llogaritjet hidrologjike të IGJEUM, këto reshje do të sjellin rritje të rrezikshme të prurjeve në lumenjtë e mëdhenj dhe të mesëm Drin-Buna, Mat, Ishëm, Erzen, Shkumbin, Seman dhe Vjosë. Përmbytje mund të shkaktohen nga lumi Drin-Buna dhe Liqeni i Shkodrës me prurjet maksimale të cilat parashikohen të arrijnë zonat e rrezikuara në datën 12 Janar 2021. Lumenjtë Mat, Ishëm, Erzen dhe Shkumbin do i arrijnë prurjet maksimale në fundin e datës 8 dhe 9 Janar 2021. Lumenjtë Seman dhe Vjosa parashikohen të rrezikshëm por me probleme më të vogla lokale të përmbytjeve. Shkalla e rrezikut nga përmbytjet lumore do varet edhe nga sasia e shkrirjes së dëborës si pasojë e rritjes së temperaturave. Përmbytjet urbane dhe rrëshqitje të dherave mund të ndodhin gjithashtu në pothuajse të gjitha qarqet. Ky informacion do të përditësohet nga IGJEUM sipas llogaritjeve më të fundit hidrologjike dhe do të njoftoheni për çdo ndryshim në parashikimin e përmbytjeve.	AKADEMIA E SIGURISË Konferencë shkencore ndërkombëtare: « Fenomenet ekstreme të natyrës dhe çështjet e sigurisë »
PARASHIKIMI METEO RESHJET Sot pasdite (e enjte, dt. 07) dhe nesër (e premte, dt. 08) priten reshje shumë intensive në qarqet Shkodër, Kukës, Dibër, Lezhë, Vlorë dhe Gjirokastrë. Në qarqet Durrës, Tiranë dhe Elbasan priten reshje intensive deri lokalisht shumë intensive, ndërsa në qarqet Fier, Berat dhe Korçë mesatare deri lokalisht intensive. Reshjet do të shoqërohen me shtrëngata (siç tregohet në tabelë, respektivisht për secilin qark). Në veri dhe lindje në lartësitë mbi 500m reshjet do të jenë në formë bore.	
TEMPERATURAT Nesër (e premte, dt. 08) temperaturat minimale dhe maksimale të ajrit pritet të arrijnë: në bregdet: 13 / 18 °C, në vendet e ulëta: 8 / 12 °C, në vendet malore: 0 / 11 °C	
ERA Sot pasdite (e enjte, dt. 07) dhe nesër (e premte, dt. 08) era pritet të fryjë e lehtë deri mesatare, ndërsa në bregdet deri e fortë.	
NIVELET E RREZIKUT	
	S'KA RREZIK I ULËT I MODERUAR I LARTË

	Instituti i Gjeoshkencave, Energjisë, Ujit dhe Mjedisit – IGJEUM Operator: Elona Abazi Supervizor: Klodian Zaimi (tel: +355 4 2232941, e-mail: albania.hazards@gmail.com) faqe 1 / 3
---	--

Figura 5: Buletini i rreziqeve natyrore dt. 7.1.2021

¹³ <https://www.geo.edu.al>

Gjithashtu *Buletini* jep informacionin për parashikimin të detajuar edhe të forme tabelore (figura 6)¹⁴ mbi ngjarjet meteorologjike (reshje, rrufe dhe shtrëngata) dhe ato hidrologjike (përmbetje nga përrrenj apo lumenj të vegjël të mesëm e të mëdhenj si dhe rrëshqitje të tokës) ku jepet shkalla e rrezikut për përmbetje me anë të ngjyrës, për secilin qark të vendit, shoqëruar edhe me shenjat përkatëse të dukurive që pritet të vrojtohen gjatë ngjarjes së mundshme.

Kështu, *Buletini* fillimisht publikohet në faqen ueb të institutit dhe para orës 12 të mesditës shpërndahet nëpërmjet *email*-it të gjithë institucioneve të interesuara për këtë produkt. Kjo bën të mundur që *Buletini i reziqeve natyrore* të arrijë në kohën e duhur dhe të japë një alarm paraprak për situatën e parashikuar, për 36 orët në vijim, për gjithë territorin e vendit, në mënyrë që drejtoria përkatëse e emergjencave civile të marrë vendimet e duhura dhe në kohë, për të përballuar situatën emergjente të parashikuar që mund të krijohet nga reziqe natyrore si, përmbetje nga lumenjtë, përmbetje të shpejta apo rrëshqitje të tokës.




Figura 6: *Buletini i reziqeve natyrore* dt. 7.1.2021

4. Përfundime

Përmbetje nga lumenjtë është një nga rreziqet natyrore më të shpeshta të Shqipëri. Për vendin tonë, në kushtet e klimës mesdhetare ajo është një dukuri e zakonshme. Faktorët kryesorë meteorologjike të zhvillimit të dukurisë së përmbetjes janë reshjet, intensiteti dhe shpërndarja e tyre në pellgun lumor si dhe temperatura e ajrit. Përmbetje të shpejta nuk gjenerohen thjesht nga një reshje intensive shiu, por edhe nga proceset hidrologjike të sipërfaqes së tokës në të cilën ndodhin reshjet. Ato janë rezultat i ndërveprimit midis hidrologjisë dhe meteorologjisë së një zone të

¹⁴ <https://www.geo.edu.al>

caktuar. Në vitin 2010, me ngritjen e Qendrës Kombëtare të Parashikimit dhe Monitorimit të Rreziqeve Natyrore, pranë Institutit të Gjeoshkencave Energjisë Ujit dhe Mjedisit (IGJEUM), për herë të parë u krijua Sistemi Bashkëkohor i Parashikimit dhe Lajmërimit të Hershëm në Shqipëri, të rreziqeve natyrore të tilla si, përmbytjet dhe zjarret.

Buletini i parashikimit të përmbytjeve është produkt i Qendrës Kombëtare për Parashikimin dhe Monitorimin e Rreziqeve Natyrore. Buletini i përcillet nëpërmjet *email*-it drejtorisë së emergjencave civile në Ministrinë e Mbrojtjes dhe të gjitha ministrive të interesuara. Buletini hartohet mbi bazën e disa rregullave dhe standardeve të përcaktuara më parë, dhe duhet të përfundojë dhe të dërgohet brenda një kohe të caktuar. Njohja me kushtet meteorologjike dhe hidrologjike dhe analiza e tyre nga parashikuesi në detyrë, bëhet duke u mbështetur në disa parime bazë.

Për të realizuar *Buletinin e parashikimit të përmbytjeve*, kryhet një punë paraprake intensive nga grupi i parashikuesve. Puna e tij mbështetet fort në të dhënat satelitore paraprake të modeleve të ndryshme evropiane për orët në vazhdim, ashtu dhe në të dhënat e vëzhgimit më të fundit apo siç quhet “Nowcasting”.

Vlerësimi i kushteve hidrometeorologjike të pellgut lumor bëhet gjithmonë duke krahasuar paralelisht të dhënat e parashikimit të modeleve me të dhënat e marra online si dhe ato manuale, nga stacionet hidrologjike dhe meteorologjike. Platformat ueb EFAS *Flash Floods* si dhe SEEFFGS informojnë qendrën kombëtare për nivelin e rrezikut të lidhje me përmbytjet e shpejta në rrjetet lumore, duke mos përfshirë përmbytjet në zonat urbane.

Pas mbledhjes së informacionit vizual dhe numerik, detyra kryesore e mbikëqyrësit të qendrës dhe parashikuesit apo operatorit në detyrë, është përshtatja e nivelit të alarmit që rekomandojnë platformat EFAS apo SEEFFGS, për një pellg lumor apo prefekturën në rrezik.

Kjo gjë arrihet jo vetëm duke njohur mire pellgun nga ana hidrologjike, por edhe gjendjen e terrenit ku pritët të ndodhë ngjarja dhe specifikat e zhvillimit dinamik të pellgut lumor në kohe reale. *Buletini mbi rreziqet natyrore* përbëhet nga pjesa përshkruese dhe treguese ku në krye jepet “Parashikimi për përmbytje” si dhe “Parashikimi meteo” në lidhje me reshjet (shiun dhe dëborën), temperaturën dhe erën.

Buletini jep parashikim të detajuar edhe në formë tabelore mbi ngjarjet meteorologjike si reshje, rrufe dhe shtrëngata dhe ato hidrologjike siç janë përmbytje nga përrenj apo lumenj të vegjël të mesëm e të mëdhenj si dhe rrëshqitje të tokës.

Një ndikim të madh të zhvillimit dhe dukurisë së përmbytjes nga lumenjtë dhe përmbytjet e shpejta ka urbanizimi i qyteteve krahas disa prej faktorëve të tilla si zhvillimi urban i pakontrolluar, mosfunksionimi i strukturave të mirëmbajtjes së kanaleve të kullimit, mosreabilitimi i argjinaturave të dëmtuara në brigjet e lumenjeve.

Rritja e shkallës së ndërgjegjësimit të popullatës nëpërmjet hartimit të planeve të menaxhimit të zonave të prira për përmbytje.

Masat më të sigurta për parandalimin, minimizimin dhe zbutjen e efekteve të padëshirueshme në jetët e njerëzve, ekonomi dhe mjedis janë parashikimi dhe lajmërimi i hershëm i përmbytjeve. Shtimi i stacioneve të vrojtimit, mirëmbajtja e rrjetit të monitorimit, rritja dhe fuqizimi i kapaciteteve njerëzore të Qendrës Kombëtare për Parashikimin dhe Monitorimin e Rreziqeve Natyrore do të ishte nga masat më të nevojshme për funksionimin me efikasitet të saj.

**AKADEMIA
E SIGURISË**

*Konferencë
shkencore
ndërkombëtare:*

« Fenomenet
ekstreme
të natyrës
dhe çështjet
e sigurisë »

Bibliografia

1. Agim Selenica: *"Përmbytjet nga lumenjtë dhe parandalimi i tyre"*, REVISTA USHTARAKE, Ministria e Mbrojtjes, Nr. 2/2010
2. Emanuela Toto, Miranda Deda, Marco Massabò Fondacionit Kërkimor CIMA Foundation: *"Mbledhja e të dhënave historike të humbjeve nga fatkeqësitë në Shqipëri"*, 2014
3. Bardhyl Shehu, Koco Karanxha, Hidrologjia inxhinierike 1, Shtëpia Botuese e Librit Universitar, Tirane 2003
4. Niko Pano, Agim Selenica, Bardhyl Shehu, *"Hidrologjia e Shqipërisë"*, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Tirane 1984
5. Leksione online të Qendres se Kerkimit Hidrologjik (HRC-USA), Elements of Meteorology, Elements of Hydrology, Flash Flood Guidance Products, 2017
6. Petra Mutic, Toni Jurlina, Milica Djordjevic, Andrej Golob: *"South East Europe Flash Flood Guidance System SEEFFGS, User Guide"*, WMO 2017
7. Petra Mutic: *"South East Europe Flash Flood Guidance (Seeffg) System"*, Second Steering Committee Meeting (SCM2), (Step-5 Training), Podgorica, Montenegro, 26–28 September 2017, Draft Report
8. Instituti Hidrometeorologjik, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, *"Klima e Shqipërisë"*, Tirane 1974



AKADEMIA E SIGURISË


*Konferencë
shkencore
ndërkombëtare:*

**« Fenomenet
ekstreme
të natyrës
dhe çështjet
e sigurisë »**

Dukuritë ekstreme meteorologjike, origjina, parashikimi dhe impaktet në jetën, ekonominë dhe sigurinë kombëtare



■Prof. Dr. Petrit ZORBA
IGJEUM, UPT
petrit.zorba@gmail



■Dr. Albana HASIMI
IGJEUM, UPT
albahasimi@gmail.com



■MSc. Elsuida HOXHA
IGJEUM, UPT
elsuida.hoxha@hotmail.com

Abstrakt

Njohja me natyrën e formimit dhe llojet e dukurive meteorologjike të mundshme, në kushtet e klimës dhe ndryshimeve të saj në Shqipëri, në kontekstin historik, por edhe hapësinor e kohor, në ditët e sotme, trajtohet pa e anashkaluar edhe influencën prej përdorimit të teknologjive të reja të aplikuara në modifikimin e motit. Dukuritë e reshjeve intensive, breshrit, dëborës, përmbytjeve, zjarreve në pyje, valëve të të nxehtit, stuhive, thatësirave, etj., kanë pësuar rritje në vitet e fundit në hapësirën e Shqipërisë. Një tërësi faktorësh natyrorë e jonatyrorë, në gërshetim apo modulim të ashpërsisë së një dukurie të caktuar meteorologjike, shpeshherë kanë përcjellë situata me mjaft pasoja për veprimtarinë ekonomike, apo dhe deri në humbje të jetëve njerëzore. Një vëmendje e veçantë i kushtohet edhe ndërlidhjes së dukurive meteorologjike me dukuri të tjera ekstreme, që në pamje të parë, nuk kanë lidhje, por më pas, pasojat negative rriten më tej. Përgatitja e shpërndarja në kohë e informacioneve dhe e parashikimit meteorologjik me institucionet përgjegjëse për emergjencat civile apo sigurinë kombëtare, paraqitet me rëndësi parësore për minimizimin e pasojave nga dukuritë ekstreme të motit. Në kontekstin e sigurisë kombëtare jepen disa mendime dhe orientime se si duhet përmirësuar puna në planin afat mesëm dhe afat gjatë me qëllim që të minimizohen sa është e mundur ndikimet nga dukuri të tilla ekstreme të motit në të ardhmen.

AKADEMIA
E SIGURISË

Konferencë
shkencore
ndërkombëtare:

« Fenomenet
ekstreme
të natyrës
dhe çështjet
e sigurisë »

Fjalëkyçe:

meteorologjia, ndryshime klimatike, modifikimi i motit, emergjenca civile, siguri kombëtare.

1. Hyrje

Dukuritë meteorologjike ekstreme në vitet e fundit kanë shënuar një rritje të theksuar, jo vetëm në hapësirën e vendit tonë. Gjithsesi duhet thënë se këto dukuri nuk janë të padëgjua dhe më parë, por problemi është se ato po vrotohen me një shpeshtësi më të lartë. Në vetvete një dukuri ekstreme meteorologjike përfaqëson një situatë kur vlerat dhe treguesit që shërbejnë për vlerësimin e saj, arrijnë nivele tjera më të larta se ecuria normale si e vlerave maksimale ashtu dhe atyre minimale, qofshin këto temperatura, reshje, erë, apo dukuri të tjera. Ndërkohë, zhvillimet demografike kanë bërë të mundur që një pjesë e popullsisë të vendoset në hapësira që karakterizohen nga këto dukuri, e për rrjedhojë ato të jenë herë pas here nën ndikimin e tyre, e më pas duke përcjellë problematika për gjithë shoqërinë. Në këtë kontekst në këtë punim synohet të jepen dukuritë meteorologjike më të njohura dhe që kanë përcjellë një rritje të ndikimeve [impakteve] negative në ekonominë dhe shoqërinë tonë si dhe duke synuar një njohje më të mirë të pasojave që ato përcjellin të jepen disa përfundime dhe sugjerime me qëllim minimizin e ndikimeve të tyre në të ardhmen.

Në ditët e sotme duhet thënë se moti nuk është më natyral, por artificial, për shkak të ndërhyrjeve në atmosferë që mjaft vende bëjnë me qëllim që të përthithin ujin prej saj duke synuar zbutjen e thatësisë në vendet e tyre, etj., etj.

Zëvendëspresidenti amerikan Lyndon B. Johnson (1908-1973) i SHBA-së, më 27 maj 1962 në një fjalim të tij në "Southwest Texas State University" tha: "Ai që kontrollon motin, kontrollon botën". Në vitin 1974 Anglia paraqiti një rezolutë në Kombet e Bashkuara me qëllim që të mos përdoren teknologjitë për modifikimin e motit për qëllime armiqësore/ushtarake. Në ditët e sotme, vende si Kina, kanë buxhete deri 30 miliard dollarë në vit dedikuar zhvillimit dhe zbatimit të teknologjive të modifikimit të motit. Australia para pak vitesh miratoi në parlament një buxhet prej 3 miliard dollarësh për modifikimin e motit. Historia modifikimit të motit nis që me luftën e Vietnamit në

**AKADEMIA
E SIGURISË**

*Konferencë
shkencore
ndërkombëtare:*

« Fenomenet
ekstreme
të natyrës
dhe çështjet
e sigurisë »

vitet 1960. Në ditët e sotme natyrisht teknikat e ndryshme dhe teknologjitë e përdorura në modifikimin e motit synojnë në dukje qëllime të mira, të cilat përmbliken në luftën kundër breshrit, thatësisë për të siguruar ujë dhe plotësuar nevojat e kulturave bujqësore me qëllimin e mirë për të siguruar ushqimin e popullsisë. Por, krahas kësaj, këto teknologji mund të përcjellin edhe të ndikojnë dhe në kahun e kundërt, duke zvogëluar reshjet në një zonë të caktuar dhe natyrisht shkaktuar thatësi, në një zonë tjetër të ndikojnë në ulje temperaturash dhe natyrisht popullatat p.sh. dhe vendet përkatëse do të jenë të detyruar të harxhojnë më shumë energji për ngrohje, etj., etj., duke prodhuar më shumë ose importuar atë, pra duke qenë më shumë në vartësi të dikujt tjetër apo duke shpenzuar më shumë.

Sot, në botë, vlerësohet se çdo investim në fushën e monitorimit meteorologjik dhe vlerësimit të klimës, arrin nga 1 me 8, në vendet në zhvillim, deri në 1 me 20 në vendet e zhvilluara, duke nënkuptuar përfitime mjaft të larta nga ekonomia në tërësi dhe rritje të mirëqenies së popullatës. Klima përbën një pasuri kombëtare dhe si e tillë ajo duhet trajtuar. Për këtë ka nevojë për vlerësim nëpërmjet matjeve dhe një monitorimi me standarde, dhe më pas vlerësimit dhe një shfrytëzim të përshtatshëm pasi ajo shërben në mjaft raste si burim i energjive të rinovueshme, siç janë energjia e erës, diellit etj., burime të cilat nuk shpëtojnë siç ndodh me hidrokarburet, apo burime të tjera energjish.

2. Dukuritë meteorologjike ekstreme në hapësirën shqiptare dhe origjina e tyre

Dukuritë meteorologjike ekstreme më të njohura dhe vrojtuar ndër vite në territorin e vendit tonë janë reshjet intensive që shoqërohen më pas me përmytje dhe dëme ekonomike apo dhe humbje jetësh njerëzore, zjarret në pyje e kullota, thatësira, reshjet e dëborës përtej disa niveleve të caktuara që shoqërohen me bllokim rrugësh dhe të qarkullimit të popullatës, si dhe dukuri të tjera që ndikimin e tyre e kanë më të lokalizuar siç janë breshëri, mjegulla, valët e të nxehtit, temperaturat e ulëta, etj.

- Reshjet intensive dhe përmytjet

Kjo tematikë është e njohur që në të shkuarën e shekujve më parë. Zona të caktuara të vendit dhe kryesisht ato pranë grykëderdhjes së lumenjve kanë qenë historikisht hapësira për t'u prekur nga përmytjet e reshjeve intensive që kanë përcjellë më pas dëme. Këtu mund të përmendim zonën e grykëderdhjes së Bunës e Drinit, Matit, Vjosës, Shkumbinit, Ishmit, Semanit, etj. Ndaj, p.sh. historikisht, në të shkuarën, për këtë qëllim banorët nuk i bënë ndërtimet në fushën e Nënshkodrës, por në zonat kodrinore pranë.



Figura nr. 1. Pamje e një përmytje në Shkodër në vitet '30.

Me zhvillimet e shoqërisë, ndërtimet e hidrocentraleve, zhvendosjet demografike, ngritjen e një sistemi ujti dhe kullimi si dhe përdorimin e tokës për qëllime bujqësore situatat ndryshuan. Gjithsesi për të mos u zgjatur, në tre dekadat e fundit janë realizuar një sërë studimesh, janë hartuar strategji, janë bërë projekte nga më të ndryshmet dhe prapëseprapë dukuritë e përmbytjeve vijnë të vrojtohen.

Ndaj del e domosdoshme para shoqërisë, individit, institucione, që sjellja e tyre të ndryshojë dhe të jetë më e ndërgjegjshme dhe të vlerësojë me drejt rrezikun dhe marrë masa në kohë për të shmangur pasojat negative kur dukuria vrojtohet. Por, duke qenë se kjo nuk ka ndodhur deri me sot dhe situatat vijnë të ngelen me pak ndryshime si në të shkuarën atëherë duhet parë se cilat duhet të jenë rrugëzgjdhjet që mund të minimizonim dëmet nga reshjet intensive (pasi nuk janë vetëm përmbytjet) dhe mos të ketë as humbje jetësh njerëzore.

Përpos faktit të shumë studimeve e projekteve për të vlerësuar se ku janë zonat me risk më të lartë e si e kur vrojtohen reshjet me 10 apo 1 për qind siguri e kur janë nivelet e lumenjve mbi një kuotë të caktuar, një herë në 100 apo 200 vjet etj., tregues teorik që përpiqen të vlerësojnë zonat dhe vendin në tërësi për këto dukuri, për aq sa dihet deri më sot, por pa pasur në konsideratë asgjë nga ato arritje teknologjike të botës së sotme, që në shumë raste e tjetërson situatën.

Ndaj, për të qenë më pragmatistë, dhe për të mos humbur kohën ende me studime e strategji të ripërsëritura ndër vite, disa herë, - jo se s' duhen, por nuk janë reflektuar me efektivitetin e duhur, - duhen ndërmarrë disa veprime më operative që dhe vendet e përparuara i praktikojnë.

Sa i takon zonave që përmbyten, mjafton t'i referohemi përmbytjes me sipërfaqen më të madhe të vrojtuar deri më sot, nga pikëpamja historike, dhe do të kishim një hartë me gjithë "hot spotet", sa i takon kësaj dukurie në territor.

Në këto zona, pikësëpari duhen marrë masa të moslejimit të ndërtimeve të mëtejshme, dhe gradualisht zhvendosjes së atyre që kanë ndërtuar pa ose me leje në këto hapësira. Kjo në bazë të disa planeve dyvjeçare apo më shumëvjeçare, do të bënte të mundur që në rast të një dukurie tjetër numri i ndërtimeve dhe banorëve të prekur, të vinte gjithnjë në rënie.

Së dyti, të gjitha objektet ekonomike ose të banimit, të realizonin një sigurim pranë kompanive të sigurimit, fillimisht dhe me mbështetjen e shtetit.

Së treti, për këto zona të kishte një sistem specifik alarmi për të bërë me dije banorët në kohë për riskun që pritet të vijë, përveç atij të ngritur nëpërmjet pushtetit lokal e qendror.

Së katërti, marrjen e masave për krijimin e hapësirave të reja bosh, të destinuara për përmbytje, krahas atyre të planifikuara kur janë ndërtuar hidrocentralet. Këto hapësira që mund të mbillen me pyje do të shërbenin si xhepa për rastin e dukurive ekstreme të reshjeve dhe përmbytjeve pranë.

Së pesti, sa i takon qyteteve, kur ndodhen nën efektin e reshjeve të shumta dhe përmbyten, ekzistojnë ide dhe teknologji, se si mund të minimizohet efekti negativ i reshjeve intensive, duke i ndërtuar rrugët në ato qytete ku janë vrojtuar problematika të tilla, me një strukturë të atillë që vetë rrugën automobilistike nën të e bën një rrugë për rrjedhjen e ujërave të tepërta në rastin e rrebesheve dhe reshjeve intensive.

Së gjashti, njohja e situatës meteorologjike dhe origjinës së reshjeve, faktorët kush i shkakton dhe arsye të tjera shkencore duhet të jenë një objekt i rëndësishëm që shteti dhe shoqëria duhet të synojnë ta kenë në kohë informacionin e duhur, ndaj duhet të

**AKADEMIA
E SIGURISË**

*Konferencë
shkencore
ndërkombëtare:*

**« Fenomenet
ekstreme
të natyrës
dhe çështjet
e sigurisë »**

investohen në kohë të mirë në këtë drejtim.

Së shtati, duhen parë se si përcillen ndryshimet klimatike në këto zona dhe cilët faktorë të tjerë e përforcojnë apo e zbusin dukurinë me qëllim ndërhyrjen në këto faktorë dhe shkaqe që në shumë raste mund të kërkojnë me pak kosto se sa veprime të tjera të përmendura më lart.

- Rezervuarët

Rezervuarët: basene hidrike të krijuar ndër vite, të cilat grumbullojnë ujërat nga reshjet e rëna në hapësirën ujëmbledhëse të tyre. Duke qene ndërtime artificiale, ato kanë një digë dhe një sistem shkarkimi, kur prurjet e shumta në to rrezikojnë ose dëmtimin e digës ose mbikalimin e saj. Ndaj kërkohet që duke qenë se këto basene kanë një kapacitet të caktuar ujëmbajtës, duke qenë se fundi i tyre me kalimin e viteve është mbushur nga mbetjet e ngurta, duke qenë se kapacitetet e tyre ujëmbajtëse në mjaft raste ngelen të vogla edhe në stinën e verës pasi ato pak ose aspak nuk përdoren për vaditje (pasi ose sistemi i ujitjes nuk është funksional dhe nuk mund të përdoret uji për vaditje, ose ato përdoren për kultivimin e peshkut dhe për rrjedhojë, uji duhet dhe nuk mund të lejohet të shkarkohet), duhet realizuar një monitorim i vazhdueshëm i tyre. Kështu në situatën e fillimit të vjeshtës (muaji shtator veçanërisht) kur mund të vrotohen reshje të larta dhe intensive ekziston një rrezik shumë i lartë për përmytje lokale apo dëmtime në zona të kufizuara, por që mund të jetë me pasoja katastrofike. Në këtë rast mund të përmendim një situatë përmytje të pak viteve më parë, kur doli dhe peshku në autostradën Tiranë - Durrës, pikërisht se mungonte një mirëmenaxhim i këtyre rezervuarve në përputhje me disa standarde teknike, dhe nuk u mbajtën në konsideratë, parashikimet meteorologjike. Për më tepër, duhet thënë se në atë rast reshjet intensive nuk ishin aty më të përqendruara, por në fillimet e pellgut ujëmbledhës në Shëngjergj.

Duhet thënë se lumenjtë e Shqipërisë janë të shkurtër në tërësi, dhe në rastin e një reshjeje me intensitet të lartë në fillim të rrjedhjes së tyre, përfundon me shpejtësi në grykëderdhje; ndryshe nga lumenjtë e mëdhenj në Europë, që kanë basene të mëdha dhe për rrjedhojë një ngritje e nivelit të tyre reflektohet me vonesë dhe ka kohë për të reaguar. Për më shumë, duke qenë se lartësia mbi nivelin e detit të vendit tonë është sa dyfishi i asaj të kontinentit, rrjedhja ujore është më e shpejtë dhe shpesh merr natyrën e përrenjve.



Figura nr. 2. Paraqitje skematike se ç'ndodh me rezervuarët kur ato nuk monitorohen dhe mirë administrohen në përputhje me standardet teknike.

Në ditët e sotme, ka shumë rezervuare me kapacitete më të ulëta ujëmbajtëse, pasi fundi i tyre është mbushur dhe ngritur; së dyti nuk përdoret për vaditje, dhe uji i ngelur aty deri në gusht për arsye peshkimi gjithashtu redukton kapacitetin ujëmbajtës,

e për rrjedhje, nëse në shtator kemi reshje intensive, atëherë mospasja e mundësive për t'i mbajtur këto rrjedhje sipërfaqësore në basenin që ato kanë, do të bëjë që reshjet të vijnë në rrjedhje sipërfaqësore dhe të kryhen shkarkime për të mos rrezikuar shembje të digave. Mospërdorimi i ujit për vaditje nuk lidhet vetëm me përdorimin e këtyre ujërave, kostoja e ujit gjithashtu është një pengesë tjetër për fermerët.

- *Thatësira*

Thatësira: përfaqëson dukurinë e kundërt me reshjet intensive që në raste të veçanta përcjellin dhe përmbytje. Në këtë rast kemi të bëjmë me mungesë të reshjeve për një periudhë kohe të gjatë duke shkaktuar situatë thatësire meteorologjike, bujqësore, hidrologjike, social ekonomike, etj.

Në tërësinë e këtyre llojeve të thatësirës natyrisht, ato paraqiten me interes në vartësi të stinës (periudhës kohore) kur vrojtohen dhe hapësirës që prekin. Për të minimizuar efektin e tyre, veçanërisht në fushën e bujqësisë, njerëzimi ka marrë masa duke zbatuar sisteme të ndryshme ujitje, të përmirësuar ndër vite. Por, në vitet e fundit, në mjaft vende, përdoren dhe teknika të modifikimit të motit, të cilat synojnë që nga tipa resh të caktuara (kryesisht ato të ulëta, *cumulonimbus*, etj.) me përmbajtje të lartë ujore dhe tregues të tjerë të përshtatshëm që mund të lejojnë të provokohen rënie reshesh në rajone të caktuara.

Në kushtet e vendit tonë dikur ka pasur të ngritur një sistem ujitje dhe kullimi funksional për një pjesë të madhe të Ultësirës Perëndimore, fushën e Korçës, etj., i cili mundësonte një zbutje të problematikës në periudhën e vegetacionit dhe plotësonte nevojat e bujqësisë për vaditje. Ky sistem bazohej në krijimin e një sasie rezerve të ujërave të reshjeve të periudhës së lagët të vitit nëpërmjet ndërtimit të mbi 650 rezervuarve artificiale. Shumica e rezervuarëve janë aty dhe sot. Por mos funksionimi i sistemit të vaditjes dhe kullimit në të dy rastet përcjell problematika me ndikim negativ për fermerët dhe zonat përkatëse. Si kur ka reshje intensive, vështirësohet largimi i ujërave, ashtu dhe në rastin e periudhës së ngrohtë, kur kërkohet ujë për vaditje.

Problematika në dukje e thjeshtë për t'u zgjidhur, por ende pa përgjigjen e duhur në nivel të lartë të shtetit, ka mundësuar që fermerët në këndvështrim të ngushtë e pragmatist për interesat e tyre lokale të gjejnë rrugë të tjera për vaditje. Deri këtu nuk ka ndonjë gjë të keqe, por cilat janë pasojat në një këndvështrim me afat gjatë, për të cilën asnjë nuk kujtohet. Fermerët në Myzeqe, kryesisht nëpërmjet instalimit të pompave në sipërfaqet e tyre bujqësore, nxjerrin ujin nga nëntoka duke e përdorur atë për vaditje dhe duke plotësuar nevojat e bimëve të kultivuara. Ndërkohë, dukuria që ka filluar të vrojtohet është interesante. Ujërat nëntokësore të sjella mbi sipërfaqe falë pompave, kanë pësuar një rënie të nivelit të tyre atje poshtë. Rënia e nivelit të ujërave freatike nëntokësore, ka mundësuar një depërtimin të ujëra të detit nën tokë duke bërë që ujërat e kripura të detit të fillojnë e të penetrojnë gjithnjë e më shumë në këto nivele nëntokësore në tokat që janë larg vijës bregdetare.

Më pas procesi vijon e thellohet më tej, me dukurinë e kripëzimit të tokave në sipërfaqe, pasi pompat tashmë nuk thithin më ujëra të ëmbla, por ujëra me kripshmëri më të lartë dhe e shpërndajnë atë mbi tokat bujqësore, duke i kripëzuar gradualisht ato dhe një ditë të bukur ato nuk do të jenë më të përshtatshme për kultivimin e bimëve, për shkak të nivelit të lartë të kripshmërisë arritur. Një paraqitje skematike është dhënë në figurën nr. 3.

AKADEMIA E SIGURISË

Konferencë
shkencore
ndërkombëtare:

« Fenomenet
ekstreme
të natyrës
dhe çështjet
e sigurisë »




Figura nr. 3. Procesi i kripëzimit të tokave bujqësore pranë zonës bregdetare në Ulëtisrën Perëndimore, si pasojë e shfrytëzimit të ujërave nëntokësore për ujë.

Kësisoj me kalimin e viteve këto toka do të kthehen në hapësira shkretëtire, pasi bimësia do e ketë të vështirë për t'u rritur e zhvilluar në toka të kripura. Kësisoj në një moment jo shumë të largët kohor, parashikojmë që në këto territore do të kemi humbje të tokës bujqësore dhe shenjat e para të shkretëtirave. Kjo dukuri do të favorizohet më tej edhe nga ndryshimet klimatike dhe ngrohja globale duke e bërë më të shpejtë këtë proces të shkretimit të tokave bujqësore në këto hapësira. Kjo situatë kërkon ndërhyje në nivele të larta nga institucionet e shtetit, ose mirëmbajtjen e sistemeve të vaditjes, ose ndalimin e këtyre praktikave duke gjetur zgjidhje të tjera teknologjike.

- Zjarret në pyje

Zjarret në pyje: një dukuri që lidhet kryesisht me periudhën e verës, dhe temperaturat e larta të ajrit, dhe të sipërfaqes së tokës, ka përcjellë herë pas here dëme të mëdha në ekonominë pyjore. Zyrtarisht pranohet kudo në botë, se zjarret në 99% të rasteve e kanë origjinën nga faktori njeri, i cili me veprimet e tij, të qëllimshme ose jo, është bërë burimi i mjaft zjarreve jo vetëm në hapësirat pyjore, por dhe në ato urbane. Pavarësisht nga arsyet se si fillojnë zjarret, duhet thënë se ato lidhen dhe me sektorë të tjerë të veprimtarisë njerëzore siç është turizmi, ku konkurrenca për tregje, etj., gjatë sezonit turistik ndikon në nxitjen e kësaj dukurie me qëllim ndryshim të orientimit të fluksit turistik. Zjarret mund të fillojnë dhe shuhen lehtë kur nuk ka erë, por ato përhapen shpejt kur kombinohen edhe me erë, qoftë dhe në vlera mesatare. Duhet thënë se në periudhën e verës temperaturat arrijnë vlera deri në 60°C në sipërfaqen e tokës, apo deri 70°C në vendmatjet meteorologjike. Këto vlera mundësojnë vetëdëzjen e lëndës organike dhe fillimin e zjarrit në vatra të caktuara aty ku ka lëndë organike të thatë, siç janë parcelat e ngelura me mbetje të tilla pas korrijës së grurit (kashtë), por dhe në zonat pyjore, ku vatra bosh, pa pemë (pikërisht për këtë nuk duhen prerë pa leje pyjet), të cilat kanë mbetje drusore të thata dhe nëse i krijohen kushtet për vetëdëzje, mundësojnë zjarre në mjediset pyjore edhe pa prezencën e njeriut.

Monitorimi meteorologjik i këtyre zonave është shumë i rëndësishëm jo vetëm për të vlerësuar situatën nga pikëpamja e potencialit që krijohet për zjarre, për hir të ecurisë së elementeve të caktuar meteorologjike, por dhe në rastin kur kjo dukuri vrojtohet,

duhet ndjekur me vëmendje ecuria e erës dhe treguesve të tjerë meteorologjikë për ta pasur sa më në kontroll situatën.

Ndaj, sigurimi i një monitorimi meteorologjik dhe pasja në dispozicion, në kohë, e një informacioni dhe vlerësimi parashikues për situatën e pritshme meteorologjike, është i një rëndësie parësore në lidhje me këtë dukuri.

- Valët e të nxehtit, temperaturat e ulta

Valët e të nxehtit, temperaturat e ulëta janë situata të përkohshme meteorologjike, të cilat në vendin tonë janë vrojtuar jo shpesh, por si në periudhën e verës ashtu dhe në dimër, - sidomos këto të kësaj stine, - kërkojnë ndërhyrjen e organeve të pushtetit lokal për strehimin e përkujdesjen ndaj njerëzve të pastrehë apo atyre që ndikohen nga temperaturat e ulëta. Treguesi i “windchill”, i vlerësuar në vendin tonë, paraqet vlera dhe prani të situatave me nivele të ashpërsisë dimërore problematike për zonat e larta dhe VL e JL të vendit, ku nuk duhet harruar se në disa raste, situatat e krijuara paraqiten me ndikime negative për sektorin e blegtorisë.

- Reshjet e dëborës

Reshjet e dëborës: janë një dukuri normale në periudhën e ftohtë të vitit. Por, në kushte të caktuara ato vrojtohen me nivele të larta. Në vitet e fundit treguesit e numrit të ditëve me dëborë dhe të numrit të ditëve me shtresë dëborë kanë shënuar ulje. Gjithsesi problematika që do përcjellim ka të bëjë me rivlerësime që duhen bërë për klimën e zonave të caktuara dhe moslejimin e investimeve për projekte që synojnë shfrytëzimin, apo ngritje të rezorteve turistike për të përdorur praninë e dëborës, ndërkohë që ajo nuk është ende më, si më parë në sipërfaqe, kohështrirje dhe trashësi. Këtë e theksojmë, duke u nisur nga fakti se edhe shumë vepra hidroenergjetike (hidrocentrale të vegjël), janë projektuar mbi baza të gabuara dhe tani rezultojnë se s’kanë ujë, pasi nuk kanë më reshjet e mëparshme, e për rrjedhojë kanë degraduar zonat pranë me praninë e tyre, e për më tepër, edhe vetë nuk janë aq efektive sa duhej të ishin, sipas projektimit fillestar, që i referohen në shumicën e rasteve të dhënave të viteve ‘50 apo ‘60.

- Breshëri

Breshëri: është dukuri që herë pas here përcjell dëme në sektorin e bujqësisë, transportit rrugor, etj., duke shkaktuar dëme në kulturat bujqësore apo automjetet. Në këto raste zgjidhja është gjetur nëpërmjet politikës së sigurimeve si për kulturat bujqësore ashtu dhe automjetet. Por, në bujqësi, përdoren dhe teknika të mbrojtjes ndaj breshrit, të cilat kanë siguruar mbrojtjen automatike të drufrutoreve dhe prodhimit të tyre duke mënjeluar humbje të mëdha ekonomike. Një shembull pozitiv është situata e fermerëve të Korçës, që vitin e kaluar shpëtuan prodhimet e tyre nga drufrutoret për shkak të aplikimit të kësaj teknologjie të mbrojtjes nga breshëri, ndërkohë që po vjet, plantacionet me agrume në skajin jugor të vendit pësuan dëme të pallogaritshme pikërisht nga kjo dukuri. Ndaj orientimi i investimeve të fermerëve në bujqësi, duhet të jetë një prioritet nga qeveritë për mbrojtjen e ekonomisë së individit, por dhe të shoqërisë. Ndaj orientimi i investimeve të fermerëve në bujqësi duhet të jetë një prioritet nga qeveritë për mbrojtjen e ekonomisë së individit, por dhe të shoqërisë. Deri më tani kjo nuk është bërë në nivelin e duhur ndaj dhënia e disa ideve dhe mendjeve shkencore do të ishte me interes të shumanshëm, përkundër asaj

**AKADEMIA
E SIGURISË**

*Konferencë
shkencore
ndërkombëtare:*

« Fenomenet
ekstreme
të natyrës
dhe çështjet
e sigurisë »

në se nuk bëhet një gjë e tillë dhe qëndrohet indiferent.

- Mjegulla

Mjegulla: në dukje një element pa rëndësi paraqitet me interes të veçantë në transportin rrugor dhe ajror. Në shumë raste informimi i popullatës për situatën e mjegullës në rrugë si dhe udhëzimeve të tjera do të mundësonin mos humbjen e jetëve njerëzore dhe aksidenteve që ndodhin shpesh për shkak të këtij faktori meteorologjik. Në aeroporte kjo dukuri trajtohet me një seriozitet të veçantë, pasi në zona të caktuara të vendit, mjegulla, në vartësi të kushteve meteorologjike, mund të bëhet shkak për aksidente, ndërkohe ajo bëhet edhe burim i uljes së efektivitetit të investimeve, kur në aeroporte pa sisteme moderne të uljes automatike, mjegulla bëhet kushtëzuese për mosuljen e avionëve. Kjo dukuri duhet pasur në konsideratë dhe vlerësuar drejt për aeroportet e reja që synohen të ndërtohen. Gjithashtu mjegulla është një element tjetër që ndikon në paralizimin funksional të pajisjeve vëzhguese në objektet e sigurisë së lartë, ku prania e saj i nxjerr jashtë funksionimit sisteme të tilla monitorimi, ndonëse mund të mos i mungojë as energjia, as interneti, etj. Një shembull tipik është ai ku për mjediset e pikës fundore të TAP në sistemet e sigurisë së objektit janë mbajtur në konsideratë dhe informacionet mbi mjegullën në zonë. Kjo dukuri duhet të mbahet në konsideratë të veçantë për aeroportin e Kukësit. Në aeroporte me shumë lëvizje, në botë, kanë instaluar sisteme për shpërndarjen e mjegullës në hapësirën aeroportuale, natyrisht kundrejt një kostoje, kur bëhet fjalë për ngritje ulje të shpeshta nga pista.

- Hapësira ajrore

Hapësira ajrore e vendit tonë është një mjedis me mundësi për dukuri ekstreme që lidhen jo vetëm me mjegullën, por dhe me praninë e zogjve në atmosferë. Kjo dukuri duhet mbajtur në konsideratë për aeroportin e Vlorës, pasi jo shumë larg saj është laguna e Nartës dhe prania e zogjve nuk mund të mënjanohet. Në këtë kontekst duhet thënë se në aeroporte të ndryshme europiane që kanë këtë problematikë janë instaluar sisteme mbrojtje, që kanë një kosto prej rreth 2.5 milion euro për t'i mbajtur funksional.

Hapësira ajrore e vendit tonë është një burim të ardhurash, që nëse do të kishte një monitorim më të mirë meteorologjik në profil vertikal, dhe në atë sipërfaqësor, do të mund të sillte të ardhura gati tre herë më të larta krahasuar me ato sot. Kjo të mundësonte, që nga rreth 1 mijë mbikalime në ditë të arrihej në 3 mijë, duke siguruar nga mbi 30 milion dollarë (USD) të ardhura në vit, deri në gati 90 milionë, dhe në një përlllogaritje të thjeshtë, për një periudhë dhjetëvjeçare, një vlerë një miliard dollarë (USD); kjo do të ishte një e ardhur kombëtare që mund të ndihmonte për kushte jetese të popullsisë mjaft më mirë nga ajo e sotmja, pasi këto të ardhura mund të investoheshin në mjaft sektorë të tjerë, të cilët gjithashtu do të ishin pjesë e një zinxhiri me përfitime dhe rritje të së ardhurave të mëtejshme në sektorë, siç janë, turizmi, bujqësia e transporti. Po përse duhet ky informacion meteorologjik për këtë hapësirë të atmosferës, që ndodhet mbi vendin tonë? Pikërisht për të parandaluar situata të papërshtatshme dhe dukuri meteorologjike të dëmshme për aviacionin, ku kompanitë paguajnë që në rrugëkalimin e avionëve të tyre të kenë siguri më të lartë³.

- Hapësira detare

Hapësira detare e Shqipërisë me një vijë bregdetare prej 276 km është gjithashtu një mjedis ku informacioni meteorologjik është shumë i nevojshëm për transportin detar.

Shpesh janë kushtet meteorologjike që bëhen problematike në porte dhe mospasja në kohë e informacionit të duhur përcjellë pasoja negative dhe rrezik për jetën e njerëzve apo dhe dëmtime në anijet. Por jo vetëm kaq, hapësira detare është dhe një mjedis me potencial të lartë energjetik. Me teknologjitë e reja shumë vende shfrytëzojnë energjinë e valëve të detit. Natyrisht dhe kjo kërkon studime dhe vlerësime me qëllim që këto resurse të mos ngelen të pashfrytëzuara.

3. Parashikimi i dukurive ekstreme meteorologjike: fuqizimi i institucioneve përgjegjëse dhe i “sistemit kombëtar të monitorimit meteorologjik”

Përgatitja dhe mundësimi i informacioneve ditore, dhe në raste dukurish ekstreme të motit dhe më të shpeshta në vitet e fundit, nga IGJEUM, është mundësuar një informacion mjaft ndihmues për vendimmarrjen e institucionit të emergjencave civile, e po ashtu, edhe për marrjen e masave në kohë nga pushteti lokal, apo për ato institucione, që kanë për detyrë informimin e popullatës, ashtu si dhe dërgimin e ndihmës në raste të caktuara. Në vijim, një rast me situatë problematike e përcjellë për qarkun Shkodër, në datë 18 nëntor 2014, është e paraqitur në figurën nr. 4, ku vihen re reshje të pritshme në nivele deri mbi 120mm në 24 orët në vijim. Përgjithësisht këto situata kanë përcjellë gjithnjë përmbytje dhe dëme ekonomike apo humbje jetësh njerëzore. Ndaj fuqizimi në këtë drejtimin i institucioneve të monitorimit meteorologjik dhe përgatitjes së këtyre buletineve, janë një ndihmesë e rëndësishme për minimizimin e pasojave.




Figura nr. 4. Paraqitje e situatës së pritshme me reshje në datën 18 nëntor 2014.

4. Ndryshimet klimatike dhe si përcillen ato, - sa i takon jo vetëm dukurive ekstreme, - në hapësirën e vendit tonë

Tashmë, pranohet nga kushdo se klima në vendin tonë ka ndryshuar dhe nuk është si më parë. Pyetja është *sa* dhe *si*. Në këtë kontekst, duhet thënë se disa tregues të analizuar dhe të pasqyruar për disa muaj, prej 5 vitesh, jepen në një buletin shkencor mujor klimatik, në një tablo të detajuar të këtyre ndryshimeve, të cilat mund të përcillen si vijon:

Shqipëria ka pësuar një zhvendosje me 2 gradë gjerësi gjeografike në drejtim të jugut, pra një klimë më e ngrohtë dhe me karakteristika më subtropikale se më parë.



Figura nr. 5. Paraqitje skematike e "zhvendosjes" së karakteristikave klimatike për Shqipërinë.

Shqipëria për pozicionin fiziko-gjeografik që ka, ndodhet në shumicën e rasteve në periferinë e influencës së masave ajrore që mbizotërojnë dhe karakterizojnë motin mbi kontinent, si të atyre që vinë nga pjesa VP apo VL e po ashtu dhe nga masat ajrore që vinë nga kontinenti afrikan. Kështu, duhet thënë se vendi ynë, në analizën mujore rezulton që të ketë qenë nën një ndikim më të moderuar si në rastet e masave ajrore të ftohta me origjinë siberiane, në periudhën e dimrit, që ndonëse për ne, në dukje kanë qenë dukuri, le të themi ekstreme e me temperatura të ulëta, në fakt, kur situata shihet në shkallë kontinentale, vihet re se Shqipëria është ndodhur në periferi të tyre. Këto masa dhe periferia e tyre, jo vetëm që kanë qenë të pranishme për një periudhë më të shkurtër kohore, por edhe vlerat kanë qenë me një ashpërsi më të vogël, duke përcjellë dhe dëme mjaft më të ulëta përkundrejt atyre të vërtetuara në zonat e tjera të kontinentit.

Nga pikëpamja klimatike kemi një periudhë vegjetacioni më të zgjatur me rreth 1 muaj si dhe një potencial më të lartë të burimeve agroklmatike të ngrohtësisë me rreth +20% më shumë.

AKADEMIA
E SIGURISË

Konferencë
shkencore
ndërkombëtare:

« Fenomenet
ekstreme
të natyrës
dhe çështjet
e sigurisë »

- Netët tropikale

Netët tropikale: një tregues tipik që evidenton një klimë, e cila përcjell gjithnjë e më shumë karakteristika të klimës subtropikale është reflektuar dhe me një rritje të treguesit të netëve tropikale (net me temperatura të ajrit mbi pragu 20.0°C) për gjithë muajt e stinës së verës. Për ilustrim jepet një panoramë e këtij treguesi për Tiranën në figurën nr. 6.




Figura nr.6. Treguesi i numrit të netëve tropikale për muajin gusht për vendmatjen meteorologjike të Tiranës dhe ecuria për periudhën 2002+2020 si dhe vlerat e normës.




Figura nr. 7. "Rrëshqitja" e motit dhe stinëve në kohë me impaktin e ndryshimeve klimatike.

- Rrëshqitja e stinëve

Rrëshqitja e stinëve: ndërkohë një karakteristikë tjetër është se në vitet e fundit vrojtohet një rrëshqitje e stinëve dhe e muajve. Muaji më i ngrohtë gjatë vitit të fundit rezultoi gushti, ndërkohë historikisht nga pikëpamja klimatike muaji më i ngrohtë ka qenë korriku. Në figurën nr. 7, bëhet një paraqitje skematike e kësaj situatë.

Gjithashtu duhet thënë se sipas projeksioneve të qendrave shkencore të kësaj fushe një klimë me karakteristika më subtropikale është e prirë të ketë masa më të ngrohta ajrore, me kapacitet ujëmbajtës më të larta e për rrjedhojë në raste shkarkimi të lagështisë së saj për arsye kondensimi kur pëson lëvizje adiabatike dhe ngritje në lartësi, mundësitë janë më të mëdha për të prodhuar reshje intensive. Praktikisht projeksionet e klimës së të ardhmes për gjerësitë gjeografike ku është vendi ynë paraqesin një situatë që do të përcjellë një stinë vere më të zgjatur dhe me netë tropikale që kanë filluar të shfaqen dhe në muajt maj e shtator përveç atyretë verës ku ka shënuar rritje, si dhe me situata rrebeshesh në orët e mesditës.

- Dimri

Dimri do të vijojë të paraqitet me një stinë më të shkurtër dhe me karakteristika "të shkërmoqura" sa i takon uljes së temperaturave, pra më pak i ashpër, me reshje intensive dhe me një raport të ndryshuar në favor të reshjeve të shiut si dhe zvogëlim të reshjeve të dëborës. Nga ana tjetër ditët me dëborë shënojnë ulje dhe po ashtu dhe treguesi i kohëzgjatjes në ditë të shtresës me dëborë, pasi përshpejtohet procesi i shkrirjes për shkak të temperaturave më të larta.

**AKADEMIA
E SIGURISË**

*Konferencë
shkencore
ndërkombëtare:*

« Fenomenet
ekstreme
të natyrës
dhe çështjet
e sigurisë »

- Viti

Viti: në kontekst vjetor evidentohet një prirje për uljen e reshjeve sa i takon numrit të ditëve me reshje por sa i takon numrit të ditëve me reshje mbi pragje të larta 20 apo 30 mm shënon rritje, që do të thotë një mot me pak ditë me reshje, por me më shumë raste / ditë kur reshjet do të jenë në formë rrebeshi dhe intesitete të larta. Mefjalëtë tjera me mundësi më të larta për të shkaktuar situata problematike në zona të caktuara.

5. Teknologjitë e reja, projektet në fushën e “modifikimit të motit” dhe rëndësia e tyre në zmadhimin apo minimizimin e efekteve, dhe pasoja që do të përcjellin dukuritë meteorologjike ekstreme

Në vitet e fundit gjithnjë e më shumë teknika dhe platforma përdoren për modifikimin e motit, natyrisht në dukje me synimin e mirë për të përfutur reshje nga masat e atmosferës që kalojnë në vendin që e përdor këtë teknologji. Në fakt në dukje synimi i mirë mund të degradojë dhe në anën e kundërt kur teknologji të tilla të mund të bëjnë të kundërtën për vendet ku synohen interesa të caktuara ekonomike dhe politike.

Në këtë kontekst po përcjellim dukuri atmosferike ekstreme me pasoja dhe dëme që kanë shoqëruar dukuri të tjera negative me ndikime negative siç është rasti i ngjarjes së vërtetuar dy ditë pas tërmetit të datës 21 shtator 2019, ku në fakt përkundrejt ecurisë normale dhe asaj të pritshme në normalitetin e zakonshëm të lëvizjes së masave ajrore dhe në përputhje me parashikimet të reshjeve për 24 orët në vijim (kategori parashikimi që ruan në ditët e sotme besueshmëri të lartë deri 99%) është vërtetuar një rrëshqitje (*shifting*) në hapësirë dhe reshjet nga zona VP e vendit ku priteshin deri në 200 mm në 24 orë, vërtetohen pikërisht mbi dhe pranë zonës së prekur dy ditë më parë nga tërmeti⁴.




Figura Nr.8. – Vierat e reshjeve të pritshme për 24 orët në vijim më datë 23 shtator 2020 ora 07:00 UTC për territorin e vendit tonë sipas SEEFFG (A), reshjet e vërtetuara me date 24 shtator 2019 (B) si dhe izohietat dhe dendësia e popullsisë (C).

Një shembull tjetër interesant është fakti që dallon dhe në shkallë kontinentale si zonën më të ftohtë në dhjetor të vitit 2019 jo Siberiane, as vendet nordike si Suedi, Finlandë, etj., që në çdo dimër shënojnë vlera mjaft të ulëta deri në minus 20 apo dhe -30°C, por një zonë pranë vendit tonë hapësirën e Kosovës. Këtu nuk bëhet fjalë për treguesin e anomalive negative, por për vlerat absolute të vërtetuara dhe pasqyruara dhe në imazhet satelitore të institucioneve të njohura. Në vijim paraqiten hartat përkatëse me situatat e vërtetuara për datën 4 janar 2020 në shkallë kontinentale ku evidentohej hapësira e Kosovës me këto vlera mjaft të ulëta⁵.

Për këtë qëllim është shkëputur për ilustrim një vlerësim në lidhje me ndërlikimin që ekziston midis konsumit të energjisë së popullatës dhe situatës së temperaturave të ulëta. Ky korrelacion i lartë dëshmon se në këto raste kërkohet një sasi më e madhe energjie për konsum për ngrohje.




Figura nr. 9. Ndërlidhja midis konsumit të energjisë dhe konsumit të energjisë elektrike (A) dhe situata e temperaturave të ajrit më datë 4 janar 2020 (B) në kontinentin European sipas NOAA-s, paraqitur në Buletinin Mujor Klimatik Nr.37, 2020.

Situatat në fjalë, duken se nuk përcjellin karakteristika normale që do të duhej të kishte atmosfera në këto zona dhe këto momente kohore, në përputhje dhe me atë çka mund të quhet normalitet të shpërndarjes hapësinore të temperaturave apo reshjeve, referuar ligjësisë natyrore që ato ndjekin. Ndaj, në këtë drejtim, studime të veçanta për këto dukuri “jashtë normalitetit” kërkojnë një mbajtje në konsideratë të mendimit dhe sugjerime të caktuara shkencore, të cilat mundësojnë hulumtimin e pistave të reja të mbrojtjes dhe marrjes së masave për një mbrojtje nga këto dukuri të cilat mund të mos jenë natyrore, por pasojë e përdorimit të teknologjive të modifikimit të motit nga vende të caktuara në kontinent.

6. Përfundime

- Çdo investim në fushën e meteorologjisë shoqërohet me një raport deri në 1 me 20 për përfitimet që përcillen në ekonominë dhe shoqërinë e një vendi. Pra nëse investohet një milion dollarë vendi përfiton deri në 20 milionë dollarë, që përkthehet në mos

AKADEMIA
E SIGURISË

Konferencë
shkencore
ndërkombëtare:

« Fenomenet
ekstreme
të natyrës
dhe çështjet
e sigurisë »

humbje dhe mënjanim të dëmeve ekonomike, pa folur dhe për mbrojtjen e jetëve njerëzore.

- Fuqizimi i institucioneve të monitorimit meteorologjike dhe vlerësimit të klimës së vendit tonë dhe hapësirave pranë duhet të jetë një prioritet urgjent i shtetit, nëse duam të kemi një zhvillim të qëndrueshme dhe afatgjatë të ekonomisë dhe prosperitetit të jetës së qytetarëve të këtij vendi.

- Strategjitë e zhvillimit në degë të ndryshme të ekonomisë duhet të mbajnë në konsideratë dhe mendimin dhe vlerësimin shkencor institucional mbi klimën dhe ecurinë e elementeve të ndryshme meteorologjik si në aspektin e dukurive ekstreme por dhe për një shfrytëzim sa më të drejtë të këtij potenciali të madh që ofron natyra e vendit tonë.

Bibliografia

1. *Klima e Shqipërisë*, ASH-IHM, 1975 - Tiranë.
2. *Veçoritë Klimatike të Ultësirës Perëndimore*, ASH-IHM, 1986 - Tiranë.
3. *Aviation Hazards*, WMO/TD-No. 1390, Geneve, 2007
4. *Buletini mujor klimatik* Nr. 33, shtator 2019
5. *Buletini mujor klimatik* Nr. 37, janar 2020
6. Comprehensive analysis of disaster risk reduction and management system for agriculture in Albania, FAO 2018.
7. *Dëmet e shkaktuara nga fatkeqësitë natyrore në Shqipëri*, shtator 2018 - REC.
8. *Dokumenti Strategjisë - Dëmet e shkaktuara nga fatkeqësitë natyrore në Shqipëri*
9. *Historical Collection of Disaster Loss Data in Albania*.
10. P. Zorba, A. Hasimi e Çomo, "Climate Change Impact On NW Albania Reflected on Rainfall Regime". *IUNES* pg 49-53 Vol 14 No 2 (2020)
11. A. Hasimi & K. Zaimi, "Practical use of information and outputs of Southeast Europe Flash Flood Guidance System for Albania". *Global Flash Flood Guidance System (FFGS) Workshop* Antalya, Turkey 4-8 November 2019.



AKADEMIA E SIGURISË

*Konferencë
shkencore
ndërkombëtare:*

**« Fenomenet
ekstreme
të natyrës
dhe çështjet
e sigurisë »**

NATO, në operacionet e ndihmës në rastet e katastrofave natyrore



■Dr. (proc.) Gjon VORFI

Lektor/kërkues shkencor,
QKSH, Akademia Sigurisë
gjon.vorfi@aspo.gov.al

Abstrakt

Fatkeqësitë natyrore po ndodhin më shpesh dhe po bëhen gjithnjë e më shkatërruese. Pas kësaj prirjeje, Aleanca e Atlantikut të Veriut (NATO) ka rritur rëndësinë e angazhimit të forcave të saj në ndihmën ndërkombëtare në raste katastrofash natyrore. Si pasojë e këtij angazhimi, ka pasur reagime nga kritikët, të cilët kanë shprehur dyshime mbi operacionet e ndihmës ndaj fatkeqësive. Qëllimi i këtij artikulli, nuk është të ndalemi në tërë veprimtarinë e gjerë të Aleancës, por të evidentojmë, se përfshirja e forcave të NATO-s në operacionet e ndihmës ndaj katastrofave, është në përputhje me parimet themeluese të Aleancës. Një përmbledhje literature, mbështetur në studimin e disa rasteve, tregon se përfshirja e NATO-s në operacionet ushtarake që nuk përfshijnë përdorimin e forcës (MOOTW- Military Operations Other Than War), në ndihmë humanitare, në rast katastrofe, është e rëndësishme dhe e përshtatshme. Megjithatë ka akoma fusha për përmirësim, ajo është një vlerë e shtuar por, mbi të gjitha ajo është efektive. Për të ilustruar argumentet e këtij shkrimi, kemi marrë shembullin konkret të angazhimit në vitin 2005 të forcave të NATO-s, pas një tërmeti të madh në Pakistan. Pas kërkesës për ndihmë të qeverisë pakistaneze (nëpërmjet Kombëve të Bashkuara), Aleanca dërgoi menjëherë në vendngjarje Forcat e Reagimit të NATO-s (NATO Reaction Force - NRF), të cilat u angazhuan më sukses më të gjitha mjetet logjistike dhe njerëzore në një operacion humanitar të përmasave të mëdha.

AKADEMIA
E SIGURISË

Fjalëkyçe:

NATO, logjistika ushtarake, fatkeqësitë natyrore, ndihma humanitare, Forcat e Reagimit të Shpejtë të NATO-s, Pakistani.

Konferencë
shkencore
ndërkombëtare:

« Fenomenet
ekstreme
të natyrës
dhe çështjet
e sigurisë »

1. Hyrje

- Politikat e NATO-s në lidhje më pjesëmarrjen e forcave të saj ushtarake në operacionet e ndihmave ndaj katastrofave në kohë paqe

Fatkeqësitë natyrore janë një ndërprerje e menjëhershme fizike e dhunshme në funksionimin e një komuniteti, që shkakton dëme ekonomike, njerëzore, materiale dhe mjedisore, duke rezultuar në një numër të madh të vdekjeve dhe lëndimeve, si dhe tejkalon aftësitë e shoqërisë për të përballuar situatën vetëm me përdorimin e burimeve të veta. Një katastrofë mund të jetë natyrore ose e bërë nga njeriu, por objekt i studimit tonë janë në veçanti ato natyrore. Katastrofat natyrore përfshijnë katastrofa me fillim të ngadaltë, graduale, të tilla si thatësira dhe uria, ose me fillim të papritur, të tilla si tërmetet, cunami dhe përmbytjet¹.

Përfshirja e NATO-s në ndihmën ndërkombëtare të katastrofave ka një histori të gjatë. Që nga krijimi i Aleancës në 1949, NATO-ja e ka vënë gjithnjë theksin te mbrojtja e popullatës. Përballë një kërcënimi të mundshëm të luftës, e cila mund të përfshijë armë bërthamore, Aleanca filloi të zhvillonte masa të ndryshme në fushat e mbrojtjes civile.

Mes vendeve anëtare të NATO-s ekzistojnë marrëveshje të veçanta që lehtësojnë operacionet e mbështetjes në raste katastrofash. Bashkëpunimi është organizuar paraprakisht me hartimin e marrëveshjeve të standardizimit të NATO-s (STANAGs). Shumë vende që kanë nevojë për ndihmë në raste katastrofash por që nuk kanë marrëveshje bilaterale të vendosura me parë, bazuar në situatën që ndodhen, mund të

¹ Wassenhove, V. L. 2006. 'Humanitarian aid logistics: supply chain management in high gear'. Journal of the Operational Research Society: 475-489.

kërkojnë të vendosin marrëveshje të tilla. Kjo, për faktin se strukturat logjistike të forcave të reagimit të shpejtë të Aleancës ofrojnë një potencial të madh të përdorimit të dyfishtë. Kjo do të thotë, se forcat logjistike, përveç misionit parësor për operacione të mirëfillta luftarake, mund të përdoren edhe në operacione ushtarake joluftarake (MOOTW), të tilla, si mbrojtja civile ose ndihma humanitare në raste të fatkeqësive natyrore.

Në këtë punim nuk do të flasim për veprimtarinë e Aleancës në tërësi, por do të ndalemi në veçanti, të politikat, procedurat dhe shembuj nga përfshirja e forcave të NATO-s në operacionet e ndihmës ndaj katastrofave, si dhe të evidentojmë faktin se kjo veprimtari është në përputhje me parimet themeluese të Aleancës. Shumë shpejt për vendet e NATO-s bëhet e qartë se aftësitë për të mbrojtur popullatat tona kundër efekteve të luftës mund të përdoren gjithashtu për t'u mbrojtur edhe nga efektet e katastrofave. Në vitin 1951, NATO-ja krijoi Komitetin e Mbrojtjes Civile për të mbikëqyrur përpjekjet për të siguruar mbrojtjen e popullatave të vendeve anëtare. Në fillim të vitit 1953, pas përmytjeve katastrofike të Detit të Veriut, NATO-ja kishte rënë dakord për një skemë të ndihmës ndaj pasojave të katastrofës. Deri në vitin 1958, Këshilli i Atlantikut të Veriut kishte vendosur procedurat për koordinimin e ndihmës së NATO-s ndërmjet vendeve anëtare në rast fatkeqësish. Këto procedura, të modifikuara më pas, qëndruan në fuqi deri në maj 1995, kur ato u zëvendësuan nga procedurat e rishikuara, të cilat gjithashtu u bënë të zbatueshme për vendet partnere. Në 1971, procedurat e NATO-s për bashkërendimin e ndihmës për katastrofat u rishikuan, duke sjellë përmirësimin e marrëdhënieve institucionale, midis NATO-s dhe organizatave humanitare ndërkombëtare. Këto procedura u vunë në përdorim në shtator 1975.

Procedurat origjinale për bashkëpunimin e NATO-s për asistencën e katastrofave në kohë paqeje, themeluar në 1953, nuk kishin asnjë dispozitë për t'iu përgjigjur një kërkesë nga një vend joanëtar i NATO-s. Në dhjetor 1992, Këshilli i Atlantikut të Veriut ra dakord se mbetet i vlefshëm, lehtësimi i vazhdueshëm i funksionimit të procedurave për bashkëpunimin e NATO-s në rast katastrofë në kohë paqeje. Sidoqoftë, NATO-ja duhet të jetë e gatshme ta bëjë këtë, nëse kjo kërkohet nga një organizatë përkatëse ndërkombëtare, pra të përdorë këto procedura, edhe në rast të një katastrofë jashtë kufijve të Aleancës.

Si pasojë, *Politika e NATO-s për ndihmën e katastrofave në kohë paqeje*, u rishikua dhe në vijim u ra dakord mbi mënyrat për ndihmë, për vendet anëtare të NATO-s. Nëse një vend jashtë Aleancës do të kërkonte ndihmë, rregullimet, normalisht do të kërkonin që të ishte një çështje midis vendit anëtar ndihmues, dhe vendit të goditur. Sidoqoftë, vendi anëtar ndihmues, pasi të kishte marrë informacion mbi kërkesat e vendit të goditur, duhet t'ua komunikonte këtë informacion mbi ndihmën e dhënë, vendeve anëtare dhe sekretarit të përgjithshëm, përmes sistemeve të komunikimit të mbarë Aleancës. Aleanca nuk duhet të dublojë, ose ndërpresë punën e organizatave të tjera ndërkombëtare të ngritura posaçërisht për të lehtësuar katastrofat. Kapacitetet civile qëndrojnë në çdo kohë nën kontrollin kombëtar.

Më 29 maj 1998, ministrat e Këshillit të Atlantikut të Veriut (EAPC) vendosën dhe miratuan krijimin e *Qendrës Euroatlantike të Reagimit ndaj Katastrofës* (EADRCC). Parimet themelore për politikën e EAPC-së janë:

- vendi i goditur mbetet pala përgjegjëse për menaxhimin e katastrofave;
- Kombet e Bashkuara mbajnë rolin kryesor në koordinimin e operacioneve ndërkombëtare të ndihmës ndaj katastrofave, prandaj EADRCC-ja nuk do të kopjojë

rolin e Kombet e Bashkuara, brenda zonës euroatlantike, por do të plotësojë dhe do të sigurojë mbështetje shtesë ndaj tyre;

- roli i EADRCC-së brenda zonës së EAPC-së, të jetë më shumë një rol koordinim-drejtimi.

Ndërsa programi i bashkëpunimit në fushën e planifikimit të emergjencave civile, ka qenë i suksesshëm, në vendet partnere ka vazhduar përmirësimi i gatishmërisë civile. Krijimi i EADRCC-së përfaqëson një hap të madh përpara, në përpjekjet kolektive të vendeve të EAPC-së për të siguruar ndihmë për popullsitë e goditura nga katastrofat e mëdha. Për më tepër, ajo dëshmon gatishmërinë e vendeve të EAPC-së për t'u angazhuar në bashkëpunim praktik në një fushë me interes jetik për të gjitha kombet dhe për të siguruar vendet e EAPC-së me aftësi operationale.

Pra, Qendra Koordinuese Euroatlantike e Reagimit ndaj Fatkeqësive (EADRCC) është mekanizmi kryesor i NATO-s për reagimin ndaj emergjencave civile dhe funksionon si një "clearing-house" për koordinimin e ndihmës në rast katastrofe².

Në vijim po sjellim disa shembuj të veprimtarisë së saj për ndihmën në rastin e pandemisë globale të koronavirusit, COVID-19. Në përgjigje ndaj krizës COVID-19, NATO-ja ka siguruar ndihma të menjëhershme për lehtësimin e situatës për Aleatët dhe partnerët në nevojë. Më shumë se tetëmbëdhjetë vende aleate kanë bërë donacione financiare dhe në natyrë, me pajisje dhe furnizime mjekësore, për *Fondin e Mirëbesimit të Përgjigjes Pandemike*. Aleatët kanë miratuar paketat e ndihmës për katër vende aleate: Shqipërinë, Republikë Çeke, Malin e Zi dhe Maqedoninë e Veriut; si dhe për pesë vende partnere: Bosnje dhe Hercegovinën, Irakun, Moldavinë, Tunizinë dhe Ukrainën.

Fondi i Mirëbesimit i Përgjigjes Pandemike të NATO-s, administron një rezervë të pajisjeve mjekësore dhe furnizimeve nga donacionet në natyrë ose nga blerjet e synuara, për të siguruar lehtësim të menjëhershëm të aleatëve ose të partnerëve në nevojë. Si mekanizëm i reagimit të emergjencave civile të NATO-s, EADRCC-ja vazhdon të koordinojë dhurimet dypalëshe në natyrë përmes mekanizmave të saja të Fondit të Mirëbesimit të Reagimit Pandemik të NATO-s.

Në përputhje me procedurat e përcaktuara (STANAGs) për ndihmë në rast katastrofe, Shqipëria i ka kërkuar ndihmë EADRCC në disa raste:

- Më 5 shkurt 2015, NATO-ja ka marrë një kërkesë nga Shqipëria për ndihmë, për shkak të reshjeve të mëdha të shiut që filluan më 31 janar 2015, kur niveli i ujit të lumenjve të mëdhenj ishte rritur dhe pati shkaktuar përmytje në disa pjesë të Shqipërisë. Aleatët dhe partnerët e NATO-s menjëherë u angazhuan duke ndihmuar Shqipërinë të përballojë reshjet më të rënda të regjistruara ndonjëherë në vend. Bullgaria, Franca, Mali i Zi, Sllovenia dhe Sllovakia si dhe Austria ofruan ndihmë, përfshirë pajisjet e shpëtimit të ujit, gjeneratorët e energjisë dhe strehimin e përkohshëm.

- Më 27 mars 2020, EADRCC-ja ka marrë një kërkesë për ndihmë ndërkombëtare nga qeveria e Shqipërisë në përgjigjen e saj ndaj pandemisë globale të koronavirusit COVID-19.

Nga *Stoku i Përgjigjes Pandemike të NATO-s* u furnizua Ukraina, me mbi 9000 litra dezinfektues sipërfaqësorë. Dhurimi u koordinua nga EADRCC-u dhe Republika e Letonisë, për t'u përgjigjur kërkesës së Ukrainës për ndihmë ndërkombëtare për COVID-

² https://www.nato.int/nato_static_fl2014/assets/pdf/2020/4/pdf/200401-EADRCC-Requesting-assistance-in_3.pdf

19. Sigurimi i ndihmës dhe transporti në Ukrainë u financua nga Letonia, si pjesë e kontributit të tyre në natyrë në Fondin e Mirëbesimit të Përgjigjes Pandemike të NATO-s. Kjo mbështetje ishte pjesë e 11 paketave të ndihmës së COVID-19, që NATO-ja ka aprovuar për aleatët dhe partnerët.

Gjithashtu, Ministria e Shëndetësisë e Maqedonisë së Veriut mori një dhurim prej 60 komplete pajisjesh ventilimi. Kjo mbështetje ishte pjesë e paketës së përgjithshme të ndihmës COVID-19, të NATO-s, për të cilën aleatët ranë dakord që të sigurojnë Maqedoninë e Veriut për të trajtuar efektet e rënda të pandemisë COVID-19. Dhurimi u koordinua nga EADRCC-u dhe u bë i mundur me kontribute financiare nga Republika Çeke, Lituania, Holanda, Mbretëria e Bashkuar si dhe Shtetet e Bashkuara. Nga pajisjet përfituan pacientët në nevojë urgjente në spitalet e dedikuara COVID-19 në Shkup, Tetovë, Manastir, Ohër dhe Prilep³.

2. Logjistika ushtarake, në operacionet e ndihmës humanitare në katastrofat natyrore

Ndërhyrja humanitare pas një katastrofe natyrore të papritur karakterizohet në mënyrë tipike nga një urgjencë akute që rezulton në operacione me një nivel të lartë intensiteti, i cili mund të matet nga numri i detyrave që do të ekzekutohen, pjesëtuar me produktin e kohës dhe me burimet e gjindshme, ku reagimi i shpejtë luan një rol qendror në minimizimin e dëmeve dhe shpëtimin e jetëve njerëzore⁴.

Fatkeqësitë e papritura natyrore nuk janë lehtësisht të menaxhueshme përmes procedurave rutinë. Në një grup detyrash, të njohura si mbrojtje civile, në një mjedis të institucionalizuar dhe në formën e operacioneve ndërmjet agjencive, kërkohen veprime të koordinuara midis agjencive të ndryshme, të tilla si: institucionet qeveritare, ato private, agjencitë humanitare dhe Forcat e Armatosura.

Kjo do të thotë që mbrojtja civile pritet të ketë një nivel të lartë të ndërveprimit ndërmjet aktorëve të interesuar (ushtri, qeveri dhe agjenci joqeveritare) me efikasitet, efektivitet dhe kosto më të ulët, në mënyrë që të përputhen interesat dhe përpjekjet për arritjen e objektivave që i shërbejnë me mirë qëllimeve të përbashkëta. Në këto lloje operacionesh, duhet të shmanget dublimi i veprimeve, shpërndarja e burimeve dhe divergjenca e zgjidhjeve. Kjo mund të nënkuptojë veprime më efikase të mbrojtjes civile⁵.

Operacionet humanitare të ndihmës ndaj katastrofave, ofrojnë ndihmë emergjente për viktimat e fatkeqësive natyrore. Këto operacione mund të përfshijnë ndihmë për të pastrehët, programet e përgatitjes dhe shpërndarjes së ushqimit, trajtimin dhe kujdesin mjekësor, vlerësimin dhe kontrollin e dëmit, identifikimin mjekoligjor, mirëmbajtjen e rendit dhe të ligjit, rivendosjen e rrjeteve të komunikimit, dhe pajisjet e higjienës/ujit. Kur nga përmasat e situatës, lokalitetet mbingarkohen dhe nuk mund të sigurojnë më nevoja themelore njerëzore dhe mbrojtjeje, aftësia për t'iu përgjigjur në një njoftim të shkurtër, më një gamë të gjerë kapacitetesh është një atribut unik i *Ushtrisë*. Kohëzgjatja e angazhimit të forcave ushtarake, normalisht, është e kufizuar në kohë, derisa të krijohen kushtet që komunitetet dhe agjencitë e tjera qeveritare dhe private të mund të trajtojnë

³ <http://www.nato.int/eadrcc/home.htm>; NATO Media Library

⁴ Tomasini, Rolando & Wassenhove. 2009. 'Humanitarian logistics'. New York: Palgrave Macmillan.

⁵ Natarajarathinam, ed.al. 2009. 'Managing supply chains in times of crisis: a review of literature and insights'. International Journal of Physical Distribution & Logistics Management: 535-573.

vetë operacionet e mëtejshme.

Kur ekzekutohet si duhet, pjesëmarrja ushtarake në ndihmën humanitare dhe operacionet e ndihmës ndaj katastrofave, ka efekte pozitive dhe afatgjata. Në aspektin e jashtëm, një pjesëmarrje e tillë demonstroi vullnet të mirë dhe krijon respekt të ndërsjellë. Në aspektin e brendshëm, u siguron ushtarakëve mundësinë për të demonstruar aftësitë e tyre ndërsa ndihmojnë bashkëqytetarët brenda vendit. Se sa e lehtë apo e vështirë është për forcat ushtarake dhe organizatat e ndihmës të arrijnë një popullsi në nevojë ndikim të madh do të kenë: *gjeografia, infrastruktura dhe madhësia e katastrofës*, të cilat mund t'i bëjnë shumë më komplekse kapacitetet e kërkuara për ndihmë logjistike. Vështirësitë lindin kur një vend, i ballafaquar me pasoja të një katastrofe natyrore, nuk është në gjendje të përgjigjet në ndonjë mënyrë të kuptimtë, qoftë nga mungesa e aftësive në *kapacitete logjistike* ose për shkak se katastrofa i ka bërë autoritetet të paaftë të veprojnë⁶.

Fjala logjistike vjen nga greqishtja *logistikos*, që do të thotë *aftësi për të llogaritur*. Në thelb, ajo sillet rreth të pasurit gjënë e duhur, në vendin e duhur, në kohën e duhur, në gjendjen e dëshiruar e me koston më të ulët të mundshme. *Përpjekjet për ndihmë në raste fatkeqësish natyrore përbëjnë 80% të logistikës humanitare*. Logjistika humanitare përcaktohet si “procesi i planifikimit, zbatimit dhe kontrollit të rrjedhës efikase me kosto efektive dhe ruajtjen e furnizimeve me qëllim të lehtësimit të vuajtjeve të njerëzve në nevojë dhe ruajtjen e jetës”.

Prandaj, mund të thuhet se “mënyra e vetme për të përmbushur pritjet në këtë lloj mjedisi është përmes operacioneve logjistike efektive dhe efektive dhe, më saktësisht, menaxhimit të zinxhirit të furnizimit”⁷.

Logjistika është gjithashtu jetike për çdo operacion ushtarak, pasi pa logjistikë, fushatat nuk mund të kryeshin dhe mbështeteshin. Megjithatë logjistika ushtarake ka si funksion të sigurojë personelin ushtarak me materialet e nevojshme për të përmbushur misionin e tyre, (të tilla si ushqimi, kujdesi shëndetësor dhe transporti), ato mund të jenë gjithashtu të dobishme, në ndihmën ndaj fatkeqësive të shkaktuara nga katastrofat natyrore. Në modelin e tyre të reagimit ndaj katastrofës, Haas, Kates dhe Bowden teorizojnë se pjesëmarrja efektive e burimeve ushtarake në momentet fillestare pas një katastrofe natyrore të papritur, varet *nga ekzistenca e forcave ushtarake me gatishmëri të lartë me logjistikë adekuate*. Megjithatë gatishmëria dhe lëvizshmëria janë të dëshirueshme për çdo forcë të armatosur, kufizimet politike dhe buxhetore mund të degradojnë nivelin e gatishmërisë gjatë kohës së paqes, duke ndikuar në operacionet që kërkojnë përgjigje të menjëhershme ushtarake. Ata përcaktuan *katër faza kryesore të reagimit ndaj katastrofave*, të cilat pas ngjarjes evoluojnë dhe me kalimin e kohës përfshijnë një grumbullim të burimeve ushtarake dhe joushtarake⁸.

Faza e parë quhet faza e urgjencës. Zakonisht zgjat nga disa ditë deri në dy ose tre javë. Ka një përfshirje shumë të lartë ushtarake për shkak të kapacitetit të shpejtë për mobilizim dhe vendosje në rajone me qasje të vështirë. Aktivitete të tilla si kërkimi dhe shpëtimi, furnizimi me ushqim dhe ilaçe dhe ndërtimi i strehimit janë intensive. Për shkak të cenueshmërisë së mjedisit pas katastrofës, shpëtimi i jetëve është qëllimi kryesor

AKADEMIA
E SIGURISË

Konferencë
shkencore
ndërkombëtare:

« Fenomenet
ekstreme
të natyrës
dhe çështjet
e sigurisë »

⁶ Seybolt, Taylor B. 2007. *Humanitarian military intervention: the conditions for success and failure*. Stockholm: SIPRI.

⁷ Wassenhove, Van Luk. 2006. 'Humanitarian aid logistics: supply chain management in high gear'. *Journal of the Operational Research Society*: 475-489.

⁸ Pettit, Beresford et al. 2005. 'Emergency relief logistics: an evaluation of military, non-military and composite response models'. *International Journal of Logistics: Research and Applications*: 313-331.

i fazës së emergjencës. Në fazën e restaurimit, jetët nuk kërcënohen më drejtpërdrejt nga katastrofa, por nga pasojat e saja, të tilla si mungesa e ushqimit, ujë të pijshëm, kujdesit mjekësor, sigurisë dhe komunikimit. Vendosi intensive ushtarake është akoma e nevojshme për shkak të infrastrukturës së dobët dhe kushteve të sigurisë, të cilat kufizojnë veprimet dhe qasjen e agjencive civile.

Ndërsa shërbimet po rivendosen, pjesëmarrja ushtarake zvogëlohet dhe puna e kryer nga agjencitë civile, nga ana tjetër, rritet në madhësi dhe intensitet. *Dy fazat e fundit janë riparimi (faza e tretë) dhe rindërtimi (faza e katërt)*. Nga faza e tretë, mund të vërehet mbizotërimi i agjencive civile në skenarin pas katastrofës. Nuk ekzistojnë më kushtet që kërkonin vazhdimin e përfshirjes së lartë ushtarake, të tilla si ndërprerja e shërbimeve vitale dhe siguri i burimeve dhe një numër i madh i njerëzve në nevojë. Përpjekjet e fazës së tretë dhe të katërt janë përqendruar në riparimin dhe rindërtimin e strukturave të dëmtuara nga katastrofa. Njësitë ushtarake që kanë mbetur janë ato që lidhen me punimet inxhinierike.

Me rendësi janë veprimet ushtarake të ndërmarra në fazën e parë si fazë e emergjencës. Kjo për shkak të dy faktorëve: pjesëmarrjes më të madhe të personelit ushtarak dhe rolit vendimtar të luajtur nga forcat e reagimit të shpejtë për shkak të gatishmërisë së tyre. Në kohë paqeje, ka formacione të afta për vendosje të shpejtë dhe të tjerë që kanë nevojë për kohë për të mobilizuar burimet e tyre për të reaguar ndaj një ngjarje të papritur. Përdorimi në kohë i personelit ushtarak në fazën e emergjencës lidhet drejtpërdrejt me ekzistencën e forcave në gjendje gatishmërie. Rezultatet mund të jenë thelbësishëm të ndryshme nga modeli i përgjigjes nëse këto forca nuk ekzistojnë. Në një katastrofë natyrore, niveli i zhvillimit është veçanërisht i rëndësishëm sepse mbrojtja civile është linja e parë e ndihmës, e përbërë nga ushtritë kombëtare dhe aktorët civilë, të cilët do të ndërmarrin veprime të menjëhershme gjatë fazës së emergjencës.

Sidoqoftë, kur kërkesat humanitare janë më të mëdha se aftësitë e shtetit, kërkohet ndihma ndërkombëtare, më së shpeshti përmes Kombet e Bashkuara. Gjithashtu *Udhëzimet e Oslos*, botuar së pari në 1994 dhe rishikuar për herë të fundit në 2007, janë referenca kryesore për përdorimin e forcave ushtarake dhe civile në operacionet e ndihmës humanitare të udhëhequr nga Organizata e Kombeve të Bashkuara (OKB).

3. Forca e Reagimit e NATO-s (The NATO Response Force - NRF)

Pas përfundimit të Luftës së Ftohtë, NATO-ja nuk i shihte më vendet e ish-Paktit të Varshavës si një kërcënim të madh dhe u gjend përballë një situatë të veçantë: të ishte aleanca më e madhe ushtarake në histori, pa ndonjë kundërshtar të caktuar. Zhdukja e *paktit sovjetik*, kriza ekonomike në disa vende perëndimore dhe presionet e opinionit publik për pajtimin dhe paqen në Evropë i lejuan aleatët të ulnin në mënyrë progresive shpenzimet e tyre të mbrojtjes. Në shoqëritë demokratike, siç është BE-ja, është e nevojshme të demonstron se si shpenzimet e mbrojtjes mund të kontribuojnë në mirëqenien sociale përmes rritjes e forcimit të sigurisë dhe paqes. Në kohë paqeje, meqenëse pak, e ndoshta asnjë, nga skenarët e kërcënimit duket se nuk mund të materializohet, atëherë investimi në burime ushtarake do të ishte i vlefshëm vetëm në kushtet e stërvitjeve dhe simulimeve ose operacioneve të ndihmës humanitare (MOOTW).

Gjatë Luftës së Gjirit Persik të vitit 1991, konfliktet e gjeneruara nga shpërbërja e ish-Jugosllavisë (1995-2001) dhe lufta kundër terrorizmit si rezultat i 11 shtatorit 2001, u bënë jetike në përcaktimin e një skenari të ri me të cilin Perëndimi duhet të merrej: të luftonin kundër kërcënimeve të reja. Atëherë NATO-s iu desh të shqyrtojë dobësitë e saj dhe të zhvillojë strategji për parandalimin e krizave dhe emergjencave me kapacitete të reja.

Pas përfundimit të Luftës së Gjirit, një ndryshim i parë i madh ndodhi kur *Aleanca u sfidua për të përfshirë në konceptin e saj strategjik aftësinë e ndërhyrjes me forca ushtarake jashtë zonës së mbrojtjes saj*. Në atë kohë, shumica e aleatëve evropianë ishin të zhgënjyer për shkak të pamundësisë së NATO-s për të projektuar fuqinë ushtarake përtej kontinentit. Forcave të mëdha dhe të armatosura mirë që ishin vendosur në Evropë u mungonte lëvizshmëria strategjike dhe mjetet e projektimit të fuqisë ushtarake për të kryer operacione në zona të largëta⁹.

Përveç mungesës së lëvizshmërisë duhej të merreshin në konsideratë edhe dobësitë strategjike. Kur shpërtheu Lufta e Kosovës në 1999, presioni i fushatës ushtarake mbi forcat serbe për të imponuar tërheqjen nga Kosova ishte e bazuar në fuqinë ajrore. Megjithatë rajonet e konfliktit ishin brenda rrezes së bazave ajrore të NATO-s, aleatët evropianë kontribuan vetëm rreth 25% të të gjitha fluturimeve ajrore, duke lënë që shumica e misionëve të sulmit ajror të kryheshin nga forcat ajrore dhe detare të SHBA-së. Për zona të tilla evropianëve u mungonin kapacitetet kritike, siç janë municionet inteligjente, komunikimet e sigurta dhe operacionet ditë-natë.

Pas sulmeve terroriste të 11 shtatorit 2001, kur Shtetet e Bashkuara shpallën emergjent nenin 5 të *Traktatit të Atlantikut të Veriut*, disa aleatë evropianë ofruan ndihmë në luftën kundër al-Kaedës dhe talibanëve, por ata u habitën kur ushtria amerikane refuzoi ofertat për arsye se shumica e ushtarakëve evropianë nuk kishin kapacitete të sofistikuara për të kontribuar në operacionet e epokës së re. Gjatë takimit të ministrave të Mbrojtjes të NATO-s, në shtator 2002, sekretari i Mbrojtjes i SHBA-së, Donald Rumsfeld, paralajmëroi që “nëse NATO-ja nuk zhvillon një forcë të shpejtë dhe të shkathët për t’u zhvendosur në disa ditë ose javë në vend të muajve ose viteve, atëherë Aleanca nuk do të kishte kapacitete për sfidat e shekullit të njëzetënjtë. NATO-ja duhet të ketë një forcë sulmuese ekspeditive që të mund të lëvizë shpejtë”¹⁰.

NATO-ja është bërë e përgjegjshme ndaj nevojave të sigurisë së shekullit të njëzetënjtë, veçanërisht në lidhje me nevojën për një koncept të ri strategjik të zhvendosjes. Forca e saj dhe strukturat logjistike janë krijuar për vendosjen dhe mbështetjen e shpejtë, në mjedise të ndryshme, me mbështetje integrale, në mënyrë që të veprojnë si një mjet i rëndësishëm parandalues dhe garantues i interesave të Aleancës, edhe në skenarë të tillë si operacione të ndihmave humanitare.

Për këtë arsye, mund të theksojmë se transformimi i NATO-s në epokën pas Luftës së Ftohtë ndodhi përmes pjekurisë institucionale, bazuar në interesin e përbashkët të anëtarëve të saj, të cilët ishin të etur për zhvillimin e aftësive dhe kapaciteteve të cilat mund të vepronin në skenarë të bashkëpunimit ose të konfliktit, shprehur në një sërë institucionesh ndërkombëtare e veçanërisht: diplomacinë, luftën dhe ekuilibrin e fuqisë.

Këto veprime modernizuese u materializuan në një strukturë ushtarake për

**AKADEMIA
E SIGURISË**

*Konferencë
shkencore
ndërkombëtare:*

« Fenomenet
ekstreme
të natyrës
dhe çështjet
e sigurisë »

⁹ Kugler, Richard L. 2007. *The NATO Response Force 2002–2006: Innovation by the Atlantic Alliance*. Washington, DC: Center for Technology and National Security Policy.

¹⁰ Mihalka, Michael. 2005. *'NATO Response Force: Rapid? Responsive? A Force?'* Connections: The Quarterly Journal 4: 67-79.

operacionet ekspedituese të etiketuara si *Forca e Përgjigjes së NATO-s (The NATO Response Force - NRF)*. Ideja e NRF-së fillimisht u konceptua nga SHBA-ja. Ata bënë thirrje për një forcë që do të ishte aq e madhe sa të kishte kuptim ushtarak, por aq e vogël sa të ishte e përballueshme dhe tërheqëse politikisht për aleatët evropianë. Kështu, NRF-ja u bë një forcë e përbashkët shumëkombëshe e gatshme për të vendosur një forcë deri në 21 000 njerëz, kudo që Aleanca ta kërkonte, brenda pesë ditësh. Mjetet e saj logjistike janë të krijuara për autonomi operationale, pa mbështetje të mëtejshme, për 30 ditë, ose më gjatë nëse furnizohen përsëri.

Struktura NRF-së u krijua për t'iu përgjigjur me shpejtësi krizave në zhvillim në të gjithë spektrin e plotë të misioneve të Aleancës, duke filluar nga operacionet ushtarake që nuk përfshijnë përdorimin e forcës (MOOTW), të tilla si lehtësimi i katastrofave ose paqeruajtja, deri në luftime me intensitet të lartë. Misionet e NRF-së përcaktohen rast pas rasti nga Këshilli i Atlantikut të Veriut pa ndonjë kufizim të tanishëm gjeografik. Si një forcë e krijuar në një skenar kërcënimesh dhe kufizimesh të reja financiare, pritet të vendoset si forcë e pavarur për operacionet e evakuimit, mbështetjen për menaxhimin e ndihmës së katastrofave (përfshirë ngjarjet kimike, biologjike, radiologjike dhe bërthamore), ndihmën humanitare dhe kundër-operacionet e terrorizmit; si një forcë fillestare hyrëse që lehtëson ardhjen e forcave vijuese; dhe si një forcë demonstrative.

Forcat logjistike të Forcës së Reagimit të Shpejtë të NATO-s (NRF) janë njësitë ushtarake me gatishmëri të lartë në kohë paqeje. Ato janë të afta të reagojnë shpejt në përgjigje të një ngjarje të papritur, ndërsa njësitë e tjera po organizohen dhe po mobilizohen. Ato janë, në veçanti, forca të përbashkëta të përbërë nga burime tokësore, ajrore dhe detare. Por, përdorimi i aftësive logjistike të forcës së reagimit të shpejtë në operacionet e ndihmës humanitare, është gjithashtu edhe një mënyrë e rëndësishme për të justifikuar kostot e larta financiare të këtyre forcave, në një kohë të kufizimeve të buxheteve të mbrojtjes¹¹.

4. Përdorimi i Forcës së Reagimit të NATO-s, për të ndihmuar viktimat e tërmetit në Pakistan

Më 8 tetor 2005, një tërmet me madhësi 7.6 ballë në shkallën *Rihter* goditi Pakistanin. Epiqendra e tërmetit ishte Muzafarabadi, kryeqyteti i pjesës së Kashmirit, të kontrolluar nga Pakistani, afërsisht 95 kilometra në verilindje të Islamabadit. Shumica e viktimave u regjistruan në Provincën Kufitare Veriperëndimore, një rajon i vështirë për t'u arritur fizikisht, i karakterizuar nga male dhe pyje të mëdha, dhe me dimër të ashpër. Në një deklaratë për agjencinë shtetërore të lajmeve të Pakistanit, presidenti Pervez Musharraf, bëri thirrje për ndihmë ndërkombëtare me përpjekjet e ndihmës, duke thënë se vendi i tij nuk mund të merrej i vetëm me pasojat e tërmetit masiv. Sipas presidentit, Pakistanit i duhej mbështetja e helikopterëve të ngarkesave për të arritur rajonet të izoluar, ndihmë financiare dhe furnizime ndihmë¹².

Kombet e Bashkuara nuk kishin burimet e nevojshme logjistike për të siguruar në kohë ndihmën e kërkuar nga Pakistani. Do të duhej kohë për t'i mobilizuar ata për një katastrofë të asaj madhësie, *kështu që ata kërkuan ndihmën e NATO-s*. Në një situatë të

¹¹ NATO Review. 2006a. 'NATO Backgrounder: Logistics Support for NATO Operations'. NATO Media Library.

¹² Source: http://news.bbc.co.uk/2/hi/south_asia/BBC 2005. 'Quake crisis overwhelms Pakistan'. BBC Online 2005

tillë, NATO-ja ngriti një operacion të ndihmës humanitare me elementë logjistike nga Forca e Reagimit të Shpejtë të NATO-s (*NATO Rapid Reaction Force - NRF*). Në fazat e hershme të katastrofës, operacioni përdori burime ajrore, tokësore dhe detare për të ngritur dhe mbajtur një urë ajrore nga Evropa, duke përfshirë vendosjen në terren në Pakistan, të strukturave të komandës dhe kontrollit, njësisë inxhinierike, helikopterë dhe spitale ushtarake, të gjitha me logjistikë të përshtatshme¹³.

Nga analiza e përpjekjeve të kryera nga NATO-ja për lehtësimin pasojave të tërmetit të Pakistanit, në tetor 2005, mundet të argumentojmë se strukturat logjistike të forcës së reagimit të shpejtë janë të afta të kryejnë një rol të dyfishtë. Megjithëse janë krijuar për të përballuar një konflikt të armatosur, ato mund të përdoren gjithashtu në operacione ushtarake përveç luftës (MOOTW), të tilla si ndihmë humanitare, mbështetje në përpjekjet e forcave të mbrojtjes civile, në operacione joluftarake të evakuimit dhe operacione paqeruajtjeje.

Tërmeti i 8 tetorit 2005 ishte katastrofa më e rëndë në historinë e Pakistanit, për shkak të madhësisë dhe efekteve të saj. Shumë qytete dhe fshatra u shkatërruan tërësisht. Numri i të vdekurve ishte 73 338 me 128 309 të plagosur dhe më shumë se 5 milionë njerëz të pastrehë. Shumica e viktimave u regjistruan në Kashmir dhe në Provincën Kufitare Veriperëndimore, në rajone që ishin të vështira për t'u arritur¹⁴.

Është vlerësuar se tërmeti preku një sipërfaqe prej afërsisht 30 000 km² dhe shkaktoi shkatërrimin e më shumë se gjysmës së shtëpive ekzistuese, mjediseve të kujdesit shëndetësor, infrastrukturës së komunikimit dhe shkollave. Rrugët dhe infrastruktura për furnizimin me ujë gjithashtu u shembën. Agjencitë e qeverisjes vendore u bënë joefektive në kryerjen e detyrave të tyre, me anëtarët e stafit të tyre ose të vdekur, të plagosur ose duke ndihmuar të afërmit e prekur nga tërmeti. *Si rezultat, ekzistonte një varësi totale nga komponentin ushtarak për të filluar veprimet e mbrojtjes civile.*

Që nga dita e parë, ushtria pakistaneze kishte mbajtur peshën e një pjesë të madhe të operacionit të ndihmës dhe shpëtimit. Megjithëse forcat e armatosura janë në funksion të mbrojtjes kombëtare, është e rëndësishme të theksohet se personeli i tyre zakonisht kishte njohje mbi gjeografinë dhe rrugët që përdoren për të lidhur vende të ndryshme, duke i bërë kështu më të lehta veprimet e kërkimit dhe shpëtimit. Gjendja e gatishmërisë dhe ekzistenca e pajisjeve operacionale dolën të dobishme për operacionet e ndihmës; pajisjet përfshirë helikopterë, kamionë, ekskavatorë dhe traktorë lehtësuan detyrat e kryera nga ushtria. U angazhuan në përpjekjet e mbrojtjes civile rreth 60 000 personel ushtarak pakistanez, duke përfaqësuar afërsisht 10% të forcave të armatosura kombëtare. Në momentet fillestare pas katastrofës, ushtria pakistaneze luajti një rol qendror dhe efektiv në bashkërendimin e përpjekjeve të ndihmës, me gjithë mungesat në pajisje dhe personel, për shkak të natyrës dhe madhësisë së katastrofës¹⁵.

Në tetor, Aleanca mori një seri kërkesash nga zyra e komisionerit të lartë të OKB-së për refugjatët (*UN Refugee Agency, UNHCR*). Megjithëse kishte disa precedentë për vendosjen e kapaciteteve ushtarake të NATO-s në kriza humanitare dhe katastrofa natyrore, veprimi u konsiderua si një sfidë e re për shkak të distancave të mëdha mbi të cilat do të duhej të kryhej. NATO nisi një përgjigje ushtarake me dy faza. Faza e parë ishte ndihma indirekte e përqendruar në ngritjen ajrore të furnizimeve nga Evropa në

**AKADEMIA
E SIGURISË**

*Konferencë
shkencore
ndërkombëtare:*

« Fenomenet
ekstreme
të natyrës
dhe çështjet
e sigurisë »

¹³ NATO Review Jochems, Maurits. 2006. 'NATO's growing humanitarian role'. NATO Media Library.

¹⁴ Özerdem, Slan. 2006. 'The Mountain Tsunami: afterthoughts on the Kashmir earthquake'. Third World Quarterly 27: 397-419.

¹⁵ Bamforth, Thomas and Jawad H Qureshi. 2007. 'Political complexities of humanitarian intervention in the Pakistan earthquake'. Journal of Humanitarian Assistance, 16 January.

Pakistan. Fluturimi i parë i ndihmës së NATO-s për në Pakistan, arriti në 14 tetor, një ditë pas kërkesës zyrtare të Kombeve të Bashkuara. Në këtë fazë të parë, ura ajrore e operuar nga NATO-ja, me 160 fluturime dorëzoi rreth 3 500 tonë mallra ndihmë.

Faza e dytë e operacionit shtoi mbështetjen për infrastrukturën dhe ndihmën shtesë indirekte, të marrë nga NRF-ja, duke përfshirë një strukturë të vendosur komande dhe kontrolli të njërive, njësi inxhinierike dhe helikopterë, të gjitha me mbështetjen e duhur. Ndihma e drejtpërdrejtë mjekësore, e kryer nga spitalet ushtarake të NATO-s, ishte gjithashtu e nevojshme për shkak të numrit të madh të viktimave. Të dy fazat nuk ishin domosdoshmërisht të pavarura nga njëra-tjetra, ndryshimi midis tyre ishte thjesht koha në të cilën ata filluan dhe burimet e përdorura. Faza e parë filloi sa më shpejt që NATO ra dakord për të ndërmarrë ndihmën humanitare dhe për përfshirjen e kapaciteteve ajrore. Faza e dytë, nga ana tjetër, filloi disa ditë pas fazës së parë dhe përbënte komponentë toke dhe ajri.

Nga sa është thënë, në lidhje me veprimet e ndërmarra në 72 orët e para pas tërmetit, rrjedh se *pajisjet logjistike të forcave të reagimit të shpejtë ushtarak luajnë një rol vendimtar në përpjekjet për lehtësimin e katastrofave natyrore*. Kjo mund të shpjegojë pjesërisht pse kërkohej ndihmë ndërkombëtare, edhe pse vetëm 10% e Forcave të Armatosura Pakistaneze ishin angazhuar. Supozohet se kjo përqindje përfaqësonte atë që ushtria pakistaneze kishte, ose në gjendje gatishmërie, ose afër zonës së prekur, ndërsa 90% e mbetur nuk mund të mobilizohej, organizohej apo mbështetej. Duhet të theksojmë se logjistika ishte një fokus i rëndësishëm si për ushtarakët pakistanezë ashtu edhe për ata të NATO-s, me helikopterët ushtarakë që luanin një rol kryesor në përgjigje të ndihmës humanitare. Dihet se transporti me helikopter është i shtrenjtë, por nuk kishte asnjë alternativë tjetër për të arritur në fshatrat malorë, duke pasur parasysh se shumë rrugë ishin prerë dhe lëkundjet e pasme kishin bërë udhëtimin rrugor të rrezikshëm. Numri i madh i helikopterëve të nevojshëm nënkuptonte që opsioni ushtarak ishte unik në aftësi dhe gatishmëri.

Njësitë *logjistike ushtarake* në thelb janë përdorur për veprime indirekte dhe në mbështetje të infrastrukturës, pavarësisht nga fakti se asnjë kufizim në veprimet e drejtpërdrejta nuk ishte vendosur nga qeveria pakistaneze. Kjo prirje e përdorimit të njërive të transportit ushtarak, inxhinierik dhe mjekësor për qëllime humanitare, siç është shpjeguar më parë tregon se logjistika ushtarake ka një karakteristikë të përdorimit të dyfishtë, pra që mund të përdoret për qëllime paqësore dhe ushtarake. E gjithë forca ushtarake, nga natyra, kërkon mbështetje logjistike. Gatishmëria dhe autonomia operacionale janë dy tipare të forcave të reagimit të shpejtë që rrisin sfidat logjistike. Këto forca janë të afta për t'u vendosur në ambiente të largëta, të arritshme me vështirësi dhe armiqësore, në një afat të shkurtër me pak ose aspak mbështetje të jashtme.

Teoria, studimet dhe rendimenti i forcave të reagimit të shpejtë në një situatë reale, puqet me idenë se struktura të tilla ushtarake janë thelbësore për t'u përgjigjur një katastrofe të papritur natyrore. Numri i jetëve të shpëtua lidhet drejtpërdrejt me ekzistencën e forcave që mbahen në gjendje gatishmërie me lëvizshmëri strategjike. Kufizimet financiare mund të jenë gjithashtu një nga arsyet e mungesës së një force të përbashkët reagimi. Me pak fjalë, investimet në forcat e reagimit të shpejtë kontribuojnë në produktin përfundimtar të çdo force të armatosur, qoftë për luftë apo operacione humanitare.

Megjithëse sondazhi i fundit i opinionëve tregon nivele të larta të besueshmërisë në forcat e armatosura, ka qenë mjaft e vështirë të transformohet mbështetja publike në

drejtim të mbështetjes financiare. Mungesa e kërcënimeve të pashmangshme ndaj mbrojtjes kombëtare mund të jetë një shpjegim për këtë vështirësi. Një forcë e armatosur e aftë të parandalojë çdo sulm nga jashtë, gjeneron një ndjenjë të sigurisë brenda shoqërisë në lidhje me kërcënimet e jashtme, e cila mund të përkthehet në prioritet të ulët në çështjet e mbrojtjes. Kjo situatë përkeqësohet kur vihet krah për krah me sfidat kryesore kombëtare siç janë kanalizimi themelor të siguria publike, arsimi dhe kujdesi shëndetësor.

5. Çfarë shkoi mirë ose vlera shtuar në ndihmën ndaj Pakistanit, gjatë ndërhyrjes së NATO-s në tërmetin e vitit 2005

Me gjithë suksesin e konsiderueshëm gjatë operacionit në këtë fatkeqësi natyrore, me siguri pa përfshirjen e NATO-s, operacioni nuk do të kishte qenë kaq i suksesshëm. Pa dyshim, kontributet e NATO-s në përgjigje të fatkeqësive natyrore përgjithësisht kanë provuar të jenë një sukses vendimtar dhe me siguri rezultati do të kishte qenë shumë ndryshe pa përfshirjen e saj. Vlera shtuar e NATO-s është e lidhur me disa faktorë. Përfshirja dhe pjesëmarrja e NATO-s në operacion ishte me *interes diplomatik* pasi ishte një mundësi e mirë për Aleancën të promovojë vetveten në mënyrë pozitive duke rritur sigurinë në këtë Rajon, por mbi të gjitha të sigurojë rolin e saj të spikatur në menaxhimin e krizave. Megjithëse ka pasur nga ata që kritikuan pjesëmarrjen e NATO-s, në këtë rast ajo është perceptuar si aspekt pozitiv.

NATO ka një *strukturë të shkëlqyer për këto operacione*, pasi ajo jo vetëm që ka kapacitete të gatshme, por ajo ka dhe aftësinë e nevojshme të koordinojë, të ndërlidhë, dhe të lehtësojë përdorimin e tyre. NATO-ja punon 24/7, në të gjitha ditët e vitit, dhe ajo ka aftësinë të përqendrojë fuqinë dhe të vendosë kapacitetet e saja në një kohë të shkurtër pas marrjes së njoftimit. Përveç kësaj, një faktor i rëndësishëm është se forcat e NATO-s kanë aftësi të sigurojnë veten e tyre, ndërsa punonjësit humanitarë mundet të përballen në situata të rrezikshme, pasi ata shpesh nuk i kanë kapacitetet e mjaftueshme që të sigurojnë veten. Një koncept i rëndësishëm i strukturës përbërëse të NATO-s është kuptimi se kapacitetet e saja, të vendosura në zonën e fatkeqësisë, mundet të mbështeten nga ekupe që punojnë nga komandat e saja: Komanda e Operacioneve (ACO) në Belgjikë, dhe Komanda e Bashkuar (JCL) në Lisbonë. Po ashtu, stafi i inteligjencës në selinë qendrore të NATO-s në përgjigje dhe me porosi, mbështet forcat e veta në operacion duke garantuar sigurinë e tyre.

Përfshirja e *aftësive unike të NATO-s* rezultoi thjesht si një domosdoshmëri. Autoritetet pakistaneze, organizatat ndërkombëtare dhe organizatat joqeveritare ishin të mbingarkuara nga shkatërrimet e shkaktuara nga fatkeqësia. Pakistani ishte në gjendje të dëshpëruar dhe nevoja e mbështetjes ndërkombëtare për ndihma dhe lehtësim të fatkeqësisë, bëri kështu që të kërkojë ndihmën e NATO-s. Për Pakistanin ishte e rëndësishme marrja e ndihmës së nevojshme, por për ata ishte e parëndësishme nëse ndihma vinte nga NATO-ja, apo aktorë civilë. Megjithatë, forcat ushtarake për shkak të aftësive të tyre unike, mund të jenë me vlerë në lehtësimin e përpjekjeve gjatë fatkeqësisë. Për më tepër, vendosja e kapaciteteve ushtarake është një çështje që duhet të konsiderohet me kujdes: ata vendosen dhe përdoren atje vetëm kur nuk ka të tjera opsione. Këtu është e rëndësishme të përmendim se ndonjëherë, NATO-ja është me të vërtetë opsioni i vetëm për vendet e prekura, e kjo, sepse entitetet e tjera nuk posedojnë kapacitetet e nevojshme.

AKADEMIA
E SIGURISË

Konferencë
shkencore
ndërkombëtare:

« Fenomenet
ekstreme
të natyrës
dhe çështjet
e sigurisë »

Duke marrë parasysh kundërshtimin e fortë në fillim të operacionit, e rëndësishme për NATO-n ishte fakti se ajo arriti të krijojë një *imazh pozitiv* me kalimin e kohës. Kur fundi i operacionit ishte afër, shumë aktorë, siç ishin politikanët pakistanezë dhe të Kashmirit, kërkuar nga forcat e NATO-s që të qëndronin në zonë. Kjo demonstroi në mënyrë të përsosur rëndësinë e përfshirjes së NATO-s. Ndryshimi i mendimit ka qenë një zhvillim shumë i vlefshëm për marrëdhëniet e tyre të ardhshme, si për NATO-n dhe për Pakistanin.

Gjatë gjithë kohës së operacionit, NATO-ja tregoi aftësinë e saj të madhe të bashkëpunimit me të gjithë aktorët e ndryshëm të përfshirë dhe përhapjes së mirëkuptimit dhe kohezionit. Për të ilustruar, megjithëse roli i NATO-s ishte jetësor, forcat e NATO-s nuk ishin udhëheqëse të operacionit: ato ishin aty se ishin të nevojshme kapacitetet ushtarake, për të koordinuar e lehtësuar furnizimin, mirëmbajtjen dhe komunikimin me aktorët ndryshëm të përfshirë, dhe shumë e rëndësishme duke ndihmuar kudo që ishte e nevojshme. Bashkëpunimi ndërmjet forcave ushtarake të NATO-s dhe ushtrisë pakistaneze shkoi posaçërisht mirë. Kjo ishte vendimtare sepse në situata si këto, ndryshe nga situata normale ushtarake, bashkëveprimi me autoritetet lokale është jetësor.

Vlera e shtuar e NATO-s bëhet më e qartë kur evidentohet sasia e ndihmave përmes operacioneve të kryera, si: fluturime përmes urave të ajrit dhe me helikopterë duke furnizuar tenda, pajisje fjetjeje, soba, pajisje mjekësore, ujë, ushqime, transporti i të zhvendosurve, të sëmurëve, të plagosurve, riparimi i rrugëve si dhe pastrimi i tyre nga bora, akulli, dhe rrënojat. Ndërtimi i shkollave dhe qendrat mjekësore, strehimoret të cilat ishin në zona më lartësi mbidetare më të larta sesa 1.500 metra. Në një vlerësim total, përfituan ndihmë të drejtpërdrejtë nga NATO mbi 40 000 pakistanezë, - dhe mbi 100 000 indirekt¹⁶.

Roli i rëndësishëm i NATO-s nuk do të kishte qenë i mundur pa përpjekjet e autoriteteve pakistaneze. Pavarësisht faktit se atje nuk kishte struktura kombëtare për menaxhimin e ndihmave në vend në kohë tërmetesh e fatkeqësisht natyrore, *roli i autoriteteve dhe ushtrisë pakistaneze ishte shumë efektiv*, duke treguar forcë udhëheqëse dhe fleksibilitet. Menjëherë pas goditjes së tërmetit, autoritetet pakistaneze nisen operacionin për linjat e shpëtimit, të cilat lejuan të vendosen 60 000 forca ushtarake në total. Këto forca ushtarake organizuan dhe realizuan një përgjigje domethënëse në lehtësimin e përpjekjeve fillestare në këtë fatkeqësi.

Pas këtij tërmeti, Pakistani ka demonstruar gatishmëri për ndryshime në përputhje me rrethanat, duke marrë masa që të përmirësohen përgjigjet ndaj katastrofave në të ardhmen, duke ngritur dy struktura për menaxhim në rast fatkeqësish: Autoriteti Kombëtar i Menaxhimit të Fatkeqësive, dhe Autoriteti i Rindërtimit dhe Rehabilitimit të Tërmeteve. Nga perspektiva e NATO-s, në përgjithësi, koordinimi civilo-ushtarak shkoi mirë, kryesisht në fushën logjistike dhe atë inxhinierike. NATO-ja tregoi gatishmëri të madhe bashkëpunimi me aktorët civilë, më synimin të arrijë rezultatet më të mira të mundshme¹⁷.

Misioni do të shërbejë si model për misionet NATO-s në të ardhmen: pjesërisht misioni ka provuar të jetë operacion humanitar shumë i suksesshëm, posaçërisht në

¹⁶ U N Office for the Coordination of Humanitarian Affairs. (OCHA). 'Guidelines on the use of foreign military and civil defence assets in disaster relief'. 2007

¹⁷ Wilder, Andrew. 2010. 'Aid and stability in Pakistan: lessons from the 2005 earthquake response'. Disasters 34: 406-426.

vendosjen komponentit të fortë civilo-ushtarak (*Forcës së Përgjigjes të NATO-s*, NRF) në rrethanat e dhëna të zonës. Përveç kësaj, përfshirja NATO-s në përgjigje të tërmetit, ka shërbyer si mekanizëm për të lehtësuar furnizimin me donacione nga vendet anëtarë të NATO-s përmes të Qendrës Euroatlantike të Koordinimit të NATO-s (EADRCC). Gjithashtu vendosja në terren e Forcës së Përgjigjes të NATO-s është ajo çfarë e bën misionin të diskutueshëm, fakti që ushtarët e NATO-s u përfshinë drejtpërdrejt në ndihmë humanitare; një fushë në të cilën jo të gjithë bien dakord. Megjithatë NATO-ja ishte ballafaquar me shumë sfida të brendshme dhe të jashtme, ajo provoi se mund të jetë një ndihmë e madhe në misionet në përgjigje ndaj fatkeqësive dhe aftë të menaxhojë, të qëndrojë e fortë dhe të arrijë rezultate mbresëlënëse.

Përfshirja e NATO-s në operacionet e ndihmës ndaj fatkeqësive natyrore është sigurisht e përshtatshme për lehtësimin e fatkeqësisë dhe është e justifikuar në dy drejtime. Së pari, ata janë plotësisht në përputhje me qëllimet dhe parimet themelore të NATO-s dhe së dyti, është e dukshme se në përgjithësi, vlera e shtuar e aftësive dhe kontributeve të NATO-s në përgjigje të fatkeqësive, të jetë e madhe dhe domethënëse. Një analizë e themelimit të *Traktatit* të vitit 1949 dhe të koncepteve strategjike që burojnë prej tij, riafirmon se operacionet në ndihmë dhe lehtësim të fatkeqësive janë plotësisht në përputhje me parimet themelore të Aleancës, të cilat janë: të promovojë stabilitetin, të ruajë sigurinë, dhe të mbrojnë ekzistencën e popujve në hapësirën euroatlantike, duke respektuar parimet Kartës së Kombeve të Bashkuara. Për më shumë, zhvillimi gradual i rolit humanitar të NATO-s, i cili në fakt gjithmonë ka qenë të kryejë misione në mbështetje të mbrojtjes. Në përputhje me këtë pikëpamje NATO-ja ka provuar të jetë dinamike dhe reaktive në organizimin me institucione liberale, duke evoluuar vazhdimisht dhe me shpejtësi me ndryshimin e mjedisit të sigurisë dhe duke i qëndruar besnike parimeve të *Traktatit* të themeluar me 1949.

Katastrofat natyrore janë identifikuar si kërcënim i rritur për paqen dhe stabilitetin e zakonshëm, duke bërë që NATO-ja të bëhet gjithnjë e më shumë aktive dhe një aktor i spikatur në ndihmën ndaj fatkeqësive, në linjë me ndryshimet në nocionin e mbrojtjes civile. Prandaj, ndihma në rast fatkeqësie i përshtatet në mënyrë të përkryer rolit të evoluuar të NATO-s, synimit që të mbrojnë popullsinë civile nga pasojat e katastrofave, në të njëjtën kohë duke theksuar shumë rëndësinë e përfshirjes dhe bashkëpunimit të NATO-s në ndihmë në rast fatkeqësie. Për nga adoptimi e qasja bashkëkohore, e përshtatur e gjithëpërfshirëse, Aleanca ka pasur sukses në mbajtjen e pozicionit të saj të përqendruar në vlerësimin se, rreziqet për mjedisin e sigurisë do të jenë komplekse dhe shumëdimensionale, ku menaxhimi i krizave dhe promovimi i sigurisë ndërkombëtare, përmes bashkëpunimit dhe dialogut, janë bërë funksione të rëndësishëm dhe jetësorë të Aleancës.

6. Përfundime

Sistemi ndërkombëtar pas Luftës së Ftohtë i përcaktuar nga të ashtuquajturat kërcënime të reja ka çuar në ndryshime strategjike në NATO, veçanërisht në zonën e saj të operacioneve dhe armikut për t'u luftuar, i cili është zhvendosur nga forcat ish-sovjetike në një fushë lineare beteje në të gjithë Evropën Lindore, te forcat hibride në operacionet me spektër të plotë në të gjithë globin.

Për pesëdhjetë vjet, interesi dhe aftësitë e NATO-s për të mbrojtur popullsitë kanë shërbyer për të mbrojtur popullsitë civile. *Partneriteti për Paqe* i ka lejuar NATO-s që

AKADEMIA
E SIGURISË

Konferencë
shkencore
ndërkombëtare:

« Fenomenet
ekstreme
të natyrës
dhe çështjet
e sigurisë »

të bashkëpunojë me partnerët e saj në gatishmërinë ndaj katastrofave, si dhe në reagimin ndaj katastrofave në vendet partnere dhe në vendet e NATO-s. Prandaj, Forca e Përgjigjes/Reagimit të Shpejtë të NATO-s (*NATO Response Force - NRF*) u krijua për të përmbushur kërkesat e Aleancës në skenarin e ri, duke ndërtuar një kapacitet të lartë të aftësive të saj operacionale dhe logjistike, siç janë gatishmëria dhe autonomia. Struktura e NRF është e përshtatur për autonomi logjistike pa mbështetje për 30 ditë dhe e aftë për reagim të shpejtë ndaj krizave të reja të tilla si ndihma humanitare ose paqeruajtja, deri te operacionet e luftës me intensitet të lartë.

Përdorimi i NRF-së në tërmetin e 8 tetorit 2005 mund të analizohet jo vetëm nga pikëpamja e bashkëpunimit, por edhe nga ajo e parandalimit strategjik. Rajoni u konsiderua strategjik për Aleancën për shkak të burimeve energjetike të Lindjes së Mesme dhe Luftës kundër Terrorizmit që po kryhej në Afganistanin fqinj. Mbështetja e përpjekjeve pakistaneze të ndihmës në këtë drejtim përfaqësonte angazhimin e NATO-s për aleatin e saj kryesor rajonal, i cili ishte thelbësor për ruajtjen e objektivave të saja globale.

Përdorimi i NRF-së në këtë fazë ishte për shkak të aftësive logjistike dhe taktike, të cilat pajisen dhe përshtaten me kërkesat për burime njerëzore dhe materiale, shpesh të gjendura në rajone të degraduara nga dëmtime të mëdha në infrastrukturën lokale. Cilado qoftë pikëpamja, vendosja e *Forcave të Reagimit të Shpejtë* (NRF) në një rajon të largët dhe të vështirë për t'u arritur, ka demonstruar se sa vendimtare mund të jetë një forcë e reagimit të shpejtë në momentet e para të një katastrofe të caktuar natyrore, si një aktor i rëndësishëm për të përmbushur kërkesat humanitare, ku përveç efektit të madh parandalues, ajo është treguar kritike për operacionet humanitare.

Programi i bashkëpunimit të Aleancës së NATO-s me vendet partnere, dhe rast pas rasti me vendet jashtë rajonit të saj, në fushën e planifikimit të emergjencave civile, duke përmirësuar gatishmërinë civile, duke krijuar politika dhe struktura për këtë qëllim, përmes përpjekjeve kolektive të vendeve të EAPC-së për të rritur sigurinë në përgjithësi dhe njëkohësisht duke siguruar ndihmë për popullatat e goditura nga katastrofa të mëdha, dëshmon gatishmërinë e vendeve të EAPC për t'u angazhuar në bashkëpunimin në një fushë me interes jetik për të gjitha kombet duke siguruar vendet me aftësitë e nevojshme operacionale.

Bibilografi

Libra

1. Özerdem, Slan. 2006. 'The Mountain Tsunami: afterthoughts on the Kashmir earthquake'. Third World Quarterly 27: 397-419.
2. Pettit, Stephen J and Anthony K C Beresford. 2005. 'Emergency relief logistics: an evaluation of military, non-military and composite response models'. International Journal of Logistics: Research and Applications 8: 313-331.
3. Natarajarathinam, Malini, Ismail Capar and Arunachalam Narayanan. 2009. 'Managing supply chains in times of crisis: a review of literature and insights'. International Journal of Physical Distribution & Logistics Management: 535-573.
4. Wassenhove, Van Luk. 2006. 'Humanitarian aid logistics: supply chain management in high gear'. Journal of the Operational Research Society: 475-489.
5. Wilder, Andrew. 2010. 'Aid and stability in Pakistan: lessons from the 2005 earthquake response'. Disasters 34: 406-426.

Revista

1. Ahmad, Qazi S. 'South Asian Earthquake of 2005. Pakistan Horizon': Vol. 58, No. 4 (October 2005), pp. 21-32, Pakistan Institute of International Affairs
2. Bamforth, Thomas and Jawad H Qureshi. 2007. 'Political complexities of humanitarian intervention in the Pakistan earthquake'. Journal of Humanitarian Assistance, 16 January.
3. Beresford, Anthony and Stephen Pettit. 2012. 'Humanitarian aid and emergency logistics'. Business Science Reference, pp. 45-67.
4. Kugler, Richard L. 2007. 'The NATO Response Force 2002-2006: Innovation by the Atlantic Alliance'. Washington, DC: Center for Technology and National Security Policy.
5. Mihalka, Michael. 2005. 'NATO Response Force: Rapid? Responsive? A Force?' Connections: The Quarterly Journal 4: 67-79.
6. NATO Review Jochems, Maurits. 2006. 'NATO's growing humanitarian role'.
7. NATO Review. 2006a. 'NATO Backgrounder: Logistics Support for NATO Operations'..
8. NATO Review. 2010. Pakistan earthquake relief operation. 27 October.
9. Seybolt, Taylor B. 2007. Humanitarian military intervention: the conditions for success and failure. Stockholm: SIPRI.
10. Tomasini, Rolando and Luk Van Wassenhove. 2009. 'Humanitarian logistics'. New York: Palgrave Macmillan.
11. U N Office for the Coordination of Humanitarian Affairs (OCHA). 2007. 'Guidelines on the use of foreign military and civil defence assets in disaster relief'.

Burime elektronike

- https://www.nato.int/cps/en/natohq/topics_117757.htm
- <http://www.nato.int/eadrcc/home.htm> NATO Homepage; EADRCC
- https://www.nato.int/nato_static_fl2014/assets/pdf/2020/4/pdf/200401-EADRCC-Requesting-assistance-in_3.pdf
- http://news.bbc.co.uk/2/hi/south_asia/4324534.stm
- http://www.emdat.be/disaster_trends/index.html . International Disaster Database. 2009
- http://news.bbc.co.uk/2/hi/south_asia/BBC_2005_Quake_crisis

AKADEMIA
E SIGURISË

Konferencë
shkencore
ndërkombëtare:

« Fenomenet
ekstreme
të natyrës
dhe çështjet
e sigurisë »

Menaxhimi i qëndrueshëm i Alpeve dhe fenomenet ekstreme të natyrës alpine



■Inxh. MSc. Petrit IMERAJ
Komisioni i Jashtëm i Vlerësimit
Petrit.Imeraj@kjqv.al

Abstrakt

Objekti i studimit dhe i hulumtimit në këtë punim, është trajtimi i dukurisë komplekse e gjithëpërfshirëse të vetëvrasjes, nën një këndvështrim psikosocial, statistikor, historik dhe analitik për të evidentuar problematikat, faktorët nxitës, nivelin e riskut të vetëvrasjes, grupet potencialisht më të rrezikuara në shoqërinë shqiptare si dhe dhënien e rekomandimeve, për hartimin e politikave për parandalim dhe reduktim të vetëvrasjes, në shërbim të një policimi më efektiv, në raport me këtë fenomen. Në funksion të realizimit të këtij qëllimi, janë realizuar analiza të ndërthurura të shifrave dhe informacioneve të vetëvrasjeve, trendi dhe prirjet në shoqëri, duke përfshirë të dy sistemet ekonomiko-shoqërore, para dhe pas viteve 1990, me një kohështrirje për më shumë se një gjysmë shekulli, por duke u fokusuar sidomos në periudhën mes viteve 2005-2015. Përmes një analize të thellë, të integruar dhe sintetike, studimi ka për objektiv që: të bëjë një skanim të plotë të fenomenit të vetëvrasjeve në Shqipëri, duke filluar nga viti 1945; tu japë përgjigje pyetjeve rreth vetëvrasjeve në shoqërinë shqiptare; të identifikojë stigmat dhe paragjykimet shoqërore që e shoqërojnë atë, faktorët psikopatologjikë, biologjikë, socialë dhe kriminogjen që ndikojnë dhe ndikohen nga ky fenomen; metodat, përhapjen, grupmoshat më të rrezikuara si dhe masat për parandalimin e tyre. Në këtë punim janë bërë hulumtime e analiza, janë nxjerrë përfundime dhe janë dhënë rekomandime mbi punën e shërbimeve të policisë në trajtimin e rasteve të vetëvrasjeve. Gjetjet kryesore të punimit nxjerrin në pah nivelin e rrezikshmërisë dhe prirjet rritëse të vetëvrasjes në Shqipëri, faktorët dhe motivet nxitëse, grupet më të rrezikuara si dhe fakte e sfida me të cilat duhet të përballen në të ardhmen, strukturat e Policisë së Shtetit, ato të shëndetit mendor e shoqëria civile. Përfundimet, konkluzionet e gjetjet kanë ndihmuar në përcaktimin e një prognoze të përafërt dhe kanë mundësuar dhënien e rekomandimeve, mbi punën e punonjësve të policisë dhe të strukturave të tjera, në kuadër të kuptimit, informimit, ndërgjegjësimit, parandalimit dhe reduktimit të vetëvrasjes, duke diktuar edhe nevojën për hartimin e një strategjie kombëtare për parandalimin e kësaj dukurie.

Fjalëkyçe:

Alpe, menaxhim i qëndrueshëm, HEC, fenomen natyror, gjeohidrologjia, biodiversitet, ekozhvillim.

AKADEMIA
E SIGURISË

Konferencë
shkencore
ndërkombëtare:

« Fenomenet
ekstreme
të natyrës
dhe çështjet
e sigurisë »

1.Hyrje

1.1 Pozicioni gjeografik¹

Alpet Shqiptare takohen në pjesën më veriore të Shqipërisë duke paraqitur rajonin me lartësi më të madhe dhe një nga më të bukurit në vendin tonë. Në pikëpamje fiziko-gjeografike, Alpet Shqiptare në jug kufizohen nga lugina e Drinit (Fierzë-Vau i Dejës), në lindje dhe verilindje kufizohen me pellgun e Tropojës dhe në perëndim ato zbresin në fushën e Mbishkodrës. Në veri vazhdojnë jashtë territorit shqiptar, në Malin e Zi dhe Kosovë (fig.1). Alpet shtrihen me rreth 60 km gjerësi dhe 64 km gjatësi dhe zënë një sipërfaqe rreth 2020 km² (figura 1).

Figura 1: Harta e Alpeve të Shqipërisë



¹ K,Onuzi , P. Imeraj , Top tour Albanian Alps . 2005

1.2 Relievi

Alpet Shqiptare dallohen për kontraste të mëdha të relievit, luginave dhe kreshtave rrethuese alpine. Malet dhe majat më të larta janë: Jezerca 2693 m, Papluka 2569 m, Radohina 2569 m, Kollata 2555 m, Grykat e Hapura 2625.5 m etj. Lartësia mesatare e Alpeve është 1140 m, nga ku rreth 73% të relievit e zënë lartësitë 600-2000 m, ndërsa lartësitë mbi 2000 m zënë rreth 7% të sipërfaqes së përgjithshme të tyre.

1.3 Formimi gjeologjik^{2,3}

Depozitimet më të vjetra në zonën e Alpeve të Shqipërisë fillojnë me rreshtet, ranorët, konglomeratët e gëlqerorët me fuzilinide të Permianit (mosha 295 milion vjet), mbi të cilët vendosen shkëmbinjtë terrigjenë, terrigjeno-karbonatikë, gëlqerorë, silicorë radiolaritikë dhe tufet e tufitet, gëlqerorët algorë e dolomitë, gëlqerorë pllakorë me thjerza silicorësh, gëlqerorë me megalodontë, gëlqerorë stromatolitike të Triasikut (mosha 250 milion vjet)⁴.

1.4 Klima⁵

Për shkak të lartësive të mëdha, klima në Alpe është mesdhetare malore, me dimër të ashpër e të lagësht dhe me reshje të shumta shiu e bore dhe me ngrica, e me verë të freskët dhe me pak reshje. Boga me 3093 mm, Thethi me 2921 mm janë dy vendet me reshjet më të shumta.

2. Flora⁶ dhe fauna⁷

Pozicioni gjeografik dhe larmia e faktorëve gjeografikë, si shtrirja nga lartësi të ulëta, rreth 600 m e deri në lartësi të larta, mbi 2500 m, relievi mjaft i thyer, ku drejtimi i ndryshëm i shpateve malore etj., kanë krijuar habitate të larmishme për rritjen e një bimësie të zhvilluar dhe një flore shumë të pasur. Rajoni i Alpeve karakterizohet nga një larmi e madhe habitatesh natyrore, si: pyll ahu e rrobudhi, shkurreta, livadhe subalpine e alpine, shpate të thepisura gëlqerore e gropa nivale, përrenj me zallishte e çakellishtë, lumenj, shpella e gjysmëshpella, toka të lagështa e toka bujqësore etj.

Zonat bimore

Bimësia e Alpeve është e ngjashme me atë të Europës Qendrore të lartësive të mëdha, ku karakteristikë janë pyjet malore të ahut (*Fagetum silvaticae*) dhe të rrobullit (*Pinetum heldreichii*), të cilat mbulojnë më shumë se një të tretën e sipërfaqes. Studimet kanë treguar se në këtë rajon (Bjeshkët e Namuna) takohen mbi 40 tipa të ndryshëm të komuniteteve bimore. Bimësia përgjithësisht është e vendosur në breza ose zona vertikale.

² Plani i manxhimit "arku Natyrore Bashkiak " Nikaj – Merture" GOPA

³ Toska Z " Studime komplekse gjeologo rievuese e kerkuese per sqarimin e e perspektives se boksideve ne zonën e Alpeve te Shkodres (Kelmend-Dukagjin) per vitet 1981 - 1983

⁴ Nopcsa F- " Geologie und geographie Nordalbanien". Vol. III Budapest 1929. 25. Noëack E- " Geologische Übersicht van Albanien " Salsburg 1929

⁵ KRUTAJ F., Gruda GJ., Kabo M., Meçaj N., Qiriaz P., Sala S., Ziu F., Kristo V. & TROJANI V., 1991 Gjeografia Fizike e Shqiperise, 21-67

⁶ Paparisto, K., Demiri, M., Mitrushi, I., Qosja, Xh, Vangjeli, J. 1992 - Flora e Shqiperise 2 Tirane.

⁷ Corbet G. & OVENDEN D., 1980. gëtarët e Britanisë dhe Evropës, 253 f. Corbet G., OVENDEN D., 1985. Guida dei Mammiferi d'Europa. Edizione Prima

Zona e dushkut shtrihet në lartësi 500-800 m mbi nivelin e detit dhe paraqitet mjaft e degraduar.

Zona e ahut shtrihet nga 700 m deri në lartësinë 1900 m mbi nivelin e detit.

Zona e kullotave alpine shtrihet mbi zonën e ahut deri në lartësinë 2300-2400 m mbi nivelin e Detit (figura 3).

2.1 Diversiteti i lartë i florës dhe faunës

Larmia e madhe e habitateve natyrore dhe faktorët klimatikë, relievi i thyer alpin, dominimi i gëlqerorëve dhe hidrografia alpine-karstike etj., kanë krijuar kushte mjaft të përshtatshme që të rritet një florë mjaft e pasur dhe me shumë endemizma.




Figura 3: Harta e bimësisë të Bjeshkëve të Namuna

Në zonën e Alpeve rriten rreth 1700 lloje bimësh, që përbëjnë më shumë se një të tretën e llojeve bimore të vendit tonë. Nga këto rreth 120 lloje janë endemike ballkanike, ndërsa të paktën 50 lloje janë subendemike dhe endemike ose specie të rralla për Alpet dhe florën e Shqipërisë. Lloje endemike janë:

Ēulfenia baldacii, *Crepis bertschea*, *Ligusticum albanicum*, *Lilium albanicum*, *Lunaria telekiana*, *Petasites doerflerii*, *Ranunculushayekii*, *Viola kosaninii*, *Pedicularis ernesti-mayerii* etj. Elementët floristikë të Europës Qendrore dominojnë florën e Bjeshkëve të Namuna, por elementë të rëndësishëm janë gjithashtu edhe ata arktiko-alpin dhe mesdhetarë⁸. Të rëndësishme për florën e kësaj zone, krahas pranisë së llojeve endemike, janë edhe llojet relikte, kryesisht të Terciarit dhe Kuaternarit. Rreth 70 lloje bimësh të kësaj zone janë me shkallë kërcënimi të ndryshme (të rrezikuara për zhdukje, të rralla, të prekshme etj.). Shumë e pasur është dhe flora e bimëve mjekësore. Studimet tregojnë se në territorin e Alpeve të Shqipërisë rriten mbi 300 lloje bimësh me vlera mjekësore dhe aromatike. Rreth 70 lloje të tilla përdoren nga

⁸ Grup autorësh, 1997 Libri i kuq (Bime, shoqërimi bimore, kafshësh të rrezikuara) Tiranë.

banorët, ndërsa tregtohen mbi 100 lloje.

2.2 Fauna e pasur⁹

Alpet e Shqipërisë si një ndër krahinat më madhështore të vendit tonë, ofrojnë habitate të ndryshme natyrore dhe ekologjike, në të cilat diversiteti biologjik (floristik dhe faunistik) është relativisht i lartë. Diversiteti i lartë biologjik para së gjithash i dedikohet veprimit të faktorëve favorizues, kryesisht të karakterit ekologjiko-geografik.

2.2.1 *Entomofauna*¹⁰ e Alpeve të Shqipërisë është pak e studiuar. Sigurisht që ka një shpërndarje të gjerë të insekteve në të gjithë zonën. Mendohet se rriten rreth 5000 lloje insektesh, prej të cilëve rreth 50 lloje janë endemike.

2.2.2 *Amfibët*¹¹ më të zakonshëm janë salamandra (*Salamandra salamandra*), e cila gjendet në vende me lagështirë të lartë, tritoni i Alpeve (*Triturus alpestris*), ndërsa lloji i rrallë është salamandra e zezë (*Salamandra atra*) dhe bretkosa greke (*Rana graeca*), endemike e Ballkanit etj.

2.2.3 *Zvarranikët*¹² janë më të shumtë se amfibët. Si lloje më të zakonshme përmendim breshkën e zakonshme (*Testudo hermanni*), kokzogëza (*Anguis fragilis*), zhapiu i gjelbër (*Lacerta viridis*), etj., nepërka e malit (*Vipera berus*), që gjendet në lartësi mbi 1200 m deri në 3000 m, të dyja janë endemike të Mesdheut. Lloji endemik i Beshkëve të Namuna është hardhuca (*Dinarolacerta mosorensis*), gjetur vitet e fundit.

2.2.4 *Shpendët*¹³ e pyllit ose shpendët që lidhen me pyllin. Në sipërfaqet pyjore të Alpeve të Shqipërisë, gjenden 40 lloje shpendësh të pyllit. Nga këto, 28 lloje janë të përhershme, ose qëndrojnë gjatë gjithë vitit në vendin tonë, 7 lloje janë veruese, 2 lloje dimëruese dhe 3 lloje kalimtarë. Këto tregojnë se pyjet e Alpeve kanë kryesisht specie të përhershme. Lloje të rralla janë *Tetrao urogalis*, *Hieraetus pennatu*, *Gyps fulvus*, *Aquila heliacea* etj.

2.2.5 Gjitarët¹⁴: 5 insektivorë (*Insectivora*), 6 brejtës (*Rodentia*), 9 lakuriq nate (*Chiroptera*), 11 mishngrënës (*Carnivora*), 3 dythundrakë (*Artiodactyla*) dhe 1 leporid (*Lagomorpha*). Nga gjitarët më të rëndësishëm përmendim: ariun, rrëqebullin, dhinë e egër, kaprollin, macen e egër, derrin e egër, ujkun, zardafin, lepurin, dhelprën, vjerdullën etj.

3. Hidrografia e alpeve, si rrezik natyror

Alpet e Shqipërisë dallohen për një rrjet hidrografik shumë të zhvilluar. Ai përfaqësohet nga lumenjtë e Shalës, Valbonës, Cemit, Vermoshit, Nikaj-Mërturit, Kirit dhe dhjetëra përrrenjve e burimeve të lidhura ose jo me këta lumenj (tabela 1), të cilët janë pjesë në pellgun ujëmbledhës të lumit Drin (dhe Bunë), përveç lumit Cem, që

⁹ Misja K. 1998 Libri i Kuq i faunës Shqiptare. 62 faqe.

¹⁰ 6-N. Rakaj, 1995. Iktiofauna e Shqipërisë. Tiranë.

¹¹ 5-Autorë të Ndryshëm, 1965-1980. Ergebnisse der Albanien-Expedition 1961 des deutschen Entomologischen, Odonata, Coleoptera.

¹² 7-I. Haxhiu, 1998. Reptilia e Shqipërisë: përbërja specie, shpërndarjes, habitate. Bonn, Zool. Beitr.

¹³ P. Imeraj, Thethi National Park .viti 2000. P. Imeraj, M. Rakaj, Dh. Dhora, Lugina e Perroit Thate

¹⁴ SMAJLAJ, RR. 1999 TE dhëna sistematike bioekologjike për Gjitarët e Malësisë së Madhe. Disertacion, 122 faqe.

është pjesë e pellgut ujëmbledhës të Liqenit të Shkodrës dhe lumit të Vermoshit, që është pjesë e pellgut ujëmbledhës të Danubit.

Luginat lumore më të rëndësishme të Alpeve të Shqipërisë janë: lugina e Valbonës, Thethit, Shalës, Cemit, Vermoshit, Nikaj-Mërturit etj. Të gjitha këto lugina karakterizohen nga pasuritë mëdha natyrore, ujore, nga bimësia e zhvilluar, flora dhe fauna të pasura, bukuria mahnitëse të peizazhit alpin, uji i kristaltë i lumenjve dhe ajri i freskët i bjeshkëve¹⁵.

Lugina e Valbonës

Lugina e Valbonës është një nga luginat më të bukura të Alpeve Shqiptare. Ajo shtrihet në qendër të Alpeve lindore. Lugina e Valbonës është *park kombëtar*, kategori e dytë prej viti 1996, me një sipërfaqe prej 8000 ha. Në pjesën veriore të Luginës së Valbonës shtrihet Lugina e Gashit, e cila gëzon statusin *Rezervat strikt natyror, kategoria e parë*, prej vitit 1996, me një sipërfaqe prej 3000 ha¹⁶. Valbona është një qendër shumë e rëndësishme turistike.

Nr	Emërtimi i pellgut	Madhësia e sipërfaqeve S(km ²)
1	Pellgu i lumit të Vermoshit	93.32
2	Pellgu i lumit të Cemit	225.6
3	Pellgu i Përroit të Thatë	241.2
4	Pellgu i lumit Kir	260.87
5	Pellgu i lumit të Shalës	268.7
6	Pellgu i lumit të Currajve	154.37
7	Pellgu i lumit të Valbonës	650.0
8	Pellgu i Seferçës	24.0
9	Shuma e pellgjeve	1894 km ²

(Tabela 1: Pellgjet ujëmbledhës të lumenjve të Alpeve)

Lugina e Shalës¹⁷

Pjesa më e sipërme e luginës quhet lugina e Thethit, ndërsa pjesa më jugore quhet lugina e Shoshit. Ujërat e lumit janë përdorur për ujë të pijshëm, për kafshët, për ujitjen e kulturave bujqësore, për energji elektrike dhe për peshkim. Qendrat kryesore të banimit janë Breglumi, Thethi, Ndërlësë, Abat, Lekaj, Gimaj, Nica, Pecaj, Nënnavriq, Vuksanaj, Lotaj në luginën e Shalës dhe Ndreaj, Brashtë, Palaj, Guri i Lekës etj., në luginën e Shoshit, në pjesën më jugore të luginës së Shalës. Thethi është një qendër shumë e rëndësishme turistike. Thethi është *park kombëtar, kategoria e dytë*, prej vitit 1966, me një sipërfaqe prej 2630 ha.

Lugina e Cemit

Lugina e Cemit shtrihet në pjesën më perëndimore të Alpeve ose Bjeshkëve të Namuna, në kufi me Malin e Zi. Lugina sot është nga më të populluarat në Bjeshkët e Namuna. Qendrat kryesore të banimit janë: Tamara, Selca, Vukli, Nikçi, Broja, Gropa e Selcës etj.

Lugina e Nikaj-Mërturit¹⁸

Lugina e Nikaj-Mërturit shtrihet në juglindje të luginës së Valbonës, duke u kufizuar

¹⁵ SMAJLAJ, RR. 1999 TE dhëna sistematike bioekologjike për Gjitarët e Malësisë së Madhe. Disertacion, 122 faqe.

¹⁶ K, Onuzi, P. Imeraj, Top tour Albanian Alps. 2005

¹⁷ Toska Z " Studime komplekse gjeologjike rëndësore e kerkuese per sqarimin e perspektives se boksidesve ne zonen e Alpeve te Shkodres (Kelmend - Dukagjin) per vitet 1981 - 198

¹⁸ Plani i manxhimit "arku Natyrore Bashkiak " Nikaj - Merture " GOPA

me luginën e Shalës dhe të Shoshit në perëndim dhe lumin e Drinit në jug. Gjatë rrjedhjes kalon nga fshatrat Mulaj, Bëtoshë dhe Shëngjergj, kurse nga e djathta merr degën më të rëndësishme, lumin e Nikajt me gjatësi 10 km.

4. Diversiteti natyror¹⁹

4.1 Gjeodiversiteti i Alpeve²⁰

Luginat e lumenjve të Bjeshkëve të Namuna karakterizohen nga një gjeodiversitet dhe biodiversitet i lartë. Ata lumenj karakterizohen nga rrjedhje të vrullshme dhe të rrëmbyeshme gjatë periudhës së reshjeve. Kjo rrjedhje ka skalitur shkëmbinjtë, gurët dhe tokën duke krijuar forma të larmishme të relievit, si kanione, ujëvara, kone, pragje, tarraca, cirqe, shpella, guva dhe galeri të ndryshme. Ndër kanionet më të thellë dhe më të bukur, përmendim kanionin e lumit Cem, që është dhe kanioni më i thellë në Shqipëri, rreth 500 m i thellë; kanionin e Grunasit (Theth) mbi lumin e Thethit, kanionin e Shoshanit mbi lumin Valbonë, ndërsa ndër ujëvarat më të larta dhe më të bukura, përmendim ujëvarën e Thethit pranë lumit Thethit, ujëvarën e Sllapit në pellgun e lumit Cem të Selcës, ujëvarën e Rragamit, pranë burimeve të Valbonës etj. Një nga konet më të bukura është Koni i Përroit të Breshtës në Grabom, rreth 30 m i lartë etj. Shumë prej këtyre formave gjeomorfologjike të luginave, kanioneve, shkëmbinjve e lumenjve janë shpallur *monumente natyrore*, ashtu si edhe disa shumë drurë të vjetër, të rrallë dhe karakteristikë të kësaj zone.

4.2 Ndikimi i biodiversitetit në parandalimin e rreziqeve

Pellgjet dhe luginat e lumenjve alpinë të Bjeshkëve të Namuna karakterizohen nga një diversitet i lartë ekologjik, i shprehur me një shumëllojshmëri peizazhesh, habitatesh, pyjesh, shkurretash dhe kullotash, si edhe nga një diversitet i lartë biologjik, me një florë dhe faunë të pasur dhe me shumë endemizma. Në territorin e Bjeshkëve të Namuna rriten mbi 1600 specie bimësh ose afërsisht gjysma e specieve bimore të Florës së Shqipërisë^{21,22,23}. Rreth 200 specie janë endemike ballkanike, subendemike, përfshirë edhe disa specie endemike të Shqipërisë²⁴, si *Wulfenia baldacii*, *Crepis bertschea*, *Ligusticum albanicum*, *Lilium albanicum*, *Lunaria telekiana*, *Petasites doerflerii*, *Ranunculus hayekii*, *Viola kosaninii*, *Pedicularis ernesti-mayerii* etj. Edhe fauna e luginave të lumenjve është mjaft e pasur²⁵. Në territorin e Bjeshkëve të Namuna jetojnë në mënyrë të përhershme ose të përkohshme rreth 6000 specie kafshësh, përfshirë insektet (rreth 4000 specie). Por natyrisht që, më të rëndësishëm janë gjitarët e mëdhenj^{26, 27} (ariu, rrëqebulli, dhia e egër, kaprolli, macja e egër, derri i egër, ujku, zardafi, lepuri, dhelpira, vjedulla etj.), shpendët, peshqit (troftat), amfibët (tritonët, bretkosat) dhe zvarranikët (gjarpërinjtë).

Larmia e peizazheve, habitateve, bimësia e zhvilluar, përfshirë pyjet e ahut, të rrobullit, të bredhit, të hormoqit (Valbonë), dhe karakterizimi nga një florë dhe faunë

AKADEMIA
E SIGURISË

Konferencë
shkencore
ndërkombëtare:

« Fenomenet
ekstreme
të natyrës
dhe çështjet
e sigurisë »

¹⁹ 11. Gaëlik H, Lein H (Austri), Vukaj S. Sedimentologjia e Alpeve Shqiptare të Shkodrës. Vitet 2004- 2006. Instituti i Kerkimeve gjeologjike Tirane.

²⁰ 13. Onuzi K, Vukaj S. Ndertimi gjeologjik i planshetave të Shkodrës, Reçit (shkallë 1 : 25000). Viti 2007. Instituti i Gjeologjisë Tirane

²¹ Demiri, M. 1983 - Flora Eskursioniste e Shqiperise.

²² Paparisto, K., Demiri, M., Mitrushi, I., Qosja, Xh. 1988 - Flora e Shqiperise 1 Tirane.

²³ Vangjeli, J., Ruci, B., Mullaj, A. 1994 - Libri i Kuq: Bimet e kercenuarae te rralla te Shqiperise.

²⁴ 6) autorësh Grup, 1997 Libri i kuq (Bime, shoqërime bimore ,kafshësh te rrezikuara) Tiranë.

e pasur, kanë bërë që shumica e Alpeve të Shqipërisë ose e Bjeshkëve të Namuna të shpallet *zonë e mbrojtur* e kategorizuar në tre nivele:

- *Rezervat strikt natyror, kategoria e parë*, lumi i Gashit, sipërfaqja 3000 ha;
- *Park kombëtar, kategoria e dytë*, Theth, sipërfaqe 2630 ha dhe lugina e Valbonës sipërfaqe 8000 ha;
- *Park rajonal natyror, lugina e Nikaj-Mërturit*.

Nisur nga diversiteti i lartë biologjik dhe në kuadër të ruajtjes së habitateve, florës dhe faunës së egër, në “Listat e tipeve të habitateve natyrore, bimëve, kafshëve dhe shpendëve me interes për Komunitetin Europian”, në përputhje me *Direktivën e habitateve (92/43 CEE) Natura 2000* dhe *Direktivën e shpendëve (2009/147/EC)*, të miratuara nga qeveria shqiptare për Shqipërinë (ligji nr. 9587, datë 20.7.2006), për Bjeshkët e Namuna përfshihen 19 tipe habitatesh, 12 specie bimësh, 43 specie kafshësh (pa shpendë) dhe rreth 60 specie shpendësh. Shumica e atyre kafshëve strehohen, ushqehen dhe ngrenë fole përgjatë luginave të lumenjve²⁸. Bimë tipike e kanioneve të lumenjve është *Ramonadserbica* specie endemike e Ballkanit, me areal kryesorë në Shqipëri (Cem, Lumi i Shalës, Curraj, Kir etj.).

4.3 Fauna ujore e lumenjve

Lumenjtë e Bjeshkëve të Namuna strehojnë një numër të konsiderueshëm speciesh endemike peshqish, kryesisht trofta. Rreth 12 specie peshqish të kërcënuar të Shqipërisë jetojnë në lumenjtë e Bjeshkëve të Namuna, prej të cilëve 10 janë endemikë të Pellgut të Drinit ose të Liqenit të Shkodrës. Në lumenjtë e Bjeshkëve të Namuna si edhe në ujërat përreth (Lumi Drin etj.) jetojnë 6 specie dhe disa subspecie troftash, si: Trofta e malit (*Salmo trutta fario*) Trofta e Drinit (*Salmo farioides*) Trofta e gjucës (*S. dentex*) Trofta e mermertë, (*S. marmoratus*) Trofta malazeze (*S. montenegrinus*) Trofta buzëbutë (*S. obtusirostris*).

Nga 7 speciet e troftave që jetojnë në ujërat e lumenjve dhe burimeve të Bjeshkëve të Namuna, 3 specie janë endemike të Shqipërisë dhe të Malit të Zi (*Salmo montenegrinus*, *S. obtusirostris*, *S. taleri*) dhe 2 specie janë endemike të Ballkanit Perëndimor (*Salmo farioides*, *S. dentex*).

Rreth 20% e specieve të kërcënuara të molusqeve të Shqipërisë jetojnë në lumenjtë e Bjeshkëve të Namuna, prej të cilëve rreth 9 specie (kryesisht Gastropoda) janë endemike.

Në lumenjtë e Bjeshkëve të Namuna jetojnë 12 specie të kërcënuara amfibësh dhe reptilësh prej të cilëve 8 lloje kanë habitatin kryesor në lumenjtë dhe liqenet akullnajore alpine.

4. HEC-et, mes rrezikut dhe ekozhvillimit

4.1 HEC-et

Kushdo që ka vizituar Alpet e Shqipërisë nuk ka mundësi të mos ketë paër me kuriozitet e habi rrjedhjen e lumenjve me ujë të pastër si kristali nën peisazhet e larta

²⁵ Libri i kuq i faunës Shqiptare, Tiranë 2006

²⁶ Corbet G. & OVENDEN D., 1980. gjitarët e Britanisë dhe Evropës, 253 f. Corbet G., OVENDEN D., 1985. Guida dei Mammiferi d'Europa. Edizione Prima

²⁷ 10) Krystufek B., 1991. Secolsi Slovenie (Gjitarët e Sllovenisë) Prirodoslovie Muzei Slovenie, Ljubljana 294 faqe

²⁸ 1997 - Libri i Kuq: Bime, shoqërimet bimore kafshet e rrezikuara. Tirane

shkëmbore të bjeshkëve alpine, kanionet e thella, ujëvarat mahnitëse (Theth, Valbonë), ishujt e zhavorreve, pyjet e harlisura aluvionale dhe shkëmbinjtë karstik me forma të veçanta e piktoreske. Këta lumenj, që çdo vit gjatë pranverës përmbysin peizazhin e ultësirave dhe pastaj uji shpesh fshihet dhe rrjedh nën tokë. Shumica e këtyre lumenjve, aktualisht janë në kushte të mira hidromorfologjike. Dinamika e rrjedhjes së tyre është normale, bimësia është e zhvilluar dhe fauna është e pasur. Ata strehojnë në gjirin e tyre rreth 6 trofta endemike dhe mbi 15 specie peshqish endemikë, ku një pjesë e tyre jetojnë shumicën e kohës në shpella.

Por nuk është për t'u habitur, që kjo pasuri sot është e kërcënuar. Disa projekte kanë planifikuar ndërtimin e 400 hidrocentraleve vetëm mbi lumenjtë në Malin e Zi dhe në Shqipëri, prej të cilëve, gati 30 hidrocentrale të vegjël dhe mesatarë janë planifikuar të ndërtohen mbi lumenjtë e Bjeshkëve të Namuna, pjesa shqiptare (tabela 2). Dhe aq më keq, hidrocentralet janë parashikuar të ndërtohen edhe në zonat e mbrojtura, përfshirë edhe parqet kombëtare. Për më tepër, shumica e këtyre projekteve janë shtyrë nga organizata ndërkombëtare, si Banka Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH) etj.

Besojmë se çdo njeriu, këto projekte do t'i duken një tepri, që më së paku, pasojat e tyre do të prishin ekuilibrat midis biodiversitetit dhe natyrës (lumit). Institucionet qeveritare dhe private që mbështesin këto projekte përpiqen të justifikojnë ndërtimin e hidrocentraleve me nevojën e këtyre vendeve për energji. Kjo shprehje tingëllon sikur ne jetojmë në vitet 1960.

Tabela 2. Hidrocentrale të ndërtuar në lumenjtë e Alpeve.

Nr.	Lumi (përroi)	Ndërtuar para viti 1990	Ndërtuar pas vitit 1990	Status i Mbrojtjes
1.	Gashit	-	1	Rezervat Strikt Natyror
2.	Valbonës	2	1	Park Kombëtar
3.	Shalës (Theth, Shosh)	2	7	Park Natyror (Thethi)
4.	Merturit (Curraj)	2	4	Park Natyror Rajonal
5.	Cemit (Vukël, Selcë)	3	6	??
	Total	9	18	

Në analizën tonë, na rezulton se afër 30% e hidrocentraleve të planifikuara të ndërtohen në Bjeshkët e Namuna do të ndodhen brenda zonave të mbrojtura, prej të cilave 10% brenda territorit të parqeve kombëtare (një në Valbonë) dhe brenda zonës strikte të mbrojtur (një në Lumin e Gashit) dhe 20% brenda parqeve natyrore rajonale, si Nikaj-Mërtur etj. Prandaj, jo vetëm nuk rekomandojmë ndërtimin e hidrocentraleve në lumin e Gashit, në lumin Valbonë dhe në lumin Theth, por e shohim si një veprim që nuk përfill ligjet shqiptare për zonat e mbrojtura as edhe konventat ndërkombëtare mbi biodiversitetin, zonat e mbrojtura, florën dhe faunën e egër dhe *Direktivën e habitateve dhe të shpendëve*.

4.2 Ekozhvillimi, turizmi ekologjik²⁹ si alternative për zhvillimin ekonomik

Kushdo që viziton Alpet e Shqipërisë apo Bjeshkët e Namuna do të sodisë peizazhet e mrekullueshme piktoreske të luginave të lumenjve të rrethuar nga kurrize të larta malore mbi 2000 m apo 2500 m të larta, kanionet e thella, ujëvarat, burimet, ujin e

²⁹ K. Onuzi, P. Imeraj, Top tour Albanian Alps. 2005

kristaltë që rrjedh përmes lumenjve të rrethuar nga pyje aluvionale dhe lulet shumëngjyrëshe që ushqejnë dhe strehojnë një faunë të pasur dhe të larmishme³⁰. Ne po përmendim vetëm disa prej monumenteve natyrore më të njohura të luginave të lumenjve të Bjeshkëve të Namuna. Tashmë janë të njohura 102 monumente natyrore ose 72 gjeomonumente dhe 30 biomonumente për rrethet Shkodër, Malësi e Madhe dhe Tropojë të shpallura dhe të miratuara nga qeveria shqiptare (ligji nr. 8906 datë 6.6.2002), prej të cilëve 72 ndodhen brenda territorit të Bjeshkëve të Namuna, dhe prej këtyre 48 ndodhen brenda ose përreth lumenjve Shalë, Valbonë, Cem dhe Nikaj-Mertur. Shumica e monumenteve natyrore janë burime, kanione, liqene akullnajore, shpella etj., pra takohen përgjatë lumenjve ose përreth tyre.

Lumi Theth-Shalë, ujëvara e Thethit, Burimet e Shtarzës, Burimet e Okolit/Thethit, Liqenet e Jezercës, Liqeni i Pejës, Kanioni i Grunasit, Habitatit i Salamandrës Alpine, Porta e Shalës Shpella e Majës së Arapit, Shpella e Kataraktit.

Lista e disa prej gjeomonumenteve natyrorë më kryesore

- Lumi Valbonë: Burimet e Valbonës, Burimi i Shoshanit, Burimi i Qukut të Dunishës, Burimi Karstik i Qirecit, Kanioni i Shoshanit, Liqenet akullnajore të Doberdolit, Liqenet akullnajore të Sylbicës, Liqeni i Ponarëve, Shpella e Dragobisë.

- Lumi Cem: Burimet e Koprishtit, Burim i Vuklit, Kanioni i Cemit, Ujëvara e Sllapit, Tarraca e Greçës, Koni i Përroit të Breshtës (Grabom).

Krahas pasurisë me gjeomonumente natyrore, Bjeshkët e Namuna janë shumë të pasura edhe me biomonumente. Gjithsej numërohen 30 biomonumente të miratuara për rrethet Shkodër, Malësi e Madhe dhe Tropojë, prej të cilëve 17 ndodhen në luginat e lumenjve Valbonë, Theth, Cem dhe Nikaj-Mertur.

Nga biomonumentet më kryesore, dallojmë:

Lumi Valbonë: Bredhishtja e Ragamit; Hormoqi i Valbonës; Shelgu i Rrjetëzuar; Mështekna e Lugut të Zi; Blirët në Markaj; Arra e Dragobisë; Dushkajat e Qafë-Luzhës; Rrobulli në liqenin e Ponarëve.

Lumi Theth-Shalë: Vulfenia Baldaçit në Shtegun e Dhenve; Pisha Flamur e Qafës së Pejës; Kërletka e Kakisë; Blirët në Lesniqe etj.

Me mijëra turistë kanë vizituar luginat alpine vitet e fundit. Me mijëra vizitorë kanë qëndruar me ditë dhe javë të tëra në bjeshkët dhe luginat tona alpine, si në Valbonë, Theth, Bogë, Razëm, Lëpushë e Vermosh. Kjo tregon se pasuritë dhe bukuritë alpine të bjeshkëve dhe lumenjve mund të jenë një biznes shumë i mirë. Çdo turist shpenzon mesatarisht 15-20 euro në natë për akomodim dhe 15 euro në ditë për ushqim, krahas shpenzimeve të tjera për peshkim, sporte apo dëfrim. Zonat e mbrojtura dhe veçanërisht zonat strikte të mbrojtura dhe parqet kombëtare, si Lugina e Gashit, Thethi dhe Valbona janë një trashëgimi dhe pasuri natyrore mbarëkombëtare janë një trashëgimi natyrore botërore. Parqet kombëtare janë vende të ruajtjes së pyjeve, bimëve dhe kafshëve të rralla, si dhe shërbejnë si vende rekreacioni. Përveç bukurive natyrore, klimës së freskët dhe bimësisë së harlisur, premisa të zhvillimit të turizmit ekologjik janë infrastruktura dhe afërsia e këtyre luginave me qytetet e Bajram Currit, Shkodrës, Koplikut, traditat mikpritëse të banorëve, ushqimet tradicionale ose prodhimet "bio" të miellit, bulmetit, mishit, pijeve alkoolike, troftës, etj.^{31, 32, 33, 34}

**AKADEMIA
E SIGURISË**

*Konferencë
shkencore
ndërkombëtare:*

« Fenomenet
ekstreme
të natyrës
dhe çështjet
e sigurisë »

³⁰ Vukaj S. Zaja I, Pirani M. Konferencë kombëtare për Ekosistemet Malore. Ministria e Mjedisit 4-5 Nëntor 2004

³¹ <https://www.albaniandf.org/2018/02/02/plani-kombetar-sektorial-i-turizmit-rajoni-i-alpeve-shqiptare/>

³² <https://albaniandf.org/wp-content/uploads/2018/07/1-RAPORTI-I-ANALIZES-SE-PERGJITHSHME.pdf>

³³ <https://albaniandf.org/wp-content/uploads/2018/07/4-RREGULLORE-E-PLANIT-PKST-ALPE.pdf>

³⁴ <https://albaniandf.org/wp-content/uploads/2018/07/2-STRATEGJIA-SEKTORIALE-PKST-ALPE.pdf>

5. Përfundime

Në Alpet e Shqipërisë, në përgjithësi, gjendja aktuale e habitateve janë ruajtur disi më mirë, kryesisht për shkak të aspekteve gjeografike dhe klimatike, numrit të vogël të banorëve e mjete të dobëta për jetesë, niveli i ulët i prodhimeve bujqësore, blegtorale, pylltarisë, artizanale, etj., si dhe mungesa e investimeve në infrastrukturën e parkut. Në këto vite të fundi janë bërë përpjekje nga banorët dhe prej disa bizneseve për shtimin e veprimtarive sociale-ekonomike, me theks zhvillimin e turizmit. Po kështu, përpjekje ka edhe për përmirësimin e infrastrukturës, sidomos atë rrugore, telekomunikacion, zgjerimin e qendrave të banimit dhe të shërbimeve turistike, shtim të numrit të vizitorëve, gjallërim të disa veprimtarive industriale, kryesisht të ndërtimit të HEC-ve.

Pa dyshim që këto veprimtari kanë rritur dhe ndikimin e tyre në mjedisin e parkut, të cilat përbëjnë edhe kërcënim të procesit të menaxhimit. Këto kërcënime potenciale kërkojnë vlerësim dhe një vëmendje të theksuar nga institucionet, komuniteti, biznesi, dhe institucionet e tjera përgjegjëse në nivel qendror dhe lokal, për t'u paraprirë me masa konkrete zbutëse apo dhe adaptuese, përfshi dhe ndryshimet klimatike.

5.1 Humbja e habitatit

Kërcënimet kryesore të mundshme të parashikuara janë fragmentimi dhe zhdukja e habitateve, modifikimi dhe/ose shkatërrimi i habitateve natyrore për shkak të ndërtimit të infrastrukturës, prerjeve të paligjshme, si dhe për shkak të një ndryshimi të mundshëm në prodhimin bujqësor që shkaktohet nga zgjerimi i tokës bujqësore. Prerja selektive e drurëve të hormoqit, bredhit etj., mund të ndryshojë mjedisin pyjor në mënyrë drastike. Në të gjithë territorin e parkut duhet të ndalohet prerja e pyjeve të virgjër, duhet të ndalohet prerja e drurëve në zonën qendrore dhe të bëhet menaxhim efektiv. Lejohet marrja e drurëve të zjarrit për nevojat e komunitetit në zonën e përdorimit tradicional dhe të qëndrueshëm, sipas një rregullore të veçantë që të sigurojë ruajtjen e mjedisit pyjor të rëndësishëm. Kërcënimet e përmendura më lart ndikojnë drejtpërsëdrejti në biodiversitetin, marrëdhëniet midis specieve dhe zinxhirin ushqimor natyral në ekosistem.

5.2 Erozioni i tokës, shembjet dhe rrëshqitjet

Dukuria e erozionit lidhet me modifikimin apo shkatërrimin e habitateve, veçanërisht në pjesën më malore të Alpeve. Edhe ky përbën një kërcënim për biodiversitetin. Cilësitë e ekosistemeve ujore mund të ndryshohen ndjeshëm. Kur materialet e shkaktuara nga erozioni shpëlahen nga ujërat, dhe habitatet në përgjithësi mund të ndikohen fizikisht nga erozioni që vjen nga zonat e sipërme. Prerja e paligjshme e drurëve dhe degradimi i pyjeve në zonat me shpate të larta, shoqërohen me rritje të mëtejshme të erozionit që së bashku me erozionin që ndodh natyrshëm, ndikon ndjeshëm tek habitatet. Nëse ndodh kjo, duhen shumë vite që një pyll të rigjenerohet në një mjedis të tillë të ashpër. Erozioni artificial çon në shkatërrimin dhe fragmentimin e habitateve, zhdukjen e specieve, modifikimin e bimëve dhe komuniteteve të kafshëve vendase, dhe së fundi, në ndryshimin e përhershëm të ekosistemit dhe peizazhit. Rrëshqitjet janë ndër rreziqet gjeomorfologjike që kanë sjellë dëme të mëdha ekonomike, por ajo që është më kryesore janë numri jo i vogël i viktimave njerëzore. Rrëshqitjet apo shembjet janë një rrezik natyror mjaft serioz për parkun. Rrëshqitjet e tokës, në territorin e parkut,

kanë kushteshumë të përshtatshme natyrore për formimin dhe riaktivizimin e tyre të vazhdueshëm.

Identifikimi dhe vlerësimi i kërcënimeve për biodiversitetin dhe ruajtjen e Alpeve të Shqipërisë kërkon një bashkëpunim të ngushtë me grupet e interesit, pasi është pjesë e rëndësishme e procesit të menaxhimit. Vlerësimi i situatës del si rezultat i vëzhgimeve në terren, i konsultave të organizuara me përfaqësues të administratës vendore, OJF-ve mjedisore, bizneset, privatët, etj., të cilat kanë ndikim në biodiversitet, ekosistemet, speciet, zhvillimin social, ekonomik dhe ekoturistik.

5.3 Identifikimi i kërcënimeve potenciale që duhet marrë në konsideratë

Në Alpet e Shqipërisë, në përgjithësi, habitatet janë ruajtur mirë si rrjedhojë e nivelit të ulët të prodhimeve bujqësore e blegtorale, mungesës së investimeve në infrastrukturë, të ekzistencës së një numri të vogël të banorëve, qendrave të banimit dhe të bizneseve, por edhe si rrjedhojë e lëvizjeve të mëdha demografike. Pasojat mjedisore dhe sociale të kësaj lëvizjeje vlerësohen pozitive në drejtim të zvogëlimit të trysnisë humane mbi mjedisin, gjë që solli gjallërimin e bimësisë, të cilat tani janë jashtë interesit të ekonomisë së tregut. Por, ndërkohë pasojat negative janë të shumta. Braktisja e tokës së punueshme po sjellë degradimin dhe shkrëtimin e saj me shpejtësi, po humbasin vlerat e shumta të trashëgimisë natyrore, sidomos kulturore, sepse po rëndohen qendrat e banuara, që mbartin vlerat arkitekturore, objektet arkeologjike, historike dhe vlera të trashëgimisë shpirtërore aq të pasura etj.

Krahas trashëgimisë shumë të pasur natyrore e kulturore, zonat malore kanë peizazh me bukuri të rrallë, klimë të shëndetshme, ajër e ujë të pastër, energji të shumta të rinovueshme ujore, eolike, diellore, pasuri të mëdha minerare, ujore, biologjike: biodiversitet të theksuar, pyje, bimë dekorative, mjaltëse, mjekësore etj. Të gjitha këto resurse, për shkak të mungesës së kapaciteteve humane, po mbeten jashtë vlerësimit dhe menaxhimit, duke penguar kështu zhvillimin e kësaj hapësire malore.

Ndër kërcënimet e mundshme kryesore për territorin e Alpeve të Shqipërisë janë marrë në konsideratë fragmentimi zhdukja e habitateve, modifikimi/ose shkatërrimi i habitateve natyrore, për shkak të ndërtimit të infrastrukturës, prerjet e paligjshme, mbi kullotja, zjarret, ndryshimi i mundshëm në prodhimin bujqësor, përdorimi i tokës, pyjeve, kullotave, shfrytëzimi i mbingarkuar i bimëve mjekësore dhe i burimeve të tjera natyrore, ujërave, ndërtimi i HEC-ve, ndotjet, etj. Këto kërcënime ndikojnë drejtpërsëdrejti mbi biodiversitetin, marrëdhëniet midis specieve dhe zinxhirit ushqimor.

Rreziqet natyrore si rrëshqitjet e tokës, erozioni i rrjedhjeve ujore dhe sipërfaqësore, ortekët, shembjet, zjarret, rrëzimet janë ndër rreziqet më kryesore që shoqërojnë rajonin e Alpeve, të cilët shoqërohen me kosto të mëdha mjedisore, ekonomike dhe sociale, që mbeten ende shumë shqetësuese për banorët dhe veprimtaritë e tyre ekonomike. Këto janë burim për katastrofa të mëdha natyrore.

Dukuria e erozionit e cila lidhet me modifikimin apo shkatërrimin e habitateve, pyjeve, tokës, dëmtimin e peizazhit dhe të ujërave, është një tjetër rrezik natyror gjeomorfologjik i pranishëm në pjesët më malore të Alpeve. Edhe ky përbën një kërcënim për biodiversitetin.

Cilësitë e ekosistemeve ujore mund të ndryshohen ndjeshëm, kur materialet e shkaktuara nga erozioni shpëlahen nga ujërat. Habitatet në përgjithësi mund të ndikohen fizikisht nga erozioni që vjen nga zonat e sipërme.

Prerja e paligjshme e drurëve dhe degradimi i pyjeve në zonat me shpate të larta,

**AKADEMIA
E SIGURISË**

*Konferencë
shkencore
ndërkombëtare:*

« Fenomenet
ekstreme
të natyrës
dhe çështjet
e sigurisë »

shoqërohen me rritje të mëtejshme të erozionit, që ndodh natyrshëm. Kjo dukuri ndikon ndjeshëm tek habitatet dhe speciet. Po kështu, problem mbetet edhe grumbullimi i bimëve mjekësore, prodhimet e dyta, shtimi i blegtorisë, kositja e barit, gjuetia e paligjshme e faunës së egër, përfshi dhe peshkimin.

Ndotjet, mosmenaxhimi i mbeturinave që prodhojnë vizitorët, ujërat e zeza dhe të përdorura pa u trajtuar në qendrat e banuara e të bizneseve, hedhja e shisheve plastike, qelqit, kanoçeve, etj., mendohet se do të jenë kërcënimi më serioz i sipërfaqes së alpeve në të ardhmen.

Problemi më specifik, me ndikim në mjedisin e sipërfaqes së Alpeve të Shqipërisë, është zhvillimi i vrullshëm dhe pa studime të thelluara i sektorit hidroenergetik, duke përdorur çdo pjesë të lumenjve dhe thuajse të gjitha degët e përrrenjve. Analiza e bërë në këtë drejtim u përqendruar në të dhënat e marra nga Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore (AKBN), në studimin e kryer nga WWF, si dhe në verifikimin e gjendjes aktuale të këtij procesi në terren, tregojnë se impakti i tyre në territorin e parkut është tepër i ndjeshëm dhe me pasoja të rënda për të ardhmen.

Megjithatë, kërcënim i madh pritet të jetë ndërtimi i rrugës në zonat e pambërritshme në lumin e Gashit apo në pjesët e tjera të Alpeve të Shqipërisë. Rruga paraqet rrezik potencial për pjesët unike të mbetura të pyllit të virgjër të ahut, ku një pjesë e tyre parashikohen të përfshihen në sitet e ruajtura ndërkombëtarisht nga *United Nations Educational, Scientific Cultural Organization* (UNESCO), apo të llojeve të tjerë me vlerë të lartë të biodiversitetit e peizazheve.

4.3 Veprimtari që kërcënojnë biodiversitetin dhe peizazhin dhe mund të çojnë drejt katastrofave në të ardhmen:

- të gjitha veprimet që shkaktojnë dëmtime dhe degradim të peizazhit;
- ndryshimet dhe modifikimet në përdorimin e tokës apo shfrytëzimi i nëntokës;
- shqetësimi dhe keqtrajtimi i llojeve të egra, p , rfshir , gjuetinë ilegale të tyre dhe pa kriter;
- shfrytëzimi i burimeve natyrore si nxjerrja e mineraleve dhe e gurove;
- shfrytëzimi i lumenjve, përrrenjve, burimeve ujore mbi e nëntokësore dhe të liqeneve akullnajore;
- derdhjet e pakontrolluara në kanale, lumenj, përrrenjtë, liqene, anës rrugëve e shtigjeve, në zonat pyjore e kullosore, të ujërave të zeza, të ujërave të bardha, të ndotësve të kimikateve që janë të padekompozueshme në kushte natyrore, mbetjeve ose lëndëve të tjera të rrezikshme, plasëse, të plehrave dhe pesticideve;
- ndotja, hedhja e inerteve, të mbeturinave të ngurta dhe të çdo lloj lënde tjetër, jashtë natyrës së parkut, si dhe impianti i prodhimit të inerteve në hyrjen e parkut (valbonë);
- ndërtimi i infrastrukturës, ndërtimet pa leje, rrugët, qendrat turistike, fshatrat, stanet etj.;
- ndryshimet klimatike, rreziqet natyrore, ortehtë, përmblytjet, rrëshqitjet, tërmetet, zjarret;
- turizmi i paorganizuar, zhvillimi i veprimtarive të mëdha sportive, argëtuese, çlodhëse, garat motorike të *rrellit*, etj;
- përdorimi dhe mostrajtimi i materialeve si kanoçe alumini, ambalazhe plastike, qelq, hekur, vajra lubrifikantë, pjesë elektronike, mungesa e *landfill*-ve, etj;
- humbja e vlerave tradicionale kulturore;

- zhvillimi intensiv i rajonit;

Alpet e Shqipërisë duhet të përfaqësojnë shëmbëlltyrën e rajonit, ku banorët, fermerët dhe biznesi jetojnë dhe punojnë në harmoni me njeri-tjetrin dhe me natyrën. Njëherazi, edhe për ata që dëshirojnë të vizitojnë Alpet, veçanërisht të rinjtë, që duhet të kontribuojnë për ndjeshmërinë e kujdesit për natyrën, biodiversitetin, peizazhin unik e të larmishëm, përfshirë trashëgiminë kulturore dhe shpirtërore, nëpërmjet pjesëmarrjes së tyre aktive, në nivel lokal, kombëtar dhe ndërrajonal kufitar, për bashkëjetesë, prosperitet social, ekonomik dhe ekoturistik.

Arritja e këtij vizioni të përbashkët për Alpet Shqiptare dhe Bjeshkët e Namuna mbështetet në identifikimin dhe plotësimin e disa objektivave specifike afatgjata, në përcaktimin e qartë të programeve menaxhuese. Programet duhet të paraqesin objektivat, çështjet kyçe të menaxhimit, masat, veprimet e zhvillimit dhe procesin e monitorimit, i cili kryhet nëpërmjet përdorimit të treguesve për të monitoruar arritjen e objektivave në menaxhimin e Alpeve të Shqipërisë.

Në kontekst të parandalimit të rreziqeve, dhe për t'i shërbyer sigurisë, mendojmë se duhen prioritetet dhe programet e qarta menaxhuese siç janë:

1. Përmirësimi i sistemit të menaxhimit të zonave malore, nëpërmjet forcimit të kapaciteteve dhe të konservimit të tipave të habitateve, biodiversitetit dhe të peizazhit. Të sigurohet që sistemi i menaxhimit të Alpeve të Shqipërisë kryhet brenda standardeve të caktuara në planet e menaxhimit dhe zbatohet në mënyrë sa më korrekte, duke përfshirë në këtë proces pjesëmarrjen e të gjitha grupeve lokale të interesit, për të kontribuar në një menaxhim efektiv të qëndrueshëm të burimeve të zonës, nëpërmjet ruajtjes së një ekuilibri të harmonizuar midis ruajtjes së natyrës e të peizazhit dhe zhvillimit të veprimtarive njerëzore. Përmirësimi i sistemit të menaxhimit nuk nënkupton ndalimin e shfrytëzimit të vlerave natyrore, por që përdorimi të bëhet në pajtim me konceptet e zhvillimit të qëndrueshëm të zonës.

2. Zhvillimin dhe përdorimin shumëfunksional dhe të qëndrueshëm të veprimtarive sociale, ekonomike dhe ekoturistike

Zhvillimi dhe menaxhimi efektiv i përdorimit të veprimtarive sociale dhe ekonomike jetike të popullatës e biznesit të integruar me vlerat ekoturistike dhe kulturore të rajonit, duke mundësuar bashkëjetesën me mbrojtjen e natyrës, të biodiversitetit e peizazhit, me zhvillimin e qëndrueshëm të veprimtarive njerëzore. Mundësimi i veprimtarive karakteristike, tradicionale të larmishme ekoturistike për vizitorët dhe banorët, duke nxitur pjesëmarrjen e tyre në menaxhimin e përshtatshëm për ruajtjen e burimeve natyrore, sigurimin e të ardhurave për përmirësimin e jetesës, sigurinë shëndetësore, me theks zhvillimin e ekoturizmit natyror, kulturor dhe shpirtëror.

3. Nxitjen e kërkimit shkencor-arsimimor të promovimit, bashkëkomunikimit, edukimit dhe ndërgjegjësimit. Territori i parkut ka tipare të shumta burimore të ruajtura që paraqesin objekte mjaftë interesante për hulumtime shkencore, për njohjen e ligjshmërive të zhvillimit të natyrës. Këtu para së gjithash vlen për thellimin e kërkimit shkencor, të arsimimit si dhe të faktit të njohurive jo të plota në këtë fushë. Njëherazi, paraqet një vend mjaftë të përshtatshëm për aktivitetet konkretizuese të promovimit.

Kushtetuta shqiptare ka për qëllim të garantojë "...Një mjedis të shëndetshëm dhe ekologjikisht të përshtatshëm për brezat e tashëm dhe të ardhshëm; shfrytëzim racional të pyjeve, ujërave, kullotave burimeve të tjera natyrore mbi bazën e parimit të zhvillimit

**AKADEMIA
E SIGURISË**

*Konferencë
shkencore
ndërkombëtare:*

**« Fenomenet
ekstreme
të natyrës
dhe çështjet
e sigurisë »**

të qendrueshëm”.

Kjo garanci kushtetuese justifikon përpjekjet për të menaxhuar Alpet duke shmangur kështu katastrofa të mëdha natyrore, njëkohësisht Alpet si rajon ndërkufitarë, janë një zonë me rëndësi për vendin dhe sigurinë kombëtare.

Bibliografia

1. K, Onuzi, P.Imeraj, Top tour Albanian Alps . 2005
2. Harta e Alpeve të Shqipërisë
3. Blloku i Jezercës
4. Plani i manxhimit “arku Natyrore Bashkiak “ Nikaj – Merture” GOPA
5. Toska Z “ Studime komplekse gjeologjike rievuesë e kerkuesë për sqarimin e e perspektives se boksidesve ne zonen e Alpeve te Shkodres (Kelmend -Dukagjin) per vitet 1981 -1983
6. Nopcsa F- “ Geologie und geographie Nordalbanien”. Vol. III Budapest 1929. 25. Noëack E- “ Geologische Übersicht van Albanien “ Salsburg 1929
7. KRUTAJ F., Gruda GJ., Kabo M., Meçaj N., Qiriazi P., Sala S., Ziu F., Kristo V. & TROJANI V., 1991 Gjeografia Fizike e Shqiperise, 21-67
8. Paparisto, K., Demiri, M., Mitrushi, I., Qosja, Xh, Vangjeli, J. 1992 - Flora e Shqiperise 2 Tirane.
9. Corbet G. & OVENDEN D., 1980.gjitarët e Britanisë dhe Evropës, 253 f. Corbet G., OVENDEN D., 1985. Guida dei Mammiferi d'Europa. Edizione Prima
10. Harta e bimësisë të Bjeshkëve të Namuna
11. Grup autorësh, 1997 Libri i kuq (Bime, shoqërime bimore ,kafshësh te rrezikuara) Tiranë.
12. Liliun albanicum
13. Misja K. 1998 Libri i Kuq i faunës Shqiptare. 62 faqe.
14. 6-N. Rakaj, 1995.Iktiofauna e Shqiperise.Tiranë.
15. 5-Autorë te Ndryshem, 1965-1980. Ergebnisse der Albanien-Expedition 1961 des deutschen Entomologischen, Odonata, Coleoptera.
16. 7-I. Haxhiu, 1998. Reptilia e Shqipërisë: përbërja specie, shpërndarjes, habitate. Bonn, Zool. Beitr.
17. P.Imeraj, Thethi National Park .viti 2000. P.Imeraj, M.Rakaj, Dh.Dhora, Lugina e Perroit Thate.
18. SMAJLAJ, RR. 1999 TE dhëna sistematike bioekologjike për Gjitarët e Malësisë së Madhe.Disertacion, 122 faqe.
19. Salamandra Atra (slamendra e zeze).
20. SMAJLAJ, RR. 1999 TE dhëna sistematike bioekologjike për Gjitarët e Malësisë së Madhe.Disertacion, 122 faqe.
21. K,Onuzi, P.Imeraj, Top tour Albanian Alps . 2005
22. Toska Z “ Studime komplekse gjeologjike rievuesë e kerkuesë për sqarimin e e perspektives se boksidesve ne zonen e Alpeve te Shkodres (Kelmend -Dukagjin) per vitet 1981 -1983
23. 1- Ujëvara e Thethit (Lumi Shale
24. Plani i manxhimit “arku Natyrore Bashkiak “ Nikaj – Merture” GOPA
25. 11. Gaëlik H, Lein H (Austri), Vukaj S. Sedimentologjia e Alpeve Shqiptare te Shkodres. Vitet 2004- 2006. Instituti i Kerkimeve gjeologjike Tirane.
26. 13. Onuzi K, Vukaj S.Ndertimi gjeologjik i planshetave te Shkodres, Reçit (shkalle 1 : 25000). Viti 2007. Instituti I Gjeologjise Tirane
27. Demiri, M. 1983 - Flora Eskursioniste e Shqiperise.
28. Paparisto, K., Demiri, M., Mitrushi, I., Qosja, Xh. 1988 - Flora e Shqiperise 1 Tirane.
29. Vangjeli, J., Ruci, B., Mullaj, A. 1994 - Libri i Kuq: Bimet e kercenuarae te rralla te Shqiperise.
30. 6) autorësh Grup, 1997 Libri i kuq (Bime, shoqërime bimore ,kafshësh te rrezikuara) Tiranë.
31. Libri i kuq i faunës Shqiptare, Tiranë 2006
32. Corbet G. & OVENDEN D., 1980.gjitarët e Britanisë dhe Evropës, 253 f. Corbet G., OVENDEN D., 1985. Guida dei Mammiferi d'Europa. Edizione Prima
33. 10) Krystufek B., 1991 Secolsi Slovenie (Gjitarët e Sillovenisë) Prirodoslavie Muzei Slovenie, Ljubliana 294 faqe
34. 1997 - Libri i Kuq: Bime, shoqërimet bimore kafshet e rrezikuara. Tirane
35. K,Onuzi, P.Imeraj, Top tour Albanian Alps . 2005
36. Vukaj S. Zaja I, Pirani M. Konferencë kombetare per Ekosistemet Malore. Ministria e Mjedisit 4-5 Nentor 2004
37. Liqen akullnajore Jezerce
38. <https://www.albaniandf.org/2018/02/02/plani-kombetar-sektorial-i-turizmit-rajoni-i-alpeve-shqiptare/>
39. <https://albaniandf.org/wp-content/uploads/2018/07/1-RAPORTI-I-ANALIZES-SE-PERGJITHSHME.pdf>
40. <https://albaniandf.org/wp-content/uploads/2018/07/4-RREGULLORE-E-PLANIT-PKST-ALPE.pdf>
41. <https://albaniandf.org/wp-content/uploads/2018/07/2-STRATEGJIA-SEKTORIALE-PKST-ALPE.pdf>



AKADEMIA E SIGURISË

*Konferencë
shkencore
ndërkombëtare:*

**« Fenomenet
ekstreme
të natyrës
dhe çështjet
e sigurisë »**

Academy of Security

Sixth International Scientific Conference

Extreme phenomena of Nature and Security issues

31 May, 2021
Tirana, Albania

**AKADEMIA
E SIGURISË**

*Konferencë
shkencore
ndërkombëtare:*

« Fenomenet
ekstreme
të natyrës
dhe çështjet
e sigurisë »

222

ABSTRACTS

"POLICIMI DHE SIGURIA", NR. 23, MAY, 2021

**AKADEMIA
E SIGURISË**

*Konferencë
shkencore
ndërkombëtare:*

**« Fenomenet
ekstreme
të natyrës
dhe çështjet
e sigurisë »**

FLOODS IN ALBANIA – AN EXTREMELY THREATENING SAFETY FACTOR

PROF. ASOC. PHD ZAHO GOLEMI

ABSTRACT

Floods are hydrological phenomena that can cause catastrophic economic, social and ecological damages. The consequences can be so devastating up to the point that it can threaten the national security of the countries. The tech giant, Google mentions the word “flood” about 96 million times, which is a very high value compared with any other terms. Unfortunately, it is not just the term that carries such a threat to the safety of humanity and communities around the planet. A reflection on floods captures a very wide spectrum when perceived correctly and given the importance it requires. Governments, military and specialists of specific fields are included in a “group” where they have to find solutions and share their insights how handle floods is the best way possible. Floods have been among the first challenges that humanity has had to face along with other natural phenomena. Personalities, kings, princes, philosophers, scientists, and leaders who even equated themselves with the Gods have tried to “discipline” the floods throughout history only to find out that the fury and rage of a flood is not preventable. Not even dams, walls, fortresses and objects of great calibre built back then could help. In the last century, mankind seems to have found solutions to minimize the damages by the floods. Many countries that are located in flood prone areas, always stay in high alert and have found short-term, medium-term and long-term solutions. Ironically, there are places that have created artificial rivers and lakes where they did not exist trying to compete with nature, just as there are places that nature has defeated with the outbreaks of a “water war”. Following on the footsteps of regional and European countries, Albania is facing the floods with better solutions. As stated on the “World Risk Report” of the United Nations, Albania ranked as the 1st place in Europe for exposure to natural disasters during 2019, and 61st in the world for exposure to floods and earthquakes (UNDRR). Floods are one of the main phenomena which remains as a high priority for every level of central or local government, and especially the scientific community. They constantly work to find ways, and means to minimize the damages of floods thanks to legislative initiatives, policies, strategies, and strong budget support. Civil emergency structures, the State Police, and the Military are often found in the vortex of this “water war”. The countries are constantly working towards preventive policies and relief strategies related to this problem. The focus of “Floods in Albania - an extreme threatening safety factor” will be to shed more light and insights on the extreme natural phenomenon of floods and their impact.

PLANNING AND MANAGEMENT OF NATURAL DISASTERS IN THE REPUBLIC OF KOSOVO

MSC. DAUT ZENELI
PHD BAJRAM IBRAJ

ABSTRACT

Like the entire Western Balkans, Kosovo is a country that is at high risk of natural disasters. Natural disasters have already become a worrying phenomenon where recent decades have had significant consequences and damage. As a result of the occurrence of these natural disasters, the community in Kosovo has been affected and damaged, bringing consequences for business and the economy, the state, but

also for individuals, families and the respective communities and society. Among the natural disasters that threaten Kosovo the most are: earthquakes, due to the fact that Kosovo lies in a seismic area with a very high tectonic activity where in the past we have faced natural disasters from material damage to loss of human lives; floods, because in our country there are many rivers which after heavy rains they come out of their beds and reach situations when certain areas are flooded near the flow of those rivers. As a result of these floods we have had a lot of damage and often people's lives are endangered; Avalanches are a very threatening natural disaster for Kosovo, especially for the southern part of the country. From these natural phenomena in the past, in addition to damage, we have also lost human lives. Laws, policies, strategies, programs and action plans have been drafted in the Republic of Kosovo for the management and coping with natural disasters, but much remains to be done in terms of implementing the best practices of developed European countries with the purpose of planning and Better involvement of all public and private actors in order to make full use of other private resources and capacities and special profiles of vital importance, especially in those areas where the needs of the state are more evident.

In this work, we will discuss and analyze the environment where the civil emergencies are present in Kosovo, effective policies and legislation in the field of civil emergency planning and emergency management caused by natural disasters and provide conclusions and recommendations regarding the management of civil emergencies and the protection of the population from damage and their consequences.

ENVIRONMENTAL SAFETY AMONG THE CHALLENGE AND POSSIBILITY OF ARCHITECTURAL DESIGN

PHD SILVANA SUKAJ

ABSTRACT

The necessity of environmental safety is documented in the history of architecture so much that it can be traced back to the roots of the arguments why, how and where we should build. From the early typology of castles to today's modern constructions, architecture creates uninterrupted harmonious connections with environmental and human safety. What connects architects with natural disasters? Disasters are happening with more frequency and intensity and it is the responsibility of architects to protect the health, safety and well-being of the community. Architects can take on essential roles after a natural disaster such as fires, earthquakes or floods. They are often called upon to assess damage and provide planning, assistance with the design and reconstruction of homes, businesses and communities. Throughout history people have asked to control their natural environment. In modern times, the creation of new cities and the expansion of existing large cities, the further industrialization of the workforce, have led to an increased interest in environmental safety by placing it at the forefront. Many concepts collide and many opportunities are created in the relationship between architectural design and the environment safety, and obviously the violation of these relationships can go as far as what is known today as environmental crime through architectural design. This paper offer a process of relations between construction and the environment starts from the stage of recognition, study and design until its full realization. If the requirements are met in an optimally harmonious way, a fair and always stable relationship is created between the environment and people. Otherwise antagonistic relationships are inevitable.

AKADEMIA E SIGURISË

*Konferencë
shkencore
ndërkombëtare:*

« Fenomenet
ekstreme
të natyrës
dhe çështjet
e sigurisë »

Safety should be treated as a design challenge from the beginning of the process, while the right solution as an opportunity for society to harmonize with nature.

NATURAL DISASTERS AND OTHER DISASTERS, ESTIMATES FOR PROTECTION AGAINST DISASTERS

PHD ENVER GËRGURI

ABSTRACT

In order to protect the life and health of people, animals, property and material goods from natural and other disasters, states organize protection mechanisms respectively institutions (police, army, medical services, fire and rescue services, governmental and non-governmental organizations) , various associations etc.

But not in all cases of natural and other disasters these mechanisms can arrive in time at the site of the disaster, so it is of great importance if citizens will make the announcement of the types of disasters, how they strike, the consequences and measures to be taken to establish the defense.

Based on what was said, I have set myself the task of in this scientific paper to make a summary of some of the natural and technological disasters which can strike us at any moment and instructions on how the population should behave in three main stages:

- Before the accident
- During the disaster and
- After the accident

I am aware that I will not be able to summarize all the disasters that may occur nor do I think I will be able to offer all the necessary advice in case we face these emergencies but I hope that no matter how little I have managed to offer basic knowledge needed to deal successfully with these situations. I would also be happy if I could contribute with this paper to raising public awareness of the need to conduct an organized campaign of institutions on the importance of education in disaster prevention measures and ways to deal with them.

CIVIL PROTECTION AND THE JOURNEY TOWARDS MEMBERSHIP IN THE EUROPEAN CIVIL PROTECTION MECHANISM (UCPM)

MSC. VALBONA LIKAJ

MSC. FATJONA XHAFERI

ABSTRACT

This paper was conceived given the significant increase in the number of natural and man-made disasters in recent years and the growing awareness that future disasters will be more extreme, more complex and with long-term consequences, as a result of climate change, vulnerability, exposure and potential interaction between some natural and technological hazards. In these circumstances, an integrated approach to disaster management is increasingly important. Good governance, including proper laws, regulations, defined responsibilities, cooperation and review of issues, is essential to manage disaster risk, a priority of the Sendai Framework. Each country should consider its approach to disaster risk reduction, tailored to its context and therefore, it is important to establish clear roles and responsibilities for all stakeholders from national to local level, all harmonized in an effective and comprehensive legal framework. Each country is expected to create a national platform for the disaster

risk reduction coordination mechanism and to designate a ministry or agency as the focal point for disaster risk reduction.

SCIENTIFIC ANALYSIS ON THE PRECIPITATION OF JANUARY 2021 AND THE FLOODS OBSERVED IN ALBANIA

PROFF. PETRIT ZORBA, PHD ELVIN ÇOMO, MSC GAZMIR ÇELA

ABSTRACT

Based on the use of information from the National Meteorological Monitoring System, satellite sources and European professional platforms with which our institution cooperates and has the exclusivity to use their products, the rainfall situation of January 2021 was assessed for our country, which was accompanied by flooding in different areas of the country. In accordance with OBM standards, various rain fall indicators, their intensities and distribution in space and time for January 2021 for the territory of Albania have been analyzed. The use of GIS and other professionals of two are enabled a further deepening in the study not only on the character of the observed precipitation, the ratio of rainfall to snowfall, but also the impacts followed by climate change and human activity in recent years. In this material is made an analysis of common and special features of floods in recent years for the factors causing them. Preparation and timely distribution of forecast meteorological and hydrological estimates by IGEWE has been an aid in the work of civil emergency infrastructure, local and central government in managing the situation, thus minimizing the negative consequences.

ANALYSIS OF HYDROLOGICAL AND METEOROLOGICAL CONDITIONS, IN THE ISSUANCE OF FLOOD ALARM, BY THE NATIONAL CENTER FOR FORECASTING AND MONITORING OF NATURAL HAZARDS IN ALBANIA

PHD. ENTELA VAKO, MSC KLODIAN ZAIMI, MSC ELONA ABAZI, MSC ANIRA GJONI

ABSTRACT

This paper provides an analysis of hydrological and meteorological conditions that characterize a river basin in a given period which are crucial in the development of the phenomenon of flooding. Their analysis as well as the follow-up of standard working procedures by the forecaster of the National Center for Forecasting and Monitoring of Natural Hazards is very important before the flood alarm is given. Knowledge of the hydrology of the river basin as well as the history of floods along with physical characteristics such as the shape of the basin, altitude, topography, etc. affect the quality of the alarm. The main meteorological parameters in the development of the flood phenomenon are precipitation and temperature. The intensity of precipitation, their duration and distribution over the catchment area determine the possibility of flooding. Also, other factors such as relative humidity, wind, etc. affect the development of floods. The combination of these parameters is the basis of the European Model of flood forecasting which informs a few days in advance about the amount of rainfall that is expected to fall in a given territory, as well as the trend and probability in % for river floods, floods or landslides. soils. On this basis, the work of the forecaster is supported to give the alarm through the Bulletin of Natural Hazards. However, obtaining this information from the model in any case would be an overestimation or underestimation of the situation if the specifics of river basin dynamics along with

**AKADEMIA
E SIGURISË**

*Konferencë
shkencore
ndërkombëtare:*

**« Fenomenet
ekstreme
të natyrës
dhe çështjet
e sigurisë »**

urban development or river basin management problems are not known.

EXTREME METEOROLOGICAL PHENOMENA, ORIGIN, FORECAST AND IMPACTS ON LIFE, ECONOMY AND NATIONAL SECURITY

PROFF. PETRIT ZORBA, PHD ALBANA HASIMI, MSC. ELSUIDA HOXHA

ABSTRACT

Knowledge with the nature of creation and the types of possible meteorological phenomena in the conditions of climate and its changes in Albania in the historical context, but also spatial and temporal context nowadays are treated without neglecting the influence of the use of new technologies applied on weather modification. Phenomena of intense rainfall, hail, snow, floods, forest fires, heat waves, storms, droughts, etc., have increased in recent years in Albania. A set of natural and unnatural factors in the intertwining or modulation of the severity of a certain meteorological phenomenon have often followed situations with many consequences for economic activity, or even the loss of human lives. Special attention is paid to the correlation of meteorological phenomena with other extreme phenomena, which at first sight are not related, but then the negative consequences increase further. The preparation and timely dissemination of meteorological information and forecasting to the institutions responsible for civil emergencies or national security is of paramount importance for minimizing the consequences of extreme weather events. In the context of national security, some thoughts and orientations are given on how to improve the work in the medium and long term to minimize as much as possible the impacts from such extreme weather phenomena in the future.

NATO IN DISASTER RELIEF OPERATIONS.

PHD (C) GJON VORFI

ABSTRACT

Natural disasters are happening more often and are becoming more and more devastating. Following this trend, the North Atlantic Alliance-NATO has increased the importance of engaging its forces in international assistance, in the event of natural disasters. As a result of this commitment, there have been reactions from critics, who have expressed doubts as to: whether disaster relief operations are a suitable area of activity for the Alliance. The purpose of this article is not to expend on the Alliance's broader activities, but to point out that the involvement of NATO forces in disaster relief operations is in line with the Alliance's founding principles. A review of the literature, based on a case study, shows that NATO involvement in non - military operations such as humanitarian assistance in the event of a disaster is important and appropriate. Although there are still areas for improvement, it is an added value but, above all it is effective. To illustrate the arguments of this paper, we have taken the concrete example of the engagement of NATO forces in 2005, following a major earthquake in Pakistan. Following a request for assistance from the Government of Pakistan (via the United Nations), the Alliance immediately dispatched the NATO Reaction Force (NRF), which successfully engaged all logistical and human resources in a Large-scale humanitarian Operation.

SUSTAINABLE ALPINE MANAGEMENT, EXTREME PHENOMENA OF ALPINE NATURE

MSC PETRIT IMERAJ

ABSTRACT

The Albanian Alps are situated in the northern part of Albania, representing the region with the highest altitude and one of the most beautiful in our country. From a physical-geographical point of view, the Albanian Alps in the south are bordered by the Drini valley (Fierzë-Vau i Dejës), in the east and northeast they are bordered by the Tropoja basin and in the west they descend to the Mbi-Shkodra plain. In the north they continue outside the Albanian territory, in Montenegro and Kosovo (see Figure below). The Albanian Alps are distinguished by great contrasts of the surrounding alpine relief, valleys and ridges. The geographical position and the variety of geographical factors, such as the extension from low altitudes, about 600 m to high altitudes, over 2500 m, quite rugged relief, different orientation of mountain slopes, etc., have created diverse habitats for the growth of a developed vegetation and a very rich flora. The Alpine region is characterized by a great variety of natural habitats, such as: beech and rhubarb forests, shrubs, subalpine and alpine meadows, steep limestone slopes and level pits, gravel streams, rivers, caves and semi-caves, land moisture of the soil.

**AKADEMIA
E SIGURISË**

*Konferencë
shkencore
ndërkombëtare:*

**« Fenomenet
ekstreme
të natyrës
dhe çështjet
e sigurisë »**

**AKADEMIA
E SIGURISË**

*Konferencë
shkencore
ndërkombëtare:*

« Fenomenet
ekstreme
të natyrës
dhe çështjet
e sigurisë »